

---


---

# Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti III (XVII) - Nr. 7 (160) ISSN: 2305-655X

---

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJI | PSIKOLOGJI | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMËDIARE



NUMRI  
ISSUE

7

2014

**Botues:**  
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

# Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI III (XVII) 2014 NR. 7 (160)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,  
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

[www.zaninalte.al](http://www.zaninalte.al)

Tiranë 2014

Revistë shkencore dhe kulturore

## Zani i Naltë

Organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

*Themeluar në tetor 1923*

*Rifilluar në tetor 2012* VITI III (XVII), prill, maj, qershor 2014, nr. 7 (160)

**Nën kujdesin:** Dok. Skender Bruçaj

**Kryeredaktor & Drejtor:** Dok. Genti Kruja

**Bordi editorial:** Dok. Klodian Shehi  
M.A. Ali Zaimi  
Dr. Ferdinand Gjana  
Prof. Dr. Qazim Qazimi  
Prof. Dr. Ayhan Tekines  
Prof. Dr. Njazi Kazazi  
Prof. Dr. Hajri Shehu

**Redaktor:** M.A. Andrin Rasha

**Fushat:** Shkencat Islame  
Tefsir  
Hadith  
Fikh  
Sociologji  
Filozofi  
Gjuhësi  
Letërsi  
Psikologji  
Histori  
Kulturë  
Art, etj.

**Realizimi grafik:** Bledar Xama

Shpëtim Bashmili

**Fotoja në kopertinë:** Xhamia e Iljaz Bej Mirahorit, Korçë

**Adresa:** KMSH, Rr. George W. Bush, Nr. 50,  
Tiranë - Shqipëri

**Mail:** e-mail: [info@zaninalte.al](mailto:info@zaninalte.al)

**Web:** [www.zaninalte.al](http://www.zaninalte.al)

## Përmbajtja

### Shkenca Islame

1. Çka është Islami  
- **H. Ali Kraja**.....5
2. Adhurimi në jetën e Profetit Muhamed (a.s.)  
- **M.A. Elton Karaj, Universiteti Bedër, Tiranë**.....16
3. Mesazhi Islam  
- **Muhammed Teufik Ahmed, Egjipt**.....23

### Studime

4. Toleranca dhe mirëkuptimi ndërjetar si dimension i historisë kombëtare të shqiptarëve  
- **Prof. Dr. Ferit Duka, Universiteti European i Tiranës**.....31
5. Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi 1937-1941 dhe roli i Bashkësisë Fetare Islame në pengimin e saj  
- **Qerim Lita - Shkup**.....38

### Sociologji-Filozofi

6. Filozofia e medreseve në sistemin arsimor të Shqipërisë  
- **Dok. Genti Kruja, Drejtor i Kulturës - KMSH**.....53

### Shkenca Komunikimi

7. Komunikimi përmes objekteve të kultit Islam në Shqipëri  
- **Msc. Ferit Lika, KMSH**.....64

### Shkenca Politike

8. A pajtohet Islami me demokracinë?  
- **M.S. Fatos A. Koplaku - Ann Arbor, Miçigan, SHBA**.....71

### Histori

9. Luftërat Ballkanike, Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia në Vitet e Fundit të Perandorisë Osmane  
- **Myzejen Myftari, Tiranë**.....80

10. Pozita kushtetuese e Kosovës në Federatën Jugosllave gjatë viteve 1946-1974  
(vështrim historik)

- **M.A. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës.....86**

11. Përhapja e besimit mysliman në rrethin e Pukës ndër vite (1523-1990)

- **Gëzim Kopani - Myfti i rrethit Pukë, KMSH.....100**

### **Përkthime**

12. Karakteristikat e stilit kryesor të literaturës boshnjake të shkruar me shkrimin arab

- **Dr. Munir Mujić, Bosnjë.....103**

### **Personalitete**

13. Vehbi Agolli (Dibra) teolog dhe veprimtar i shquar për pavarësi kombëtare

- **Dr. Mojs Kamberi, Durrës.....107**

### **Retrospektivë**

14. Tefsiri i sure-i Ihlasit

- **H. Ali Korça.....113**

15. Vargje nga **Sheh Ahmed Shkodra.....116**

### **Abstracts**

16. Abstracts in English.....118

17. Rregullat e shkrimit.....124



## Çka është Islami H. Ali Kraja

### Abstrakt

*Është e vërtetë se Besimi Islam nuk është një besim i ri, por është i amshueshëm. Njerëzit mund ta pranojnë ose hedhin, ai Besim mbetet gjithmonë i vërtetë, por duhet ditur se pranimi i besimit njerëzisë i sjell dobi. Besimi Islam nuk humbi kurrë, por sikur shkencat që prej padijenisë së njerëzve humbin vlerën nganjëherë, ashtu edhe Besimi Islam humbi vlerën e tij. Le të thotë kush çka të dojë, çka të dëshirojë ëndja e tyre, por Zoti është një Krijues i kujdesshëm i gjithçkaje. Mubamedi (a.s.) nuk e shpiku, por e kumtoi dhe e fuqizoi këtë të Vërtetë me të gjitha detajet shkencore, morale dhe praktike, me qëllim që njerëzimi të ketë dobi prej saj. Ai, burimet shkencore të besimit që kishin nisur të thahen, edhe një herë i njomi. Me predikimet e Mubamedit (a.s.) filloi një fazë e re e evolucionit të Besimit... Për këtë arsye, Besimi Islam u lëshoi vend të merituar ndërgjegjes, arsyes dhe nevojave të jetës dhe gjallërimit duke u deklaruar prapë në anën tjetër, se në esencë është një, dhe i bashkuar me besimet e tjera qiellore.*

*Ja ky është besimi që mësoi e porositi Mubamedi (a.s.), Besim ky i amshueshëm.*

Ajo dituri, pa kurrfarë lajthitje, ato urdhra e porosi të pakundërshtueshme, të cilat më i Madhi i gjithë njerëzisë që mban në mend historia, i dalluari ndër të gjithë pejgamberët, Muhamedi (a.s.), që e mësoi dhe e vuri në praktikë, përmblihet në fjalën Islam. Ky besim, për të cilin i Madhi Zot tha në Kurandin e Shenjtë: “Ky Besim, Besimi Islam është Imi”, u mboll në kokë dhe në zemër të njerëzve se si adhurohet një Zot i Vetëm, dhe se si duhet njeriu t’i bindet ligjeve të Tijja Hyjnore, nëse ata dëshirojnë ta gjejnë lumturinë e të dy botëve.

Si thotë vetë ky Besim dhe si e cek Kurani Famëlartë në shumë vende,

Besimi Islam më së pari nuk filloi vetëm me Muhamedin (a.s.). Ky besim përtëriti dhe këndelli shpirtin e vërtetë besimtar, shpirt ky që do ta përfshinte jo një komb a komunitet, por mbarë njerëzimin, mbarë botën, se Zoti në Kurandin e Tij e kujton me këto fjalë të dashurin e Vet, Muhamedin (a.s.): “O ti Muhamed, o i mbrami i gjithë Pejgamberëve, ato që po t’i porosis nën emrin Besim, nuk janë gjë tjetër përveç asaj që e porosita Nuhin, Ibrahimin, Musain dhe Isain. O ju popuj, ruajuni e mos krijoni ndasi në çështje të Besimit”. Pra, Muhamedi (a.s.) e tha atë çka e thanë pejgamberët që erdhën para tij: “Zoti është Një e i pa shok”.

Me të vërtetë, koncepti i Besimit ose është shprehje e një gjëje të njëmendtë e të saktë ose të një sendi të rrejshëm. Nëse Besimi do të ishte pjellë e ndonjë bindjeje të rrejshme, natyrisht se në përpjesëtim të shumë hyjnive do të kishim shumë besime pa ngjashmëri dhe unitet mes veti.

Por, kur Besimi na paraqitet si një ligj i vërtetë, atëherë shprehja e tij është pozitive sado që kohërat e kaluara dikudiku kanë mundur të lindin besime të rrejshme.

Besimet qiellore të vërteta, edhe pse në detaje kanë pësuar disa ndryshime, të cilat janë më tepër fryt i ndryshimeve kohore ose hapësinore, ato prapëseprapë në themel kanë mbetur të ngjashme, d.m.th. nuk kanë qenë aspak në kundërshtim njëra me tjetrën, (Zoti i Madh dërgoi Resulin e Vet ta predikojë rrugën e drejtë dhe besimin e vërtetë, Kurani). Muhamedi (a.s.) s'bëri gjë tjetër por këndëlli, ringjalli dhe tërhoqi kah origjinaliteti i humbur atë Besim të vërtetë të cilin e kishin predikuar profetët para tij. E ringjalli në trajtën më të shëndoshë, duke stolisur shkencën me argumente e duke ia futur atij Besimi një shpirt gjithmonë të pavdekshëm, nën fuqinë e të cilit i tërë rruzulli do të shkonte drejt shtigjeve të një përparimi, të një qytetërimi të pashoq.

Ky është besimi i vërtetë në Zotin, besim ky që ishte gati të flakët në zemrat e popujve të ndërkryer dhe të mohitur, po të mos vinte ky shpëtimtar i gjithë njerëzimit (Muhamedi a.s.) që e ndezi edhe një herë dritën e flakadanit të besimit.

Megjithëkëtë, disa deshën ta interpretojnë në mënyrë të shtrembëruar këtë zhvillim, duke

tentuar ta mohojnë madhërinë e besimit të Muhamedit (a.s.). Nën ndikimin e shpikjeve dhe invencioneve të kohës, e të prirë gjithnjë kah një përparim, disa thonë se Muhamedi (a.s.) nuk ka qenë peygamber por një gjeni i cili prej shumë besimeve e ka krijuar besimin e vet. Prandaj, besimi i tij nuk është besim i ri. Ndoshta ky mendim ka lindur nga të kujtuarit se profeti duhet ta ketë një pjesë të hyjnisë (Uluhiyet) dhe si ai duhet të jetë një ligdhënës i besimit. Kjo është një teori shumë e gabuar, sepse Besimi nuk është shpikje e njeriut dhe se askush s'ka shpikur dhe krijuar besim, veçse peygamberët kanë komunikuar atë për të cilën kanë qenë të urdhëruar. Invencionit i shumë mendimtarëve nuk është tjetër gjë veçse një vizion i shpikjeve (kesh) i cili nuk e ka humbur vlerën dhe mundimin e atyre që kanë shpikur më përpara. Fjala vjen, ata që e kanë zbuluar rrumbullakësinë e tokës e kanë gjithmonë nderin e meritën e tyre, sepse mbi këtë zbulim mandej shumë dijetarë mbështetën teorinë e tyre shkencore. U gjet fuqia elektrike e cila më vonë hyri në punë. Por, çfarë do të jetë vlera e atyre që këtë fuqi e përdorën ndaj shpikësit të parë?

Është e vërtetë se Besimi Islam nuk është një besim i ri, por është i amshueshëm. Njerëzit mund ta pranojnë ose hedhin, ai Besim mbetet gjithmonë i vërtetë, por duhet ditur se pranimi i besimit njerëzisë i sjell dobi. Besimi Islam nuk humbi kurrë, por sikur shkencat që prej padijenisë së njerëzve humbin vlerën nganjëherë, ashtu edhe Besimi Islam humbi vlerën e tij. Le të thotë kush çka të dojë, çka të dëshirojë ëndja e tyre, por Zoti është një Krijues i kujdesshëm i gjithçkaje. Muhamedi

(a.s.) nuk e shpiku, por e kumtoi dhe e fuqizoi këtë të Vërtetë me të gjitha detajet shkencore, morale dhe praktike, me qëllim që njerëzimi të ketë dobi prej saj. Ai, burimet shkencore të besimit që kishin nisur të thahen, edhe një herë i njomi. Me predikimet e Muhamedit (a.s.) filloi një fazë e re e evolucionit të Besimit. Fjala vjen, seksionet konike në gjeometri mbetën të paharruara me mijëra vjet në rrafshin teorik, pa dalë në lëmin e praktikës. Atëherë kur Besimi kishte humbur pothuaj edhe formën e tij teorike u shfaq përnjëherë në fushë të teorisë dhe praktikës sikur shumë të vërteta shkencore. Për këtë arsye, Besimi Islam u lëshoi vend të merituar ndërgjegjes, arsyes dhe nevojave të jetës dhe gjallërimit duke u deklaruar prapë në anën tjetër, se në esencë është një, dhe i bashkuar me besimet e tjera qiellore.

Ja ky është besimi që mësoi e porositi Muhamedi (a.s.), Besim ky i amshueshëm.

### Islami dhe Fanatizmi

Më parë të kuptojmë njëherë se çka do të thotë fjala Islam.

Fjala Islam në fjalorin religjioz ka kuptimin e bindjes, bindje ndaj një të vërtete, në Hyjni. Bindja ndaj tjetërkujt përveç ndaj Zotit dhe ndaj të vërtetës është në kundërshtim me fjalën e me shpirtin Islam, sepse t'i bindet njeriu një të vërtete të shtrembër, është një kundërshtim ndaj të vërtetës, ndaj Hyjnisë. Për këtë flet Kurani në shumë vende. Andaj, çdo mysliman, sipas besimit të tij, do t'i përulet atyre gjërave që janë të vërteta para Zotit dhe do të jetë gjithnjë në përpjekje bashkë me ata njerëz që janë në udhë të drejtë, në udhë

të Perëndisë e do t'i luftojë ata që janë të dhënë pas epshit e pas punëve të këqija.

Një ndërgjegje e formuar kësisoj mund ta quajmë një adhurim i së vërtetës. Ai që është i bindur se Zoti është një e vërtetë, po themi ai, nuk i gjykon gjërat sipas pikëpamjes së vet, por atyre u jep vlerën e merituar sipas pikëpamjes hyjnore, kështu që, atij mandej, i vjen turp t'i mohojë gjërat të cilat kanë atë vlerë.

Në zemrat ku është rrënjosur dashuria për të vërtetën, aty nuk ka vend për fanatizëm. Zoti në Kuranin e Vet thotë: “Zoti Mëshirëplotë dërgoi Profetin e Vet ta predikojë rrugën e drejtë e Besimin e vërtetë”. “O ju që u besoni librave të shenjta, pse e përzieni të drejtën me të shtrembrën, e mohoni të drejtën duke ditur mirëfilli se cila është”. “O ju besimtarë, mos e teproni në besimin tuaj, veçse ta ndiqni të vërtetën”. “Besimtarë! Në Besim mos e teproni e mos thoni tjetër mbi Perëndinë, veç të drejtën”.

Me këto urdhra e porosi, Kurani i vërtetë ka përbuzur teprimin në fanatizëm, dhe treguar se vetëm në të drejtën duhet ngulur këmbë. Feja Islame, të mirën (hajrin) e gjen vetëm në njohje dhe në adhurim të së drejtës; aty ku nuk qëndron e drejta nuk kundërmon asnjë e mirë, feja Islame këtë e konsideron si një dëm. Ja, prej këtyre shpjegimeve kuptohet se fanatizmi nuk pajtohet me Islamin.

### Islami dhe Ateizmi

Shtylla e parë e Besimit Islam është: Principi i lartë i të besuarit në Zot dhe adhurimi i të vetmit Zot, të pastër nga çdo send.

Çdo mysliman më parë se çdo gjë

beson se “Gjithësia është vepër e një Krijuesi”. Qeniet e gjalla kanë një Krijues të Vetëm, një Hartues i pagabueshëm i tyre. të gjitha cilësitë e plota gjenden në Të, dhe është i zhveshur prej çdo cilësie të mangët. Në asnjë vend, as në Njësi, as në cilësi e as në veprime, Ai nuk ka shok a shëmbëlltyrë. Njeriu kurrë nuk arrin ta njohë realitetin hyjnor të Tij. Vullneti i Tij është një ligj absolut mbi krejt gjithësinë. Ai çdo send e ka vënë nën një shkak dhe përbërja e çdo gjëje është rruzulluar me një ligj. Njeriu, për të siguruar kënaqësinë e vet, duhet patjetër, t’i nënshtrohet ligjeve të Tij Hyjnorë. Ky është Zoti i vërtetë, të cilin e cilëson dhe e sqaron feja Islame. Në anën tjetër, ta shqyrtojmë edhe vlerën dhe natyrën e kundërshtimeve që i parashtrajnë mohuesit për të. Zoti i Madh, duke përmendur kundërshtimet e mohuesve të Tij, në Kuranin e Vet të Shenjtë, thotë: “Kanë thënë se ajo që neve na paraqet nuk është gjë tjetër veçse koha dhe natyra. Ata që kështu thonë, mos kujtoni se mbështeten në dituri. Këto nuk janë fjalë diturie veç fryt iluzionesh”.

Po, njëmend, njerëzit e diturisë që kanë gjykuar me gjakftohtësi, të gjitha kanë dëshmuar Qenien e një të Vetmit Zot; gjithnjë edhe dëshmojnë duke ditur se detyra kryesore e shkencave është: sqarimi i çdo problemi. Negacioni a mohimi nuk kanë asgjë të bëjnë me shkencë, pos një kundërshtimi, nuk kanë tjetër dobi.

Në çdo problem shkencor, një pozitiv është më i fuqishëm se njëmijë negativa, për arsye se negacioni nuk ka bazë, andaj nuk ka as vlerë: sikurse kur themi  $0 \times 0$  janë 0. Po ta kishim zhvilluar një problem në matematikë, përfundimi

do të ishte po ky. Po të shtegtoni nëpër botë dhe të pyesni, do të ndeshemi me miliona njerëz që nuk dinë, fjala vjen, se planeti Jupiter i ka satelitët e tij sikur Hëna dhe se ata satelitë kanë eklipsin e tyre. Këta miliona njerëz, para një astronomi, kanë vlerën e zeros.

Shih për këtë, njerëzit me vlerë të zeros, mohues të së Vërtetës, në njërën anë, i lexojnë veprat e dijetarëve, por, në anën tjetër, ata nuk janë në gjendje të kuptojnë shpirtin e atyre leximeve. Ata vazhdojnë në udhën e tyre të mohimit, sepse të vërtetat shkencore nuk u shkojnë për shtat.

Pa i njohur kushtet e silogjizmës, ata krijojnë mija silogjizma. Të qenit e gjykojnë për mosqenie. Nuk i shohin apo s’duan t’i shohin argumentet e së vërtetës. Ata thonë se pasi ka Zot, pse ky nuk flet me ne? Pse nuk na tregon një shenjë të qenies së Tij? Ky lloj njerëzish, i cili shtrembëron të vërtetën, është ai që as erën nuk ia ka ndjerë diturisë, e që në trup të vet nuk e ka atë zemër të thjeshtë, nëpër të cilën mund të depërtojnë rrezet e saj. Shfaqja e ideve të diturisë që janë prej dritave shpirtërore varet nga kapaciteti i veçantë i një sekretit shpirtëror që quhet zemër, e kjo nuk është e njëjtë te të gjithë njerëzit. Ka shumë njerëz, që kapaciteti shkencor i tyre nuk mund ta kuptojë mekanizmin e dukshëm të lëvizjeve kolektive. Ata flasin për dituri, por nuk e njohin ekzistencën e diturive, ideve, mendjes dhe intelektit. Prej kësaj kuptohet vlera e gjykimeve të këtyre njerëzve mbi ligjet e shkencave dhe intelektit, kur nuk kanë dijeni ta japin një gjykim as mbi të thjeshtin trup. Prej një peshku nuk lind një kaproll e prej një hunde nuk formohet një sy ose bebe e syrit. Po ky ligj i njëjtë shohim

se sundon në fushën shpirtërore, po edhe në perceptimin e ndryshëm mes organizmave të gjalla. Pa dyshim, ndryshimet që shihen në ndjenja, në vullnet e në kuptimet e njerëzve lindin nga ndryshimi i shpirttrave. Ka shpirttra e zemra që arrijnë ta kuptojnë të vërtetën shumë shpejt, prej një coincidence më të vogël zbulojnë një ligj të madh, por ka edhe njerëz që rrokullisen nëpër fushat e eksperiencës së mijëra ndodhive, dhe aspak nuk binden dhe s'marrin mësim prej tyre për ta formuar një ide të saktë. Për ata një gjë është e fiksuar: Dyshimi e mohimi, sepse zemrat i kanë të prishura e organet e kuptimit të shkatërruara. Gjërat nuk mund të bëhen të qarta kur shikohen me syze me xham të thyer. Kështu edhe përmes një zemre të keqe nuk mund të vrojtohet e vërteta. Andaj, të parit nuk është e njëjtë me të shikuarit. Njerëzit e diturisë, me vite të tëra mundohen që mos ta humbin edhe shkëndijën më të vogël të së vërtetës, kurse ata që nuk janë të pajisur me dituri, kapërcejnë përmbi mijëra të vërteta, pa kuptuar asgjë prej tyre, duke llogaritur për zotësi arritjen e qëllimeve epushore. Në librin e vet të quajtur "Mylehas", filozofi Fahrudin Razi dhe filozofi Thabit ibni Kurra, tregojnë për zbritjen e trupave (rënia e lirë) duke shpjeguar ligjin e tërheqjes, kurse dijetarët e asaj kohe që këtë lëvizje ia mbathnin një teorie tjetër, nuk donin ta pranojnë këtë tezë dhe bënë një kundërshtim. Por, ç'sollti kundërshtimi i tyre? asgjë! Del një ditë Njutoni, i cili përmes rënies së një guri shpjegon në mënyrë të qartë ligjin e rënies. Këtu na shfaqet një pikë e rëndësishme: Duhet çmuar fakti se Njutoni këtë ligj nuk e zbuloi me teleskop, por me një fuqi që

quhet Gjenerali. Pas Njutonit u shpikën sa e sa teleskopë të mëdhenj, por asnjë astronom nuk tentojë që me këto teleskopë ta gjejë ligjin e tërheqjes.. u morën me kërkime në fushën e lëvizjeve e të veprave, të cilat Zoti Fuqplotë i rregullon me këtë ligj. Ata e dinin se shumë pak mund të shohin në këtë gjithësi me sytë e tyre të ballit! Askush nuk e kërkon arsyetimin (mendjen) e vetëdijen (shu'ur) me teleskop apo mikroskop. Ata që mohojnë thërmijat që nuk duken me teleskop, më parë mohojnë arsyen e tyre. Atomet, eteret (ethir, arabisht) e fuqia elektrike nuk shihen me sy. Deri më sot nuk ka dalë ndonjë dijetar i cili me teleskop në dorë do të orvatet ta gjejë mendjen dhe fuqinë tërheqëse. Kështu pra, asnjë njeri me mend në kokë, nuk është parë ta kërkojë Zotin me teleskop, dhe duke mos e gjetur, ta mohojë Atë. Dijetarët e dinë se të kërkuarit e Perëndisë është baras me misterin e krijimit të trupave e të qiellit prej një thërmie çfarë është atomi.

Misteri i lëvizjes së gjithësisë mund të zbulohet pak a shumë, prej misterit të lëvizjes së një atomi. Në natyrë, ku mbretëron ligji i baraspeshës së fuqive (muvazene-i kuvet) sipas pikëpamjeve të shkencës nuk duhet të ekzistonte asnjë lëvizje dhe në gjithësi duhet të mbretëronte një qetësi. Po të ishte ashtu, gjithësia do të ishte ende sot në formën e atomeve të energjisë (made) dhe nuk do të formohej asnjë materie ose trup. Është fenomen i madh shkencor krijimi i një atomi ose vënia e tij në veprim dhe me fuqinë e tij të shkaktohet lëvizja e atomeve të tjera.

Nëse është, sipas shkencës, lëvizja e atomeve e përhershme, atëherë të

përherëshme janë edhe baraspeshat (muvażene) e tyre; dhe po të ishin baraspeshat e përherëshme, atëherë nuk do të krijohesh asgjë prej tyre. Atëherë nuk do të formoheshin trupat, nuk do t'u vinte rendi lëvizjeve të përbashkëta mekanike, të lidhura me lëvizjet e atomeve, nuk do të ndodhesh asnjë incident, dhe jeta nuk do të ishte e vijueshme. Ndaj, prej kësaj rrjedh që materialistët e natyralistët, të cilët duan ta zhvillojnë çdo lëmshe sipas teorive të tyre, qysh prej kohëve të lashta greke e deri më sot, nuk kanë bërë tjetër gjë pos kanë thënë se pa qenë shkak ndonjë fuqi e jashtme, një atom nuk mund të lëvizë. E kjo lëvizje pastaj ka prishur baraspeshën dhe në këtë mënyrë, ligjet e natyrës janë shpartalluar, ligje këto që ata i mbështesin. Erdhi një ditë kur, shkencë në dorë të tyre bëri një ankesë, sepse ata kapërcyen çdo kufi që e kishte caktuar po ajo shkencë. Ata nuk qenë të zotët kurrsesi t'i vërtetojnë tezat e tyre pa rrënuar teoritë shkencore. Atij grupi dijetarësh iu gërthitën shkencat me ulërima të mëdha: "Na lini në cakun tonë e mos të kapërcëjmë më tej".

Ata që dëgjuan ulërimat e shkencave në këtë mënyrë nuk vonuan dhe e vënë natyrën nën pushtetin e Krijuesit. Filozofi klasik Aristotel, e mandej, filozofi i mëvonshëm Dekarti, shkencave ua kthyen edhe një herë dinjitetin e humbur.

Ta zhvillojmë më tepër këtë pikë: Disa që kanë dashur t'i shpjegojnë të gjitha veprimet e rruzullimit nëpërmjet lëvizjeve, kanë parë se mjafton teoria mekanike. Por, edhe këtë duhet ta dimë se, nuk do të thotë të mohohet Zoti, i Cili është fillimi i parë, kur mendon dikush se lëvizjet rruzullore

rregullohen sipas lëvizjeve mekanike. Ndoshta përkundrazi nëpërmjet teorisë mekanike dalin në shesh argumentet më të forta për Qenien Hyjnore. Për arsye se mekanika, sipas fjalorit filozofik, shpjegon këtë fenomen sikur që ndodh në çdo makinë, përmes ndikimit të një fuqie lëvizëse (kuvet-i-muharriket) që zbatohet për së jashtmi sipas ligjit të plogështisë (Ligji II i termodinamikës). H. Moris thotë se me këtë ligj shpjegohet fillimi i përgjithshëm i jetës sepse pa të bota do të ishte e vdekur (vër. M. G). Andaj, ai që mendon për rruzullimin mbi baza të mekanikës dhe i studion lëvizjet aktuale, ato të së nesërme, apo të kaluarat nëpër vargun e tyre të saktë, pa dyshim, do ta pohojë Qenien e një Pushteti lëvistar, që ka qenë e do të jetë përgjithmonë dhe do ta dallojë këtë pushtet në kolektivitetin e atyre ndodhive. Po të mos mendojë kështu, nuk e ka zbatuar teorinë e mekanikës që ka të bëjë me dy ligjet e termodinamikës; me këtë rrëzohet vetë procesi i ligjeve të përmendura, dhe kjo duket si një prerje e degës në të cilën është ulur njeriu. Andaj, filozofi Dekart, i cili është ithtar i teorisë mekanike të lëvizjeve, nuk ka dyshuar në ekzistimin e Qenies Hyjnore, si shtytës i makinës së rruzullimit, duke pretenduar se nuk mund të vërtetohet asgjë pa u vërtetuar njëherit Qenia Hyjnore. Po të shqyrtohet historia e filozofisë, nga kjo pikëpamje shohim se mekanika shërben ta lëvizë makinën e rruzullimit nga ana e një force të jashtme në një mënyrë të logjikshme. Kuptimi i tillë i këtyre proceseve është i obligueshëm. Me ndihmë e përkrahje të shkencës sillen rrotat dhe veglat e një makine. Këtu na paraqitet nevoja e kuptimit të ekzistimit të një Force (Pushteti) e cila mban

strukë në vetvete misteret e fshehta (Almursi velhafa), pushtet ky që i vë në lëvizje të gjithë trupat, përmirëson e përsërit pra “makinen e rruzullimit”. Do të ishte injorancë qesharake po të mos kuptohej një gjë e tillë. Shpjegimet që dhamë deri këtu mjaftojnë si argumente se me anën e teorisë së mekanikës vërtetohet se ekziston një forcë shtytëse në “makinerinë e rruzullimit të trupave” (Kudret-i-muharriket). Duke u përpjekur ta imitojnë Zakonin e Kuranit të Shenjtë, këtë të vërtetë po e argumentojmë edhe me shpjegimin e kësaj teorie në njeriun, si pjesa më e shtrenjtë e këtij rruzullimi. Për ta marrë njeriun si objekt, në teorinë e mekanikës, ekziston një problem, i cili duhet të jetë i pranishëm te njeriu dhe kafshët. Po t’i mendojmë objektet e qarkullimeve dhe të kompetencave të shkencave pozitive aktuale, shohim se në krye të tyre është njeriu më i thjeshtë me vetëdijen e vet, por prapë më i ngatërruar për arsye të shpirtit të tij, ku mekanika paraqet një degë të shkencave. Aq më tepër, mekanizmi duhet kërkuar në lëmin e fiziologjisë, kimisë, anatomisë e të biologjisë, kurse po të dalim në rrafshin e psikologjisë, neve na paraqitet një botë tjetër. Por, nuk ka gjë: këtë ta vështrojmë me një kuptim logjik, bashkë me mendimet e Dekartit, i cili shpjegon faktin se mekanizmi i lëvizjeve të trupave varet nga lëvizja e atomeve. Po të mos e zgjeronim këtë edhe në rrafshin e jetës, do të ishte si të mos studiohen fuqitë e gjalla që përbëjnë në vete disa organe, të cilat janë në luftim dhe këmbim me ambientin e vet (Rrethina-Enviroment, vër. M. G.). Kjo pikëpamje do të dukej si ta barazonim automobilin me një qerre që tërhiqet

nga kafshët shtëpiake. Është e vërtetë se Dekarti edhe kafshët i ka konsideruar si një pjesë të makinës automatike. Por çka se, ata që bëjnë të fluturon një aeroplan, nuk kanë të zotët ta krijojnë një zog dhe t’i japin forcën e fluturimit. Njohuritë mbi mekanikën dhe fizikën kanë ardhur deri në një gradë të caktuar, prandaj në tokë shohim trenat e automobilat, në det vaporët e nëndetëset, kurse në ajër aeroplanët, por, njohuritë mbi jetën bimore e shtazore kanë mbetur në sferën e hipotezave, nuk është e mundur të trajtohet një fije bari apo një krah i fluturës. Megjithatë neve nuk do të ndalemi këtu, por do të kalojmë në fushën e studimeve që i përkasin njeriut, për arsye se me këtë, padyshim, do të vërtetohet se njeriu nuk është një pjesë vetëm mekanike dhe fizike që lëviz pa dijeninë e vet.

Njeriu, që vërtetë meriton të quhet kështu, është elter i asaj zemre dhe i atij shpirti që qëndrojnë si një burim i vetëm i disa ngjarjeve të bukura, si fjala vjen, i ndjenjave, i vetëdijes, i mendjes dhe i logjikës, prej ku kundron njeriu vetë po t’i fërkojë pak sytë e t’i sheh qiejt dhe tokën. Po ta shikojmë njeriun në pikëpamje mekanike dhe fizike, brenda këtij rruzullimi do të dukej ndryshe: si insekt a mikrob në përpjesëtim me lëmshin e dheut. Po për çudi, se vetë mohuesit a heretikët që pretendojnë t’ia japin njeriut formën e duhur, shtrojnë një tezë duke thënë se “mbi njeriun nuk ekziston një Kreaturë”. Me pretendime se mbi njeriun, i cili në këtë rruzullim duket si një thërrmijë ose, porsi asgjë, nuk ekziston ndonjë Kreaturë, duket si një pranim se njeriu është kreaturë më e fuqishme. Këtë a ta quajmë si kontradiktë apo të pohojmë se njeriu

i paska dy dinjitate reciproke ose dy pikëpamje. Pa dyshim se e vërteta shkon me tezën e dytë, por heretikët tanë, duke mos dashur ta shkojnë njeriun me dy pikëpamje dhe duke ngulur këmbë në vrojtimin e njeriut në mënyrë mekanike e fizike, kanë mbetur rob të kontradiktës. Ky bir i Ademit, i cili ndaj rruzullimit të gjithësisë është asgjë, qenka një kreaturë e madhërueshme brenda jetës organike që gufoi prej nëndheut, deri te truri që atë e stolis.

Pra, kjo veçanti e privilegj ia paska siguruar njeriut sundimin mbi krejt natyrën! Çudi! E para, edhe lëmshi i dheut tonë paraqet një thërrmijë në raport me kozmosin, pastaj njeriu paraqet një thërrmijë krejt të pavlerë në atë thërrmijë. E atëherë, trutë e njeriut, që na qenkan sa një thërrmijë, ç'vlerë mund të kenë? Kur një njeri me peshë njëqind okë nuk çon kandar mbi këtë tokë, çfarë rëndësie u mbetet truve që peshojnë një okë? Si mundet pra, këto të sundojnë mbi natyrë? Si bëhet që heretikët në njëerën anë, e tregojnë njeriun në këtë mënyrë definitive, e në anën tjetër, thonë se mbi njeriun nuk ekziston asnjë Krijues? Ja pra arsyeja përse ata njerëz kanë rënë prej kontradikte në një kontradiktë tjetër. Të pohuarit e asaj çka shkenca, arsyeja, vrojtimit e eksperienca e kanë përgënjeshtuar, nuk është asgjë tjetër pos një marrje; sikur do të ishte marrje e madhe të insistohet në atë se një grusht tru peshon më rëndë se lëmshi i dheut, dhe se ato mbajnë nën sundim gjithë natyrën. Nëse njeriu zotëron një cilësi me të cilën sundohen ndër kultura të gjithë, rruzujt mekanikë, kjo cilësi nuk i vjen prej fakultete fizike, por një fakulteti tjetër, që është i amshueshëm,

i cili quhet shpirt. Njeriun mekanik e mërzi një plesht ose mushkonjë me thumbin e vet, kurse njeriu shpirtëror, me një shikim të syrit, i përfshin tokë e qiejt. T'i marrim dy njerëz: Një që sheh e një që shihet. Njëri prej tyre ka hipur lart në minare. Shikimi dhe vetëdija e tij shtrihen deri në tokë dhe sipër në qiell. Ai hedh poshtë sytë dhe njerëzit i duken si thnegla. Ja pra, këta njerëz që shihen janë njerëz mekanikë, kurse ai që i sheh është njeri i përkryer (me një sifrat të Allahut xh.sh.).

Dielli endet kupës së qiellit duke tërhequr në rrezet e veta çdo pamje me të cilën ndeshet. Por, për t'i ravijëzuar këto pamje që shihen ka nevojë për objektivat e një aparati fotografik. Ky aparat thith prej dritës hijet e çdo sendi që i kap objektivi i tij, mandej këto i transporton mbi faqe të letrave e të tabelave. Por, gjallërinë që shfaqet në një bebëz syri nuk mund ta vërejmë kurrë në gastare ose tabela. Hija që syri, organ ky i shikimit, thith prej vetes, vendoset në ju menjëherë me një nur (dritë) krejt tjetër që quhet vetëdije. Për më tepër, në ju zënë vend jo hijet e sendeve, por vetë sendet. Kjo dritë e vetëdijes është ai mjeti që dallon atelienë e një fotografi nga visaret e impresioneve të trurit të njerëzve. Kjo vetëdije ndoshta është e para gjallesë, dhe për ta njohur qenien e kësaj drite, është njësoj si ta njihite njeriu vetveten. Ju krejt sendet i vëzhgoni nëpërmes këtij nuri të vetëdijshëm, por këtë nur nuk mund ta vëzhgoni përpos nëpërmjet fuqisë së tij. Nëse nuk mundeni ta dalloni vetëdijen prej veprave që janë dhunti të saj, atëherë do të thotë se ende nuk e keni njohur vetveten. Ata që mundohen ta shpjegojnë vetëdijen me anë të lëvizjeve, d.m.th. me anë të

përshtypjeve të trurit, nuk janë ende në gjendje ta zgjidhin problemin e njohjes së vetëdijes. Po të ishte vetëdija e përbërë vetëm nga ravijëzimet e përshtypjeve të trurit, atëherë do të duhej të shiheshin objektivat e aparateve fotografik, të dëgjoheshin pllakat e gramafonave e të kishin këta një vetëdije. Si thotë filozofi francez Rabie: “Po të përparojë shkenca edhe më tepër, e nëpërmjet aparateve të shpikura të vrojtohet plotësisht truri i njeriut kur fle, sikurse vëzhgohen skajet e vrimat e një fabrike, vijmë në përfundim: se jemi në gjendje t’i vështrojmë edhe lëvizjet e trurit. Ndoshta do të na duken lëvizjet e trurit sikur ato që bëhen në një mulli. Por, kurrën e kurrës nuk mund të vijmë në përfundim se kemi konstatuar se çfarë mendojnë e ëndërrojnë trutë kur janë në lëvizje”. Nga kjo kuptojmë se neve nuk jemi në gjendje të marrim vesh asgjë kur është fjala për vetëdijen sepse vetëdija e çdo njeriu është e fshehur te ai vetë, sikurse ajo e juaja në ju. Çështja ndërron në rast se dy shpirta kanë gjetur një vijë të përbashkët të marrëveshjes mes veti. Ata që nuk dinë ta ndajnë vetëdijen prej veprave të saj, si të themi, ta dallojnë gurrën dhe ujin që rrjedh prej saj, ata njerëz nuk njohin vetveten, sepse rëndësi më tepër i japin vetëdijes e pastaj veprave të saj. Kujdesi për koshiencë quhet *entendement* (fr. Kuptim, arsye; arab. Basiret). Kur themi zemër, psikologjikisht kuptojmë se ky është faktori i atyre ndjenjave, arsyes (*entendement*) dhe është si qendër prej ku njeriu mëson ta njohë vetveten. Me gjithë përpjekjet që i bëjnë fiziologët, për ta zbuluar arsyen e vetëdijen, asgjë nuk ka dalë në shesh, vetëm sa kanë arritur të thonë se vetëdija nuk është gjë tjetër veçse zbulimi i lëvizjeve që truri i

shkakton, sa mos ta tregojnë paaftësinë e tyre për këtë problem. Por, edhe kjo nuk është gjë tjetër përpos një pohim i tërthortë për mungesën e kuptimit të këtij problemi.

Nuk shohin që ato gjëra, të cilave iu japin emrin lëvizje mekanike dhe fizike, nuk janë gjë tjetër por vetëm dhuntitë e arsyes dhe vetëdijes. Nëse nuk ka vetëdije, ose nëse krejt kjo është një gënjeshtër, atëherë, qysh më parë, nuk do të ekzistonin ose do të ishin gënjeshtera ato lëvizje dhe ata trupa. Nëse vetëdija qëndron në egon (unin) time, ato tjerat janë afër meje, përpara ose prapa meje.

Tani të konkludojmë: Njeriu së pari, ka ndjenja, vetëdije dhe shpirt, e mandej na shfaqet neve nëpërmes fuqisë së kësaj vetëdijeje i gjithë mekanizmi dhe jeta trupore. Prandaj në pikëpamje shkencore shfaqen dy lloj raste (*incidente*): njëri i përket vetes sonë dhe është rast objektiv ose fizik. Të dy këto raste (*incidente*) gjenden brenda përshtypjeve të vetëdijes sonë. Kështu, po ta abstrahojmë njeriun shpirtëror, atëherë kemi apstrahuar çdo gjë dhe me këtë rast do të kemi një mendim të përbashkët mbi jetën mekanike. Kështu jemi të shtrënguar, se duke kërkuar fillin ose motivin e parë të të gjitha lëvizjeve, duhet kërkuar filli i forcës që ushtron ndikim mbi cilësi të rasteve shpirtërore e jo vetëm mbi mekanizmin sepse unë nuk jam as shpirt e as trup por jam një kompozicion i përbërë nga të dyja. Unë jam vetëm unë. Mirëpo, unë jam vetëm një krijesë sepse më parë nuk kam ekzistuar. Ndaj, nuk mbetet dyshim se unë kam një Krijues. Krijuesi im nuk është një trup sepse po të ishte ashtu nuk do të kishte një forcë shpirtërore

dhe mua nuk do të mund të më jepte shpirt. Por, as shpirt nuk është Krijuesi im, sepse po të ishte vetëm i atillë, unë nuk do të isha i përbërë prej trupit dhe shpirtin Ai nuk do ta bashkonte me trupin. Prandaj, Krijuesi im ka atë pushtet (forcë) sa të ma jep mua trupin shpirtin dhe këto t'i bashkojë në një vend, prej tyre të formojë një njeri. Unë adhuroj vetëm këtë Krijues dhe vetëm këtë e njoh për Zot. Nëse unë jetoj, nëse kam dituri (ilm) dhe vullnet (irade), edhe Zoti ka cilësi të cilat janë fillim i gjithë këtyre cilësive njerëzore.

Nëse unë e zotëroj një fuqi mekanike, Ai Zot e ka pushtetin e plotë që është fillimi i asaj fuqie. Nëse unë nxënësve ose fëmijëve të mi u mësoj gjuhë, dijeni dhe u jap urdhra, këtë fuqi e marrë prej Zotit, i cili posedon cilësinë e të folurit (sifati-kelam) në vetvete, se përndryshe unë nuk do të isha i zoti të mësoj, të flas e të urdhëroj. Për këtë arsye Ai disponon me cilësi që janë si gurra e atyreve, dhe unë nuk do të isha në gjendje të zotoj diçka, ngase një gjë e mangët nuk mund të jetë motiv për një gjë të plotë. Pra, prej asgjëje nuk del asgjë. Ato që u krijuan pa qenë fare, qenien e tyre e kanë nga një gjë ekzistuese, e jo nga asgjëja. Kuptimi shkencor i ligjit të evolucionit nuk është ajo që ta konsiderojmë evolucionin si një fillim absolut. Në botën e kafshëve ligji i evolucionit është një ligj proporcional i Hyjnisë. Kafshët, duke bërë evolucionin gradualisht, këtë evolucion ia atribuojnë fillimit absolut, e njerëzit e dijes këtë e kanë mirë të kuptuar. Shih për këtë arsye, filozofi anglez Spencer, duke caktuar evolucionin si proporcion i domosdoshëm, ka vërtetuar ekzistimin e një Qenie të një fillimi absolut. Me të

vërtetë, po të mos ishte prania absolute e të Madhit Zot, vargu i evolucionit do të zgjatej kot, gjithnjë e më shumë pa pasur ndonjë bazë me të cilën do të plotësohej fillimi absolut. Një ndër parimet kryesore të diturisë, siç e kemi përmendur më parë është ky: prej asgjëje nuk del asgjë (rien ne vien de rien), me fjalë të tjera, asgjëja mund të jetë motiv për qenien. Kështu pra, neve kemi të drejtë kur të themi se Zoti ynë nuk është vetëm shpirt e trup, përndryshe kjo do të ishte një rënie në kontradiktë me të cilën gjë do ta mohonim, në emër të shkencës, një ligj që është rrënjë e të gjitha shkencave.

Pra, nëse ne e njohim vetveten dhe dimë ta çmojmë shkencën kurrë nuk duhet të besojmë se prej një natyre të vdekur apo të verbër del një njeri i gjallë e i bukur. Dikur moti, revolucioni i kobshëm, hutoi njerëzit në përgjithësi në Francë dhe zbuloi një ide, ide të zbrapsjes së njeriut kah periudhat primitive të filozofisë, me të cilën njeriu është i imagjinuar si të ishte një makinë trupore. Mandej, shumë njerëz e pranuan këtë ide për të cilën menduan se është një gjë e re, kurse në realitet ishte krejt e vjetër, trashëgim i kohërave primitive. Një heretik i asaj kohe u bë i famshëm me një vepër që botoi me titullin “L’homme-machine” (Fr. Njeriu-makinë). Por, Monteskieu, me një frazë kuturu, u ishte përgjigjur atyre bukur mirë: “A një fuqi e verbër i ka krijuar këta njerëz që dinë të arsyetojnë ? ....sa larg!” Po si duket, ata që njeriun e pranonin për makinë, nuk kishin arritur ta njohin fuqinë e mendjes. Ata mendonin si natyralistët e kohëve antike të Greqisë derisa nuk u paraqitën ende sofistët. Ata nuk kanë qenë të aftë ta

dallojnë objektin prej subjektit dhe vetëdijen prej veprave të saj. Ndër tiranët e Athinës sundonte epshi. Pos epshit ata nuk njihnin asgjë tjetër dhe mohonin të vërtetën. Në të gjitha këto konceptione që kishin për qëllim mohimin e moralit dhe hyjnizimin (deification) e njeriut, një send shfaqej në shesh: se mendja e njeriut kishte një vlerë ndaj natyrës. Pas kësaj, më vonë, shkencat e artet morën një rrugë të drejtë. Filluan të caktohen në format pozitive relacionet e vërteta në mes objektit dhe subjektit. Duke u kodifikuar në një rën anë shkencat shpirtërore, e në anën tjetër, shkencat natyrore, u formuan edhe ligjet e logjikës; u konstatua se artet dhe shkencat e argumentonin Krijuesin e Gjithësisë e nuk e mohonin. Por, në periudhën e Revolucionit Francez, me pretendime të lirisë mendore e të ndërgjegjes, filloi të zhvillohet edhe epoka e sofizmit dhe tiranisë, që kishin për qëllim zmbropsjen e njerëzimit kah periudhat primitive antike dhe kah mohimi i Zotit. Buchneri (Byshneri), autor i veprës “L’homme-machine”, i këndellte një formë të re periudhat primitive antike, duke u përgatitur sheshin heretikëve dhe skeptikëve (nihilistëve), të cilëve u ndihet zëri ndonjëherë edhe në kohërat tona.

Heretikët e sotëm mund t’i ndajmë në tri grupe: 1. Natyralistët primitivë ose njerëzit makinë; 2. Tiranët, të cilët veç epshit të tyre nuk njohin tjetër Zot; 3. Skeptikët (nihilistët), që nuk u besojnë të vërtetave subjektive e objektive.

Dogma e njerëzve –makinë është stomaku; dogma e njerëzve-tiranë është sundimi barbar e mizor, me vrasje dhe rrënime; dogma e skeptikëve janë ngatërresa dhe gënjeshtër. Prandaj,

cilido prej tyre, edhe skeptikët bile, shpesh kanë ëndje t’i shfaqin dogmat e tyre, por mendimet e tyre kurrë nuk hasin në nderim, për arsye se e mohojnë të vërtetën, mohojnë Qenien Fillestare të krejt Gjithësisë. Neve atyre u japim këtë këshillë: Njerëzimit, të mendojnë edhe pak mbi vlerën e mendjes e të vetëdijes, të lirisë e vullnetit. Mos t’i harrojmë tiranët dhe ligjet e tyre barbare e mizore me të cilat ata i ndëshkojnë njerëzit, ndoshta ndonjëherë edhe dikush prej tyre do të jetë i qëlluar.

Pra, pasi njeriu nuk e sheh veten pranë tij e as mendjen e ndërgjegjen, mos të çohet ta kërkojë Krijuesin me anë të teleskopëve. Mos të ecë njeriu në rrugën e faraonit, i cili ndërtoi vrojtore (observatoirs) me qëllim që ta gjejë udhën e qiellit dhe të ndeshet me Zotin e Musait. Po, qiellin është mirë ta shikojmë e studiojmë që ta zbulojmë Krijuesin, por çka se, për të pasur sukses në këtë punë, duhet të kemi një zemër e një kujdes mbi veprat e krijuara prej Tij. Te Perëndia mbërrihet nëpërmjet mendjes dhe zemrës. Bukuria Hyjnore kuptohet dhe besohet në këtë jetë, kurse arrihet dhe shihet në atë jetë.

Ja kjo është Qenia e Perëndisë të cilën e argumenton feja Islame, dhe ja natyra dhe vlera e kundërshtimeve të bëra.<sup>1</sup>

---

1. Marrë nga libri “A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar”, botuar në vitin 1934 nga autori H. Ali Kraja, ribotuar disa herë dhe së fundmi botuar nga KMSH, Tiranë, 2010.

## Adhurimi në jetën e Profetit (a.s) dhe ekuilibri në adhurim

M.A. Elton Karaj  
Universiteti Hëna e Plotë Bedër

### Hyrje

Në këtë artikull do të mundohemi të trajtojmë pjesërisht adhurimin në jetën e Profetit (a.s) si dhe ekuilibrin që ai ruante në këtë çështje, duke u bazuar në disa prej formave të adhurimit si namazi, agjërimi dhe lutja, pasi e kemi të pamundur të trajtojmë të gjitha format e adhurimit në një artikull të vetëm. Që në krye dëshirojmë të shprehim se ky artikull është përgatitur prej veprës Drita e Pashuar, me autor Fetullah Gylen.

Në gjuhën arabe, për të shprehur adhurimin përdoret fjala *Ibâdet* (عبادة). Ky është adhurimi ndaj Allahut (xh.sh.). Termi “*ibadet*” vjen nga rrënja *a-b-d* (عبد) që do të thotë “të bësh adhurim, të adhurosh dikë”, etj. Nga e njëjta rrënjë vjen edhe fjala *abd* (عبد), që do të thotë njeri i lirë ose i robëruar, por njëkohësisht ka kuptimin e jetesës si një rob i Zotit dhe kjo formë jetese me ndërgjegjshmërinë e të qenit rob i Zotit shprehet me termin *ubudijet* (عبودية). Pra shpreh një nënshttrim ndaj Krijuesit. Kështu që kjo fjalë, kerahas adhurimit të institucionalizuar, si namazi, agjërimi, haxhi, etj, shpreh edhe një formë jetese.

### Përkufizimi i adhurimit

Në literaturën islame, ibadeti/adhurimi ka dy kuptime, njëri i përgjithshëm e tjetri i veçantë. *Kuptimi i përgjithshëm* mund të shprehet kështu: Veprat që kryen ndërgjegjshëmrisht nga njerëzit në përshtatje me kënaqësinë e Allahut si rezultat i respektit dhe dashurisë ndaj Tij. Sipas këtij përkufizimi, çdo veprë e bërë për kënaqësi të Allahut quhet ibadet/adhurim. Kurse *kuptimi i veçantë* e përkufizojmë kështu: Vepra të caktuara që kryhen prej personave përgjegjës me qëllim që të fitojnë kënaqësinë e Allahut. Kurse termi

“person përgjegjës” në Islam, përfshin çdo person që ka arritur moshën e pubertetit dhe që ka një zhvillim normal mendor. Në këtë rang adhurimesh hyn namazi, agjërimi, zekati, e adhurime të tjera të ngjashme.<sup>1</sup> Edhe Xhurxhânî në veprën e tij et-Ta’rifât jep përkufizimin e medhhebit Hanefi duke thënë: هو فعل المكلف على خلاف هوى نفسه تعظيماً لربه “*Ibadet* quhen veprat e personit përgjegjës të bëra për të lartësuar Zotin, pavarësisht dëshirave të nefsit të tij”.<sup>2</sup>

1. DËA, artikulli “Ibadet”.

2. El-Xhurxhani, *Et-Tarifât*, artikulli “el-Ibâde”, fq. 123.

### Profeti (a.s) dhe adhurimet

Nëse marrim për bazë kuptimin e parë të fjalës iradet, atëherë mund të themi se e gjithë jeta e Hz. Muhammed (a.s) ishte e përqendruar në realizimin e këtij synimi. Megjithatë kur themi ibadet në fillim na vjen ndër mend kuptimi i veçantë i kësaj fjale, kështu që do të mundohemi t'i hedhim një sy jetës së Profetit (a.s) në këtë këndvështrim duke analizuar disa shembuj.

### Disa shembuj nga adhurimet

Duhet të themi që Hz. Muhamed (a.s) ishte tejet i përkushtuar në adhurim. Gjithashtu ai, nga vetë Allahu ishte titulluar në krye *abd/rob* e më pas *rasul/i dërguar*. Kur sheh përkushtimin e Profetit (a.s) në adhurim, mendon se gjatë gjithë jetës së tij, ai nuk kishte bërë asgjë tjetër veç adhurimit. Askush, në asnjë aspekt, nuk mund të krahasohet me të. Në namaz ai përjetonte më të thellin e adhurimeve dhe aq të plotë e ndjente dhe e shfaqte atë, sa thua se nuk kishte namaz që nuk rrënqethej e nuk derdhete lot. Dëshmitarë të kësaj të vërtete kemi shumë sahabë, ndër të cilët edhe bashkëshortja Aishja (r.anha), e cila shpesh herë e ka gjetur Profetin (a.s) në sexhde të përplotur duke iu përgjyruar të Madhit Zot gjatë natës së zymtë.

### Namazi

Padyshim që adhurimi kryesor në fenë Islame është namazi. Jeta dhe praktika e të Dërguarit të Allahut (s.a.s) e tregonte më së miri këtë fakt. Namazi ishte një vepër që ai e priste me dëshirën e pasionin më të madh. Asgjë tjetër nuk i falte atij kënaqësinë që i falte namazi. Ndaj, në një hadith sherif të transmetuar

nga Enes b. Mâlik (r.a) ai thotë: حُبِّ إِلَهِ النَّسَاءِ وَالطَّيِّبِ وَجُعِلَتْ قُرَّةُ عَيْنِي فِي الصَّلَاةِ. “*Më janë bërë të dashura: gruaja dhe aroma e mirë, ndërsa drita e syrit tim është namazi*”.<sup>3</sup> Sikur gëzohemi e bëhemi me krahë kur na jepet lajmi që po vjen njeriu ynë më i dashur, të cilin ka kohë që e presim, atë ndjenjë e gëzim ka Profeti (a.s) kur i afrohet namazi, vetëm se ndoshta në këtë rast ky gëzim është njëqind herë më i fortë. Sikur ai të kishte ndenjur një kohë të gjatë larg nënës sonë Fatmës, bijës së tij të dashur, pastaj dikush t’i thoshte “Fatma po vjen!” Sa do të gëzohej, sa do të lumturohej ai shpirt i shenjtë! Ashtu gëzohej e lumturohej kur dëgjonte zërin që lajmëronte ardhjen e namazit... madje edhe më tepër. Sepse namazi ishte dashuria e tij, pasioni i tij dhe gjaku i zemrës së tij. Në një hadith tjetër, të transmetuar nga Taberani, i cili e përforcon hadithin e lartpërmendur, thuhet kështu: “*Allahu i ka dhënë secilit profet një dëshirë, qëllim e pasion. Sa për mua, pasioni im është namazi i natës*”.<sup>4</sup> Kuptimi i tij është ky: Ju tërhiqeni prej pasioneve fizike, materiale e trupore, i ndiqni ato hap pas hapi dhe janë sinjalet e këtyre pasioneve që ju mbajnë në këmbë e ju tërheqin t’i ndiqni. Kurse unë, me të dëgjuar zërin e ndërgjegjes që më thotë: “Ngrihu, koha për t’u falur!” i shkoj nga pas atij sinjali që më magjeps, më merr pas vetes derisa nuk bëj dot pa namazin. Ato net që nuk falem ose nuk ngrihem dot, janë çastet më të dhimbshme, më të trishtueshme për mua.

3. Nesâî, *Ishratu'n-Nisâ* 1; Ahmed İbn Hanbel, *El-Musned* 3/128, 199, 285.

4. Mexhmeu'z-Zeuâid, 2/271.

### Çfarë thonin sahabet për namazin e tij?

**Ebu Dherr** (r.a.) thotë: “Një natë ai u fal gjer në mëngjes. Sa herë u vinte radha ajeteve të lutjeve, ai i përsëriste ato disa herë dhe falej me respekt e përkushtim, duke e bërë namazin një mozaik përgjërimit, bindjeje, paqeje e qetësie. Ai lexonte vazhdimisht lutje gjatë namazeve nafile, në sexhde, ruku’ e në këmbë. Ai nuk kishte ngopje me faljen. Sado që të falej e të lutej, dëshira për namaz veç sa vinte e i rritej më tepër.”

**Ibn Mesudi** (r.a) tregon: “Një herë, vendosa të fal namaz natën bashkë me profetin. Do ta kaloja natën pranë tij dhe do të kryeja të njëjtat adhurime me të. Nisi të falej, nisa edhe unë. Por ai vazhdonte të qëndronte në këmbë, pa u përkulur në ruku’. Kur mbaroi së lexuari suren Bekare, thashë me vete: “Ja, tani do të përkulet në ruku’”. Po ai vazhdoi, lexoi suren Ali Imran, pastaj suren Nisa, pastaj kaloi në ruku’. Aq u lodha gjatë atij namazi, sa e humba përqendrimin e nisa të mendoja gjëra të tjerë. Njëri nga ata të grupit që po i tregoja ngjarjen, më pyeti: “Ç’të erdhi ndërmend?” “Mendova ta prish namazin e ta lë të qetë në namazin e tij”, tha Ibn Mesudi (r.a).

Nëna jonë e nderuar **Aishe** (r.a) e tregonte me këto fjalë namazin e tij: “Ai qëndronte në këmbë në një mënyrë të tillë, sa s’përshekruhet dot. Ai përkulej ashtu në ruku’, sa nuk përshekruhet dot. Ai shkonte në sexhde... nuk përshekruhet dot!”<sup>5</sup>

### Atmosfera e adhurimit të tij

Një tjetër ditë, ai ishte sërish i mallëngjyer. Qante e qante pa pushim. Erdhi Xhebraili (a.s) dhe i solli selam nga Allahu (xh.xh.): “Zoti pyet, pse qan Muhamedi im?” Allahu është njohësi i të hapurës e të fshehtës Gajbit... Dituria e Tij ka përfshirë çdo gjë. Askush, asnjë nuk mund të jetë jashtë njohjes së Tij. Por prapë, pyet. Qoftë dëshmi apo shpallje e pozitës së jashtëzakonshme që kishte Profeti Muhamed (s.a.s.) pranë Tij, nuk ka ndonjë ndryshim. Por profeti, aq shumë qante, sa nuk ishte në gjendje të jepte përgjigje. Nga buzët i doli vetëm kjo fjalë: “*Ummeti, ummeti*” Brenga e tij ishte e qartë. Populli i vet! Xhebraili u kthye menjëherë për të raportuar gjendjen. Atëherë Allahu (xh.xh.) e dërgoi sërish atë me një tjetër përshëndetje dhe e ngushëlloi të Dashurin e Vet me këto fjalë: “Shko, (jepi selamin Tim) te i Dashuri Im dhe thuaji: *“Padyshim, se edhe në çështjen e popullit tënd do të të lumturojmë e nuk do të lëmë asnjëherë në brengë e në hall!”*<sup>6</sup>

Gjithë jetën e tij ai e kishte kaluar me adhurim e përkushtim. Namazi ishte drita e syrit të tij. Dashuria e tij më e madhe. Ai u fal ditë e natë, gjatë gjithë jetës së vet. Ai kishte jetuar duke thënë “Namaz, Namaz”, e duke thënë Namaz, do t’i linte lamtumirën kësaj bote. Jetonte ditët e fundit. Nuk kishte më fuqi as të hapte sytë. Mund t’i hapte paksa, veç kur i derdhnin një kovë me ujë përsipër dhe atëherë arrinte të thoshte vetëm një fjalë: “*A e fali xhemati namazin?*” Por edhe ky sforcim ia shpenzonte ato pak energji të mbetura e ai i humbte ndjenjat sërish. Kur vinte

5. Buhari, *Tehexhud*, 16; Muslim, *Musafirin*, 125.

6. Muslim, *Iman*, 346.

në vete pasi i hidhnin ujë përsipër, sërish pyetja që bënte ishte e njëjtë: “A e fali xhemati namazin?” Jo, xhemati kishte orë të tëra që priste atë. Ndërkohë, si e kuptoi se nuk i kishte mbetur më fuqi të drejtonte namazin, profeti urdhëroi e tha: *“Çojini fjalë Ebu Bekrit, le ta drejtojë ai namazin!”* Sa e ndjeu veten pak më mirë, “vrapi” në faltore. Nga njëri krah e mbante xhaxhai, Abasi, nga krahu tjetër dhëndri i tij, Aliu. Ndërsa ai thujse ecte zvarrë drejt faltores. U ul pas personit që do të drejtonte namazin e do të bëhej imam pas tij dhe u fal ndenjur. Në këtë mënyrë, mundi të shkonte në mesxhid të falej vetëm dy herë. Kështu ai gjer në çastin e fundit nuk e kishte braktisur faljen me xhemat, edhe pse deri në xhami kishte shkuar në krahët e të tjerëve e thujse duke u tërhequr zvarrë...

### Agjërimi

Adhurimi i tij përbënte një tërësi në vetvete. Ndërsa falte më së miri namazin, Ai nuk neglizhonte kurrsesi një adhurim tjetër, për shembull, agjërimin. Agjërimi, i quajtur saum (صَوْم) në gjuhën arabe, është farz në muajin e shenjtë të ramazanit<sup>7</sup> dhe përbën një nga adhurimet më të rëndësishme për lartësimin shpirtëror të besimtarit. Në një hadith profetik thuhet: *“Islami është ngritur mbi pesë parime: dëshmimi se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe profeti Muhamed është rob i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i ramazanit, vizita në Qabe për ata që kanë mundësi.”*<sup>8</sup>

7. *O ju që keni besuar, ashtu siç u bë mbajtja e agjërimit farz për paraardhësit tuaj, u bë edhe për ju që të ruheni!”* (Bekara 2/183.)

8. Buhari, *Iman*, 1; Muslim, *Iman*, 20; Tirmidhi, *Iman*, 3.

Kështu që edhe Profeti (paqja e begatia e Allahut qofshin mbi të) i ka kushtuar rëndësinë e duhur adhurimit në fjalë, si në këshillat e si në veprat e tij. Ai e shpreh kështu rëndësinë e agjërimit: I Dërguari i Allahut paqja qoftë mbi të ka thënë: *“Allahu ka urdhëruar kështu: “Çdo akt i njeriut është për vetë atë, me përjashtim të agjërimit. Shpërblimin e agjërimit e jap unë, sepse njeriu i braktis ngrënien dhe dëshirat trupore vetëm për mua. Për agjëruenin ka dy çaste të gëzuara. Njëri, kur ha iftarin dhe i dyti, kur bashkohet me Zotin. Kundërmimi i gojës së agjëruetit është pranë Allahut më i këndshëm se aroma e parfumit!”*

Të paktën, një ose dy ditë në javë (të hënë e të enjte), ai i kalonte me agjërim. Herë pas here, ai agjëronte pa iftar e pa ndërprerje (Savmi Visal), duke agjëruar kështu ditë me radhë, pa futur gjë në gojë. Profeti (s.a.s) e vazhdonte agjërimin edhe në ditët më të nxehta të verës arabike. Ai thoshte gjithmonë: *“Agjërimi është një mburojë që e mbron njeriun nga mëkatet.”*<sup>9</sup>

Gjithashtu ne kemi mësuar nga Profeti (s.a.s) edhe shumë agjërimet të tjerë si agjërimi i nedhrit (kushtimit), agjërimi i Davudit (a.s), agjërimi i ditëve pasuese të netëve 13, 14, 15 të çdo muaji të kalendarit hënor, agjërimi në ditën e Arefesë dhe në muajin dhilxhe, gjashtë ditë agjërim në muajin sheval, agjërimi në ditën e Ashures, agjërimi në muajin e shabanit, për të cilin Hz. Aishe (r.anha) na tregon që ishte muaji në të cilin Profeti (s.a.s) agjëronte më tepër pas ramazanit, pra e kalonte të gjithin me agjërim<sup>11</sup>.

9. Buhari, *Saum*, 2; Muslim, *Sijam*, 152; Tirmidhi, *Saum*, 54; Nesai, *Sijam*, 41; Ibn Maxhe, *Sijam*, 1.

10. Buhari, *Saum*, 2. Tevhid, 35; Muslim, *Sijam*, 162-163.

11. Shih: Buhari, *Savm*, 52; Muslim, *Sijam*,

### Duaja/Lutja

Lutja gjithashtu është adhurim. Lutja është bërthama e përkushtimit, është emri i kthimit e drejtimit total nga Zoti. Kur flitet për adhurim, është e pamundur të mos përmendet lutja. Allahu shprehet kështu: *قُلْ مَا يُعْبَأُ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ وَقَالَ رَبُّكُمْ ادْعُونِي أَسْتَجِبْ لَكُمْ* “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj” (Furkan 25/77), e na sugjeron: *“Zoti juaj ka thënë: Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem.”* (Gafir, 40/60) Lutja është një relacion i fortë mes robit e Zotit. Me të tjera fjalë, lutja është mënyra e shfaqjes së botës së mendimit e apasionatave të robit, para Zotit.

Çdo veprim i Profetit (a.s) ishte i mbështetur në një dua. Ai nuk dilte në udhë pa iu mbështetur fort të Plotfuqishmit. Në librat e hadithit vërejmë lutjet e tij në namaz, para gjumit, kur hynte në shtrat, kur ngrihej për tehexhud, kur zgjohej në mëngjes, kur bëhej darkë, kur nis ushqimin e kur e përfundon atë, madje edhe kur hyn e del nga banja për të kryer nevojat e tij personale... Të përmendim disa shembuj rreth lutjeve të tij kuptimplota:

**Një nga lutjet që lexonte në ruku:** “O Zoti im, para Teje u përkula në ruku’, Ty të besova, Ty t’u dorëzova. Veshi im, syri im, palca e kockat e mia, sistemi im nervor e gjithë ç’mbajnë këmbët e mia, janë përkulur e i janë bindur Zotit të botërave, Allahu!”<sup>12</sup>

**Sapo zgjohej në mëngjes thoshte:** “O Zoti im, u gdhiva duke pohuar se: Ti je Allahu, nuk ka zot tjetër veç Teje dhe se Muhamedi është robi Yt e Profeti Yt dhe për këtë të mbaj

Ty dëshmitar dhe mbaj dëshmitarë të gjithë banorët e gjithësisë, gjithë engjëjt e gjithë krijesat”<sup>13</sup>.

**Kur bëhej darkë shprehte falënderimin e tij me këto fjalë:** “O Zoti im! U ngrysa duke dëshmuar e duke mbajtur dëshmitarë të gjithë ata që mbajnë kupën e qiejve, engjëjt e gjithë krijesat, se nuk ka zot tjetër veç teje, se nuk ke shok e as ortak dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari Yt”<sup>14</sup>

Të gjitha këto shembuj që përmendëm deri këtu janë disa nga fragmentet e një jete të përkushtuar Allahut, Krijuesit të gjithësisë. Ai është shembulli më i madh për ne në të gjitha këndvështrimet e jetës, ndër të cilat përfshihet edhe adhurimi. Kur vështrojmë jetën e Profetit (a.s) kuptojmë se ditën e fillonte me namaz dhe e gjithë veprimtaria e tij ditore ishte e gërshetuar me adhurim.

### Shembull dhe kriter për njerëzinë

Nga ana tjetër duhet të përmendim edhe që Hz. Muhamed (a.s) ishte profet i ndërgjegjshëm për natyrën njerëzore. Allahu dhe vetë Profeti (a.s) e dinin mirë që njerëzit kanë një kufi të caktuar, të cilin nuk mund ta kalojnë edhe sikur ta sforcojnë jashtë mase veten e tyre. Prandaj adhurimet ndahen në kategori të ndryshme si farz, vaxhip, sunet, etj. Disa prej tyre janë të detyrueshme në grada të ndryshme e disa të tjera janë të pëlqyeshme apo suplementare. Ai (s.a.s), duke qenë shembull për të gjithë njerëzinë, shpreh edhe kriteret e pranueshme në adhurim, duke theksuar

176; Ebu Davud, *Savm*, 59.

12. Muslim, *Musafirin*, 201.

13. Ebu Davud, *Edep*, 101; Tirmidhi, *De’auât*, 79.

14. Ebu Davud, *Edeb*, 101.

ekuilibrin që njeriu duhet të ruajë në adhurim. Hadithi më i njohur në këtë çështje ndoshta është si më poshtë:

أَنَّ بِنَ مَالِكِ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُ يَقُولُ: جَاءَ ثَلَاثَةٌ رَهْطٍ إِلَى  
 بُيُوتِ أَزْوَاجِ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ يَسْأَلُونَ عَنْ عِبَادَةِ النَّبِيِّ  
 صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ فَلَمَّا أُخْبِرُوا كَانَهُمْ تَقَالُوهَا فَقَالُوا وَإَيْنَ نَحْنُ  
 مِنَ النَّبِيِّ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ قَدْ غَفَرَ لَهُ مَا تَقَدَّمَ مِنْ ذَنْبِهِ وَمَا  
 تَأَخَّرَ قَالَ أَحَدُهُمْ أَمَا أَنَا فَإِنِّي أَصَلِّي اللَّيْلَ أَبَدًا وَقَالَ آخَرُ أَنَا أَصُومُ  
 الدَّهْرَ وَلَا أَفْطِرُ وَقَالَ آخَرُ أَنَا أَعْتَرِلُ النِّسَاءَ فَلَا أَتَزَوَّجُ أَبَدًا فَجَاءَ  
 رَسُولُ اللَّهِ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ إِلَيْهِمْ فَقَالَ أَنْتُمْ الَّذِينَ قُلْتُمْ كَذَا  
 وَكَذَا أَمَا وَاللَّهِ إِنِّي لِأَخْشَاكُمْ لِلَّهِ وَأَتَقَاكُمْ لَهُ لَكِنِّي أَصُومُ وَأَفْطِرُ  
 وَأَصَلِّي وَأَزْوَاجُ النِّسَاءِ فَمَنْ رَغِبَ عَن شَيْئِي فَلَيْسَ مِنِّي

Një ditë erdhën tek Profeti (a.s) tre të rinj të cilët pyetën për adhurimin e të Dërguarit të Allahut dhe pasi dëgjuan se sa shumë adhurim bënte ai dhe pasi arritën në përfundimin që ndodheshin tepër larg Profetit (a.s), të cilit megjithëse i ishin falur të gjitha mëkatet që mund të kishte bërë ose që mund të bënte në të ardhmen kishte një jetë tepër aktive në adhurim, respektivisht u shprehën në këtë mënyrë: i pari tha që nuk do t'u afrohej më grave, i dyti që do të agjëronte çdo ditë dhe i treti që do t'i kalonte të gjitha netët me namaz. Kur Shembulli më i Bukur (a.s) i dëgjoi këto fjalë i dha pasuesve të tij një këshillë të artë e të vlefshme për të gjithë njerëzimin: *“Në mes jush, unë jam ai që e njëj Zotin më së miri e që i drubet Atij më shumë. Por, unë edhe adhuroj, edhe u ndaj kohë grave, edhe pushoj, edhe falem gjatë natës, edhe agjëroj, po edhe ushqehem. Rruga ime është kjo. Kush i kthen*

*kerahët kësaj rruge, nuk është prej meje”*.<sup>15</sup> Ai ishte njeriu i ekuilibrit të vërtetë, i cili ishte dërguar me parime objektive.

Madje edhe këto që bënte Profeti (a.s) ishin tepër të vështira për shumë njerëz. Në këtë këndvështrim, ashtu siç mund të jetë e realizueshme një jetë e ngjashme me atë të Krenarisë së njerëzimit, paqja e bekimi i Allahut qofshin mbi të, nuk duhet të harrojmë që përveç detyrës së tij si Profet, Hz. Muhamed (a.s), mendohej që të plotësonte falënderimin ndaj Allahut<sup>16</sup>.

### Përfundim

Siç shprehëm edhe në fillim, ky artikull pasqyron pjesërisht dhe shumë shkurtimisht disa fragmente nga jeta adhuroese e Profetit Muhamed (s.a.s) dhe ekuilibrit që ai ruante në këtë çështje. Por duhet të theksojmë se krahas këtyre, mbeten edhe aspekte të tjera për t'u trajtuar si qëndrimi i Profetit (a.s) ndaj lëmoshës, jeta asketike, frika dhe respekti ndaj Allahut, format e sjelljes dhe të përkujdesjes ndaj familjarëve dhe shokëve të tij, etj, të cilat mund t'i përfshijmë në çështjet e adhurimit, si një mënyrë jetese. Urojmë që këto të fundit të trajtohen në artikuj të tjerë.

15. Buhari, *Nikah*, 1; Muslim, *Sijam*, 73.

16. DÍA, artikulli “Muhammed, Jeta adhurimore”.

**BIBLIOGRAFIA**

- Enciklopedia islame, <http://www.tdvia.org/>
- Gylen, Fethullah, Dritë e Pashuar-1, Shtëpia Botuese Prizmi, Botimi 3, Tiranë (2010).
- Khurxhani, Sejjid Sherif (V. 816 H.), Et-Tarifât, (t' hk: Muhammed S. Minsheui), Daru'l-Fadile.
- Buhari, Ebu Abdullah Muhammed b. Ismail (v. 256 h.); El-Xhamiu's-Sahih, Çağrı Yay., I-VIII, Botimi 2, Stamboll (1413-1992).
- Ebu Davud, Sulejman b. Esh'ath es-Sixhistani (202-275 h.); Es-Sunen, I-V, Çağrı Yay., Botimi 2, Stamboll (1413-1992).
- Ibn Maxhe, Muhammed b. Yezid el-Kazuini (207-275 h.); Es-Sunen, I-II, Çağrı Yay., Botimi 2, Stamboll (1413- 1992).
- Muslim, Ebu'l-Husejn el-Haxhxhâxh en-Nejsaburi (v. 261 h.); El-Xhâmiu's-Sahih, I-III, Çağrı Yay., Botimi 2, Stamboll (1413-1992).
- En-Nesai, Ebu Abdurrahman Ahmed b. Shuajb (215-303 h.); Es-Sunen, I-VIII, Çağrı Yay., Botimi 2, Stamboll (1413-1992).
- Tirmidhi, Ebu Isa Muhammed b. Isa b. Theura (209-279 h.); El-Xhâmiu's-Sahih, I-V, Çağrı Yay., Botimi 2, Stamboll (1413-1992).
- El-Hejthemi, Nureddin Ali b. Ebi Bekr (v. 807 h.), Mexhmeu'z-Zeuaid ue Menbeu'l-Feuaid, I-X, Daru'r-Rajjen li'tturâth, Kajro, 1407.
- Ahmed b. Hanbel, Ebu Abdullah esh-Shejbani (164-241 h.); El-Musned, Çağrı Yay., I-VI, Botimi 2, Stamboll (1413-1992).

## Mesazhi Islam - Fe për të gjithë

### Muhamed Teufik Ahmed Egjipt

- Të nderuar vëllezër dhe motra!  
A e keni menduar më parë çështjen e fesë?

A keni vërejtur mospajtme të shumta në mendime rreth kësaj teme?

A keni vërejtur ndonjëherë armiqësi mes grupeve dhe njerëzve të ndryshëm?

Çdo person mendon se e ka gjetur fenë e vërtetë, madje edhe ai që për zot të tij e adhuron gurian dhe e shenjtëron atë.

Unë jam më se i sigurt se në mendjet tuaja kanë kaluar pyetje të tilla, e që ju kanë ndihmuar të bindeni se ekziston vetëm një fe e vërtetë për të gjithë, sepse Zoti është Një dhe nuk është i kënaqur të ketë shume fe, duke qenë se kjo fe është e kuptueshme për të gjithë njerëzit.

Çdo njeri duhet të ndiej në vetveten e tij, pa ndikim nga askush këto parime themelore:

- Besimi në një Zot të vetëm të adhuruar [sepse politeizmi i supozuar shkatërron universin]

- Përhapja e së mirës mes gjithë njerëzve.

- Besimi se Allahu ka dërguar të dërguarit e Tij për t'ia mësuar njerëzimit këto dy parime të shenjta.

Nëse meditojmë me kujdes këto

parime do ta pyesim veten: a thua vallë me të vërtetë ekziston një fe e tillë?

E vërteta është se kjo fe ekziston që nga krijimi i ekzistencës. Këtë fe monoteiste Allahu e zgjodhi për njerëzimin duke e dërguar nëpërmjet të dërguarve të Tij. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Feja e pranueshme tek Allahu është Islami”*<sup>1</sup>. Gjithashtu thotë: *“E kush kërkon fe tjetër përveç fesë Islame, atij nuk i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit”*<sup>2</sup>.

Atëherë mund të themi se feja është nga Allahu, por disa njerëz gabimisht i emëruan me emra të pejgamberëve gjatë kohëve të ndryshme kur ishin dërguar ata. Emërtime të tilla shkaktojnë mospajtme dhe ekstremizëm mes shoqërive të ndryshme sa që kjo ndarje ka qar deri te harresa e së vërtetës. Edhe Islamin e quajtën ‘muhamedanizëm’ sipas emrit të pejgamberit Muhamed (a.s.), ashtu siç u quajtën edhe fetë e tjera me emrat e pejgamberëve të tyre, përkundër faktit se të gjithë thirrën në një Zot [Allahun].

E ndiej obligim që me pak fjalë të sjell realitetin e fesë së Vërtetë. Mirëpo, nëse pjesëtarët e besimeve të tjera vazhdojnë të mos e njohin Islamin dhe

---

1. Al Imran 3:19.

2. Al Imran 3:85.

mësimet e tij, ky qëndrim i tyre kundër Islamit apriori do ti shmangë dhe do t'ua pamundësojë kuptimin e esencës së kësaj feje dhe nuk do të arrijnë tek ndonjë përfundim i dobishëm.

### ISLAMI

Fjala “Islam”do të thotë paqe mes njerëzve dhe nënshtrim i plotë ndaj vullnetit të Allahut (xh.sh.). Gjithashtu do të thotë paqe mes individit dhe vetvetes së tij, mes tij dhe të tjerëve si dhe devotshmëri e plotë ndaj Allahut (xh.sh.).

Të gjitha këto kuptime janë të përfshira në Kur'anin Famëlartë nga i cili mëson individit që të bëjë mirë për të tjerët dhe që ta pastrojë vetveten duke vepruar sipas asaj që është shpallur në Kur'an.

Muhamedi (a.s.) ishte i dërguari i fundit në Islam, por jo edhe i vetmi, sepse myslimanët besojnë në të gjithë pejgamberët e mëparshëm: në Ibrahimin (a.s.), Musain (a.s.), Isain (a.s.) etj., etj.

Allahu (xh.sh.) thotë: *“Ne edhe ty [o Muhamed] ta zbritëm Librin me të vërtetën, si përmbyshës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ketebeni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshtitë.”*<sup>3</sup>

3. El-Maideh 5:48.

### IMANI-BESIMI

Islami mëson myslimanët të besojnë në një Zot [ALLAHUN], në engjëjt, librat, pejgamberët, ringjalljen pas vdekjes dhe në ditën e Kijametit. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Kushdo që mobon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe ditën e Kijametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg prej udhës së drejtë”*<sup>4</sup>.

Myslimanët besojnë në dallimin mes së mirës dhe së keqes. Çdo gjë që ka krijuar Allahu është e mirë. Nëse përdoret aty ku është i kënaqur Allahu, ajo do të na shpjerë në lumturi, por nëse keqpërdoret ajo do të shpjerë në të keqe dhe pendim. Allahu (xh.sh.) thotë:

*“Kush bën mirë, e bën për dobi të vet, e kush punon keq, punon në dëm të vet. Zoti yt nuk u bën padrejtësi robërve të Tij”*<sup>5</sup>.

### ALLAHU (XH.SH.)

Të gjithë myslimanët i luten një Zoti {Allahut}. Ai është i Gjithëfuqishmi, i Gjithëdijshtmi, i Drejti, Ndihmëtar i tërë njerëzimit, i Cili as s'ka lindur kënd dhe as nuk është i lindur. Ai është drita e qiejve dhe e tokës. Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërësi.

Është i pari pa fillim dhe i fundit pa mbarim. Ai është i përjetshmi. Ndërkaq sa i përket përdorimit nga Isai (a.s.) të shprehjes “At”për Zotin e tij, kjo është shenjë e mëshirës dhe bujarisë së Allahut.

### PARIMET E ISLAMIT

Myslimanët janë të obliguar të veprojnë sipas parimeve vijuese:

1- Besimi i paluhatshtëm se nuk ka hyjni tjetër pos Allahut.

4. En-Nisa 4:136.

5. Fussilet 41:46.

2- Namazi [për pastrimin e shpirtit dhe trupit.

3- Agjërimi-shërim i shpirtit dhe trupit, edukues i ndjenjave në raport me njerëzit, kafshët, bimët; mësues i durimit dhe forcues i vullnetit.

4- Dhënia e zekatit: E drejtë e të varfërve nga pasuria e të pasurve 2.5% nga kapitali, çdo vit hixhrij, nëse ajo pasuri arrin nisabin, që është e barabarte me vlerën e 85 gr. ar. Edhe pse nga i pasuri nuk kërkohet më shumë se kjo vlerë, ai nuk duhet të mjaftohet me kaq, sepse prej obligimeve më të shenjta të myslimanit është ndihma ndaj të varfrit dhe sjellja e mirë ndaj tij.

5- Haxhi në Mekë: Çdo mysliman e ka obligim vizitën e Qabesë një herë në jetë nëse ka mundësi. Myslimani atje nuk adhuron ndonjë gur apo pejgamber, por ai vetëm mediton në kuptimet e shenjta të Islamit, e falënderon Allahun, dhe kështu e kryen detyrën e Haxhit. Haxhi u ofron mundësinë [myslimanëve] të ardhur nga vise të ndryshme të botës që të njihen mes veti dhe të forcojnë lidhjet [dashurinë] reciproke mes tyre.

### NUK KA DHUNË NË FE

Kur'ani na mëson se nuk ka dhunë në fe, duke u shprehur kundër çdo forme të dhunës. Të gjitha luftërat në Islam janë zhvilluar për të mbrojtur fenë dhe besimin. Edhe pse në disa kohëra, disa udhëheqës të vendeve Islame luftuan për interesa e përfitime të kësaj bote, me çka ata zbritën nga piramida e formës të cilën e realizuan [arritën] paraardhësit e tyre derisa i pasonin mësimet e vërteta të fesë së tyre. Andaj nuk duhet të kritikojmë Islamit për këtë dështim, sepse ai është kundër këtyre luftërave.

Duhet të theksojmë se edhe pjesëtarët e feve të tjera kanë zhvilluar luftëra në emër të fesë me të njëjtat qëllime, por feja është e pastër nga këto luftëra.

Islami i ka dhuruar njeriut liri absolute të mendimit. Ai e lartëson shpirtin e njeriut nga dhuna, për të jetuar kështu në paqe të përvetshme.

Njeriu nuk ka nevojë për rituale fetare që të bëhet mysliman. Islami jo vetëm që është fe praktike që përhapet shpejt, por ai gjithashtu i përshtatet natyrës njerëzore. Çdo fëmijë për nga natyra është i përshtatshëm [i gatshëm] për tu bërë mysliman. Në këtë pikëpamje janë fjalët e Muhamedit (a.s.): “Çdo fëmijë lind në fenë e pastër natyrore, e prindërit pastaj e edukojnë si hebraik, kristian apo zjarradhurues.”

### UNË JAM MUSLIMAN [NJERI I PAQES]

Unë besoj në një Zot [Allah]; Atë të cilit çdo krijesë i drejtohet e i mbështetet për çdo nevojë, Ai është me ne gjithmonë. Allahu (xh.sh.) thotë: *...“Ai është që krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Arsin [Fron]. Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zhbret prej qiellit dhe çfarë ngrihet drejt tij. Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni”*<sup>6</sup>. Atij nuk i përngjet askush, askush nuk është si Ai, Ai është Krijues i çdo gjëje.

Unë besoj në të gjithë të dërguarit e Tij pa dallim mes Musait (a.s.) dhe Isait (a.s.), apo Muhamedit (a.s.).

Për mëkatet e mia kërkoj falje të drejtpërdrejtë nga Allahu pa ndonjë ndërmjetësim. Unë e përmend Allahun në çdo kohë. Atë e ndiej në veten time,

6. El-Hadid 57:4.

rreth meje dhe kudo që shkoj. Ai gjykon veprat e mia, ndërsa unë i kryej urdhrat e Tij të kërkuara në Kur'an.

– Unë zbatoj të gjitha parimet islame, fal namaz, agjëroj, jap zekatin, vizitoj Qabenë.

– Është e ndaluar vetëvrasja apo vrasja e dikujt tjetër. Islami kërkon nga njerëzit që të jetojnë në paqe.

– Unë nuk bëj prostitucion, i druham rrugëve të cilat më shpiten në humbje duke ditur se njeriu është i krijuar i dobët. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Dhe mos iu afroni imoralitetit [zinasë], sepse vërtetë ai është veprë e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe”*<sup>7</sup>.

– Lumturia e mirëfilltë është ajo të cilën e arrijmë pa u penduar më pastaj pas saj. Kjo lumturi arrihet në pasurimin e shpirtit me vlera të moralit. Shembulli i kësaj është tregimi i njeriut i cili dëshironte të bënte prostitucion porse ndërgjegjja e tij e ndalonte, por që më pastaj nën ndikimin e alkoolit ai e mbyti njeriun i cili dëshiroi ta ndalonte nga akti i prostitucionit. Andaj nuk mbetet asgjë tjetër, veçse të konkludojmë se alkooli është fajtor i mëkateve.

– Unë nuk luaj bixhoz i cilitdo lloji qoftë ai, sepse bixhozçiu nuk e nderon furnizimin e tij. Ta vësh fatin tënd në peshojën e lojës së letrave apo ngjashëm është dobësi e turpshme për personalitetin tënd. Allahu (xh.sh.) thotë: *“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe bedhja e shijetës [për fall] janë vepra të ndyta të shejtanit. Pra largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar”*<sup>8</sup>.

– Myslimani as nuk merr dhe as nuk jep para me kamatë, sepse ajo është

rrugë e shkatërrimit. Ai mund të jep hua për t’u ndihmuar nevojtarëve, por duhet kujdesur për ruajtjen e kapitalit të vet. Allahu (xh.sh.) thotë: *“O ju që besuat, keni frikë Allahun dhe nëse jeni besimtarë të sigurtë, hiqni dorë prej asaj që ka mbetur nga kamata. E në qoftë se nuk e bëni këtë [nuk hiqni dorë nga kamata], atëherë binduni se jeni në konflikt me Allahun dhe të dërguarin e Tij. E nëse jeni penduar, atëherë juve u takon kryet e mallit tuaj, askënd nuk e dëmtoni, as vetë nuk dëmtoheni. Por në qoftë se ai [borxhliu] është në gjendje të vështirë, atëherë bëni një pritje deri të vijë një çlirim. E ta falni [borxhin] në emër të lëmoshës, ajo nëse e dini, është shumë më mirë për ju.”*<sup>9</sup>

– Myslimani nuk e përgojon askënd dhe nuk i përhap fjalët. Ata që e veprojnë këtë janë në pozitë sikur të kishin ngrënë mishin e vëllait të tyre të vdekur. Kjo ka të bëjë me ata, të cilët njollosin të tjerët prapa shpine, pa ju dhënë rast që të vetëmbrohen. Allahu (xh.sh.) thotë: *“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe keni frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar [nga Zoti]. O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë te përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin [duke nënçmuar njeri-tjetrin] dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë. O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgojoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra*

7. El-Isra 17:32.

8. El-Maideh 5:90.

9. El-Bekare 2:278-280.

*e urrenit! Kini frikë nga ndësbkimi i Allahut, e Allahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.*<sup>10</sup>

### BESIMI DHE VEPRA

Besimi pa vepër është besim i mangët. Besimi i vetmuar është i pamjaftueshëm nëse nuk manifestohet me vepra. Myslimanët besojnë se do të japin llogari për veprat e tyre qoftë në këtë botë apo në botën tjetër. Secili mysliman është përgjegjës për veprën e tij dhe askush nuk mund të bartë përgjegjësinë e gabimeve të të tjerëve. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Pasha kobën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njeri-tjetrin t’i përmbahen së vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”*<sup>11</sup>

### ISLAMI DHE SHOQËRIA POZITA E FEMRËS NË ISLAM

Burri dhe gruaja rrjedhin nga një origjinë. Secili prej tyre është i pajisur nga ana e Allahut me aftësi mendore dhe morale që të veprojnë me to; që të jenë përgjegjës në jetën e tyre, ndërsa gruaja për aq sa ka mundësi t’i kryej ato.

Si burri ashtu edhe gruaja kanë detyra të cilat i përshtaten natyrës së tyre. Në funksionin e gruas myslimane ajo duhet t’i bindet urdhrave të burrit, ndërsa si nënë ajo duhet të edukojë fëmijët e saj; thënë shkurt ajo duhet të kalojë shumicën e kohës së saj në edukimin dhe rregullimin e familjes së saj, si obligim primar i saj. Nëse gruaja është e shtyrë të punojë për shkak të

gjendjes së rëndë ekonomike, duhet të zgjedhë punën që i përshtatet natyrës së saj dhe konform parimeve islame, si p.sh. mësuese, infermiere, gjinekologe apo pediatre, etj.

Femra sipas Islamit ka arritur çdo respekt dhe të drejtë kudo që të jetë, edhe pse ajo në disa vende të Lindjes nuk i gëzon të drejtat e saj, dhe kjo si pasojë e mosrealizimit të parimeve islame në ato vende. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”*<sup>12</sup>

### SHPIFJET E ARMIQVE TË ISLAMIT

Mendimet e gabuara të postuara kundër Islamit në librat e autorëve fanatikë nuk janë aspak të vërteta. Ata pa asnjë të drejtë shpërndajnë librat e tyre me shpifje në të katër anët e botës.

Gjykuesi i drejtë duhet të njohë së pari parimet bazë të një çështje, për të ardhur deri te mendimi i drejtë për të. Siç duket këta fanatikë veprojnë në shërbim të aspiratave kolonizuese, sepse ata heshtin para torturave që i bën Perëndimi kundër Lindjes së lënë doresh, kurse nga ana tjetër pretendon se lufton robërinë dhe i mbron të dobëtit. Ata kanë gjetur rrugën më të lehtë për shkatërrimin e popujve duke bërë shpërndarjen e alkoolit dhe përhapjen e dukurive të tjera negative. A thua vallë, këto janë reformat që paraqet Perëndimi për Lindjen?

10. El-Huxhurat 49:10-12.

11. El-Asr 103:1-3.

12. Err-Rrum 30:21.

## BARAZIA DHE VËLLAZËRIMI NË ISLAM

Islami është fe e të gjithëve, për këtë ai thërret në barazinë mes të gjithë njerëzve para Krijuesit të tyre. Përkundër vendeve të ndryshme në të cilat jetojnë, ata duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në marrëdhënie reciproke të mira ku i pasuri ndihmon të varfrin. Të gjitha këto obligime reciproke përbëjnë sistemin e ekzistencës shoqërore. Çdo ndarje dhe diskriminim sipas racës, ngjyrës a kulturës nuk është prej parimeve Islame. Të gjithë njerëzit në Islam janë një familje e përbërë nga të zinjte dhe të bardhët, të gjithë vëllezër me njëri-tjetrin.

Allahu (xh.sh.) thotë: *“O ju njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush te Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijsbëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”*<sup>13</sup>

## GJYKIMI PERSONAL

Islami e inkurajon mendimin personal si dhe e respekton besimin e çdo individit në kufijtë e kuptimit të drejtë të fesë së pastër. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Thuaj (o Muhamed): “Unë ju këshilloj vetëm një gjë: ngrihuni singërisht për Allahun, dy nga dy ose një nga një, e pastaj gjykoni për shokun tuaj (Muhamedin) që nuk është i çmendur. Ai është dërguar vetëm që t’ju paralajmërojë para një dënimi të rëndë.”*<sup>14</sup>

## ISLAMI DHE SHKENCA

Në Islam çdo mysliman e ka për detyrë arritjen e sa më shumë njohurive.

Allahu (xh.sh.) thotë: *“...se Allahu do t’i ngrëjë në shkallë të lartë ata midis jush që besojnë dhe që u është dhënë dija.”*<sup>15</sup>

## PUNA

Pejgamberi (a.s.) thotë: *“Jepja punëtorit pagesën para se ti thahen djersët.”* Çdo punë e dobishme e cila e bën njeriun të jetojë i lumtur është punë e ndershme, ndërsa papunësia në Islam konsiderohet mëkat.

Allahu (xh.sh.) thotë: *“Thuaj: Punoni, se Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët do të shohin punën tuaj. Së shpejti do të keteheni te Ai që të di të dukshmen dhe të padukshmen e Ai do t’ju njoftojë për atë që keni bërë.”*<sup>16</sup>

## TEORIA EKONOMIKE

Qeveria Islame është e obliguar t’u siguroj banorëve të saj nevojat elementare në strehim, ushqim dhe veshmbathje. Dihet mirëfilli se është praktikuar teoria e ekonomisë Islame për disa shekuj dhe ka treguar sukses. Islami i siguron punëtorit rezultatit e punës qoftë ajo e vogël apo e madhe, sipas natyrës së saj.

Prona private ka lindur si rezultat i një pune serioze të pronarit. Për këtë arsye Islami e respekton pronën private duke mbrojtur motivet kryesore të punës dhe jetës së pronarit.

## TRASHËGIMIA NË ISLAM

Natyra e njeriut kërkon që emri i tij të mbetet përgjithmonë mbi sipërfaqen e tokës, pasi ai pas vetes le fëmijët dhe nipërit e tij, gjë që e shtyn atë të grumbullojë sa më shumë pasuri,

13. El-Huxhurat 49:13.

14. Sebe’ 34:46.

15. El-Muxhadele 58:11.

16. Et-Teube 9:105.

respektivisht trashëgimi për pasardhësit e tij. Depozitimi i kësaj pasurie konsiderohet një faktor i rëndësishëm në zhvillim dhe bazë e trashëgimisë. Trashëgimia njëherazi konsiderohet mjet për shpërndarjen dhe kthimin e drejtë të pasurive në Islam, sepse gruaja, djemtë dhe vajzat marrin pjesë në pasurinë e babait të tyre. Nëse personi nuk lë pas vetes fëmijë atë e trashëgon gruaja me pjesëmarrjen e babait, motrave dhe vëllezërve të tij.

Trashëgimia konsiderohet si mjet për shpërndarjen e pasurisë në vend të grumbullimit të saj te një pakicë e vogël që shpie në shtresën feudale. Njëkohësisht realizohet drejtësia dhe mëshira mes fëmijëve dhe të afërmeve. Islami konsideron njeriun trashëgimtar të pasurisë e cila i është dhënë amanet nga Allahu (xh.sh.). Për këtë ai është i obliguar ta menaxhojë atë në shërbim të njeriut. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Mos e lini në dorë të të paafteve mendërisht pasurinë tuaj që Allahu jua ka dhënë si mjet jetese për ju; ushqejini dhe vishini ata prej saj dhe u thoni atyre fjalë të mira.”*<sup>17</sup>

Mendjelehtëve nuk duhet tu dhurohet pasuria e tyre derisa të arrijnë pjekurinë. Me këtë ruhet pasuria e tyre nga shpërbërja, pasi ajo konsiderohet thesar për dobinë e njerëzimit.

### TREGTIA

Tregtia konsiderohet ndër shtyllat kryesore të ekonomisë Islame, ku janë numëruar  $\frac{9}{10}$  e fitimit. Për këtë Islami ka vënë rregulla të prera për vendosjen e sigurisë në transaksionet tregtare. Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Si blerësi edhe shitësi gëzojnë lirinë e zgjedhjes

derisa të vijë koha kur ndahen. Nëse i qëndrojnë besnikë së vërtetës dhe singërisht e bëjnë këtë, marrëveshja e tyre do të jetë e bekuar, por nëse preferojnë mashtrimin dhe hilet, marrëveshja e tyre, herët a vonë do të dështojë.”<sup>18</sup>

### MONOPOLI

Rezervimi i ushqimit me qëllim fitimi të mëvonshëm është i ndaluar në Islam. Islami ka vendosur për këtë rregulla të cilat kontrollojnë tregtinë botërore për të qenë në përshtatshmëri me humanizmin njerëzor.

### SHFRYTËZIMI

Shfrytëzimi i padrejtë është i refuzuar me të gjitha format e tij derisa të mos bëhet e lehtë jeta për të gjithë njerëzit. Shteti është i obliguar të paguajë borxhet e të vdekurit për të parandaluar çrregullimet në treg, nëse i vdekuri nuk ka lënë nga pasuria e tij e mjaftueshme. Pejgamberi (a.s.) thotë: “Unë kam të drejtë mbi besimtarët më shumë se vetvetja e tyre, andaj kush vdes prej tyre dhe pas vetes ka lënë borxh, më takon mua ta paguaj, ndërsa nëse ka lënë pasuri e paguajnë trashëgimtarët e tij.”

### KAMATA

Kamata është e ndaluar në Islam. Parimi themelor për këtë është “Nuk ka dobi pa punë,

as pasuri pa angazhim”. Allahu (xh.sh.) thotë: *“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë. Allahu nuk i do ata që janë mohues-gjynahqarë.”*<sup>19</sup> Për këtë edhe Kur’ani e ka

17. En-Nisa 4:5.

18. Sahih Buhari.

19. El-Bekare 2:276.

krahasuar atë që vepron me kamatë si i çmenduri nga të prekurit e djallit.

### **NATYRA E ISLAMIT**

Islami është feja e vetme në botë e cila zbriti për mbarë njerëzinë dhe për të gjitha kohërat. Për këtë arsye:

1- Ajo është feja e vetme e cila përshtatet me natyrën e njeriut si moralisht ashtu edhe logjikisht pa ndonjë kundërthënie.

2- Ajo është feja e cila iu zbrit të gjithë pejgamberëve të dërguar nga Allahu (xh.sh.) te popujt të cilët humbën rrugën e drejtë për shkak të injorancës, moskuptimit të drejtë të saj, si dhe si rezultat i pasimit të epsheve të tyre.

3- Islami kërkon nga besimtarët e tij që t'i besojnë të gjithë pejgamberët e Zotit.

4- Ka ngritur lart rolin e arsyes dhe mendimit si gjykues i vetëm në çdo polemikë rreth besimit, sjelljes shoqërore dhe personale.

5- Thërret në barazi absolute mes të gjithëve, ndërsa ka kritikuar ashpër çdo konflikt mes popujve me qëllim dallimi mes racave njerëzore.

Allahu xh.sh.thotë: *“O ju njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush te Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë.”*<sup>20</sup>

Përktheu nga arabishtja:

**Feim HOXHA**

---

20. El-Huxhurat 49:13.

## Toleranca dhe mirëkuptimi ndërjetar si dimension i historisë kombëtare të shqiptarëve

Prof. Dr. Ferit Duka  
UET, Tiranë

### Abstrakt

*Të dhënat e përftuara nga burime të ndryshme historike vërtetojnë qartësisht ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme. Lëvizja Kombëtare Shqiptare për çlirim nga sundimi osman dhe krijimin e shtetit kombëtar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të bashkëpunimit të singertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, të cilët, pavarësisht nga përkatësia e ndryshme fetare, dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar. Solidariteti dhe toleranca fetare midis shqiptarëve u shfaqën me një qartësi të veçantë edhe në periudhat e mëvonshme. Imam Vehbi Dibrën, Atë Luigj Bumçin, Atë Gjergj Fishtën, Mehdi Frashërin, Mihal Turtullin, Hoxhë Kadrinë, Luigj Gurakuqin, Fan Nolin dhe Faik Konicën, etj., i shohim të gjithë së bashku në Shqipëri apo jashtë saj në mbrojtje të çështjes shqiptare.*

*Pas shembjes së komunizmit në Shqipëri dhe rivendosjes së lirisë së besimit, në mbarë vendin u bënë përpjekje të mëdha për rikuperimin dhe gjallërimin e jetës fetare. Që në fillimet e këtij procesi u rishfaq në një mënyrë mbresëlënëse tradita e vyer e mirëkuptimit, tolerancës dhe bashkëpunimit vëllazëror të shqiptarëve të besimeve të ndryshme. Shumë prej nesh i kujtojnë më së miri ato ditë të entuziazmit dhe të ngazëllimit të përgjithshëm kur myslimanë, ortodoksë e katolikë, morën pjesë në ceremonitë e njëri-tjetrit për ribashkimin e institucioneve fetare, sikundër edhe sot e kësaj dite festojnë së bashku ditët e shenja të njëri-tjetrit.*

**H**istoria e popullit shqiptar ofron një model pothuajse unik për sa u përket veçorive të kompozicionit fetar të këtij populli në rrjedhën e shekujve. Shqiptarët ishin ndër të parët popuj të Evropës që përqaftuan Krishterimin në fillimet e erës së re të historisë së njerëzimit. Skizma e vitit 1054 kur

Kisha Katolike (Perëndimore) u nda përfundimisht nga Kisha Lindore (Ortodokse), shënoi ndarjen e parë të shqiptarëve në ndjekës të ritit katolik dhe në ndjekës të ritit ortodoks. S'ka dyshim se prania e riteve të ndryshme të krishtere në mesin e shqiptarëve krijonte një gjendje specifike në krahasim me popujt e tjerë të Ballkanit, të

cilët pothuajse ishin homogjenë nga pikëpamja e strukturës fetare.

Megjithatë, pamja fetare në tokat shqiptare do të pësonte ndryshime thelbësore, duke filluar nga shek. XV. Me vendosjen e sundimit osman në tokat shqiptare, përkatësia e krishterë e shqiptarëve (pjesërisht në ritin ortodoks dhe pjesërisht në atë katolik), filloi të reduktohej në dobi të përhapjes së Islamit, fe zyrtare e shtetit osman.

Nëse vështrohet procesi i islamizimit nga pikëpamja sociale, bëhet e qartë se pjesa e sipërme e piramidës shoqërore, fisnikëria shqiptare, ishte e para që provoi dukurinë e kalimit në Islam, ndërsa, nga ana tjetër, vëmë re se depërtimi në shkallë të gjerë i fesë islame në radhët e popullit shqiptar gjeti shprehje pikësëpari në qytete.

Qytetet kryesore shqiptare, si Elbasani, Berati, Prizreni, Shkodra, Vuçitërna (sot: Vushtrria-F.D.), etj. u bënë seli e dinjitarëve të lartë të pushtetit provincial osman si, e sanxhakbejlerëve, allajbejlerëve, kadijve, etj. Qytete të tjera më të vogla u shndërruan në qendra të kazave apo nahijeve. Nga ana tjetër, degët kryesore të veprimtarisë ekonomike në qytete, zejtaria dhe tregtia, filluan të modelohen në përputhje me kërkesat e ushtrisë dhe të funksionarëve të pushtetit osman në provinca dhe në qendër. Në këto rrethana, fillimi i rimëkëmbjes ekonomike dhe shoqërore të qyteteve shqiptare në fund të shek. XV dhe fillim të shek. XVI, përkon në kohë edhe me fillimet e depërtimit të Islamit në masën e gjerë të popullsisë qytetare. Ndërsa për mjaft qendra qytetare fillimet e këtij procesi konstatohen vetëm në vitet '20-30 të shek XVI, për

disa të tjera duket se feja e re ka nisur të “zbresë” nga parësia e islamizuar në masën e popullsisë qytetare të krishterë, të paktën që nga vitet '80 të shek. XV.

Kështu, p.sh., qytetet e Vlorës, Gjirokastrës dhe Beratit, ende në fillim të shek. XVI nuk kishin të regjistruar asnjë shtëpi myslimane (këtu përjashtohet klasa ushtarake-administrative pjesëtarët e së cilës nuk regjistroheshin në defterët osmanë, sepse nuk bënë pjesë në popullsinë taksapaguese). Ndryshe nga qytetet e lartpërmendura, që në vitin 1485 qyteti i Shkodrës numëronte 26 shtëpi myslimane, ndërsa qyteti i Pejës 23 syresh. Për më tej, në qytetin e Vuçitërnës më 1487, ekzistonte “bashkësia e myslimanëve” me 33 shtëpi nga 107 shtëpi që kishte qyteti; po këtë vit në qytetin e Prishtinës numëroheshin 51 shtëpi të islamizuara nga 299 shtëpi, që kishte gjithsej qyteti; ndërsa qyteti i Tetovës, që më 1468 kishte të regjistruara 41 shtëpi të kthyer në Islam nga 164 shtëpi që numëronte gjithsej ky qytet.

Ndërsa në pjesën qytetare të popullsisë shqiptare feja islame u përhap me ritme relativisht të shpejta, veçanërisht gjatë gjysmës së dytë të shek. XVI, dukuria e apostazisë (lëshimit të fesë) ende kësaj kohe nuk ishte karakteristike për popullsinë fshatare. Dallimet e mëdha midis popullsisë qytetare dhe asaj fshatare për sa i përket shkallës së islamizimit, duken në faktin se aty nga fundi i shek. XVI përqindja e islamizimit të së parës kapte shifrën 49 në një kohë që e dyta ishte islamizuar vetëm në rreth 17% të saj. Megjithatë, kalimi total në Islam i parësisë shqiptare, konsolidimi i pozitave të fesë islame në

qytete nëpërmjet depërtimit masiv të saj në radhët e popullsisë qytetare, ishin premisa të fuqishme për shpejtimin e ritmeve të islamizimit edhe në pjesën rurale të popullsisë.

Për këtë arsye, duke filluar që nga shek. XVII, burimet historike flasin për kalime masive në Islam të popullsisë së krishterë. Gjatë kësaj kohe një numër i madh fshatrash u islamizuan tërësisht. Në mjaft fshatra të tjera konstatohet rënie e dukshme në numrin e shtëpive të krishtera nga njëra anë dhe shtim i shtëpive myslimane nga ana tjetër.

Në vitin 1624 në tërë dioqezën katolike të Tivarit nuk numëroheshin më shumë se 2000 banorë të besimit katolik, ndërsa në qytetin me të njëjtin emër kishte mbetur vetëm një kishë e ritit të lartpërmendur, e cila mundi të shërbente si e tillë deri në fund të shekullit XVII. Sipas një relacioni të kreut të Arkipeshkvisë së Tivarit V. Zmajević, përpiluar më 1703, procesi i islamizimit në dioqezat e përfshira brenda juridiksionit të arkipeshkvisë së lartpërmendur (Shkodra, Pulti, Zadrima, Lezha dhe Durrësi) kishte arritur në kuota të konsiderueshme. Në vitet '20 të shek. XVIII, në nahijet dhe në kazatë e Shqipërisë së Mesme, popullsia pothuajse tërësisht kishte përqafuar besimin islam. Gjatë shek. XVIII edhe popullsia e krahinave të Shqipërisë Jugore u fut në rrugën e islamizimit masiv. Në vitet 1735-40 pjesa dërrmuese e banorëve të Vlorës, Beratit dhe krahinave përreth, e kishte lëshuar fenë ortodokse duke kaluar në Islam.

Vrojtimi i dinamikës së procesit të islamizimit tregon se rreth mesit të shek.

XVIII, struktura e re fetare e popullit shqiptar, d.m.th. përpjesëtimet sasiore midis popullsisë së krishterë dhe asaj të islamizuar, kishin arritur pak a shumë në nivele të qëndrueshme, të cilat, me ndryshime të pakta, do të ruhen deri në ditët tona. Kalimet e mëvonshme në Islam, nga ana numerike nuk ishin të asaj shkalle sa të kishin ndikime të ndjeshme në strukturën konfesionale të popullit shqiptar.

Islami u përhap në tokat shqiptare jo vetëm në variantin e vet kryesor, sunit, por edhe në formën e sekteve (tarikateve) të ndryshme siç ishin Bektashizmi, Halvetizmi, Rufaizmi, etj. Dëshmi të pranisë së këtyre sekteve mistike në territorin shqiptar ishin teqetë e ndërtuara në një numër vendbanimesh. Midis sekteve islamike në fjalë, Bektashizmi fitoi një popullaritet dhe shtrirje të konsiderueshme në viset shqiptare.

Natyra liberale dhe eklektike e Bektashizmit e bëri këtë sekt mjaft të pranueshëm për mjedisin ballkanik e veçanërisht për atë shqiptar, ku feja e krishterë bashkëjetonte me elemente të fuqishëm të trashëgimisë pagane të periudhës parakristiane. Në këtë mënyrë, përhapja e Bektashizmit në tokat shqiptare, u bë një nga aspektet kryesore të procesit të islamizimit të popullsisë, duke e shoqëruar këtë proces që nga fillimet e tij. Edhe pse siç u theksua më sipër, tradita bektashiane duhet të ketë qenë e hershme në Shqipëri (fundi i shek. XIV- fillimet e shek. XV), burimet historike të njohura deri më tani, i regjistrojnë gjurmët e saj që nga gjysma e dytë e shek. XVII.

Ritmet e përhapjes së Bektashizmit

në radhët e popullit shqiptar u shpejtuan gjatë gjysmës së dytë të shek. XVIII dhe fillimeve të shek. XIX. Në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XIX përmasat gjeografike të shtrirjes së Bektashizmit në viset shqiptare ishin pothuajse të trajtës përfundimtare dhe më pas, mund të flitet përgjithësisht vetëm për evolucion të brendshëm të këtij sekti në Shqipëri dhe jo për ndonjë ridimensionim hapësinor të përhapjes së tij.

Me përhapjen e fesë islame, në viset shqiptare u thellua më tej diversiteti fetar, gjë që potencialisht krijonte kushte për përçarjen dhe shpërbërjen e kombit shqiptar. Mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi, për arsye se realiteti i ri fetar ishte një mozaik i vendosur mbi një shtrat të fuqishëm, të përforcuar në rrjedhën e historisë nga veprimi i faktorëve të konvergencës, siç ishin tiparet etnopsikologjike, gjuha dhe kultura e përbashkët, etj. Nga ana tjetër, ashtu sikundër Krishterimi (Ortodoks apo Katolik) edhe Islami tek shqiptarët, përgjithësisht, mbeti një fe popullore (veçanërisht në pjesën rurale të popullsisë), larg intolerancës dhe fanatizmit. Për më tepër, përhapja në viset shqiptare e sekteve (tarikateve) të ndryshme islamike krahas Islamit sunit, e zbuti së tepërmi klimën e marrëdhënieve ndërfitare në trevat shqiptare. Një rol të veçantë në këtë drejtim luajti urdhri bektashian, duke predikuar tolerancën dhe mirëkuptimin mbarëshqiptar, kontribuoi në frenimin e prirjeve ndarëse në gjirin e popullsisë dhe në fuqizimin e lidhëzave të unitetit mbi baza etnike e kombëtare.

Të dhënat e përfutuara nga

burime të ndryshme historike mund të konsiderohen si vërtetimi më i sigurt për ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës paqësore midis shqiptarëve të besimeve të ndryshme. Misionarët katolikë të shek. XVII në raportet e tyre dërguar Selisë së Shenjtë të Romës, na e përcjellin me qartësi një realitet të tillë kur theksojnë se nga që rrinë vazhdimisht bashkë, të krishterët mësonin shumë sende nga myslimanët, si p.sh., të kremtonin ditën e premte, që ishte festa kryesore e këtyre të fundit, ndërsa myslimanët, si të prejardhur nga të krishterët, ruanin shumë zakone të këtyre të fundit. Të dy palët ftonin njëri-tjetrin në kremtime festash, në raste vdekjesh, në dasma, etj. Shumë nga të krishterët, sipas të njëjtave burime, duke marrë e dhënë me myslimanët, besonin se edhe ata çliroheshin nga mëkatet, në se kishin të tilla. Një gjë e tillë e vinte re edhe një vëzhguese e huaj në Stamboll, e cila më 1717 në lidhje me shqiptarët shkruante: “Këta njerëz, që jetojnë midis të krishterëve dhe muhamedanëve dhe që nuk ua kanë marrë dorën mosmarrëveshjeve (fetare-F.D.), deklarojnë se nuk janë aspak në gjendje të gjykojnë, se cili besim është më i miri. Por, për hir të së vërtetës, ata i ndjekin me maturi të dy besimet. Shkojnë në xhami të premtëve dhe në kishë të dielave, duke nxjerrë si pretekst se në ditën e gjykimit do të kenë mbrojtjen e profetit të vërtetë; mirëpo, se kush është ky profet, nuk janë në gjendje ta përcaktojnë në këtë botë”.

Veçanërisht gjatë shekujve kur procesi i islamizimit të popullsisë shqiptare ishte në zhvillim e sipër, vija dalluese midis pjesës së krishterë dhe

asaj të islamizuar të popullsisë, paraqitej jo fort e theksuar. Kështu, p.sh. në mjaft raste, ndryshimet në përkatësinë fetare u neglizhuan në sfera të tilla të rëndësishme të jetës shoqërore, siç ishin marrëdhëniet martesore. Burimet historike të shek. XVII-XVIII jo rrallë ofrojnë të dhëna, sipas të cilave, vajza të krishtera martoheshin me djem të islamizuar dhe se këta të fundit u kërkonin priftërinjve katolikë, që grave të tyre të krishtera t'u jepeshin sakramentet e shenjta (pagëzimi, kungimi, rrëfimi etj.). Për më tej, ishin të shumta rastet kur edhe familje tërësisht të islamizuara u kërkonin priftërinjve pagëzimin e fëmijëve të vet. Në zonën rurale sidomos, toleranca në zbatimin e normave dhe të porosive të fesë islame ishte akoma më e shprehur. Në mesin e popullsisë fshatare, ishin pothuajse të panjohura dukuri të tilla si mbulimi i fytyrës së grave, etj. Në këtë segment të popullsisë shqiptare, për shkak të prirjeve konservuese më të fuqishme, bashkëjetesa e traditave parakristiane (pagane), kristiane dhe islamike, ishte më karakteristike se sa në mjedisin qytetar.

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e përbashkët e popullsisë shqiptare, si të krishtere ashtu dhe myslimane, në lëvizjen çlirimtare kundërosmane, flet qartë për cektësinë e ndarjes fetare përballë vetëdijes së bazuar në njësinë etnike e kombëtare. Midis të tjerash, këtë fakt e përforcon edhe Pjetër Budi, një nga prelatët katolikë dhe intelektualët e shquar shqiptarë të shek. XVII, i cili në një projekt të vetin të vitit 1621, për organizimin e kryengritjes çlirimtare në Shqipëri, llogariste si pjesëmarrës në të,

jo vetëm pjesën e krishterë, por edhe atë myslimane të popullit shqiptar.

Realiteti i ri konfesional, i cili gjente shprehje në ekzistencën tashmë të katër komuniteteve fetare (mysliman-sunit e bektashian, ortodoks dhe katolik), fatmirësisht në rastin shqiptar, nuk u shoqërua me krijimin e një realiteti të ri etnik. Si popullsia e krishterë, ashtu dhe ajo e islamizuar, pavarësisht nga dallimet fetare, vijuan të ruanin përkatësinë etnike shqiptare, e cila shprehej në gjuhën, zakonet, traditat dhe përgjithësisht në konstitucionin shpirtëror të përbashkët. Fuqia e lidhjeve tradicionale midis shqiptarëve të përforcuara në rrjedhën e historisë ishte e tillë që neutralizonte një përçarje të mundshme të shkaktuar nga diversiteti fetar. Në këtë mënyrë, vetëdija kombëtare e shqiptarëve mbeti parësore në identifikimin e tyre përpara të huajve. Ndryshe nga provincat e tjera të Perandorisë Osmane, ku njerëzit që pyeteshin se ç'ishin, të përgjigjeshin se ishin “turq”, apo “kristianë”, në Shqipëri për të njëjtën pyetje përgjigja ishte “jam shqiptar”.

Bashkëjetesa paqësore dhe toleranca në marrëdhëniet ndërfetare si një vlerë e spikatur dhe e qëndrueshme e popullit shqiptar ka gjetur shprehje të qartë edhe në veprën e njohur “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët” të rilindasit shqiptar Pashko Vasë Shkodrani, ku, ndër të tjerash thuhet: “Myslimanët e Shqipërisë janë shqiptarë, si dhe të krishterët; flasin po atë gjuhë, kanë po ato zakone, vazhdojnë po ato doke dhe po ato tradita. Në mes atyre dhe të krishterëve kurrë s'ka pasur smira të rrënjosura as dhe armiqësira shekullore. Ndryshimi i fesë kurrë

s'ka qenë një shkak për t'i shtyrë në një përçarje sistematike; myslimanët dhe të krishterët, me pak përjashtime, gjithmonë kanë jetuar në një shkallë barazie, që gëzojnë po ato të drejta dhe përmbushin ato detyra”.

Mjaft domethënëse janë në këtë drejtim edhe përshtypjet e përfutuara nga publicistja dhe etnologja e njohur E. Durham, e cila e ka vizituar Shqipërinë në vitet e para të shek. XX. Gjatë udhëtimit në juglindje të vendit ajo kishte takuar kajmekamin e Leskovikut, një shqiptar i ri që fliste mirë frëngjisht. Në bisedë e sipër ai i kish thënë zonjës angleze se të gjitha fetë, për të, të nxirrnin në të njëjtin shteg: që të shkojmë në një vend duhet të ndjekim rrugën; shkojmë nëpërmjet rrugës së Kishës apo të Xhamisë, s'ka asnjë ndryshim. Zoti është gjithmonë po ai, por ajo që duhet të mbajmë mend në radhë të parë është se ne jemi shqiptarë.”

Gjatë rrugës Leskovik-Përmet, Durhami ndeshi një kishëz guri të dalë jashtë funksionit, sepse tashmë fshati përreth ishte kthyer në mysliman. Megjithatë, asaj i kishin thënë se kjo kishë ishte e mbrojtur nga një mrekulli dhe se asnjë njeri nuk guxonte të priste dru pranë saj.

Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare, aktivistët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare forcimin dhe zhvillimin e vetëdijes kombëtare të shqiptarëve, e vendosën në qendër të veprimtarisë së tyre patriotike. Në këtë mënyrë, shqiptarët ftoheshin për bashkim, jo duke i mohuar, por përkundrazi, duke i respektuar fetë e ndryshme që ekzistonin në Shqipëri.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare

për çlirim nga sundimi osman dhe krijimin e shtetit kombëtar të pavarur, përbën një shembull mjaft domethënës të bashkëpunimit të sinqertë dhe pa asnjë paragjykim të intelektualëve dhe aktivistëve patriotë, pavarësisht nga përkatësia e ndryshme fetare, të cilët dhanë një kontribut vendimtar për afirmimin politik e kulturor të kombit shqiptar.

Solidariteti dhe toleranca fetare midis shqiptarëve u shfaqën me një shkëlqim të veçantë edhe në periudhat e mëvonshme. Atë Luigj Bumçin, Atë Gjergj Fishtën, Mehdi Frashërin, Mihal Turtullin, Hoxhë Kadrinë, Luigj Gurakuqin, Fan Nolin dhe Faik Konicën, i shohim të gjithë së bashku në Shqipëri, apo jashtë saj në mbrojtje të çështjes shqiptare.

Prifti katolik Luigj Bumçi, i cili në dhjetor të 1919 shkoi në Vatikan në mbrojtje të çështjes shqiptare, i tha Papës se shumica e shqiptarëve që ndodheshin në Paris si anëtarë të delegacionit shqiptar ishin myslimanë, dhe se e kishin zgjedhur atë kryetar të tyre dhe e kishin dërguar atje (pra në Vatikan – F.D.) për t'i kërkuar Shenjtërisë së Tij të ndihmonte në zgjidhjen e çështjes shqiptare.

Ishte pikërisht ky realitet fetar në Shqipëri, që tërhoqi dukshëm vëmendjen edhe të diplomatëve të huaj në aktivitetet ndërkombëtare të organizuara për Shqipërinë në fillim të viteve 20-të. Duke marrë fjalën në Gjenevë më 17 dhjetor 1920 në Lidhjen e Kombeve kur diskutohet çështja e pranimit të Shqipërisë në të, delegati indian u shpreh: “Kur në botë zhvillohen ende luftëra ndërfitare,

në Shqipëri, myslimanët, katolikët, ortodoksët, jetojnë në harmoni dhe është fakt i shkëlqyer për një vend me shumicë dërmuese të popullsisë myslimane të përfaqësohej këtu nga një kristian (është fjala për Fan Nolin – që kryesonte delegacionin shqiptar) dhe pikërisht një prift.”

Fan Noli i kapërceu kufijtë e përkatësisë fetare dhe mendoi dhe veproi gjatë gjithë jetës së tij në dobi të mbarë popullit shqiptar. Në këtë prizëm ai vlerësonte si të domosdoshëm afrimin dhe bashkimin kishtar të krishterëve shqiptarë, si dhe për zhvillimin e dialogut ndër fetar krishtero-mysliman.

Edhe mbreti i shqiptarëve Zogu I, i cili bëri shumë për modernizimin e institucioneve fetare në Shqipëri, për ndarjen e shtetit nga feja, ditën që u bë

mbret i shqiptarëve me 1 shtator 1928, bëri betimin e tij, duke vendosur duart mbi Bibël dhe Kur'an, duke premtuar se do të mbronte unitetin kombëtar.

Me shembjen e komunizmit në Shqipëri, me rihapjen e institucioneve fetare, myslimanët, katolikët dhe ortodoksët, morën pjesë së bashku në ceremonitë e rihapjes së këtyre institucioneve, ashtu siç festojnë sot së bashku festat fetare të njëri-tjetrit.

Sot, ne shqiptarët jemi më të vetëdijshëm që të luftojmë më shumë për fuqizimin e faktorëve, që ndihmojnë dhe ushqejnë harmoninë dhe bashkëjetesën paqësore fetare e kultivuar historikisht, duke luftuar dhe shmangur ndikimet negative, që mund tu imponohen shqiptarëve kryesisht nga jashtë Shqipërisë.



**Xhamia e Fushë Çelës dhe Kisha e Fretënve në Shkodër përballë njëra-tjetrës. Këto dy objekte kulturi me 28 nëntor 1913 (me rastin e 1 vjetorit të pavarësisë), u lidhën me kandilë dhe flamuj nga At Gjergj Fishta. Foto Marubi**

# Shpërngulja e shqiptarëve për në Turqi 1937-1941 dhe roli i Bashkësisë Fetare Islame në pengimin e saj

Qerim Lita – Shkup

## Abstrakt

*Bashkësia Fetare Islame në Mbretërinë e SKS (jugosllave), përkatësisht Ulema Mexhlsi i Shkupit, i cili përfshinte tërë viset shqiptare nën Jugosllavi, pati një rol të rëndësishëm në organizimin e popullsisë myslimane. Nisur nga ky fakt, pushteti i atëhershëm jugosllav, te kjo organizatë, shihet një “alete” (vegël) të fuqishme për realizimin e planeve të veta të errëta, siç ishin: asimilimi i popullsisë myslimane veçanërisht të asaj shqiptare e turke; dëbimi i dhunshëm i kësaj popullsie për në Turqi dhe kolonizimi i këtyre viseve me kolona sllave.*

Për këtë qëllim, zyrtarët e Beogradit, menjëherë pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, ndërhyjnë brutalisht në organizimin e brendshëm të BFI-së, duke emëruar emisarë të tyre nëpër të gjitha organet drejtuese të saja. Këta emisarë, të cilët vinin nga Bosnja e Hercegovina, siç ishin: Hasan Rebac, Ahmed Mehmedbashiç, Fejzi Haxiamziq, Sheçerkadiç e shumë të tjerë, në përpikëri do ti zbatojnë detyrat e marra nga padronët e tyre të Beogradit.

Përveç kësaj, me qëllim të realizimit të planeve të parapara, qeveria mbretërore e atëhershme e SKS, në vitin 1925, në Shkup, hapi një shkollë të mesme, gjoja për krijimin e “kuadrit fetar” për popullsinë myslimane, për viset siç thuhej “jugore jugosllave”. Në këtë shkollë që e mori emrin “Medreseja

e Madhe Kral Aleksandri i I-rë”, përveç drejtorit (Mehmedbashiç, një mysliman nga Bosnja e Hercegovina, i deklaruar si serb), nuk pati asnjë të punësuar që i takonte besimit Islam, përkundrazi të gjithë ishin të krishterë, serb ose rus, përfshi këtu edhe mësimdhënësit e lëndëve fetare si dhe edukatorët.

Në një situatë të këtillë, u krijua një pakënaqësi e madhe në mesin e popullsisë myslimane, veçanërisht të asaj shqiptare, e cila në fillim të viteve tridhjetë do të shprehet në mënyrë publike. Për rrjedhojë në vitin 1930, u soll Kushtetuta e parë e Bashkësisë Fetare Islame e Mbretërisë Jugosllave. Sipas dispozitave të saj, tani Shkupi u bë qendër e barabartë me Sarajevën, sepse këtu tani u krijuan institucionet më të larta të BFI-së, siç ishin: “Ulema Mexhlsi” dhe “Kuvendi Mearif i

Vakëfit”. Mirëpo e gjithë kjo, nuk solli ndonjë përmirësim të dukshëm në punën e saj, sepse udhëheqjen e saj e drejtonte klika serbomadhe. Nuk vonoi shumë, me qëllim të përmirësimit të pozitës tejet të palakmueshme të popullsisë shqiptare, në Shkup me nismën e disa veprimtarëve me ndikim, siç ishin: Ferhat bej Draga, Hasan Shukriu, Shaban Efendiu, Idriz Cërcëri, Remzi Abdullau, Mulla Idriz Gjilani, Kadri Saliu, Sali Beu, Bedri Hamidi etj., u krijua një qendër opozitare shqiptare. Fushëveprimi i kësaj qendre u përqendrua brenda Bashkësisë fetare Islame, ku ata ishin thellë të bindur se me marrjen e kësaj bashkësie, do të mund ti kundërviheshin më me sukses projekteve antishqiptare të autoriteteve të Beogradit.

Pas një beteje të gjatë dhe të mundimshme, në fillim të vitit 1936, në bashkëpunim me Mehmet Spahon, i cili i printe Organizatës së Myslimanëve të Bosnjës e Hercegovinës, ata bënë ndryshime radikale në dispozitat e Kushtetutës së BFI-së. Me këto ndryshime, BFI u bë një organizatë thuasje autonome, sepse të gjitha organet e saja drejtuese zgjidheshin nëpërmjet zgjedhjeve të fshehta e të lira nga popullsia myslimane, përkatësisht xhemati. Kjo u pa në zgjedhjet e vitit 1937, të cilat njëherë ishin të parat dhe të vetmet që u zhvilluan në këtë bashkësi gjatë sundimit të Mbretërisë së atëhershme jugosllave, në të cilat fitoi bindshëm krahu kombëtar shqiptar me në krye Ferhat bej Dragën.

Udhëheqja e re e BFI-së në Shkup, e cila erdhi menjëherë pas këtyre zgjedhjeve, bëri ndryshime radikale si në

mënyrën e organizimit të myslimanëve, po ashtu edhe në krijimin e politikës brenda organeve të saja drejtuese. Falë kësaj, së shpejti kjo organizatë u bë shumë e popullarizuar tek popullsia shqiptare, e cila tani atë e konsideronte si “institucionin e vetëm ku mund ti mbronin interesat e tyre nacionale e fetare.”

Ndër aktivitetet e shumta që zhvilloi kjo organizatë fetare, gjatë periudhës kohore 1937-1941, duhet veçuar fushata e bujshme kundra shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi. Qarqet e atëhershme, policore e ushtarake jugosllave, me të madhe e akuzonin udhëheqjen e Ulema Mexhllisit të Shkupit, për aktivitetin e saj politik e organizativ brenda popullsisë shqiptare, që sipas tyre binte ndesh me “politikën shtetërore” dhe se në mënyrë të dukshme po i acaronte marrëdhëniet fetare e nacionale në ato vise. Sipas tyre, bartës i këtyre aktiviteteve ishte Ferhat bej Draga, i cili siç vihej në dukje “me ndihmën e Mehmed Spahos ka arrit ta shqiptarizoj Bashkësinë Fetare Islame në Shkup”, dhe se “tash më ai është shpall lider i pakontestueshëm i shqiptarëve në Jugosllavi”.

### **Një pasqyrë e shkurtër e Bashkësisë Fetare Islame në Shkup 1918-1937**

Bashkësia Fetare Islame në Shkup (në vazhdim BFI), në periudha të ndryshme kohore pati organe të ndryshme drejtuese, disa prej të cilave funksiononin që nga periudha e Perandorisë Osmane. Me themelimin e Mbretërisë SKS (1918), me qëllim të futjes nën kontrollin e saj, autoritetet

e Beogradit, themeluan Myftininë Supreme<sup>1</sup>, e cila drejtpërsëdrejti merrej me organizimin fetar të mbarë popullsisë myslimane në vend. Burimet arkivore bëjnë të ditur se nga viti 1921, krahas Myftinisë Supreme u themeluan edhe disa Myftini të qarqeve si dhe ato të rretheve. Kështu në trevat e sotme të Maqedonisë, Kosovës, Serbisë dhe Malit të Zi u themeluan katër myftini qarkore: Myftinia e Qarkut të Shkupit<sup>2</sup>, Myftinia e Qarkut të Prizrenit<sup>3</sup>, Myftinia e Qarkut të Novi Pazarit<sup>4</sup> dhe Myftinia e Qarkut të Plavës.<sup>5</sup>

Këtyre myftinive ju ishte caktuar territori, ku ata përgjigjeshin për organizimin e jetës fetare të myslimanëve. Kështu, territori i Myftinisë së Qarkut të Shkupit, përfshinte tërë Maqedoninë e sotme, Luginën e Preshevës si dhe rrethin e Kaçanikut, ndërsa ajo e Prizrenit, me përjashtim të rrethit të Kaçanikut, përfshinte territorin e sotëm të Kosovës. Në kuadër të këtyre myftinive u themeluan edhe myftinitë e rretheve siç ishin: Myftinia e rrethit të Shkupit, Kumanovës, Preshevës, Velesit, Gostivarit, Resnjës, Gjilanit, Prishtinës, Gjakovës, Pejës etj.<sup>6</sup>

Duhet të vëmë në dukje se krahas myftinive të sipërpërmendura, në këta

territore funksiononin edhe shumë drejtori të Vakëfeve, si në: Shkup, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kumanovë, Gjilan, Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Mitrovicë, Pejë etj.<sup>7</sup> Themelimi i këtyre drejtorive, erdhi për faktin që të kontrollohej pasuria e patundshme e “BFI-së”, e trashëguar që nga periudha e Perandorisë Osmane. Kjo pasuri ishte e shumëllojshme duke filluar nga objektet fetare siç ishin xhamitë, teqetë, mejtepet, mezhhidet etj., e deri te pronat e shumta të patundshme si toka bujqësore, pyje, kullota, pastaj dyqane dhe hane të shumta nëpër vendbanimet urbane etj. E gjithë kjo pasuri kontrollohej nga një numër i vogël personash, të cilët pushteti i atëhershëm hegjemonist serb, si vegla të tyre më të besueshme, i solli nga Bosnja e Hercegovina, siç ishin Haxhiamziqi, Mehmetbashiqi, Rebac, Haxhibegiqi, Torfiç etj.<sup>8</sup>

Kjo strukturë, siç do të shohim në vazhdim të këtij punimi, në përpikëri do ta zbatojë politikën hegjemoniste serbomadhe, e cila parashihte “serbizimin e këtyre viseve të pastra shqiptare”, që sipas hartuesve të këtij plani, do të arrihej nëpërmjet asimilimit, përkatësisht dëbimit me dhunë të popullsisë shqiptare nga këto vise për në Turqi dhe Shqipëri, dhe në vend të tyre do të vendoseshin elemente sllave, nga viset e ndryshme të Serbisë, Malit

1. Државен архив на Република Македонија, Фонд. Врховно Муфтијство-Белград.1919-1929 год. (мë tej ДАРМ.1.611.1.1/1-5).

2. ДАРМ.1.619, Округно Муфтијство Скопје -1921-1941 год.

3. По ату, 1.626, Округно Муфтијство Призрен -1921-1941 год.

4. По ату, 1.622, Округно Муфтијство Нови Пазар – 1921-1941 год.

5. По ату, 1.623, Округно Муфтијство Плевље -1921-1941 год.

6. По ату.

7. ДАРМ.1.627-663; “..Вакувски Управи: Бар, Беране, Велес, Вучитрн, Гилане, Гусиње, Дебар, Гаковица, Кавадарци, Косовска Митровица, Кочани, Крива Паланка, Куманово, Лесковац, Ниш, Нови Пазар, Ораховец, Охрид, Пеќ, Плав, Плевље, Подгорица, Прешево, Призрен, Прилеп, Приштина, Радовиш, Ресен, Сјеница, Скопје, Стари Бар, Струга, Струмица, Урошевац, Уљцин, Штип...”

8. ДАРМ.1.615.1.4/28-29.

të Zi dhe Bosnjës e Hercegovinës. Çerdhja kryesore e serbomëdhenjve, ishte Medreseja e Madhe, e cila u themelua në shtator të vitit 1925, me propozim të Ministrisë për Fe të qeverisë së atëhershme mbretërore të SKS-së, dhe me dekretin e Mbretit Aleksandri i I-rë, të datës 24 prill 1924<sup>9</sup>, e cila e mori emrin: “Medreseja e Madhe Kral Aleksandri i I-rë”<sup>10</sup>. Që qëllimi primar i kësaj shkolle ishte asimilimi i popullsisë shqiptare, mund ta shohim në raportin vjetor për punën e kësaj shkolle, dërguar me 14 korrik 1930 deri te Ministria e arsimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, nga ana e Dragosllav Jovanoviçit, këshilltarit të ministrit dhe profesor universitar, i cili qartë shprehet se: “..përveç drejtorit (Mehmedbashiq, një boshnjak i serbizuar – Q.L.) nuk ka asnjë arsimtar ose edukator të besimit islam, por të gjithë janë ortodoksë të vërtetë, serb ose rus.” Në vazhdim ai në raport, ndalet në shkaqet e themelimit të saj ku shprehimisht thotë: “... që t’ju dilet në ndihmë, elementeve myslimane të shkojnë në rrugën e vërtetë të arsimit dhe progresit, të bëhet rinovimi i kuadrit teologjik, të edukuar nëpër shkollat në frymën e kulturës sonë, për nevojat tona shtetërore dhe të aspiratave e idealeve tona nacionale,

9. Архив Југославија (мë tej АЈ), Фонд 66 / Министарство просвете Краљевине Срба, Хрвата и Словенца, фасцикл 1101, арх. јед. 1429 (Велика.Медреса Краља Александра I), бр. 373, 11. IV.1926 г., Скопље.

10. По ату, бр.3846, 11 августа 1925 год. у Београду, shkresë e Ministrit të Fesë së Mbretërisë së SKS, dërguar Ministrit të Arsimit në Beograd, nëpërmjet së cilës ky i fundit njoftohet se më 1 shtator të vitit 1925, në Shkup do të fillojë punë Medreseja e Madhe Kral Aleksandri i I-rë.

që të eliminohet propaganda e huaj në mesin e elementeve shqiptare e turke, që të përshpejtohet procesi i asimilimit i këtyre elementeve, si zgjidhje më e përshtatshme e çështjes u pa hapja e shkollës Medreseja e Madhe...”<sup>11</sup>

Në rrethana, kur shqiptarëve ju mohohet çdo e drejtë qoftë ajo qytetare apo nacionale, arsimore, kulturore etj., një pjesë e parisë fetare dhe kombëtare shqiptare, ndër morën një sërë aktiviteteve politike dhe organizative, të cilat kishin për qëllim vetëdijesimin e popullsisë shqiptare. Dokumentet e kohës flasin se drejtuesit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si qendër të tyre, nga ku do t’ju kundërvihen planeve dhe projekteve antishqiptare të pushtuesve hegjemonistë serbë, zgjedhën Shkupin. Ishin të shumta arsyet se përse atdhetarët shqiptarë fushëveprimin e tyre politik e organizativ e përqendruan në këtë qytet, disa prej të cilave po i paraqesim në vazhdim:

- Shkupi në atë kohë njihej si qytet me numrin më të madh të shqiptarëve, më shumë se në cilindo qytet tjetër shqiptar;

- Qeveria e Mbretërisë Jugosllave, Shkupin e kishte shpallur qendër, siç i quante ajo këto vise, të: “trevave jugore serbe”, përkatësisht: “Banovinës së Vardarit”, andaj këtu ishin vendosur një numër i madh i institucioneve civile e ushtarake jugosllave siç ishin: udhëheqja e Banovinës në krye me Banin, Qendra për realizimin e Reformës Agrare, ministritë rajonale të arsimit, fesë, drejtësisë, policisë, bujqësisë si dhe

11. А.Ј. Фонд 66, /Министарство за просвете Краљевине СХС (Југославије)/, Арх. јед. 1429 (Велика Медреса „Крал Александар I,, ви - Скопље) 1925/26; 1930/34.

Komanda e Tretë e Armatës së saj;  
 - gjithashtu, nuk duhen harruar as institucionet e BFI-së, përfshi edhe Medresenë e Madhe, nëpërmjet së cilave pushteti tentonte të zbatonte politikën e vet antishqiptare;

Në anën tjetër, këtu në Shkup nga fillimi i viteve '30 ishin vendosur disa Përfaqësi Konsullore Diplomatike, si ajo e Mbretërisë Shqiptare, Republikës së Turqisë etj.<sup>12</sup>

Nga këto si dhe shumë arsye të tjera, atdhetarët shqiptarë vendosën që aktivitetin e tyre ta përqendrojnë mu në këtë qytet të lashtë shqiptar. Duhet të vëmë në dukje se numri më i madh i drejtuesve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në atë kohë ishin teologë, të cilëve do t'ju bashkëngjiten edhe atdhetarë dhe intelektualë të tjerë shqiptarë.

Në fillim të vitit 1936, ndodhën trazira të shumta brenda organeve të BFI-së, të cilat ishin rezultat i kërkesave permanente të krahut opozitar shqiptar, që me këtë bashkësi të udhëheqin vendorët, përkatësisht shqiptarët, e jo klika serbomadhe e instaluar nga Bosnja e Hercegovina në Shkup. Ndërkohë, prijësve fetarë shqiptarë, do t'ju bashkëngjiten edhe disa krerë shqiptarë më me ndikim siç ishin; Ferhat bej Draga, Hasan Shukriu, Kadri Saliu, Zenel Strazimiri, Emin bej Kumbara, Asim Luzha etj.<sup>13</sup> Njëkohësisht me ndihmën

e Legatës shqiptare në Beograd, u themelua organizata studentore "BESA", veprimtaria e së cilës së shpejti u përhap në mbarë trojet e okupuara shqiptare. Nismëtarët e themelimit të kësaj organizate ishin: Tahir Ismaili<sup>14</sup>, Jahja Osmani nga Matejci i Kumanovës, Shaip Mustafa nga Presheva, Abdulla Saqipi nga Presheva, Sokol Dobroshti nga Gjakova, Xhevdet Pallaska nga Gjakova, Shaip Kamberi nga Tetova, Esat Berisha nga Gjilani, Qazim Bllaca nga Bllaca e Malishevës, Ibrahim Lutviu nga Prizreni etj.<sup>15</sup>

Kjo bërthamë e shëndoshë, kombëtare e fetare, së shpejti vendosi lidhje të ngushta edhe me konsullin shqiptar në Shkup, Rexhep Stablën, i cili pa rezervë do tu dilte në ndihmë, si në pikëpamjet materiale, po ashtu edhe në ato politiko-organizative. Burimet arkivore të kohës, bëjnë të ditur se, diplomati shqiptar, gjatë viteve 1935-1939, mbante lidhje të fshehta me disa veprimtarë të kauzës shqiptare siç ishin: Ferhat Draga, Hasan Shukriu,

---

me të ka marrë pjesë në zgjedhjet e Bashkësisë Fetare Islame. Hasan Shukriu rregullisht vinte te babai im i ndjerë, ku bashkërisht kanë zhvilluar politikë. Babai im ka pas edhe shumë miq të tjerë në Shkup, vetëm se ata tashmë kanë vdekur, si p.sh. Sali Rustem Beu e shumë të tjerë..."; ДАРМ.Ф.В.ИИ.М.346.Пов.бр.12851/39, Београд; ДАРМ.Ф. ОЗНА, к.2.2/II/II, бр.13.6, Lista me të dhëna për ish deputetët e Jugosllavisë: Në këtë listë jepen edhe aktiviteti politik i Emin Beut ku veç tjerash thuhet: "Pas vdekjes së mbretit Aleksandër, ai e humbi mandatin e deputetit, e njëkohësisht humbi edhe pronën. Për të gjitha këtyre ai nuk u kushtoi asnjëfarë rëndësie dhe theksonte se si do të vijë koha kur ai do ta kthejë pronën..."

14. Qerim Lita, Shaban Efendiu – atdhetar i devotshëm, Kumanovë, 2010, fq. 39.

15. Po aty.

12. Hamit Kokolari, Kosova – Djepi i Shqiptarizmit, botuar në vitin 1962 nga Lidhja Kosovare në Mërgim, fq. 120.

13. ДАРМ: Ф. УДБ-РСВР, Д. Ферат Драга: Deklaratë e Fahirete Ferhat Draga, vajza e Ferhat Dragës, dhënë para organeve të UDB: "Miku më i ngushtë i babait tim në Shkup ishte Hasan Shukriu. Atje babai im ishte ditë e natë. Atje

Fetah Mehmeti, Nevzat Maksuti, Gani Selimi, Shaban Efendiu, Remzi efendi Abdullahu etj. Takimet, siç vënë në dukje burimet e sipërpërmendura: “zakonisht mbaheshin në Bojali Han”, që më vonë ky lokal do të shndërrohet në qendër të rezistencës shqiptare, kundra politikës hegjemoniste serbe.<sup>16</sup>

Duhet të vëmë në dukje, se pas zgjedhjeve të vitit 1935, në qeverinë e Stojadinoviçit, merrte pjesë edhe “Organizata e Myslimanëve të Jugosllavisë”, që udhëhiqej nga Mehmet Spaho. Ndër kërkesat e Spahos dhe të partisë së tij, për ta mbështetur qeverinë e Stojadinoviçit, do të jetë: “.kthimi i selisë së Reis Ulemasë nga Beogradi në Sarajevë” dhe “revizioni i Kushtetutës së BFI, si dhe pensionimi i Reisit të atëhershëm Maglajç.”<sup>17</sup>

Pas këtyre kërkesave qëndronte edhe opozita e BFI-së në Shkup, e cila autorizoi Ferhat bej Dragën, që të mbajë kontakte me Spahon. Për rrjedhojë, me 25 mars të vitit 1936, organet kompetente të Bashkësisë Fetare Islame të Jugosllavisë, sollën Kushtetutën e re, e cila me 24 tetor të vitit 1936 u nënshkrua nga ana e Mbretit, ndërsa me 5 nëntor u publikua edhe në gazetën zyrtare.<sup>18</sup>

Më 30 maj 1937 u mbajtën zgjedhjet e para të lira e demokratike të BFI-së, në të cilat fitoi krahu opozitar, përkatësisht lista e Ferhat bej Dragës, të cilat përfundimisht e bënë këtë bashkësi armën më të fuqishme

kundër projekteve antishqiptare të klikës hegjemoniste serbomadhe. Se cili ishte roli i udhëheqjes së re të “Bashkësisë Islame” në Shkup, më së miri e përshkruan Vasa Çubrilloviq, në referatin e tij me titull: “Problemet e pakicave në Jugosllavinë e Re”, lexuar më 3 nëntor 1944 në Beograd, ku ndër të tjera pohon: “Kur pas marrëveshjes zgjedhore me Stojadinoviçin, nëpërmjet Mehmet Spahos, Ferhat bej Draga arriti ta zgjerojë autonominë e Bashkësisë Fetare Islame edhe në Serbinë e vjetër<sup>19</sup> dhe në Maqedoni, me seli në Shkup, separatistët shqiptarë përfituan një armë të fuqishme në duart e veta. Ata për dy tre vjet, aq shumë e shfrytëzuan, saqë e morën në duart e veta tërë organizatën fetare dhe arsimore të Myslimanëve në Jug. Nëpërmjet saj ata u organizuan politikisht, dhe kaluan në sulm.”<sup>20</sup>

### **Marrëveshja turko-jugosllave për shpërnguljen e shqiptarëve**

Krahinat shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia deri në vitin 1912 përbënin shumicën absolute të popullsisë së përgjithshme, ndërsa elementi sllav (serb, malazez, maqedonas), ishte një pakicë e parëndësishme, e që ishte infiltruar gjatë kohës së Perandorisë Osmane. Menjëherë pas pushtimit të këtyre tokave, nga ushtria serbe, filloi shpërngulja e dhunshme e shqiptarëve për në Turqi në njërën anë, si dhe kolonizimi i vendbanimeve të

19. Bëhet fjalë për Kosovën.

20. Hamdija Sharkinoviç, Boshnjaci od Načertanija do memorandum, Podgoricë, 1997, fq. 243-259. Autori i veprës, këtu në tërësi e paraqet referatin e Vasa Çubrilloviçit, me titull “Manjinski Problem u Novoj Jugosllaviji”, lexuar më 3 nëntor 1944 në Beograd.

16. Po aty, fq. 42.

17. Ferat Shala, Reis Ulematë e Bosnjës e Hercegovinës dhe të Jugosllavisë nga 1882 – 1991, fq. 9.

18. Muhamed Salkiç, Ustavi Islamske Zajednice, el-Kalem, Sarajevë, 1442/2001, fq. 119.

pastra shqiptare me serbë, malazezë, maqedonas, boshnjakë etj.

Historiografia sllave, për ti mbuluar gjurmët e gjenocidit të kryer mbi popullsinë shqiptare nga ana e tyre, gjithmonë ka tentuar ta fshehtë realitetin etnik në këto krahina shqiptare. Ndër “argumentet”, që më së shumti përdoren nga historianët serbo-maqedonas, janë regjistrimet e popullsisë të kryera gjatë viteve 1921 dhe 1931, nga regjimi i atëhershëm i Jugosllavisë Mbretërore. Këto të dhëna, nuk mund të pranohen si të mirëqena, sepse siç dihet regjistrimet e atëhershme nuk janë mbajtur sipas kriterit të kombësisë por sipas atij fetar. Kështu, nga 700 000 banorë të deklaruar si mysliman, gjatë regjistrimit të vitit 1921, në krahinat shqiptare nën sundimin jugosllav, qeveria e atëhershme, si shqipfolës, llogariste 441 000 banorë, 132 000 turko-folës, ndërsa të tjerët serbo-folës. Ndarja e shqiptarëve në: shqiptarë, turq dhe serbë, zbulon haptazi qëllimin e qeverisë së atëhershme jugosllave, e cila parashihte shpërnguljen e detyrueshme të shqiptarëve për në Turqi në njërën anë, si dhe kolonizimin e këtyre krahinave me elemente sllave.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë rreth përbërjes etnike, të krahinave shqiptare të aneksuara nga Jugosllavia, po i referohem librit: “Kosova - Djepi i Shqiptarizmit”, të autorit Hamit Kokolari, në të cilin përveç tjerash thuhet: “..elementët serbe e malazeze të infiltruar gjer më 1912 në krahinat shqiptare që më vonë do të aneksoheshin nga Jugosllavia, nuk përfaqësonin veçse 5% të popullsisë së përgjithshme, por çka meriton të vihet në dukje është fakti

se në krahinat në fjalë, sidomos në veri të distrikteve të Shkupit, Kumanovës dhe Tetovës, Gostivarit e Kërçovës, as para as pas vitit 1912, nuk figuron asnjë element bullgaro-maqedonas. Por dhe në ato vise shqiptare si Shkupi, Tetova, Gostivari, Kërçova, Struga, Ohri, Manastiri, ku elementi maqedonas ka mundur të infiltrohet para vitit 1912, numri i tij ka qenë kurdoherë pa rëndësi në krahasim me numrin e Shqiptarëve.”<sup>21</sup>

Pra, nga kjo, shihet qartë se këto vise kanë qenë të banuara kryesisht me shqiptarë dhe se elementi sllav është vendosur pas vitit 1912. Mbështetur në të dhënat e dokumentuara, si dhe në literaturën shkencore të autorëve vendas dhe ndërkombëtarë, shpërngulja e shqiptarëve nga vatrat e tyre është zhvilluar në tri faza: faza e parë filloi nga viti 1912 dhe zgjati deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore. Karakteristikë e kësaj faze është se okupatori serb gjatë kësaj periudhe me qëllim të pastrimit etnik zhvilloi një fushatë të egër, ndaj popullsisë vendase shqiptare si vrasje masive, përndjekje, etj. Faza e dytë filloi nga viti 1919 dhe zgjati deri në vitin 1931. Në dallim nga faza e parë, tani autoritetet serbe zhvillojnë një politikë tjetër antishqiptare, ku në emër të “Reformës Agrare”, bëjnë konfiskimin e pronës shqiptare dhe të njëjtat ua shpërndajnë kolonistëve serbë. Faza e tretë filloi pas vitit 1931 kur: “Mbretëria jugosllave shpall ligjin mbi kolonizimin e krahinave jugore.”<sup>22</sup> Veç kësaj në vitin

21. Hamit Kokolari - “Kosova - Djepi i Shqiptarizmit”, Botuar në vitin 1962 nga Lidhja Kosovare në Mërgim, fq. 86.

22. Mathieu Aref, Shqipëria (Historia dhe Gjuha)-Odiseja e pabesueshme e një populli para helen, Plejad, Tiranë, 2007, fq. 192.

1937: “Klubi kulturor serb i Beogradit vendos një projekt për shpërnguljen e detyruar të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë drejt Turqisë dhe Shqipërisë.” Konform këtij projekti, qeveria jugosllave, më 29-30 shtator të vitit 1938, nënshkruan një Marrëveshje me qeverinë turke, që njihet si: “Marrëveshja turko-jugosllave për kalimin e shqiptarëve në Turqi.”<sup>23</sup> Në fakt kjo politikë antishqiptare u iniciua nga Vasa Çubrilloviçi në vitin 1936 për ta vazhduar Ivo Andriçi në vitin 1939.<sup>24</sup>

Në vitin 1935 pushtetarët e Beogradit, respektivisht Dhoma e Reformës Agrare në Shkup, filloi një aksion edhe më të ashpër, sa i përket konfiskimit të tokës pjellore nëpër vendbanimet shqiptare. Aksioni i ri parashihte që “fshatarëve shqiptarë, t’u lejohet vetëm 0,4 hektar tokë për një anëtar të familjes.” Qëllimi i kësaj politike, siç theksohet në raportet e ndryshme të organeve policore dhe ushtarake serbe, ishte “dëshpërimi i banorëve shqiptarë”, sidomos i fshatrave “që shtrihen buzë Malit Sharr, e deri në linjën Kumanovë – Prishtinë”, ku sipas tyre “fshatrat shqiptare janë tepër kompakte”.<sup>25</sup> Pushtetarët e Beogradit shpresonin, se nëpërmjet këtij presioni do të mund ti detyrojnë shqiptarët, ti shesin pronat dhe shtëpitë e tyre, për t’u shpërngulur në Turqi apo Shqipëri. Parashikimet serbe nuk do të realizohen, sepse udhëheqja kombëtare e fetare shqiptare në bashkëpunim me konsullatën shqiptare në Shkup, morën një sërë aktivitetesh, kryesisht

informative, në mbarë hapësirën shqiptare nën Jugosllavi, ku veç tjerash, apelonin të fshatarësia shqiptare, që mos ta shesin tokën e tyre sepse, sipas tyre, pushtetarët: “mund t’u konfiskojnë gjithçka por shtëpitë nuk mund tua marrin”, dhe se kjo politikë “është afatshkurtër kur do të vijë dita që Shqipëria do ti çlirojë të gjitha viset e robëruara shqiptare edhe atë nga Shkupi e deri në Prishtinë.”<sup>26</sup> Kështu, sipas burimeve policore serbe: “Shqiptarët janë tepër të dëgjueshëm ndaj kërkesave të parisë së tyre” dhe se “tani që prej rreth tre vitesh të tëra nuk shesin as një pëllëmbë tokë.”<sup>27</sup>

### **Aktiviteti politik e diplomatik i atdhetarëve në pengimin e shpërnguljes**

Në këto rrethana tragjike për fatin e shqiptarëve në sipërfaqe dolën dy grupime politike shqiptare, të cilat në mënyrë të hapur ju kundërvunë zbatimit të planit famëkeq “Naçertanie” të Ilija Garashaninit, të vitit 1844, i cili parashihte spastrimin e trojeve shqiptare.<sup>28</sup> Grupimi politik i udhëhequr nga Ferhat Draga, në të cilin merrnin pjesë paria e atëhershme kombëtare e fetare shqiptare siç ishin: Mulla Idriz Gjilani, Shaban Efendiu, Rexhep ef. Abdullau, Bedri ef. Hamidi, Kadri Saliu, Azem Hoxha, Idriz Cërcëri, Akshi Sulejmani, Mulla Lutfi Ahmeti, Zenel Ibrahim Strazimiri e shumë të tjerë. Ndryshe ky grup njihet si opozita e BFI-së, apo grupi i “Bojali Hanit” në Shkup.

26. Po aty.

27. Po aty.

28. Mr. Aliriza Selmani - Hafiz Avni Aliu - Myderriz Haki Efendiu (1914-1948), Prishtinë 2005 fq. 73.

23. Po aty.

24. Po aty, fq. 208.

25. ДАРМ. Ф. МНРП, Д. Прилике у Јсжној Србији, 1938 године.

Grupimin e dytë e udhëhiqte Ataulla ef. Kurtishi, një ulema i njohur në hapësirat shqiptare e më gjerë.

Grupi që udhëhiqej prej Ataullah Hoxhës, fushatën e tyre kundra shpërnguljes e zhvillonin gjithnjë në botëkuptime fetare, respektivisht, ata apelonin te xhemati i tyre, që të mos i lëshojnë vatrën e tyre, sepse siç theksonin ata: “Ai që e lëshon vatanin është shkja (i pa fe – Q.L.)”.<sup>29</sup> Përveç kësaj, ata: “Turqinë e quanin si një vend pa fe, shtet ku nuk ekziston morali dhe ku nuk respektohen liritë fetare.”<sup>30</sup>

Roli i Ataullah efendi Kurtishit, në pengimin e shpërnguljes së popullsisë shqiptare ishte shumë i madh, sidomos në viset e Shkupit, Kumanovës e të Preshevës. Ai, gjatë fushatës së tij kundra shpërnguljes, e demaskoi projektin sllav për pastrimin e myslimanëve nga trojet tona etnike, i sqaroi dëmet dhe pasojat e emigrimit, qëllimin e vërtetë të kësaj çmendurie serbe, me qëllim që ti largojë myslimanët e posaçërisht shqiptarët nga këto troje dhe ti instalojë diku larg në Anadoll, ku do të shërbejnë si tampon zonë në mes turqve në njërin anë dhe armenëve dhe kurdëve në anën tjetër.<sup>31</sup>

Hoxha dhe nxënësit e tij, qëndrimin e mos shpërnguljes, e mbështesnin në dy parime:

1. Ta ruajmë fenë, dhe
2. Ta ruajmë atdhenë.

Parimin e parë e mbështetnin në Hadithin e Pejgamberit (a.s), i cili me rastin e çlirimit të Mekës kishte thënë:

“Nuk ka hixhret (shpërngulje – Q.L.) pas çlirimit, por xhihad, përpjekje dhe nijet.” Ndërsa për parimin e dytë “ta ruajmë atdhenë” vinin në dukje se “vendet e lashta ku pushojnë eshtrat e të parëve tanë, është vend me peshë, Turqia nuk është parajsë, mos i braktisni këto treva, të parët tanë i mbrojtën me gjak.”<sup>32</sup>

Në dallim nga grupi i dytë, grupi i parë fushatën e tyre kundër shpërnguljes, e zhvillonte në pikëpamje kombëtare, respektivisht, ata apelonin që: “shqiptarët të mos i lëshojnë vatrën e tyre, sepse këto troje gjithmonë kanë qenë shqiptare dhe se shqiptari duhet të deklarohet si shqiptar e jo turk.”<sup>33</sup> Ferhat Draga me mbështetësit e tij, mbante lidhje të përhershme si me legatën shqiptare në Beograd, po ashtu edhe me konsullatën në Shkup. Dy përfaqësitë shqiptare, e përcillnin me vëmendje aksionin e shpërnguljes së dhunshme të shqiptarëve për në Turqi dhe bënin çmos për pengimin e saj. Kështu në vitin 1935, konsulli shqiptar në Shkup Asaf Xhaxhuli, përpiloi një projekt për pengimin e shpërnguljes së shqiptarëve, projekt i cili u diskutua në organet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë. Për këtë projekt ishte në dijeni edhe vetë mbreti Zog. Pra, projekti ishte mjaft serioz, në të cilin, veç tjerash theksohej se “brenda një kohe të shkurtër nga Kosova do të shpërngulen jo më pak se 800 000 shqiptarë.”<sup>34</sup>

29. Hilmi Qerimi, po aty.

30. AM.F.1.427.60.7/116-129.

31. Mr. Taxhudin Bislimi, Medreseja e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011, fq. 80.

32. Po aty, fq. 80.

33. ДАРМ.Ф.УДБ-PCBP.Д.43200948, Izjava od Refik Shaqiri, po aty.

34. Dr. Izber Hoti, Qëndrimi i diplomacisë Italiane ndaj Shqipërisë dhe Shqiptarëve, Prishtinë 1997, fq. 113-114.

Ndër krerët më të shquar të grupit të dytë, gjithsesi ishte Shaban Efendi, i cili bashkarisht me disa krerë të tjerë me vetëdije të qartë kombëtare si: Hafiz Lutfi Ahmeti - Myftia i Preshevës, Mulla Idriz Gjilani, Azem Hoxha nga Kumanova, Abdulla Saqipi nga Presheva, pastaj dy tregtarët e njohur nga Presheva: Abdulla Veliu dhe Niazi Nuhiu<sup>35</sup>, Esad Berisha nga Gjilani, Shaip Mustafa, Abdulla Ebipi i njohur si Mulla Dulla i Hotlës, Aqif Tetova nga Gjilani, Ilijaz Osmani, Jahja Osmani etj.<sup>36</sup>, gjatë periudhës 1938-1941, zhvilluan një fushatë të fuqishme kundra shpërnguljes, nëpër fshatrat e rretheve të Kumanovës, Gjilanit dhe Preshevës dhe si rezultat i kësaj fushate, shpërngulja në këto vise nuk mori përmasa të një pastrimi etnik, siç e kishin paramenduar pushtetarët e atëhershëm serbë.

Aktiviteti i tyre zhvillohej, nëpër konakë, xhami, mejtepe, lokale, gjatë së cilit shpërndanin edhe materiale të ndryshme me karakter kombëtar si: revista, gazeta, libra në gjuhën shqipe, të cilat ata i merrnin nëpërmjet konsullatës shqiptare në Shkup. Lidhja e tyre me konsullatën shqiptare ishte vendosur që nga viti 1935, ndërsa ajo do të përforcohet sidomos gjatë dhe pas zgjedhjeve në “Bashkësinë Islame” të mbajtura në vitin 1937. Në atë kohë, përfaqësuesi i konsullatës shqiptare në Shkup Rexhep Stabla, mbante kontakte të shpeshta me Shaban Efendiun, Azem Hoxhën etj., në “Bojali Han”<sup>37</sup>.

35. Hilmi Qerimi, po aty.

36. ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.43200948, Fotodokumentacija (identifikacija), 14.IX.1948 god. Kumanovo.

37. ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.43200948, Zapisnik-Od saslushanja osuxhenika Fazli Vebi Shukri,

Lidhur me aktivitetet e bujshme, që zhvilloheshin nga krerët e “BFI-së” në Shkup, të organizatës “Besa” dhe “Kishës Katolike Shqiptare” gjatë vitit 1938, shërbimi sekret i armatës jugosllave njoftonte se: “Në kohë të fundit po vërehet një lëvizje te shqiptarët për shkak të aktiviteteve të pushtetit në konfiskimin e tokës.

Shqiptarët... shkojnë në Shkup deri te konsulli shqiptar dhe kërkojnë nga ai mbrojtje, ndërsa katolikët ju drejtohen klerikëve të tyre. Në përgjithësi gjendja është e alarmuar.”<sup>38</sup> Siç shihet, gjatë viteve 1937-38, politika serbe rreth reformës agrare ishte gjithnjë e më e ashpër, madje ajo tashmë ishte e dhunshme, gjë që e detyroi popullsinë shqiptare të kërkojë ndihmë nga konsullata shqiptare në Shkup. Në kuadër të kësaj, qeveria shqiptare e autorizon Ministrin e Punëve të Brendshme Musa Jukën, që të dërgojë disa njerëz të besuar në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare nën pushtimin jugosllav, të cilët së bashku me krerët e atjeshëm shqiptarë, të ndikojnë te masat e përgjithshme shqiptare që të mos i lëshojnë vatrat e tyre.<sup>39</sup>

bakalina, koji je suxhen u grupi «Juxhel» na 12 godina: Na tregoni se cilët personalitete me ndikim i njihni në Shkup dhe si i njeh? Ndër personalitetet me ndikim në Shkup i njoh... Rexhep Stablën, i cili gjatë kohës së Jugosllavisë së vjetër ka punuar në përfaqësinë e Shqipërisë, ndërsa pas kapitullimit ju bashkëngjit konsullatës italiane...Shabani, vinte në Shkup dhe takoheshe me Rexhepin si edhe me të tjerët në «Bojali Han». ..Mendoj se me Shabanin vinte edhe Azem Hoxha nga Kumanova, vetëm se nuk mund të them se sa herë i kam parë së bashku...

38. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346. Пов.Б.ОБ.Бр.. 438, 15 – I – 1938 године, Београд.

39. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.УЏГ.Пов.И.ОБ.Бр. 206. 6. I. 1939 год.

### Roli i Qeverisë shqiptare në pengimin e shpërnguljes

Njëkohësisht, Qeveria shqiptare në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme kishte formuar një komision të posaçëm për mbrojtjen e çështjes shqiptare nën Jugosllavi. Ky komision organizoi një mbledhje me 6, 7 dhe 11 janar të vitit 1937, nën kryesinë e zotit Ministër i Punëve të Jashtme E. Libohova, me anëtarë; z. Rauf Fiço, deri në atë kohë i Dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministër Fuqiptotë në Beograd, z. Ekrem Vlora, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Hamdi Kazazi, zv-drejtor për punët e lidhjes së Kombeve. Komisioni, pasi konstatoi politikën shkombëtarizuese Jugosllave në Kosovë dhe shpërnguljen e tyre në Turqi, gjykoj të arsyeshme të hartojë programin e punës; do të përmend disa nga ato pika:

“..I. Të vazhdohet zhvillimi i organizimit për mbrojtjen e organizimin e elementit shqiptar në Jugosllavi, duke e kundërshtuar emigrimin e tij kudo qoftë.

II. Të nisat aksion diplomatik ndaj aleates (Italisë).

III. Nëse dështon plani i mësipërm të vijmë në bisedime me qeverinë e Beogradit mbi kushtet e krijimit të një zone në tokën Jugosllave.

IV. Në rast se edhe krijimi i kësaj zone nuk do të jetë i mundshëm atëherë do të duhet mjerisht të vijmë në marrëveshje me qeverinë Jugosllave për ta tërhequr atë sasi familjesh emigrantësh Kosovarë, që do të mundemi të marrin nga një shpërblim që do të japë qeveria Jugosllave.

Shënim: nën b) Në organizatën

nacionaliste të Kosovës hyjnë personalitete si Ferhat Draga, Hasan Shukriu etj.

Kësaj organizate ti jepen 300 napolona në vit. Vejsel Kryeziu ti jepet një shpërblim mujor. Dhurata periodike tu jepen edhe hoxhallarëve të Kosovës.

Për ta legata të disponojë 150 fr. ar në muaj...”<sup>40</sup>

Në promemorian e MPJ-së, të gjysmës së dytë të vitit 1938, që instruktonte stafin e vet diplomatik në Jugosllavi për politikën që duhet ndjekur për të ndihmuar popullsinë shqiptare të Jugosllavisë dhe për të penguar shpërnguljen e saj në Turqi, duke i propozuar legatës (zotit Tahir Shtyllës) të “kultivojë me çdo mjet miqësinë nëpërmjet myslimanëve boshnjakë dhe myslimanëve shqiptarë”, duke përdor “ndjenjën fetare që ndër boshnjakët është tepër e fortë dhe të bëjmë që shqiptarët e Kosovës të jenë nën influencën e politikës së brendshme të zotit Mehmet Spaho. Ky ka interesa vitale që të qëndrojnë të gjithë myslimanët në Jugosllavi, sepse duke pasur këta, një bllok afro 1.500 mijë frymë, ai peshon në balancën e politikës së brendshme. Sa të pakësohen këta, aq i pakësohet influenza atij në politikë. Në anën tjetër vëllai i tij, siç dihet, është Reis-ul-Ulema i tërë myslimanëve në Jugosllavi, pra ka çdo interes dhe arsye që të bashkohet me ne në fushatën për të ndaluar emigracionin në Turqi të shqiptarëve myslimanë.”<sup>41</sup>

Pas pushtimit të Shqipërisë, nga Italia fashiste (7 prill 1939), qeveritarët e

40. Marenglen Verli, Shqipëria dhe Kosova – historia e një asprate, Tiranë 2007, fq. 374-375.

41. Po aty, fq. 377.

Beogradit, duke e shfrytëzuar fatkeqësinë e shtetit shqiptar, ndërmorën masa edhe më radikale, me qëllim siç theksonin: “që njëherë e përgjithmonë ta heqin nga rendi i ditës çështjen shqiptare.” Në kuadër të këtyre planeve, Komanda e Shtatmadhorisë së Armatës hartoi një Memorandum, në të cilin fillimisht përkthehet disponimi i shqiptarëve nën sundimin jugosllav, pas pushtimit të Shqipërisë, ku sipas tyre gjithnjë e më tepër po e mbështetin politikën italiane. Hartuesit e Memorandumit në vazhdim shprehën qartë se: “Shqiptarët janë të pakënaqur me gjendjen e tyre aktuale në Jugosllavi. Ky është një fakt të cilin nuk mund ta mbulojmë. Konfiskimi i tokës bujqësore shqiptarëve, si edhe të kuptuarit se ato në territorin tonë janë vërtetë elementë të padëshirueshëm, gjithsesi ka ndikuar pozitivisht në zgjerimin e propagandës në favor të Italisë.” Kjo gjendje sipas kësaj komande mund të paralizohet në dy mënyra: “ose sa më parë ti shpërngulim nga territoret tona ose tua plotësojmë kërkesat e tyre në pikëpamje materiale dhe kulturore.” Lidhur me këto dy mënyra në memorandum thuhet se: “Është e qartë se kjo e fundit ndoshta vetëm përkohësisht do ti kënaqte dhe që pastaj në një kohë sa më të afërt dhe në një moment për ne shumë të pafavorshëm, përsëri të kërkojnë bashkimin me Shqipërinë. Për këtë arsye është nevojë e patjetërsueshme, që shpërngulja e shqiptarëve nga këto troje të fillojë sa më parë. Kjo sa më parë, sepse në këtë moment shqiptarët janë të dezorientuar, ndërsa marrëdhëniet tona të politikës së jashtme përbalë shqiptarëve aq shumë kanë përparësi sa që mundemi të

punojmë ashtu siç dëshirojmë ne.»<sup>42</sup>

Këto plane jugosllave nuk do të realizohen, falë aktivitetit politiko-organizativ, të parisë intelektuale dhe nacionaliste shqiptare, që njihej si grupi opozitar i “Bojali Hanit”. Në kuadër të këtyre aktiviteteve duhet përmendur takimi i Zenel Strazimirit, Shaban Efendiut dhe Iliaz Agushit me konsullin shqiptar në Shkup, i cili, ju garantoj atyre, se qeveria shqiptare, nuk do të lejojë në asnjë mënyrë të bëhet deportimi i dhunshëm i shqiptarëve nga këto treva. Rreth këtij takimi, shërbimet informative jugosllave nga Shkupi njoftonin se: “Nga paria shqiptare me ndikim ndërmerren masa, që shqiptarët në vendin tonë (Jugosllavi-Q.L.) të solidarizohen me gjendjen e re të krijuar në Shqipëri. Propagandohet se, për shqiptarët tanë, kanë ardhur ditë më të mira.”<sup>43</sup> Gjithashtu, në informatë theksohej se: “Konsulli shqiptar në Shkup, gjatë ardhjes së trupave italiane në Shqipëri, ju ka thënë deputetëve të popullit Zenel Strazimirit dhe Iliaz Agushit, se tash për shqiptarët në Jugosllavi do të jetë më lehtë.”<sup>44</sup>

Po këto shërbime, në mënyrë permanente njoftonin për takime dhe mbledhje të shpeshta që organizoheshin nga Ferhat Draga me grupin e tij në mbarë territoret shqiptare, në të cilat temë debati kishte qenë, pengimi i shpërnguljes së dhunshme si dhe e ardhmja e çështjes shqiptare. Sipas njoftimit të shërbimit sekret të armatës jugosllave, merret vesh se: “më 4 gusht

42. ДАРМ.Ф.ВИИ.М. 344.Пов.І.ОБ.Бр.. 760, 1939 год., Скопље.

43. ДАРМ.Ф.ВИИ.М. 344.Пов.Бр. 4603/39 – Скопље.

44. По аты.

të vitit 1939 në Prizren kanë qëndruar deputetët shqiptarë: Kadri Saliu nga Gostivari, Iliaz Agushi nga rrethi i Nerodimes, Asim Murtezi Luzha nga rrethi i Drenicës, Mustafa Dërguti nga rrethi i Podrimës dhe Zenel bej Strazimiri nga rrethi i Kaçanikut.<sup>45</sup> Ky delegacion shqiptar, përveç rrethit të Prizrenit, “vizitoi edhe shumicën e rretheve të tjera në Kosovë”, gjë kjo që, te kreu më i lartë i armatës jugosllave krijon përshtypjen se këto vizita kanë “prapavijë politike”, aq më tepër, që sipas burimeve të tyre: “që nga muaji qershor i këtij viti, në mesin e shqiptarëve tanë vërehet një gjallërim dhe takime të shpeshta të parisë së tyre. Të gjitha këto takime mbahen gjithmonë në mbrëmje dhe vetëm nëpër fshatra”<sup>46</sup>, - theksohet në fillim të këtij njoftimi, - për të shtuar: “Agjentët e Italisë, nëpërmjet lidhjeve të tyre në Shkup, ju kanë parashtruar parisë shqiptare pyetjen: a dëshirojnë ata, që Italia, me kërkesën e tyre, në një moment të përshtatshëm dhe në një afat sa më të shkurtër, të fillojë veprimin, që këto vise t’i bashkëngjiten Shqipërisë?” “Shqiptarët” vazhdon informata “nuk kanë dhënë as çfarë përgjigje, por menjëherë fillojnë konsultimet dhe studimin e mendimeve të personaliteteve të shquara shqiptare.” Në kuadër të kësaj, sipas këtyre burimeve “menjëherë pas kësaj, Ferhat bej Draga udhëtoi për në Stamboll”, ku ai me këtë rast ishte takuar edhe me “Mbretin Zog”, ndërsa nëpërmjet “disa turqve më me ndikim ka arritur të lidhet edhe me disa personalitete të

afërta me qeverinë turke.” Ferhat Draga gjatë bisedës “i paska premtuar Mbretit Zog, se ai dhe shqiptarët në Kosovë do të ngelin edhe më tutje besnik ndaj tij dhe se do t’i refuzojnë propozimet italiane. Por, për këtë Mbreti Zog, duhet të veprojë te qeveria turke, që të prishet konventa e nënshkruar ndërmjet Jugosllavisë dhe Turqisë, lidhur me çështjen e shpërnguljes së shqiptarëve nga Jugosllavia.”<sup>47</sup> Veç kësaj, dy bashkëbiseduesit kanë rënë në ujdj që: “Mbreti Zog të veprojë mes qeverisë turke dhe demokracisë perëndimore, për rikthimin e tij në Shqipëri, që pas kësaj nga ana e shqiptarëve të Jugosllavisë do të iniciohet bashkimi me Shqipërinë.” Në fund të këtij njoftimi thuhet se: “vizita e fundit në Kosovë, nga ana e deputetëve shqiptarë ka qenë, gjoja për qëllim, që për sa i përket çështjes së bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, e iniciuar nga Italia, tash për tash ti jepet përgjigje negative...”<sup>48</sup>

Rreth qëndrimit të deputetëve shqiptarë në Kosovë, njoftonte edhe shërbimi sekret i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që sipas këtij shërbimi: “me 5 gusht 1939, për Gjakovë kanë udhëtuar deputetët e popullit: Asim Luzha nga Drenica, Adem Marmullaku nga Istogu dhe Zenel Strazimiri nga Kaçaniku”. Këta në Gjakovë mbajnë takim me kryetarin e komunës Sulejman Kryeziun dhe me anëtarin e këshillit ekzekutiv të Gjakovës, Ramiz Rizën. Qëllimi i vizitës, sipas njoftimit në fjalë kishte qenë: “Ngritja e vetëdijes kombëtare te elementi mysliman dhe grumbullimi i të dhënave për çështjen

45. ДАРМ. Ф. В. ИИ. М. 346. Пов. Ц. ОБ. Бр. 11570/1939 – Београд.

46. По аты.

47. По аты.

48. По аты.

agrare”. Deputetët para miqve të tyre kanë deklaruar: “se ata do të kërkojnë te pushtetarët, që të gjithë shqiptarët që ju është marrë toka të marrin dëmshpërblim në para.”<sup>49</sup> Po ky shërbim njoftonte për një mbledhje të krerëve udhëheqës shqiptarë, mbajtur në pjesën e parë të shtatorit, ku kishte marrë pjesë edhe Ferhat Draga. Në fjalimin e mbajtur, Draga, paska deklaruar se: “Shqipërisë do ti bashkëngjiten të gjitha krahinat shqiptare deri në Nish.”<sup>50</sup> Rreth problemit të shpërnguljes, Draga, paska bërë apel te të pranishmit që ti kundërvihen kësaj propagande të zhvilluar nga pushtetarët serbë, duke kërkuar nga ata: “që në asnjë mënyrë të mos i lëshojnë vatrat e tyre sepse pushteti nuk ka mënyrë dhe rrugë tjetër që me forcë ti shpërngulë.”<sup>51</sup>

Dy çështje me prioritet ishin për krerët shqiptarë: çështja e politikës agrare, ku pushtetarët serbë në emër të politikës agrare, vazhdonin tua konfiskonin tokën pjellore shqiptarëve dhe të njëjtën ua jepnin kolonistëve serbë dhe malazezë, dhe e dyta: shpërngulja e dhunshme e shqiptarëve për në Turqi. Rreth çështjes së parë, paria shqiptare, me vëmendje i përcollti bisedimet e mbajtura mes kryeministrit jugosllav Dragisha Cvetkoviç dhe delegacionit kroat në krye me Vlatko Mačekun, për zgjidhjen e çështjes kroate. Ata: “në zgjidhjen e çështjes kroate e shihnin edhe zgjidhjen e çështjes së tyre agrare në Kosovë, respektivisht shkëputjen e saj nga rendi i ditës dhe kthimi i tokës së

49. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346, Пов.Бр.12851/39-Београд.

50. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346. Пов.Бр.13501/39-Београд.

51. По ату.

konfiskuar.”<sup>52</sup> Menjëherë, pas dështimit të bisedave, si pasojë çështja kroate nuk do të zgjidhet, krerët e “Besës”, si dhe krerët e “BFI”, të vetëdijshëm se kjo çështje nuk mund të zgjidhet me dialog, apelojnë te shqiptarët që të refuzojnë shkuarjen e tyre në ushtri apo çfarëdo lloj aktiviteti tjetër në Armatën Jugosllave. Ky apel, së shpejti u përhap në mbarë trevat shqiptare nën pushtimin jugosllav, që sipas njoftimeve të lëshuara nga MPB, kuptojmë se: “shqiptarët në kohë të fundit nuk kanë pranuar të shkojnë në stërvitje ushtarake”, madje ky refuzim, ishte shprehur publikisht, nëpërmjet deklaratave se: “përse na thërrasin të luftojmë për ta, kur në shtëpitë tona i lëmë fëmijët e uritur. Pasi na e kanë marrë tokën, le të na lanë nëpër shtëpitë tona, që në mënyra tjera ta fitojmë bukën për fëmijët tanë, e jo të na dërgojnë në kufirin hungarez.”<sup>53</sup>

Shihet qartë, se refuzimi i hapur nga ana e shqiptarëve, për të shkuar në stërvitje ushtarake, ishte organizuar nga krerët e “BFI-së” si dhe nga organizata studentore “Besë”. Krerët e këtyre dy organizatave kombëtare e fetare në muajin nëntor 1939, do të zhvillojnë aktivitete të bujshme, në mbarë territoret shqiptare. Ky aktivitet erdhi nga shkak se, pikërisht në atë muaj, ndodhi acarimi i marrëdhënieve politike mes Jugosllavisë dhe Italisë, ndërsa menjëherë pas, pushtetarët e Beogradit ndërmorën një aksion, i cili parashihte mobilizimin e popullsisë civile në stërvitje ushtarake. Ky organizim, e tronditi qeverinë e Beogradit, e cila

52. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346. Пов.Ц.ОБ. Бр.610/39-Београд.

53. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346. Пов.Бр.14371/39-Београд.

nëpërmjet MPB, për këtë fajësonte “BFI-në” në Shkup, respektivisht siç thuhej: “agjentët e Ferhat bej Dragës”, të cilët “kanë qëndruar në këto vise, në pjesën e dytë të këtij muaji (nëntor-Q.I)” ku “sipas të gjitha gjasave, kjo vizitë ka pasur për qëllim grumbullimin e të dhënave për situatën në këtë pjesë, me rastin e zbatimit të thirrjes për stërvitje ushtarake.”<sup>54</sup>, thuhej veç të tjerash në njoftimin e lëshuar nga MPBJ.

Në anën tjetër edhe krerët e “BFI”, si edhe të “Kishës Katolike”, ndërmoren një sërë aktivitete, rreth pengimit të shpërnguljes. Aktivitete të tilla u mbajtën në Shkup, Kumanovë, Manastir, Prizren, Gjakovë, Ulqin etj. Rreth këtyre aktiviteteve, burimet serbe, në dhjetor të vitit 1939, bëjnë me dije se: “para pak kohësh në Manastir ka qëndruar kryetari i Ulemasë në Shkup, Sherif Osmani, për ta kontrolluar punën e kësaj myftinie. Me këtë rast në mesin e popullsisë shqiptare ka agjitur, që të mos shpërngulen për Turqi.” Po i njëjti burim shton se: “pas një kohe të shkurtër pas kësaj, këtë e ka bërë njëlloj edhe konsulli turk në Shkup.”<sup>55</sup>

Përderisa, atdhetarët shqiptarë brenda BFI-së, bënin çmos që ta ndërprisnin shpërnguljen e shqiptarëve, në anën tjetër, me qëllim të përçarjes së

popullsisë shqiptare, pushtetarët serbë, në atë kohë nëpërmjet disa veglave të tyre, lëshuan parulla të ndryshme, se myslimanët nuk duhen të ndahen në kombe, sepse sipas tyre: “vetëm myslimanët janë vëllezër mes veti” dhe se: “për myslimanët vendi më i përshtatshëm është Turqia.” Këto parulla u lëshuan kudo, posaçërisht në regjionin e Kumanovës ku më së shumti dallohej aktiviteti i Zija Murtezit, një shqiptar i turqizuar, i cili e sulmonte Shaban Efendiun për shkak të asaj se ai kudo që shkonte, apelonte te popullsia shqiptare që: “të mos turqizohen dhe të mos deklarohen si turq.”<sup>56</sup>

Aktiviteti i krerëve opozitarë shqiptarë, të kryesuar nga Ferhat bej Draga, si edhe aktiviteti i grupit që udhëhiqej nga Ataulla Efendiu, rreth pengimit të shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi dha rezultatet e duhura, sepse pikërisht në kohën kur autoritetet e Beogradit, bënin plane të fshehta për deportimin e dhunshëm të shqiptarëve, ndodhi e kundërta, respektivisht, numri i familjeve që u shpërngulën gjatë viteve 1938-1941 ra në minimum. Këtu duhet nxjerrë në pah edhe roli konstruktiv i diplomacisë së atëhershme shqiptare e vendosur në Shkup, e cila në momentet më të vështira për çështjen shqiptare, ju doli në ndihmë krerëve shqiptarë.

54. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346.Пов.Бр.3799/39-Београд.

55. ДАРМ.Ф.ВИИ.М.346.Пов.Бр.13228/39-Београд.

56. ДАРМ.Ф.УДБ-РСВР.Д.43200948, Извештај за Шабан еф. од Куманово, ро ату.

## Filozofia e medreseve në sistemin arsimor të Shqipërisë

Dok. Genti Kruja  
Drejtör i Kulturës - KMSH

### Abstrakt

*Problemet e arsimit dhe të edukimit kanë preokupuar shumë filozofi, religjione, mendimtarë, dijetarë dhe sisteme politike në kohë dhe vende të ndryshme të botës. Edukimi dhe arsimit sot përbën një nga shtyllat kryesore të shoqërisë, ku në shumë vende dhe zona ku mungon ose keqpërdoret ajo, kemi probleme sociale, të cilat shpeshherë shkaktojnë kriza shoqërore, madje dhe konflikte e luftëra.*

*Kështu sot me anë të një miredukimi dhe arsimimi, ku gërsbetohen shkencat e saktë me vlerat e besimit, e sidomos me normat dhe parimet e Islamit, do të kemi një shoqëri më të shëndetshme moralisht dhe shpirtërisht, nga të cilat do të rrezatojë paqja, mirëkuptimi dhe bashkëjetesa pa dallim race, gjinie dhe feje. Ky model aktualisht aplikohet me shumë sukses në medresetë e Shqipërisë, të cilat vitet e fundit e kanë vërtetuar tezhën e suksesit me anë të arritjeve dhe nivelit shumë të mirë të nxënësve të tyre.*

1. Familja shqiptare tradicionalisht është karakterizuar nga lidhje të shumëllojshme ekonomike, shpirtërore, emocionale, përgjegjësie të ndërsjellë ndërmjet gjithë anëtarëve të saj, veçanërisht ndërmjet prindërve dhe fëmijëve. Familja shqiptare si një strukturë shoqërore solide ka funksionuar deri në fund të shekullit XX. Për gjatë viteve 1991-2000 mjaft sociologëve të huaj, u kanë bërë përshtypje të veçantë lidhjet e ngushta, përkushtimi i veçantë, deri në vetësakrificim i anëtarëve të familjes shqiptare për njëri-tjetrin, veçanërisht i prindërve për fëmijët. Mjaft emigrantë shqiptarë, kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë ekonomikisht me shumta të konsiderueshme financiare, jo vetëm

prindërit, vëllezërit dhe motrat e tyre, që jetojnë në hapësirën shqiptare, por herë-herë edhe kushërinj të tyre të afërt. Mjaft prindër shqiptarë të rinj, të moshës së mesme ose dhe në prag të pensionimit, braktisin karrierën e tyre profesionale, politike dhe shoqërore, atë të mjekut mjaft të kualifikuar, të pedagogut në universitet, ose të punonjësit kërkimor-shkencor, të drejtuesit të organizatave jofitimprurëse dhe emigrojnë në vende të tjerë, kryesisht në vendet e Perëndimit, ku kryejnë punë fizike të rëndomta. Përvoja tregon se në shumicën e rasteve motivi kryesor, që e nxit këtë kategori prindërisht të bëjnë një sakrificë të tillë është dëshira e zjarrtë për të siguruar fëmijëve të tyre një të ardhme sa më të mirë dhe sa

më të sigurt, veçanërisht dëshira për të arsimuar fëmijët e tyre në universitetet më prestigjioze të Perëndimit.

## 2. Aspekte të metodës së studimit

Por veçanërisht gjatë dhjetëvjeçarit të fundit konstatohet një farë dobësimi i marrëdhënieve midis anëtarëve të familjes shqiptare. Është rritur numri i akteve të dhunës brenda familjes shqiptare, janë rritur dhe janë ashpërsuar konfliktet e shumëllojshme ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, ndërmjet vëllezërve dhe motrave dhe ndërmjet vëllezërve të grupmohave të ndryshme etj. Një faktor që ka nxitur dukuri të tilla ka qenë dhe vazhdon të jetë edhe dhuna që emetohet nga ekranet e televizionit, veçanërisht dhuna e filmave artistikë. Për të zbuluar se si ndikojnë filmat televizivë me dhunë në marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të familjes shqiptare të ditëve tona kemi realizuar një studim-anketim me të rinj adoleshentë të qytetit të Tiranës në muajin maj 2012.

Janë anketuar 1244 nxënës. Pyetëtori përmbante 20 pyetje: 3 të lira dhe 17 të strukturuar, të cilat ofronin rreth 110 alternativa përgjigjesh më të mundshme. Anketat u plotësuan nga nxënës të shkollave të zonës qendrore të Tiranës, si: Shkolla e Mesme «Petro Nini Luarasi» dhe ajo «Qemal Stafa» dhe nga nxënës adoleshentë të shkollave nëntëvjeçare «Fan Noli» dhe «Dora D'Istria». Anketa u plotësua dhe nga nxënës adoleshentë të shkollave në periferi të Tiranës, si: shkolla e mesme «Myslym Keta» dhe shkolla nëntëvjeçare «Shyqyri Peza» në lagjen «Kombinat», ku janë përqendruar më shumë nxënës të ardhur me familjet e tyre nga qytetet dhe krahinat jugore të

Shqipërisë, ndërsa në shkollën e mesme «Eqrem Çabej» mësojnë më shumë nxënës të ardhur me familjet e tyre për gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, kryesisht nga qytetet dhe krahinat veriore të Republikës së Shqipërisë.

Kolegji «Mehmet Akif» dhe «Medreseja» e Tiranës u përzgjedhën, jo vetëm se kanë nxënës të klasave të teta e të nënta nga gjithë hapësira shqiptare, por edhe ngaqë kanë kohën e pasmësimi të programuar sipas standardeve të disiplinës së kolegjit. Ndërsa Shkolla e Mesme Artistike «Jordan Misja» u përzgjedh si shkollë artistike me traditë të konsoliduar, ku mësojnë nxënës të talentuar nga gjithë Republika e Shqipërisë. Nxënësit e kësaj shkolle jo vetëm janë më të lidhur me forma të ndryshme të artit, por edhe janë karakterizuar më parë e karakterizohen aktualisht nga një frymë liberale.

I përzgjedhur sipas kriterëve të tilla ky kampion përfaqëson në një shkallë të konsiderueshme nxënësit e klasave të teta e të nënta të shkollave nëntëvjeçare dhe të shkollave të mesme të Republikës së Shqipërisë. Në këtë kumtesë do të paraqesim disa nga rezultatet kryesore të këtij studimi-anketimi të plotësuar dhe me opinione të grumbulluara përmes intervistave dhe bisedave të lira me nxënës, prindër dhe mësues.

Kështu në Medresenë e Tiranës është ndjeshëm më e ulët (rreth 12.0 për qind), në krahasim me atë të gjimnazeve, pesha specifike e nxënësve adoleshentë, që konfliktohen me nënën. Morali i shëndoshë edhe me përmbajtje fetare, që shndërrohet e praktikohet nga mësuesit dhe nxënësit medresistë shërben si faktor i rëndësishëm për shoqërizimin e nxënësve adoleshentë me modelet e

sjelljes humane më të fisme, jo vetëm në marrëdhënie me nënën e pjesëtarët e tjerë të familjes, por edhe me gjithë të tjerët.

Kështu disa elementë të mekanizmave shoqëruës, që realizohen nëpërmjet moralit fetar dhe disiplinës së medreseve, mund të praktikohet edhe në shkollat e mesme të përgjithshme të Shqipërisë, me qëllim që të neutralizohen ndikimet çoroditëse të filmave televizivë me akte dhune, të programeve të tejnrgarkuara me vulgaritete.<sup>1</sup>

“Lartësimi ose rënia poshtë e një kombi varen nga shpirti dhe vetëdija me të cilat do të pajisen brezat e tij, nga arsimi dhe edukata që do të marrin. Në kundërshtim me faktin që kombet me brezat e rinj të përgatitur mirë, janë të paracaktuar të përparojnë paprerë, regresi i kombeve që i nënvleftësojnë ata, është i pashmangshëm!..”,- thotë mendimtari Gylen. (Gylen (a), 2003: 153)

### 3. Filozofia e medreseve të Shqipërisë

Filozofia e medreseve të Shqipërisë, edukimin e ka parë nga tri kënde të gërshetuara mes vete: human-psikologjik, nacional-social dhe universal. Por, duke e trajtuar në rrjedhë historike këtë proces, shohim se edukimi dhe arsimi në botën islame kishte kohë shumë të gjatë nën ndikimin e mendimit perëndimor. Duhet kthyer vëmendja në faktin se teokratizmi mesjetar perëndimor u riformulua me periudhën e Rilindjes, kur krahas stimulimit për plotësimin e nevojave

1. Dervishi, Zyhdi & Kruja, Genti, “Një vështrim sociologjik mbi problemet familjare tek të rinjtë e shkollave të Tiranës”, revista Zani i Naltë, nr. 2, fq. 66-67.

materiale, lind edhe kërkesa për studime shkencore, duke krijuar kështu edhe një konflikt mes shkencës dhe kishës. Pikërisht ky konflikt në mes fesë dhe shkencës ka bërë që një pjesë e botës sonë të përfundojë në materializëm dhe komunizëm. Kjo ndarje bëri që të ketë luftëra dhe konflikte të gjera botërore, si edhe konflikte të mëdha ekonomike.<sup>2</sup>

Qasja kritike e mendimtarëve myslimanë për lëvizjen iluministe të shek. XVIII, konsiston, pasi në një epokë të tillë, njerëzit shiheshin vetëm si entitete materiale apo fizike. Esenca e konfliktit shkencor dhe arsimor, konceptohet duke ndërtuar sistemin e mendimit kritik, që njeriu nuk është i krijuar vetëm nga trupi dhe mendja, por ka ndjenja dhe shpirt. Pikërisht ndjenja dhe shpirti i japin një identitet esencial dhe human secilit njeri, në këtë kontekst, edhe dijetarit.

Po kështu, në vrojtimit lidhur me raportin mes edukimit dhe procesit provokues të ideologjizimit, mund të veçojmë se pikërisht edukimi i drejtë ngre perfeksionin e botës njerëzore, e cila në fakt përmes këtij perfeksioni edhe dallon nga ajo shtazore. Pra, është fjala për arsyen dhe jo për instinktin. Në këtë aspekt njeriu e ka të kushtëzuar mësimin e gjithçkaje në këtë botë duke nisur nga rregullat më të thjeshta të jetës.<sup>3</sup>

2. Gylen, “Dashuri dhe tolerancë”, Prizmi, Tiranë, 2004: 279.

3. Berisha, Dr. Ibrahim, kumtesë “Mendimi i Gylenit për rolin e shkencës, arsimit dhe edukimit në shoqërinë bashkëkohore”, simpozium: “Këndvështrim i diversitetit fetar, kulturor dhe shoqëror në Ballkan nga perspektiva globale; Përvoja e Fethullah Gylenit si Model dhe Harmonia Ndërfetare në Shqipëri”, Tiranë 25-26 Mars 2011.

Në fakt konflikti ndërmjet shkencës dhe fesë përgjatë gjithë historisë së njerëzimit është përjetuar vetëm në periudhën e Mesjetës:

*“Nuk është e mundur të vërejmë një konflikt të tillë në Greqinë e Lashtë apo në qytetërimet e lashta egjiptiane, indiane, kineze apo të Mesopotamisë. ...ekzistojnë arsye antropologjike, sociologjike dhe historike për këtë fakt. Ne mund të vërejmë për shembull në literaturën sanskritishte se të gjitha shkencat, që nga astronomia, deri tek astrologjia dhe matematika, janë përballur me një ndërthurje të fesë dhe të shkencës. Edhe tek qytetërimi kinez u vërejt e njëjta gjë. Konfucizmi nuk ishte edhe aq një sistem fetar, por më shumë konsistonte në një kod vlerash strikte morale. Kështu që nuk mund të flasim për një konflikt ndërmjet kësaj disipline vlerash dhe shkencës. Fetë e lashta egjiptiane dhe mesopotame përmbanin gjithashtu retorikë mitologjike. Shkenca në këto qytetërimet, duke përfshirë degët e astronomisë dhe mjekësisë, nuk arriti në një nivel plotësisht empirik apo racional të saj.”<sup>4</sup>*

Vlerësimi i Islamit mbi Zbulesën si një kategori e veçantë e dijes, e bën atë mjaft të dallueshëm nga qëndrimet e tjera që ekzistojnë në kulturat e ndryshme.

Sot shohim se, në themelin e të gjitha problemeve globale qëndron faktori njeri. Pra të gjitha problemet fillojnë te njeriu e mbarojnë me të. Kështu për një rend shoqëror funksional apo të mesëm, forma më efektive është edukimi. Edukimi nëpërmjet të mësuarit dhe mësimdhënies, cilësohen edhe si dy misione hyjnore.

4. Irfan Yılmaz dhe al., Yeni Bir Bakış Açısıyla İlim ve Din, Izmir: Nil Yayınları, 1998:16.

Edukimi dhe arsimi përbëjnë një temë jetike në jetën individuale dhe në jetën e shoqërive. Së pari, në planin individual, një njeri mbetet i tillë në raport të drejtë me mirësinë që ushqen në vetvete. Thua se kushdo e kupton dhe e vlerëson rëndësinë e edukimit trupor të njeriut, por të paktë janë ata që e kuptojnë dhe e vlerësojnë edukimin moral, ideal e sentimental të njeriut. Së dyti, ekzekutimi i çdo elementi negativ brenda një kombi, nuk është një rrugë efektive për shpëtimin e tij. Shërbimi më efikas që mund t'i bëhet një kombi është edukimi i brezave me një frymë të lartë vlerash morale universale dhe me ndjenja të vërteta kombëtare. Ndaj edhe investimet që bëhen për zhvillimin dhe ngritjen e brezave, janë një pasuri pafund, që jep frytet e saj pa ndalesë.<sup>5</sup>

Në filozofinë e medreseve shkolla është vendi ku jepet mësim dhe edukatë. Aty mësohet gjithçka në lidhje me jetën. Në fakt, edhe jeta vetë është një shkollë. Vetëm se ne mund ta mësojmë jetën vetëm në sajë të shkollës.

Shkolla është institucioni që hedh dritë mbi ngjarjet jetësore dhe u jep nxënësve mundësinë të kuptojnë atë që ndodh rreth tyre. Njëkohësisht shkolla hap rrugën për të mësuar në një mënyrë shumë të shpejtë lëndën dhe ngjarjen, duke e përgatitur njeriun mendërisht, duke parashtruar drejtimin e tij dhe duke e mësuar të gjejë uniken në mes të tërësisë. Një shkollë e mirë i jep nxënësve dimension shpirtëror dhe i jep shtysë ndjenjës, një vend ku fëmija përfiton formën e vet të vërtetë. Edukimi që jepet në shkollë përfshin të

5. Gylen, F., “Kriteret ose Dritat e Rrugës”, Prizmi, Tiranë, 2003: 151, 152, 158, 160.

gjithë jetën e njeriut. Njeriu gjatë gjithë jetës zbaton e përsërit mësimet që merr në shkollë, virtutet e aftësitë e fituara në shkollë janë udhërrëfyese i tij në rrugën drejt urtësisë dhe shifra që hap kodet e komplikuara të ekzistencës.

Një vlerë të madhe në shoqëri kanë dhe mësuesit. Mësuesi është një udhërrëfyese i përsosur, që i jep formë gjithë jetës së njeriut. Ndikimi i mësuesit mbi individin është shumë më i madh se ndikimi i prindërve apo i shoqërisë. Në një shkollë të mirë, mësuesi është ai që mbjell e që ruan farën e pastër e të pafajshme. Sikurse është përgjegjësia e tij që të kujdeset për mirësinë e mbrojtjen, ashtu është detyrë e tij edhe të bëhet shembull me sjelljen e vet ndaj ngjarjeve të ndryshme dhe ndaj gjetjes së qëllimit në jetë prej individëve.<sup>6</sup>

Librat që i jepen nxënësve në shkolla, qofshin libra të lëndës, qofshin romane a poezi, duhet të jenë të tillë që të arrijnë të zhvillojnë vullnetin, t'i japin forcë mendjes, vendosmëri shpirtit dhe shkëndijë shpresës. Vetëm në këtë mënyrë do të arrijmë të rrisim një gjeneratë të aftë e të vendosur në idealet e veta.

Kështu, që në periudhën e hershme të jetës shkollore, nxënësit i duhen mësuar së pari gjuha, ideali, besimi, morali e karakteri, pastaj duhet synuar ndërtimi i një personaliteti të shëndoshë mbi këto themele. Qëllimi i mësimet duhet të jetë përgatitja intelektuale e sociale në përshtatje me kohën e vendin ku jeton dhe shtytja e tij drejt një revolucionarizimi të dijes, më saktë, drejt një mënyre të menduarit, që nxit zhvillimin e lulëzimin në çdo fushë.

Pasi të arrihen këto perspektiva, duhet përgatitur specializimi i nxënësit për art, shkencë, bujqësi, financë apo teknikë. E gjitha kjo është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin në paqe të shoqërisë, me moralin e besimin e saj, me sukseset në fushat e ndryshme të shkencës, artit e teknikës, si dhe me përpjekjen për të zënë vendin e duhur në arenën ndërkombëtare.<sup>7</sup>

Institutet moderne të arsimit i ngjajnë fabrikave, që bëjnë prodhim me shumicë në sistemin e tregut global. Vetëm se në këto institucione janë lënë pas dore vlerat intelektuale e morale, siç janë kthjelltësia e të menduarit, pasuria shpirtërore e larmia kulturore.

Duke e zberthyer më shumë këtë çështje, kur flitet për “moralin“ dhe “vlerat shpirtërore”, dy koncepte që disa mund t'i cilësojnë thjesht “fe”, njerëzit që janë të ndjeshëm në lidhje me laicizmin, mund ta trajtojnë këtë terminologji, si një kërcënim ndaj sistemit laik aktual. Në metodologjinë e sistemit arsimor të medreseve, morali nuk konsiston vetëm në kuptimin e ngushtë të doktrinës fetare, por ai përfshin edhe moralin e lartë, ekuilibrin shpirtëror dhe logjikën e sinqertë.

Një model edukimi që përfshin edhe aktivitetet shkencore, edhe formimin e karakterit të nxënësit edhe ndërgjegjësimit social, por edhe konsolidimin moral e shpirtëror të nxënësit, mund të cilësohet si shumë idealist, madje utopik nga shumë kritikë. Megjithatë, mund të pohojmë se me gjithë ndryshimet e niveleve nga shkolla në shkollë, modeli edukativ i medreseve ka gjetur zbatim në vendin tonë dhe

---

6. “Sizinti”, Tetor, Dhjetor, 1979.

7. Po aty, 128.

këto ideale kanë marrë jetë në to.

Imitimi i verbër i traditës dhe i trashëgimisë kulturore, i bazuar mbi riprodhimin përmendësh, në vend të të kuptuarit të saktë, përbën problemin rrënjësor që ka sjellë këtë ndryshim negativ dhe prapambetje të botës islame. Edukimi në botën myslimane i ka detyruar brezat e fundit ta ndajnë jetën e tyre kulturore dhe teknologjike nga identiteti i tyre historik, duke bërë kështu që subkoshienca e tyre të rrethohet nga ndikimi perëndimor. Imitimi i verbër dhe memorizimi i thatë i traditave, mund të vërehet në perceptimin e vlerave islame, ashtu si në rastin e perceptimit të qytetërimit perëndimor.

Medresetë dikur ishin institucione të pavarura edukative, që nuk i nënshtroheshin kontrollit shtetëror. Të gjitha ato ishin të themeluara nga fondacione të ndryshme (vakëfe). Familjet e pasura i pajisnin ato me bazë materiale për të mirën e shoqërisë, pa pasur asnjë lloj interesi.

Meqenëse medreseja ishte një institucion i pavarur nga kontrolli dhe ndërhyrja e shtetit, ajo ishte konturuar sipas karakteristikave mbizotëruese shoqërore dhe fetare. Kjo është arsyeja përse ajo ishte e fuqishme kur shoqëria osmane shfaqej e shëndetshme dhe e gjallë.

Impakti shoqëror i medreseve ishte më i gjerë sesa ai i shkollave laike. Për shumë shekuj me radhë, ai ndihmoi në krijimin e marrëdhënieve relativisht harmonike mes familjes, fqinjëve dhe shoqërisë. Kështu medreseja siguronte një këndvështrim të kuptueshëm për shoqërinë nëpërmjet edukimit të saj të

integruar shoqëror, fetar dhe kulturor.

Për sistemin arsimor të Komunitetit Mysliman sot, ndarja e të menduarit fetar nga shkencat natyrore shkon kundër frymës së Kur'anit, sepse Kur'ani e rekomandon qartë lidhjen e fesë me shkencat natyrore.

*Pjesët që flasin për qiejt dhe tokën - me fjalë të tjera, të dukshmen dhe të padukshmen - përbëjnë afërsisht një të tretën e Kur'anit. Megjithëse Kur'ani u lexua, Libri i Natyrës u la mënjanë. Askush nuk u kujdes që të dy librat bashkërisht të merreshin si bazë për shkencat natyrore, si: fizika, kimia, matematika dhe astrofizika. Leximi i gjërave dhe i dukurive në univers, i ngjan leximit të një libri dhe përbën gjysmën e detyrimeve të një besimtari...<sup>8</sup>*

Sistemi edukativ i medreseve, hapi rrugën për një epokë të re, duke ribashkuar sistemin edukativ bashkëkohor me sistemin klasik të medreseve të dikurshme. Kështu mund të vërehet se nuk ekziston ndonjë mospërputhje, apo përplasje dialektike ndërmjet shkencave natyrore dhe vlerave, qofshin ato fetare, etike, sociale apo individuale. Këto lloj përplasjesh mund të shpien në shkatërrimin e personalitetit dhe të strukturës shoqërore. Medresetë sot bashkojnë mendjen dhe zemrën nëpërmjet përqendrimit në një objekt, që merr parasysh mënyrën sesi duhen integruar dija dhe edukimi te njerëzit dhe te jeta sociale përkundrejt diçkaje, që i drejtohet vetëm trurit, botës së jashtme dhe objekteve të pajeta. Në këtë sens,

8. Gylen, "Statuja e Shpirtrave Tanë", (në turqisht), f. 41; Shih gjithashtu: Can, f. 71-89; *Iyğın Göründüğü Ufuk*, f. 71; *Fasıldan Fasıla*, Vol. 3, f. 198-199, 122; [www.herkul.org/Kirik\\_Testi/](http://www.herkul.org/Kirik_Testi/) "Devlet Kutsanmamalı ama...", 5.09.2004.

dija përbën mençuri dhe dashuri. Ai i bën thirrje kësaj “kulture të zemrës dhe të ndërgjegjes”.

Njerëzimi nuk përbëhet vetëm prej zemrës dhe ndërgjegjes. Edukimi duhet të synojë dimensionin material të njerëzimit, po aq sa synon edhe dimensionin shpirtëror, në mënyrë që të arrijë unitetin.

Edukimi dhe arsimimi krijojnë mundësinë e një konkurrence aktive dhe kreative në shoqëri. Njeriu i arsimuar kërkohet të jetë i aftësuar për të përballuar standardet bashkëkohore për t’u bërë pjesë e një tregu global të dijes, në të cilin dominon cilësia dhe konkurrenca.

Modeli perfekt i dimensionit shpirtëror-intelektual dhe fizik realizohet pikërisht përmes arsimimit dhe edukimit të vazhdueshëm kreativ. Mësimi u shërben njerëzve për të ndërtuar baraspeshë të drejtë me botën përreth, pasi aftësitë njerëzore janë arsyeja, zemërimi dhe lakmia. Nëse duam të jemi të arsyeshëm ne duhet të mësojmë për të kuptuar botën përreth, dhe po kështu edhe vetveten. Zemërimi kërkohet të frenohet përmes vetëpërmbytjes dhe vlerave të tjera të larta. Po kështu edhe lakminë njeriu e mund, në mënyrë që të mbajë dëshirat në kuadër të realiteteve njerëzore. Kënaqësia shpirtërore pra është e mundur të mbërrihet përmes dijeve. Dijeve për shkencën dhe për Zotin.

Medresetë e Shqipërisë sot, u bënë të rëndësishme në këto dy dekada, në dy aspekte: së pari në pikëpamjen e aspektit të tyre social dhe së dyti nga pikëpamja e cilësisë së shkollimit. Ato e reflektuan interesin në lidhje me edukimin kudo, si

në qarqet ku i mbështesnin, ashtu dhe në ata që i kritikonin ato. Në një kuptim, këto medrese kontribuuan në përhapjen e edukimit tek organizatat joqeveritare, duke e shndërruar arsimin në pronë të segmenteve më të gjera të shoqërisë. Menjëherë pas historive të suksesit të këtyre shkollave, atyre nisi t’u kushtohej një vëmendje e gjerë nga publiku dhe njerëzit të cilët dëshironin dhe shfaqnin interes të madh në projektet arsimore.

Në ditët tona, programe të veçanta edukative në media, si dhe tema të veçanta në lajme, që kanë të bëjnë me edukimin, janë shndërruar në një praktikë të zakonshme. Edukimi përbën një element në rritje në sektorin privat dhe çdo ditë e më tepër po merr rëndësi përherë e më të madhe.

Edukimi përbën një maratonë të gjatë. Ai kërkon punë dhe përpjekje të mëdha. Suksesi i këtyre shkollave bazohet në altruizmin dhe idealizmin e tyre. Qindra njerëz shërbejnë në këto institucione me një entuziazëm të pareshtur. Ata punojnë me një ndjenjë kënaqësie dhe dëshmojnë idenë e shpirttrave të përkushtuar ndaj njerëzimit. Një konturim harmonik i punësimit dhe i mjedisit mësimdhënës, përbën një çështje mjaft kuptimplotë për këto shkolla.

Sot çështja e edukimit përkufizohet dhe konsiderohet si problemi më i madh i të gjithë botës. Gjatë dy shekujve të fundit, edukimi dhe mendimi shkencor modern i kanë kthyer të gjitha marrëdhëniet njerëzore, sociale dhe ideologjike në objekte profane. Një nga gjërat e reja të sjella nga medresetë është edhe kujdesi për unitetin harmonik të mendjes dhe të zemrës. Këto shkolla

e trajtojnë mendjen dhe zemrën njëkohësisht, si qendra të informacionit dhe të mendimit dhe ofrojnë një sistem, që i sheh njerëzit si qenie në një lidhje harmonike me universin dhe shoqërinë. Këto shkolla punojnë për të krijuar individë model, me besim tek vetja dhe e ardhmja, në paqe me personalitetin e tyre, të mbushur me respekt për traditat dhe për identitetin e tyre shoqëror, të hapur ndaj mendimit shkencor modern, novatorizmit dhe ndryshimit. Kjo është arsyeja përse aty ku janë hapur këto shkolla, ato përfaqësojnë një zë të ri në edukim dhe një model të shkëlqyer të studentëve të suksesshëm. Programi arsimor i këtyre shkollave ka përcaktuar një metodë progresiste matematike dhe një formë të re eksperimentale logjike.

Medresetë gjithashtu kanë risjellë marrëdhënie të ngrohta dhe pozitive ndërmjet familjeve, lagjeve dhe bashkësive, duke ia përshtatur këto marrëdhënie kushteve moderne. Ato kanë rindërtuar të dikurshmin “njeri të shoqërisë”, që është vetësakrifikues dhe totalisht i devotshëm ndaj vendit të tij dhe njerëzimit dhe i cili është hero i dashurisë dhe afeksionit. Në këtë epokë të shekullit XXI, në të cilën mbizotëron interesi personal, egoizmi dhe materializmi, kjo përbën një dukuri të shënuar. Në një kohë që dominohet nga interesi material dhe nga kulti i individit, kjo formë e re e arsimit po i përgatit studentët që ta duan profesionin e mësuesit mbi gjithë profesionet e tjera.

Nëpërmjet ndërgjegjësimit të njerëzve, të cilët janë të qëndrueshëm për sa i përket vlerave të tyre morale, njerëzore dhe sociale dhe të cilët janë në gjendje ta mirëpresin të ndryshmen,

këto shkolla, kanë themeluar një infrastrukturë të përshtatshme për dialogun e ardhshëm ndërqytetëruës. Një qenie njerëzore e cila është harmonike me gjithë aspektet e saj të ndryshme kulturore, përbën elementin më themelor të kulturës së pajtimit. Ideja që një person të jetë i hapur ndaj ideve të ndryshme kulturore, sigurisht nuk ka kuptimin e luhatjes apo të largimit nga origjina vetjake. Si dialogu ashtu edhe pajtimi lidhen me një spektër më të gjerë dhe të zakonshëm të hapësirës sociale, që i lejon njerëzit të jetojnë bashkarisht përmes respektit reciprok, pa mohuar themelet e ekzistencës së secilit prej tyre. Në të kundërt, ai nuk përbën një aktivitet me pjesëmarrje të plotë. Në këtë aspekt, përpunimi ekonomik dhe social sikurse edhe asimilimi kulturor janë në kundërshtim me qëllimin e dialogut dhe të pajtimit.

Në sistemin edukativ të këtyre shkollave, një person shihet si pjesëmarrës aktiv në proceset sociale. Shkollat i përkasin një modeli, që vendos balancën ndërmjet botës materiale dhe shpirtërore, pa e zvogëluar ndonjëherë në dëm të tjetrës, në mënyrë që të ndërtojë një model aktiv, i tillë që është në gjendje të mbartë përgjegjësinë e dialogut kulturor dhe shoqëror.

#### 4. Mësuesi

Në filozofinë e medreseve, mësuesi është tejet i rëndësishëm për arsye se ai përgatit individin dhe shoqërinë e së ardhmes. Prishja e sistemit edukativ së pari preku mësuesit. Meqenëse ata e humbën cilësinë dhe ndikimin e tyre shoqëror, bashkë me ta ra edhe cilësia e njerëzve.

Dhe në fakt, mësuesit janë edhe përçues të vlerave të një shoqërie të virtytshme, edhe shembuj të individëve të devotshëm të cilët aspirojnë për dialog dhe tolerancë.

Mësuesi në përgjithësi, qoftë nëna, babai, apo të vjetrit, mësuesi përmes konceptesh, apo përmes shembujsh, është saktësisht ndihmësi, që i ndihmon njeriut të perceptojë drejt dhe kështu t'i kapërcejë keqperceptimet. Edukimi është i vetmi proces i shpëtimit, sepse edhe sipas formulës sokratike, “dija është virtyt”<sup>9</sup>.

Në filozofinë e medreseve, mësuesi që nga lindja e deri në vdekje, përbën një mjeshtër të bekuar që i jep jetë botës nëpërmjet formësimit të jetës së njerëzve. Nuk ka të barabartë me të mbi tokë, për sa i përket udhëheqjes së popullit drejt fatit të tij, rishikimin e etikës dhe karakteristikave të tij.

Dhe në fakt ndikimi i mësuesve mbi individët e tejkalon ndikimin e prindërve dhe të shoqërisë mbi ta. Mësuesi është ai, i cili gatuan nënën, babain dhe të gjithë anëtarët e shoqërisë së të ardhmes. Në qoftë se ai nuk përfshihet në gatimin e ndonjë pjese të brumit të individit, atëherë ky individ mbetet tërë jetën i paformuar.

Mësuesi është si një mjeshtër, në duart e të cilit, metalet pastrohen, duke u shndërruar në ar të pastër dhe argjend të shndritshëm. Në këto duar mistike, edhe gjërat më të papërpunuara dhe më të paçmueshme, shndërrohen në diamante të vlefshme. Asnjë fabrikë nuk mund të punojë aq shpejt dhe aq sistematikisht sa mësuesi. Askush

përveç mësuesit nuk mund t'u rrëfejë gjerësinë e spektrit emocional njerëzve rreth tij dhe të bëhet pjesë e ekzistencës së tyre.

## 5. Shkolla

Shkolla duhet të konsiderohet si një vend që ndërthur përvojat e ndryshme të njerëzimit brenda një njësie të vetme, ndaj, në këtë mënyrë, shkolla përbën një vend që e mbron njerëzimin nga çrregullimet e ndryshme mendore dhe praktike. Kjo pamje, pasqyron kështu tablonë e shkollës në filozofinë e medreseve.

Shkolla është një vend që i bën mësuesit dhe nxënësit subjekte të një transformimi të madh kimik. Është një laborator që i përgatit ata të zgjidhin çdo problem të njerëzimit dhe të qytetërimit. Shkolla është një institucion që bën të mundur edhe formimin e fëmijës ashtu dhe të mësuesit dhe që i jep formë mjedisit social dhe ekologjik.

Shkolla në fakt përbën një shtëpi që ka për detyrë shfaqjen e çdo gjëje joharmonike në shkollën e universit. Ajo përbën një shtëpi, që u ofron studentëve mundësinë e të studiuarit në çdo kohë, është një shtëpi që flet edhe kur hesht. Për këtë arsye, megjithëse duket sikur zë një vend të vogël në jetën e një njeriu, përbën megjithatë një shtëpi simbolike, e cila mbizotëron mbi kohën dhe i detyron të gjitha përjetimet ta dëgjojnë atë. Çdo nxënës që e ndjek shkollën me vëmendjen e nxënësit të devotshëm, do ta artikulojë mësimin e marrë në shkollë gjatë gjithë jetës.

Sistemi më i mirë edukativ është një shkollë, që e vë theksin njëkohësisht në ndodhitë e jashtme, ashtu dhe në dijet

---

9. Faruki, Ismail, “Islami dhe Krishterimi, Konflikt apo Dialog”, Erasmus, Tiranë, 2009: 48.

e brendshme. Në këtë shkollë, mësuesi përbën një udhëheqës të jashtëm. Megjithatë, për ata të cilët nuk dinë si të mësojnë nga ajo, mësuesit duhet të shërbejnë si ndërmjetës që lidhin së bashku jetën dhe vetveten dhe të cilët shpjegojnë dallimin e errësirës nga drita.

Nëpërmjet fitimit të zemrave të studentëve çdo ditë, nëpërmjet mjeteve të ndryshme, duke përballuar çdo dhembje dhe kokëçarje, si dhe duke lënë gjurmë të pashlyeshme në mendjet e tyre, si nëpërmjet mësimave, ashtu edhe nëpërmjet sjelljes së tij, mësuesi zë një vend të tillë që nuk mund të zëvendësohet me asgjë tjetër dhe me asnjë person tjetër. Është kjo arsyeja përse nxënësit mësojnë diçka edhe falë metodave lehtësuese të Perëndimit, asnjë qëllim i shkencës nuk mund të mësohet dhe asnjë objektiv nuk mund të arrihet nëse vetë mësuesi nuk jep shembuj të virtytit. Këto elemente mund të shpjegohen vetëm prej një mësuesi të tillë, fytyra e të cilit shndrit nga e vërteta, vështrimi i të cilit është pafundësisht i thellë dhe i cili zbukuron gjithçka që jep nga zemra e tij. Mësuesi i Rusoit ishte ndërgjegjja. Për Kantin ishte ndërthurja e ndërgjegjes dhe e arsyes. Në shkollën e Mevlana Rumiut dhe Junus Emresë, mësuesi është Profeti.

Sa i bekuar është mësuesi i cili është i përkushtuar ndaj nxënësve, i cili i ndjek ata hap pas hapi, në çdo stacion të jetës së tyre dhe i cili ndjehet i ekzaltuar kur ata ngrihen në nivelet e larta njerëzore. Vetëm një mësues i tillë është në gjendje t'u tregojë atyre të vërtetat absolute nëpërmjet lenteve të shkencës, shpesh i ngarkuar si rrufe, por i aftë të ndriçojë zemrat e studentëve të tij dhe të zbutë shpirtrat e tyre!<sup>10</sup>



### Konkluzione

Mbase në një të ardhme të afërt, në sajë të këtyre mësuesve të medreseve, që nuk kursyen vetveten me qëllim që të tjerët të jetojnë, mendja dhe shpirti do të përqafojnë njëri-tjetrin përsëri. Ndërgjegjja dhe logjika do të plotësojnë thellësitë e njëra-tjetrës dhe gjithçka do të gjejë mundësinë për të shprehur bukurinë që e karakterizon përmes gjuhës së saj, njerëzit do të pendohen që kanë luftuar njëri-tjetrin për asgjë, atmosfera e paqes që nuk ekzistonte më parë në treg, në shkollë dhe në vatrën familjare, do të jetë vendosur dhe erërat e lumturisë do të fryjnë, pastërtia morale nuk do të jetë dhunuar, ndershmëria nuk do të jetë nëpërkëmbur, zemrat gjithmonë do të rrahin me respekt dhe vlerësim, asnjëri nuk do t'i ketë zili të tjerët për pasurinë ose reputacionin e tyre, i fuqishmi do të sillet drejtësisht me të dobët, i varfri dhe i dobëti do të kenë mundësinë që të jetojnë njerëzisht, askush nuk do të jetë ndaluar me forcë vetëm për dyshime, banesat dhe vendet e punës nuk do të jenë sulmuar, gjaku i askujt nuk do të derdhet dhe i dobëti nuk do të qajë, çdokush do të dojë njerëzimin.

10. Gülen, Çağ ve Nesil, f. 110-114; Buuhanlar

Anaforunda Insan, f. 101.

**Literatura kryesore**

- Abertrombie, Nicholas; Longhurst, Brian: *Audiences. A Sociological Theory of Performance and Imagination*, Sage, London 1998.
- Backer, Martin;Petley, Julian: *Effects. The Media -Violence, Debate*, Routledge, London 1997
- Dervishi Zyhd: *Adoleshentët, bashkëjetesë me demonët e konflikteve*, Shtëpia Botuese “Emal”, Tiranë 2009.
- Frashëri, Pandi M: *Familja shqiptare*, Botues Ismail Mal Osmani, Tiranë 1944.
- Gauntlett, David: *Media, Gender and Identity*, Routledge, London 2002.
- Gylen, Fethullah (a): *Kriteret ose Dritat e Rrugës – ese, gjykimë, aforizma*, Prizmi, Tiranë, 2003.
- Gylen, Fethulah (b): *Nga fara te lisi*, Prizmi, Tiranë, 2008.
- Instituti i Kulturës Popullore: *Fjalë të urta të popullit shqiptar*, Botuar nga Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë 1983.
- Maigret, Eric: *Sociologjia e komunikimit dhe e mediave*, Botimet “Papyrus”, Tiranë 2010.
- Silvestone, Roger: *Television and Everyday Life*, Routledge, London 1994.
- Wimmes, Roger D., Dominick Joseph R. *Mass Media Research*, Wodsmorth Publishing Company, Belmont 1987.

## Komunikimi përmes objekteve të kultit Islam në Shqipëri

Msc. Ferit Lika - KMSH

### Abstrakt

*Në objektet e kultit komunikohet dhe vazhdon të komunikohet nevoja e njeriut për të studiuar, për tu shkolluar për të qene i ditur, pasi fitimi i dijeve është detyrë parësore e çdo myslimani sepse në vetvete thelbi i islamit është të mësosh dhe të përcjellësh dijen...*

*Dyndjet masive nëpër xhami, pas shembjes së komunizmit, treguan se besimtarët i mbajtën fort bindjet e tyre fetare, pavarësisht nga përndjekjet. Të gjithë ata fetarë e atdhetarë që kundërshtuan idetë shkatërrimtare të këtij regjimi, u përdoqën, u vranë dhe u masakruan në mënyrën më çnjerëzore, por as kejo nuk mundi të shkulë rrënjët e besimit në vend.*

### 1. Komunikimi në xhami përmes ligjëratave

Në kushtet e mungesës së shtetit shqiptar (1912-1939), apo të ekzistencës së tij të dobët, institucionet fetare (ndër to edhe xhamitë), kryenin funksionet e administrimit të jetës shoqërore të besimtarëve.<sup>1</sup> Feja islame dallonte nga fetë e tjera për nga brendia dhe funksionet shoqërore të saj. “Ajo bashkonte në vetvete parimet shpirtërore dhe shekullore, synonte të depërtonte në të gjithë sferat e jetës e të veprimtarisë së besimtarit. Dispozitat e saj përfshinin veprimtarinë ideologjike, shtetërore, politike, administrative, fiskale, ushtarake, juridike e familjare. Ky karakter shumëdimensional i fesë islame synonte të krijonte të besimtarët shprehitë për t’i vlerësuar të gjitha

ngjarjet dhe dukuritë e jetës nëpërmjet prizmit të kanuneve fetare: Kur’anit, synetit si dhe të drejtës tradicionale myslimane – ligji i sheriatit”.<sup>2</sup> Pra, në objektet e kultit islam, përkatësisht xhamitë por jo vetëm, komunikohet ajo se si një person besimtar duhet të ishte i dobishëm për veten, shoqërinë, vendin dhe kombin e tij.

Në këto objekte kulti komunikohet dhe vazhdon të komunikohet nevoja e njeriut për të studiuar, për tu shkolluar për të qene i ditur, pasi fitimi i dijeve është detyrë parësore e çdo myslimani sepse në vetvete thelbi i islamit është të mësosh dhe të përcjellësh dijen. Në librin “Rrugëtimi i islamit në Shqipëri”, studiuesi Ali M. Basha, shkruan: “... Myslmanët ndërtuan xhami dhe medrese, në të cilat lulëzoi dija për

1. Shih Basha Ali f. 47.

2. Stafanaq Pollo, f. 22, Ali Basha, f. 50.

natyrën dhe shoqërinë, nëpërmjet një sistemi të qartë dhe të saktë arsimor”.<sup>3</sup> Më 14 dhjetor 1920, Këshilli i Naltë i Sheriatit nxori urdhrin ku ngulte këmbë që të gjithë nëpunësit dhe kleri mysliman që ishin në shërbim të popullit ta mësonin gjuhën shqipe me shkrim dhe lexim dhe ta përdorin atë në kontaktet, predikimet dhe korrespondencën që mund të kishin në çështjet e përditshme.<sup>4</sup>

Nga dokumentet më të vjetra që kanë arritur deri në kohën tonë, e deri te krishterimi dhe islami, respektimi i Zotit asnjëherë nuk ka munguar. Njeriu gjithmonë është në kërkim të lumturisë së tij të brendshme dhe vendi i parë ku ai gjen lumturinë dhe prehjen është feja/besimi. Eliade<sup>5</sup>, filozof rumun, thotë se të jetuarit si njeri është një veprimtari fetare ne vetvete. Ndërsa Schopenhaueri thotë se njeriu është një krijesë metafizike. Sipas tij tempujt, kishat, pagodat, lutjet dhe përgjimet të cilat i hasim në çdo kohë dhe çdo vend me tërë ndriçimin dhe madhështinë e vet paraqesin prova të nevojës për elementin metafizik që e ruan ekzistencën e vet, që është ndikues dhe që s’humbe dot.<sup>6</sup> Pra njeriu asnjëherë nuk ka mundur të jetojë pa Zotin. E shenja është pjesë e pandashme e jetës së tij. Modernizmi s’ka arritur ta kënaqë njeriun. Për këtë arsye njeriu i kohës sonë kërkon rrugë mënyra dhe alternativa të reja për të arritur lumturinë e humbur. Në mesin e këtyre metodave të kërkimit të lumturisë, vend të posaçëm zë religjioni.

3. Basha, A., f. 116.

4. Po aty, f. 25.

5. Eliade M., Dinin Anlam ve sosyal fanksiyonu.

6. Bahtijarevic B., Socijolištičko društvo, crkra I religija (f. 9).

Vendi ynë ashtu si shoqëritë e tjera post komuniste, kaloi një periudhe të ndryshimeve rrënjësore shoqërore, ekonomike dhe politike, etapë kohore kjo e quajtur “periudha e tranzicionit”. Me këto ndryshime njeriu i këtij nënqielli me një entuziazëm të flaktë i kthye shpirtërores dhe fesë. Për shkak të ndryshimeve të dukshme fetare kjo periudhë mund të quhet edhe “periudha e kthimit në skenë e së shenjtës dhe hyjnore”<sup>7</sup>

Këtë hulumtim të shkurtër rreth komunikimit përmes objekteve të kultit të fesë islame në Shqipëri do ta grupoja në tre periudha edhe pse përfshin një kohë të gjatë me ndryshime të mëdha historike për pasojë me ndryshime edhe në metodikën e komunikimit verbal nëpër xhami. E para përfshin kohën që nga pavarësia e Shqipërisë deri në mbisundimin e regjimit komunist 1912-1966; E dyta është periudha komuniste 1966-1990; dhe e treta, periudha e demokracisë 1990 – 2014. Në dy periudhat e para do të ndalemi shkurtimisht për t’u thelluar më tepër në periudhën e tretë, pra atë të kohës së tranzicionit shqiptar (demokracisë).

Periudha e parë 1912-1966, karakterizohet nga kuadro fetarë intelektualë mjaft të përgatitur dhe shumëdimensional, ata ishin hafizë, letrarë, poetë, diplomatë, luftëtarë, e atdhetarë të flaktë. Shumica prej tyre ishin shkolluar jashtë dhe zotëronin disa gjuhë të huaja. “Shqipëria nga shpallja e pavarësisë më 1912 e pastaj me Qeverinë e Mbretit Zog derisa u ndalua feja më 1967 nga regjimi komunist

7. Pajaziti A., Modernizmi, feja dhe lumturia e njeriut.

ka pasur dijetarë të shquar islam si H. Vehbi Dibra, H. Ismet Dibra, H. Mahmud Dashi, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, Hafiz Ali Kraja e shumë të tjerë që janë diplomuar në Stamboll dhe kanë bërë një seri përkthimesh e vepra origjinale.”<sup>8</sup>

Në këtë periudhë ajo çka komunikohet në objektet e kultit islam përveç fesë ishte edhe ndjenja e atdhetarizmit, ku kërkohet mbrojtja e atdheut nga pushtuesit. Në këtë periudhë nëpër xhami komunikohet rreziku i ateizmit të imponuar që do të sillte më vonë komunizmi, komunikohet dhe nxiteshin njerëzit të arsimoheshin dhe të përgatiteshin për veten, fenë dhe kombin e tyre, etj. “Teologët shqiptarë në 100 vjetorin e pavarësisë vlerësohen për promovimin e vlerave morale të shoqërisë, që nuk e ndanë fenë nga atdheu dhe familja; kanë kontribuar për mësimin e gjuhës shqipe, si mësimdhënës dhe edukatorë të brezit të ri si dhe me edukatën fetare. Ligjëratat e tyre kanë ngritur në këmbë myslimanët kur ka qenë nevoja për mbrojtjen e vendit.”<sup>9</sup>

Periudha e dytë 1966-1990 është edhe periudha më e errët për religjionin dhe objektet e tij njëkohësisht dhe njerëzit e fesë. Institucioni i fesë u dobësua në mënyrë të pallogaritshme derisa edhe u shkatërrua totalisht.

Dyndjet masive nëpër xhami, pas shembjes së komunizmit, treguan se besimtarët i mbajtën fort bindjet e tyre fetare, pavarësisht nga përndjekjet. Të gjithë ata fetarë e atdhetarë që

kundërshtuan idetë shkatërrimtare të këtij regjimi, u përdoqën, u vranë dhe u masakruan në mënyrën më çnjerëzore, por as kjo nuk mundi të shkulë rrënjët e besimit në vend. “...Të gjithë elementët shqiptaro-fetar, si vëllezër të një gjaku e si besues të një Zoti të Amsbueshëm, dubet me u bashkue e me u organizue në një front të përbashkët për ta luftuar ateizmin, që do me shkatërrue “Fe e Atdhe”. Kjo është lufta e shenjtë që dubet të bëjnë të gjitha fetë në Shqipëri”, ishte kjo thirrja e myslimanëve kundër komunizmit. Qindra xhami u shkatërruan, ndërsa qindra njerëz të fesë, intelektualë e patriotë u pushkatuan, u burgosën apo u internuan, terror i cili vazhdoi deri në fillim të viteve ‘90.”<sup>10</sup> Në këtë periudhë nuk mund të flasim për një komunikim përmes objekteve të kultit pasi ato u shkatërruan, u mbyllën dhe u kthyen barbarisht në depo e magazina, por në këtë kohë ekzistoi një tjetër lloj komunikimi që njerëzit e fesë realizonin fshehurazi nëpër shtëpi siç ishte këndimi i mevludeve (vepra letrare, poema ku tregohet jeta e profetit Muhamed dhe misioni i tij).

Me shembjen e regjimit komunist në vitet ‘90, më 16 nëntor 1990, pas 23 vjetësh u këndua Ezani dhe u fal Xhumaja në Shkodër, në Xhaminë e Plumbit, e më pas në të gjithë vendin. “Dalëngadalë feja filloi të zërë vendin që i takonte në shoqërinë shqiptare. Paralelisht edhe Komuniteti Mysliman (Xhamitë) ndërmori një rol aktiv në jetën social-kulturore të vendit duke i paraprirë, madje dhe parandaluar

8. Intervistë: Balla, Xh. Komunikimi përmes hytbes, intervistoi Lika, F., Maj 2013.

9. Po aty.

10. Lika, F., 90 vjet Komunitet Mysliman Shqiptar, Revista Drita Islame, Shkurt 2013, “<http://www.dritaislame.al/90-vjet-komunitet-mysliman-shqiptar/>”.

probleme të shumta sociale, sepse as fuqia e ligjit nuk e ka fuqinë e bindjes dhe ndikimit të besimit. Por mbi të gjitha sot liria e besimit triumfon, shpirti i besimtarit ndjehet i lirë të adhurojë Atë që i dha frymë, Atë që e ngjizi, Krijuesin e gjithësisë.”<sup>11</sup>

Pas viteve 90-të shumë të rinj myslimanë u shkolluan brenda e jashtë vendit nëpër shkollat islame në të gjitha nivelet. Përrjedhojë xhamitë në Shqipëri sot kanë një kuadër të mirëpërgatitur për Islamin, por që siç duket edhe nga veprimtaria e tyre por edhe siç studiuesit e fushës i shohin, nuk janë në nivelin e atyre të para komunizmit. “Sot kemi një brez të ri kuadrosh fetarë, të diplomuar në universitetet fetare jashtë vendit, por që nuk e kanë pjekurinë e stazhin, që dhe këta të bëhen dijetarë të tillë. E ardhmja është pikërisht për këtë brez të kuadrove fetar imam-vaiza; që të vazhdojnë trashëgiminë e të parëve dhe t’u bëjnë brezave që vijnë edhe ata vepra fetare që të mbeten dijetarë islamë që kanë kontribuar për këtë vend.”<sup>12</sup>

Si kudo edhe ligjëruesit predikues, vaizët kanë secili përvojën, stilin dhe metodën individuale komunikative. “Nëpër xhamitë e qytetit të Tiranës ka predikues që duhen përmendur për taktin, stilin, metodën dhe ëmbëlsinë e komunikimit. Predikuesit i kushtojnë vëmendjen e duhur si specifikave teknike e profesionale, ashtu edhe specifikave stilistike. Dallohen e shquhen për korrektësinë komunikative, stilin, metodën, tonin e zërit e timbrin, intonacionin fjalë për fjalë dhe në lidhjen logjike të mendimit. Ata nuk e njohin

polemikën, fjalën e ashpër e të vrazhdë. Predikuesi mundohet të përvetësojë e të aplikojë metodën e triumfit të zemrave, duke i qëndruar larg diskutimit të ashpër dhe fjalëve me lojëra logjike.”<sup>13</sup>

Predikimi dhe këshilla duhet të jenë të tilla që ta zbusin zemrën e të zënë vend në ndjesi. Ligjëruesi duhet të jetë njeri edhe i mendjes edhe i zemrës. Ai, që nuk mund të mendojë me mendjen e vet e të ndiejë me zemrën e vet, nuk mund të tregojë. Shprehjet e tija nuk mund të jenë të ngarkuara me mëshirë. “Këto dy dekadat e fundit, me përmbysjen e diktaturës komuniste dhe me ardhjen në pushtet të demokracisë, ka ardhur një brez i ri teologësh të kualifikuar, që me ligjëratat e tyre kanë tërhequr një masë të madhe të rinjsh e të rejash besimtarë myslimanë, që frekuentojnë rregullisht institucionet fetare për adhurim. Ata manifestojnë vlera të normave morale si individë, në familje dhe shoqëri. Ata janë të papajtuësëm me antivlerat që shfaqen sot në shoqërinë tonë si alkooli, bixhozi, droga, prostitucioni, vjedhja, grabitja etj. Masa e të rinjve myslimanë sot janë bërë solidarë për vepra humane dhe iniciatorë në ndihmë dhe përkrahës të jetimëve e nevojtarëve.”<sup>14</sup>

## 2. Hytbeja shqiptare dhe Ligjëruesi

Fjala “hytbe” rrjedh nga fjala arabe “hatabe” që do të thotë mban fjalim (predikim). Hytbeja që mbahet ditën e Premte është obligim fetar, që plotëson kushtin e faljes apo namazit dy rekatësh, detyrë për çdo mysliman.

13. Xhina, R., Predikimi dhe predikuesi, Drita Islame, “<http://www.dritaislame.al/predikimi-dhe-predikuesit/>”

14. Balla, Xh, Intervista.

11. Po aty.

12. Balla, Xh, Intervista.

Ligjërata fillon me një falënderim të veçantë për Zotin e Madhërisëm, Zotin e botëve dhe Sunduesin e gjithçkaje që ndodhet në to, pastaj dhe me dëshminë se profeti Muhamed është i dërguar i Zotit. Mbas kësaj hyrje të shkurtër trajtohen problemet e caktuara adresuar besimtarëve dhe në mbyllje me detyrat që ka secili besimtar për të zbatuar sipas ligjeve e Sheriatit Islam. Mënyra e mbajtjes së ligjëratave në xhami i përmbahet rregullave të fesë islame që janë të njëjta për të gjithë myslimanët e botës. “Procedura është e njëjtë edhe për një fakt tjetër se imamët apo predikuesit tanë janë shkolluar në këto vende. Mund të ndryshojë vetëm tematika e ligjëratave mbasi secili vend ka problemet e veta si dhe shkalla e kulturës, e nivelit të përgatitjes fetare, ku dihet se vendet islame kanë dijetarë më të shquar. Literatura e tyre në zbërthimin e ligjeve të Kur’anit dhe Hadithit të Profetit (a.s.) merret e studiohet nga imamët apo vaizët e vendit tonë. Në fshat ka dhe imam që janë vetëm me arsim të mesëm, e sigurisht niveli i tyre nuk është në shkallën më të lartë që kërkohet.”<sup>15</sup>

Ndërtimi i një hytbeje ashtu si edhe në vendet e tjera edhe në Shqipëri ka një kornizë të caktuar fetare që fillon me hyrjen, brendinë, salavate për Profetin (a.s.) e pastaj fillon pjesa e dytë. Në fund bëhet lutja që e shoqëron një citim i Kur’anit, ku Zoti urdhëron vetëm drejtësi për njerëzit në tokë. Kjo metodologji zbatohet sipas nivelit kulturor të ligjëruesit. Këtë fjalim (predikim) e mban imami i xhamisë, që në këtë rast quhet “hatib”, që do

15. Po aty.

të thotë: folës, orator ose referues. Në podiumin e caktuar posaçërisht për këtë ditë të Premte, për të biseduar me xhematin (myslimanët) në xhami, imami u drejtohet të pranishmëve për problemet kryesore që ai ka menduar të bashkëbisedojë si mësim, këshilla, thirrje etj. Në vendin tonë deri më tani nuk ekzistojnë trajnime të caktuara, specifike që mund të përgatisin një imam se si të mbajë një hytbe ndërsa në vende të ndryshme të botës, universitetet islame kanë të ingranuar në strukturat e tyre lëndë të posaçme për metodologjinë e hytbes. “Personat e ngarkuar me detyrën e predikuesit, kanë marrë njohuri të mjaftueshme në shkollën fetare ku kanë studiuar. Por për trajnime të mëtejshme këtu në vendin tonë nuk ka strukturë arsimit që të merret me trajnimin shumë të nevojshëm të tyre. Në vendet e tjera i kanë kushtet sepse ka universitete me degë të posaçme fetare.”<sup>16</sup>

Ligjëruesi dallohet nga besimtari i thjeshtë sepse ky është i emëruar në këtë detyrë nga institucioni vartës, Komuniteti Mysliman. Ai duhet të jetë i diplomuar për teologji dhe dallohet nga aftësia dhe mjeshtëria për të mbajtur këtë predikim, që në gjuhën arabe quhet “hatabetun”. Përveç kësaj, ai duhet të karakterizohet nga arti i të folurit, të mbajturit fjalim, që në gjuhën arabe i thonë “hitabetun”.

Predikuesi i fesë islame, imami (hoxha) ose mësuesi duhet të karakterizohet nga aftësitë njohëse të realitetit, të bëjë analizën dhe konkluzionin e tyre mbi baza të shëndosha të fesë islame. Atëherë ai

16. Po aty.

duhet të arrijë të njohë personalitetin e çdo besimtari e myslimani, të përcaktojë nivelin kulturor e pastaj të arrijë në përfundime të drejta, për masën që duhet marrë për të ndihmuar në frenimin, ndalimin dhe parandalimin e përfshirjes së tyre në mëkate ose veprime të ndaluara nga ligjet islame. Ai duhet të ketë aftësi, që të vlerësojë çdo shenjë që prek ndjenjat dhe emocionet, me butësi e ëmbëlsi, për t'ia lehtësuar shpirtin e të priret gjithmonë nga shpresa e besimi tek Zoti. Pra, ai duhet të depërtojë në botën e brendshme të çdo besimtari. Për të arritur këtu, besimtarët duhet të tërhiqen e të tregohen të vëmendshëm, për të kuptuar dhe përvetësuar materialin që paraqet predikuesi.

“Nga shkalla e përgatitjes së predikimit (imami-vaiz) nga ana profesionale, psikologjike e metodike, varet drejtpërsëdrejti niveli i njohjes dhe i zbatimit të ligjeve islame e trajtimi i tyre në ligjëratat të veçanta. Themeli bazë i fesë islame është Kur’ani Famëllartë dhe Syneti i Profetit a.s., por në fund të fundit atyre u jep jetë kuadri teologjik, imami apo vaizi me punën e tij të përditshme, plot pasion e me mjeshtëri profesionale. Imami apo vaizi duhet të dallohet për saktësinë e interpretimit të dijeve apo ligjeve islame, me origjinalitet në këtë proces, si dhe aftësi në përzgjedhjen, përpunimin dhe pasqyrimin e realitetit në të cilin jetojmë. Atëherë ata do të gëzojnë autoritet e respekt tek besimtarët, që do të bëhen pjesë e tyre në zbatimin e detyrimeve fetare. Kështu ata bëhen një forcë e madhe nxitëse për të forcuar ndjenjat fetare të çdo myslimani, që kultivojnë motive të shëndosha për familjen e

shoqërinë. Pra, shkalla e përgatitjes së këtij kuadri të fesë islame është faktori bazë në detyrën e shenjtë fetare.”<sup>17</sup>

Ligjëruesi përballet me njerëz të moshave dhe kategorive të ndryshme sociale dhe për këtë ai duhet të ketë formim të shëndoshë teologjik por dhe psikologjik e metodik. Studiuesi shqiptar Xhemal Balla thotë se Imami ose vaizi komunikon direkt me xhematin islam në podiumin e posaçëm në xhami. Mirëpo sado i ditur, i kulturuar që të jetë, nuk është e mundur t’u përgjigjet në shkallë absolute problemeve të ndryshme që dalin në realitetin e sotëm, sepse njerëzit sot janë në kontakt të vazhdueshëm me burime të shumta informacioni. Për një komunikim të lirshëm e tërheqës kuadri fetar jo vetëm që duhet të ketë formim të shëndoshë teologjik por kërkon dhe atë psikologjik e metodik sepse kemi të bëjmë me moshën të ndryshme që nga ajo e fëmijërisë, adoleshencës, brezit të ri dhe moshës së thyer. Materiali i përgatitur nga imami apo vaizi duhet t’i përshtatet nivelit të moshave për të pasur efektin e duhur tek ata.

“Për të qenë me efekt bisedat që paraqet predikuesi përpara xhematit islam, duhet që ai të jetë i aftë të njohë qëndrimin e vëmendshëm ose të pavëmendshëm të besimtarëve ndaj ligjëratës që ai paraqet. Ai duhet të kuptojë shenjat e lodhjes apo të moskuptimit e deri në rastësi e ndonjë pëshpëritje të vogël të tyre. Prandaj nga imami ose vaizi kërkohet, para së gjithash, që të njohë në mënyrë të thellë e të gjithanshme nivelin e zhvillimit të vëmendjes së vet, të cilësive të saj dhe, mbi këtë bazë, të punojë sistematikisht

---

17. Po aty.

me synime të caktuara për edukimin e saj, të njohë e të përvetësojë anët psikologjike të këtij procesi. Intuita psikologjike e imamit apo vaizit është një parakusht tjetër për mënyrën e ndërtimit të bisedës, për atë çka ai thotë, për të krijuar një atmosferë sa më të ngrohtë e dashamirëse me dëgjuesit.”<sup>18</sup>

“Institucionet fetare, xhamitë, nuk mjafton të konsiderohen vetëm si vend adhurimi pesë herë në ditë në qytet dhe një herë në javë në fshat. Puna e imamit duhet të priret edhe nga veprimtaria e tij edhe ..., me literaturën e nevojshme fetare sipas moshave, madje dhe në veçanti për gjininë femërore. Ky është një kusht i brendshëm që duhet të karakterizojë çdo imam, i cili duhet të ketë predispozita nga detyra fisnike që përfaqëson. Ai konsiderohet

dhe si mësues i popullit mbasi të gjithë besimtarët e thërrasin Hoxhë, i cili di gjithçka dhe nga i cili duhet marrë mësim.”

Imamët apo predikuesit nëpër qytete janë kuadro të caktuar nga Komuniteti Mysliman, posaçërisht me funksionin e drejtimit të një institucioni të shenjtë ku i bëhet adhurim Zotit të madhërishtëm. Ata janë diplomuar në universitetet islame për teologji dhe janë të përgatitur për këtë detyrë. “Shkalla e realizimit të kësaj detyre varet nga ndërgjegjja personale e secilit për t'u angazhuar e përgatitur në ligjëratat. Ndërsa në fshatra sigurisht niveli është më i ulët. Për këta persona, herë pas here duhen organizuar seminare kualifikimi.”<sup>19</sup>

18. Po aty.

19. Po aty.



Kupola e xhamisë Sinan Pasha, Prizren

## A pajtohet Islami me demokracinë?

M.S. Fatos A. Kopliku  
Ann Arbor, Miçigan, SHBA

### Abstrakt

*Islami është i pajtueshëm me çdo formë qeverisjeje, demokraci a sido që të quhet, për sa kohë që shteti nuk trazon qytetarët e vet duke futur hundët në çdo detaj të jetës shoqërore e personale për të diktuar me bistrinë e ligjeve e rregulloreve se si duhet ta jetojnë atë. Myslimanët do të përkrabnin njëzëri poetin e filozofin amerikan Henry David Thoreau kur shprehet se “Qeveria më e mirë është ajo që qeveris më pak.” Veçanërisht është shumë e rëndësishme për myslimanët që religjioni, pra ri-lidhja me Hyjnoren, të mos cënohet apo manipulohet nga ndërhyrjet e shtetit. Rumin thotë se “Shtëpia pa dritare është ferr. Qëllimi i fesë është të hapë një dritare”, e kejo do të thotë se ndërhyrja e shtetit, apo çdo lloj organizate në fe, për ta lakuar fenë sipas axhendës së vet, është ngushtim i kësaj dritareje providenciale (të cilën komunistët e mbyllën fare), dhe një hap më afër drejt një shtëpie apo hapësire infernale.*

**N**dër mend po më vjen një shprehje popullore turke që komenton me qesëndi situata të tilla; “nuk di ngaqë s’pyet, e nuk pyet ngaqë s’di”<sup>1</sup>. Jo vetëm është e domosdoshme të pyesësh që të mësosh, por është po aq e domosdoshme një bazë njohurie për të pyetur siç duhet, në atë mënyrë që mundëson ndjekjen e fillit te përgjigjja e duhur, te e vërteta.

Para se dikush të na akuzojë se po i bëjmë bisht pyetjes duam, sepse duhet, të dimë qartë se çfarë nënkuptohet me fjalën “demokraci”. Ka demokraci direkte<sup>2</sup>, ku qytetarët marrin pjesë

personalisht në vendimet politike, ka demokraci përfaqësuese, ku qeveritarët zgjidhen të përfaqësojnë interesat e elektoratit<sup>3</sup>, ka demokraci parlamentare, presidenciale, kushtetuese... Nuk është qëllimi i këtij shkrimi detajimi në format

---

bashki në qyteza të vogla në SHBA praktikohet demokraci direkte ku qytetarët marrin pjesë direkt në vendime për disa çështje të caktuara lokale. Demokracia e Athinës së lashtë është një tjetër shembull. Megjithatë, këshillat a kuvendet ku vendime të caktuara votoheshin kanë ekzistuar, dhe ekzistojnë, në shumë popuj e kultura.

3. Një nga kritikantët e kësaj forme është se jo rrallë klasa politike do të marrë vendime që janë në kundërshtim me vullnetin e popullit. P.sh., Mbretëria e Bashkuar shkoi në luftë në Irak edhe pse shumica dërrmuese e britanikëve ishte kundër.

---

1S ormaz ke bilmez, bilmez ke sorsun.

2. Në disa kantone të Zvicrës, dhe në disa

e ndryshme të qeverisjes në kohët moderne, por i cekëm për të nënvizuar se nuk është shumë e qartë, ose nuk është shprehur qartë nga ata gazetarë, analistë e opinionistë, që i kërkojnë llogari Islamit në Shqipëri, se për cilën demokraci e kanë fjalën?

Megjithatë, ndoshta nuk është edhe aq e thjeshtë. Shkrimtari dhe linguisti gjerman Uwe Pöerksen në librin e tij *“Fjalët plastike: tirania e një gjube modularë”*<sup>4</sup> studion dhe shpjegon dukurinë dhe origjinën e fjalëve plastike. Sipas tij këto fjalë nuk janë të reja në mënyrën si shkruhen apo shqiptohen, por në mënyrën se si përdoren. Ato janë fjalë, vazhdon Pöerksen, me kuptim të mjegullt, por që imponojnë respekt në sajë të një aure që e huazojnë nga origjina e tyre në sferën e shkencës. Për shkak të efektit sugjestionues që mbartin ai i quan ato “tiranë” dhe na jep si shembull fjalë si “zhvillim”, “informacion”, “seksualitet”, “standard jetese”, “konsum”, “strategji”, “progres”, “faktor”, “liri” etj., etj. Si rrjedhojë, kushdo që flet në emër të tyre pozicionohet me progresin, të ardhmen, e kushdo që edhe heziton për një çast konsiderohet si pinjollë e një mentaliteti të vjetër (sikur të ishte diçka që rinohet a plakët mentaliteti). Për të ilustruar përdorimin e fjalëve plastike, dhe aftësinë e tyre që të nënkuptojnë gjithçka dhe asgjë në të njëjtën kohë, ai na jep shembuj nga fjalime të politikanëve e biznesmenëve në Gjermani<sup>5</sup>. Ndërsa ne menduam se në përvojën e Shqipërisë

shembulli ndoshta më i mirë i kësaj forme të të shprehurit është ai i ish-kryeministrit Fatos Nano, megjithëse edhe të tjerë nuk mbesin shumë pas, dhe duam të citojmë pjesë nga një fjalim i tij në forumin ‘Shqipëria: sfidat 2005’ të datës 12 janar 2005.

*“...Qeveria është në momentin e përfundimit të analizave të punës së saj, e cila nuk është një punë e mbyllur dhe kjo është një shprehje e një cikli publik të punës së qeverisë. Do të vijmë brenda pak ditësh në konkluzionet e këtij arsyetimi, pasi është dhënë aq informacion sa kemi mundur në analizat sektoriale apo të dikastereve të veçantë...”*

*Vendi ka arritur në një nivel të caktuar, një stad të caktuar dhe ka parametra që e shprehin këtë gjendje të vendit, atë që drejtues vendas normalë - përfundimisht Shqipëria është një vend normal - e cilësojnë si gjendja e kombit apo e shtetit...”*

*Duket se në 2004 vendi ka shënuar një progres të dukshëm, i cili po konsolidon parametrat kryesorë të funksionimit të institucioneve, të administratës, të ekonomisë, të shoqërisë dhe të marrëdhënieve gjithnjë e më nxitëse, pra problemore me botën, duke filluar që nga rajoni... Ne kemi arritur që këtë dinamikë ekonomike ta administrojmë në mënyrë më racionale, sepse ka rënë pesha e borxhit të brendshëm apo e borxhit ndërkombëtar që mban ekonomia, që shlyen ekonomia dhe për pasojë që u transmetohet vit pas viti taksapaguesve.”*

Sidoqoftë, profesor Pöerksen nuk është i pari që e ka pikasur këtë varfërim të mënyrës së të shprehurit. Shkrimtari anglez George Orwell në esenë e tij *“Politika dhe gjuba angleze”* mes të tjerash thotë:

*“...Shumë fjalë politike abuzohen... Fjalët si demokraci,*

4. Uwe Pöerksen, *Plastic Words: The Tyranny of a Modular Language* (University Park, PA: PSU Press, 1995).

5. Ibid., p. 57.

*socializëm, liri, patriotik, realist, drejtësi* kanë secila kuptime të ndryshme që nuk mund të pajtohen me njëra tjetrën. Në rastin e një fjale si *demokracia*, jo vetëm që nuk ka pajtim, konsensus për një përkufizim, por edhe përpjekjes për konsensus i rezistohet nga të gjitha palët. Ka një perceptim pothuajse universal se kur e quajmë një vend demokratik (d.m.th.) po e lëvdojmë atë: si rrjedhojë, mbrojtësit e çdo lloj regjimi deklarojnë se është demokraci dhe frikësohen se mund të detyrohen mos ta përdorin më atë fjalë nëse do të ishte e kufizuar në një kuptim të vetëm.<sup>6</sup>

Ndërsa mendimtari dhe historiani francez Alexis de Tocqueville në veprën e tij të njohur "*Demokracia në Amerikë*" i dedikon një kapitull të veçantë ndikimit të kësaj forme të re qeverisjeje mbi gjuhën angleze, dhe vëren se është pasuar nga një rritje e përdorimit të termave abstraktë, personifikues dhe mjegullues. Ja ç'thotë:

"Kombet demokratike janë të dhëna me pasion pas termave gjenerike dhe shprehjeve abstrakte sepse këto mënyra ligjërimi zgjerojnë mendimin dhe asistojnë funksionimin e mendjes duke e mundësuar atë të përfshijë shumë objekte në një qark të vogël...

Këto terma abstraktë që ngopin gjuhët demokratike, dhe që përdoren vend e pa vend pa lidhje me ndonjë fakt të veçantë, zmadhojnë dhe mjegullojnë mendimin. Ato e përshpejtojnë të shprehururin ndërsa e paqartësojnë idenë...

Njerëzit që jetojnë këtu, meqë lihen vetëm në dorë të kapacitetit të tyre

intelektual, janë gjithmonë nën sikletin e dyshimit... Ngase ata nuk e dinë nëse ideja që shprehin sot do t'i përshtatet situatës me të cilën do të përballen nesër, ata natyrshëm kultivojnë një shije për terma abstraktë. Një term abstrakt është si një kuti pa taban; mund të vendosësh brenda idetë që të pëlqejnë, dhe mund t'i nxjerrësh prapë jashtë pa u vënë re nga askush."<sup>7</sup>

Nuk është e vështirë të vërehet se vërshimi i një morie termash abstraktë ka krijuar një situatë të ngjashme edhe në Shqipëri. Vëzhgimet e Pöerksen-it, Orwell-it dhe Tocqueville-it dëshmojnë se ekziston një paqartësi në lidhje me përkufizimin e domethënien e shumë termave që përdoren sot, veçanërisht në politikë, përfshirë dhe konceptin "demokraci". Duke u bazuar në këto vëzhgime nëse e ri-shtrojmë pyetjen-titull edhe një herë ajo merr këtë formë: A pajtohet Islami me diçka të papërcaktuar mirë, si demokracia?

Kjo do të ishte me të vërtetë një pyetje absurde, një situatë absurde madje, sepse kur duam të dimë nëse dy gjëra pajtohen, apo nëse duam të krahasojmë dy gjëra, *dubet* të kemi njohuri të saktë për te dyja. Mesa dimë akoma nuk është bërë ndonjë vëzhgim apo vlerësim mbi efektin e vërshimit të termave që shqyrtoam deri tani në gjuhën shqipe. Ky do të ishte hapi i parë drejt njëfarë kthjelltësie jo vetëm në dialogun politik shqiptar por edhe në fusha të tjera. Përndryshe çdo pyetje a shprehje që nuk përmban terma të ravijëzuar mirë nuk mund të jetë kumtuese, e madje edhe

6. George Orwell, *Politics and the English Language* (1946), (përkthimi i autorit).

7. Alexis de Tocqueville, *Democracy in America* (Indianapolis, IN: Liberty Fund Inc, 2010), Vol. 2, chap. 16, p. 827-9, (përkthimi i autorit).

i hap rrugë keqkuptimeve. Sidoqoftë, edhe pse jemi përballë një problemi me të vërtetë serioz, do të mundohemi të përgjigjemi.

Për momentin të kthehemi tek Islami. Kërkon një guxim të madh (e të marrë mund të shtoja) të dalësh e të flasësh për diçka pa pasur njohuri, apo edhe më keq, duke pasur njohuri të gabuara. Megjithatë, në Shqipëri guximtarët e ekspertët që gëlojnë me opinione nga më interesantet, për të mos thënë tjetër gjë, në lidhje me Islamin (e jo vetëm) nuk mungojnë. Jemi munduar, me modesti, duke iu referuar disa nga autoriteteve më të respektuar të studimeve islame, të përmbledhim me pak fjalë se çfarë është Islami.<sup>8</sup>

Fillimisht po japim një shembull pak të rëndomtë në krahasim me temën por jo pa lidhje. Imagjinoni sikur dikujt i bëhet pyetja se kush është, çfarë është një futbollist. I pyeturi na thotë se futbollist është një njeri që përfshihet në skandale nëpër klube nate, ka për zemër makinat e shpejta apo se është protagonist në reklama. Ndërsa përshkrimet janë të vërteta, asnjëra nuk hedh as më të voglën dritë në atë se çfarë është një futbollist, e si rrjedhë as çfarë është futboll. Në mënyrë të ngjashme ka një ushtri “ekspertësh” që na tregojnë se myslimani apo myslimania është një

8. Ka shumë referenca me vlerë në lidhje me këtë temë, por unë do të veçoja dy (në shqip): S. Murata & W. C. Chittick, *Vizioni i Islamit*, shqip. Sokrat Ahmataj (Tiranë: Fondacioni Rumi, 2008); dhe S. H. Nasr, *Ideale dhe Realitete të Islamit*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2008). Tek ky i fundit ka gjithashtu një bibliografi të përzgjedhur në gjuhë perëndimore kryesisht në lidhje me Islamin, Kur’anin, Profetin, Përshpirtshmërinë Islame etj; shih f. 176-198.

njeri që hedh në erë godina, kundërmon naftë e dollarë, apo vallëzon me fytyrë të mbuluar e me bark përjashta (belly dance). Tani, një përshkrim i tillë na tregon për myslimanët e Islamit po aq sa përshkrimi më lart na tregon për futbollistët e futbollin.

Islami, si çdo religjion autentik, ka si preokupim qendror ri-lidhjen (latinisht re-ligare) e njeriut me Zotin, me Origjinën e tij, me Realitetin Suprem, dhe çdo gjë tjetër është në funksion të kësaj ri-lidhjeje. Kjo e fundit fillon pikë së pari me doktrinën e cila lejon njohjen e këtij Realiteti ashtu siç është, duke bërë dallimin esencial të Absolutes nga relativja. Njohja vetëm është e pamjaftueshme, dhe shoqërohet nga metoda, e cila përfshin ritualin (namazi, agjërimi etj.) por nuk kufizohet aty. Metoda gjallohet vetëm dhe vetëm nga një vullnet i lirë për të zgjedhur mes Zotit dhe profanes. Pikërisht kjo konfirmohet nga parimi kuranor që thotë “Nuk ka detyrim në fe.”<sup>9</sup> Ndërsa një nga fanarët shpirtërorë të Islamit e të njerëzimit, Mevlana Xhelaledin Rumi shprehet kështu:

Zgjedhja (e lirë) është kripa e adhurimit; fundja këto kupa qiellore sillen pavullnetshmi.

Rrotullimi i tyre as shpërblim as ndëshkim nuk ka...

Gjithë bota e madhëron Zotin, po ai madhërim i detyruar

fajde hiç nuk ka.<sup>10</sup>

Doktrinës e metodës u bashkëngjitet kultivimi i virtyeteve. D.m.th., një besimtar a besimtare

9. Kur’ani, 2:256.

10. Cituar nga William C. Chittick, *Doktrina Sufiste e Rumiut*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2009), f. 70.

duhet të synojë të jetë i drejtë sepse kështu bëhet pjesëmarrës në natyrën Hyjnore (Zoti është *el-Adil*), duhet të synojë ta dojë të bukurën sepse Zoti është i tillë dhe e do të bukurën siç thotë profeti Muhamed në një hadith, duhet të flasë të vërtetën sepse e vërteta pasqyron një sifit Hyjnor (Zoti është *el-Hakk*). Padrejtësia, shëmtria (ligësia) apo gënjeshtria shihen si mërgim larg Hyjnore, sepse janë në kundërshtim me natyrën e Saj. Pra në këtë prizëm kultivimi i virtyteve nuk është çështje moralizmi, por një urë lidhëse me Zotin, me Originën tonë<sup>11</sup>. Kuptohet një komunitet që aspiron virtyte të tilla do të jetë një komunitet qytetarësh shembullorë. Por duhet ndërkohë të nënvizohet se të qenit qytetarë shembullorë nuk është qëllim i asnjë komuniteti të mirëfilltë besimtarësh, por është pasojë e natyrshme e aspiratës për t’u qasur Hyjnore.

Përfundimisht mund të thuhet se doktrina (islam), metoda (iman) dhe virtytet (ihsan) përfaqësojnë tre rrafshet e fesë ashtu siç i përkufizoi profeti Muhamed (a.s.) në atë që njihet si hadithi i Xhibrailit<sup>12</sup>.

Pyetja nëse Islami toleron larminë dhe nëse mund të bashkëjetojë me të tjera botëkuptime buron, me shumë gjasë, nga njëfarë amnezie kolektive apo selektive duke pasur parasysh shembujt e panumërt të kësaj bashkëjetese, disa

nga të cilët do t’i paraqesim më poshtë. Por më përpara, është me vend, në këtë kontekst, të citojmë filozofin dhe akademikun francez Éric Geoffroy i cili thotë: “Doktrina islame e pluralizmit buron nga një parim logjik: meqë, në Islam, vetëm Zoti është Një dhe i Vetëm, çdo gjë përveç Tij, d.m.th. krijimi i Tij, është i projektuar në larmi, shumëllojshmëri.”<sup>13</sup> Libri i shenjtë i Islamit, Kur’ani, tërheq vëmendjen se kjo larmi gjuhësh e ngjyrash është dëshmi e Zotit për ata që mendojnë<sup>14</sup>, se nëse Zoti do të dëshironte mund ta kishte bërë njerëzimin një komb<sup>15</sup>, por Ai i krijoi njerëzit në kombe e fise të ndryshme që të njohin<sup>16</sup> e të maten<sup>17</sup> me njëri tjetrin në vepra të mira. Kjo vetëdije ka qenë arsyeja që myslimanët tradicionalisht i kanë parë kulturat, kombet e fetë e ndryshme si manifestim i larmisë që buron nga Thesari Hyjnor.

Ndryshe nga përvoja e Krishterimit perëndimor, Islami u njoh dhe njohu që në fillim pothuajse të gjitha fetë e botës<sup>18</sup>; në Lindjen e Largët, në Kinën perëndimore e bregdetare (Guangzhou), u njoh me Budizmin e Konfucianizmin që në shekullin e VII-të, e në të njëjtën kohë edhe me Zoroastrianizmin në Persi, me Hinduizmin që në shekullin e XI-të, ndërsa Judaizmin e Krishterimin

13. Cituar nga eseja e Éric Geoffroy-t, *Pluralism or the Consciousness of Alterity in Islam* në përmbledhjen nga Patrick Laude, *Universal Dimensions of Islam Studies in Comparative Religion* (Bloomington, IN: World Wisdom Inc., 2011).

14. Kur’an, 30:22.

15. Kur’an, 11:118.

16. Kur’an, 49:13.

17. Kur’an, 5:48.

18. Me përjashtim të religjioneve të indianëve të Amerikës.

11. Mes të shumtave të këtij lloji, ka vend të veçantë vepra klasike e shekullit XV-të e përshtirësisë islame që trajton kultivimin e virtyteve si qasje ndaj natyrës profetike nga Imam Birgivi, *The Path of Muhammad*, trans. Shaykh Tosun Bayrak (Bloomington, IN: World Wisdom Inc., 2005).

12. Sahih Buhari 1:2:48.

i njohu që në fillim falë pranisë së këtyre feve në gadishullin arabik. Njohja dhe ruajtja e kësaj larmie, pra, ka qenë parimisht obligim për myslimanët, qofshin sundimtarë të pushtetshëm, qofshin njerëz të thjeshtë. Shembull? Në vitin 1463, më 28 maj, manastiri françeskan i Fojnicës në Bosnjë merr fermanin (originali akoma ruhet aty) e dërguar nga Fatih Sulltan Mehmeti II që deklaroi:

**“Unë, Fatih Sulltan Khan, deklaroj para botës se Françeskanët boshnjakë që u është dhënë ky ferman mbretëror janë nën mbrojtjen time. Dhe urdhëroj se:**

**Askush nuk do të trazojë a dëmtojë këta njerëz dhe kishat e tyre! Ata do të jetojnë në paqe në shtetin tim... Askush nuk do të ofendojë, cenojë a sulmojë jetën, pronën dhe faltoret e tyre...**

**Duke shpallur këtë ferman, betohem mbi shpatën time në emrin e shenjtë të Allahut që ka krijuar qiell e dhé, në Muhamedin, profetin e Allahut, dhe në shtatë profetët se; asnjë nga shtetasit e mi nuk do të veprojë në kundërshtim me këtë ferman!”<sup>19</sup>**

Pak a shumë në të njëjtën kohë (viti 1492) pas rënies së emiratit të fundit mysliman, atij të Granatës, në duart e Ferdinandit e Izabelës, brenda rreth 80 viteve Rekonkuista fshiu, sikur të mos kishte ekzistuar fare, prezencën 800 vjeçare të myslimanëve e hebrenjve në gadishullin Iberik. Kjo nuk ka të bëjë me atë se sundimtarët myslimanë ishin më të “mire” a “zemërdhembshur” se të tjerë sundimtarë të botës, apo se kishin

imunitet më shumë ndaj pushtetit, por se udhëzimet kuranore dhe profetike kanë qenë të qarta dhe të prera në këtë pikë. Pavarësisht abuzimeve, që janë pjesë e natyrës së njeriut të rënë, asnjë sundimtar mysliman nuk ka guxuar ligjërisht të vërë dorë mbi pronën, pasurinë e jetën e shtetasve të vet myslimanë, përkundrazi, kanë qenë të detyruar t’i mbrojnë ato. Nëse, siç pretendohet rëndom akoma në Shqipëri e Ballkan, Krishterimi mbijetoi kryesisht në sajë të një rezistence e burrërie për pesë shekuj, e ka menduar kush se si ka mundësi që kjo burrëri papritmas firoi kur një Enver Hoxhë, në krye të një shteti, që nuk ishte veç një fraksion vogëlith në krahësim me Perandorinë Osmane, si nga madhësia e nga pushteti, i vuri të gjithë para e për 23 vjet, **vetëm 23 vjet**, vrau e burgosi klerikët, rrënoi faltoret, madje edhe fshiu fjalën “Zot” nga çdo tekst kënge a poezie. Sikur Osmanët për shekuj me radhë të kishin bërë atë që bëri komunizmi, Ballkani jo vetëm do të ishte mysliman, por edhe me shumë gjasë do të fliste turqisht. Nga ana tjetër kjo do të ishte detyrim e dhunë në fe që është, siç edhe e treguam, katërcipërisht në kundërshtim me parimet islame, të cilat përbënin burimin e legjitimitetit të Perandorisë Osmane, Safavide, Mogule, Abaside, Fatimide, Omajade, etj., etj. Perandoritë e mbretëritë tradicionale myslimane nuk e kanë pasur “luksin” (falë Zotit!) e shteteve nacionaliste e komuniste që të mos njihnin, madje të mohonin krejt, çdo autoritet shpirtëror. Është e logjikshme që shtete të tilla mundën pa hezitim të eliminonin këdo që nuk i përshtatej kallëpit profan të ideologjive të

19. Përkthimi nga anglishtja i autorit.

tyre dhe fenë e luftuan (komunistët) ose e kthyen në shërbëtores (nacionalistët) duke i “dhuruar” njerëzimit gjenocidet, kampet e përqendrimit e të burgosurit e ndërgegjes.

Udhëzimi qendror kuranor i njohjes dhe respektimit të larmisë është në thelb arsyeja se Patriarkana Ortodokse ndodhet akoma në Stamboll, disa nga komunitetet më të vjetra arabe të krishtera jetojnë në Lindjen e Mesme, si nestorianët apo koptikët, apo se kemi akoma zoroastrianë<sup>20</sup> në Iranin e sotëm. Nuk po mundohemi këtu të japim një pikturë rozë e të themi se çdo mbretëri tradicionale myslimane ka qenë parajsë mbi tokë e nuk ka pasur abuzime. As nuk diskutohet. Por duhet të kuptohet se myslimanët nuk po u bënin nder feve të tjera duke i toleruar sa për faqe a mëshirë, ata thjesht po vepronin në linjë me mësimet e fesë së tyre, dhe abuzimet kanë qenë në përpjesëtim të zhdrejtë me zbatimin e këtyre mësimëve.

Për sa i përket veçorisë bazë të një komuniteti mysliman mendoj se është mjaft me vend vëzhgimi dhe përshkrimi nga diplomati dhe shkrimtari britanik Charles Gai Eaton që vijon si më poshtë:

“Shoqëria islame është teocentrike dhe jo teokratike. Sikur të ishte kjo e fundit do të ishte e nevojshme prania e një sundimtari gati-profetik, përfaqësues i Zotit në tokë dhe interpretues i Vullnetit të Tij; por në kontekstin e një shoqërie teocentrike sundimtari zë një vend periferik e jo qendror. Me gjithë nostalgjinë për kohën e Rashidunëve, katër kalifët e parë, myslimanët në tërësi

kanë marrë një qëndrim mjaft pragmatik ndaj funksionit të sundimtarit. Ai nuk pritet të jetë shenjtor, madje as domosdoshmërisht një njeri i mirë, siç kuptohet zakonisht, dhe veseve të tij private mund t’u mbyllet një sy përderisa mbahen private.

...Një nga problemet madhore të myslimanëve në shekullin e XX-të është se toleranca e tyre ndaj një sundimtari të pamëshirshëm, që mund të justifikohet për sa kohë që shteti kishte krahun e shkurtër dhe ndërhynte shumë pak me jetën e njerëzve, u bë burim rreziku sapo teoritë politike, falë teknologjisë moderne, e sollën shtetin brenda çdo rrugice e shtëpie.”<sup>21</sup>

Eaton gjithashtu shton se,

“...komuniteti islam ia detyron kohezionin e vet kryesisht besimit, jo shtetit, e as prijësve fetarë. Çdo mysliman është përgjegjës për veten e vet dhe të tjerët, ‘vëllezërit’ e ‘motrat’ e veta, t’i ngushëllojë në vështirësi e udhëzojë kur gabojnë (ama gjithmonë në një frymë butësie); të paktën në parim, çdo anëtar i komunitetit, sado i thjeshtë, e ka për detyrë – kur sheh gabim a padrejtësi – ta korrigjojë me dorën a me fjalën e vet, dhe nëse as këto nuk janë brenda mundësisë, ta korrigjojë në zemrën e vet.”<sup>22</sup>

Është e qartë nga përshkrimi i mësipërm se Islami është i pajtueshëm me çdo formë qeverisjeje, demokraci a sido që të quhet, për sa kohë që shteti nuk trazon qytetarët e vet duke futur hundët në çdo detaj të jetës shoqërore e personale për të diktuar me bistrinë

20. Origjina e Zoroastrianizmit nuk është krejt e qartë por ajo është, si fe, të paktën mbi 2500 vjeçare.

21. Charles Gai Eaton, *Islam and the Destiny of Man* (Albany, NY: State University of New York Press, 1985), p. 164 (përkthimi i autorit).

22. *Ibid.*, p. 172.

e ligjeve e rregulloreve se si duhet ta jetojnë atë. Myslimanët do të përkrahnin njëzëri poetin e filozofin amerikan Henry David Thoreau kur shprehet se: “Qeveria më e mirë është ajo që qeveris më pak.”<sup>23</sup>. Veçanërisht është shumë e rëndësishme për myslimanët që religjioni, pra ri-lidhja me Hyjnore, të mos cenohet apo manipulohet nga ndërhyrjet e shtetit. Rumi thotë se: “Shtëpia pa dritare është ferr. Qëllimi i fesë është të hapë një dritare.”<sup>24</sup>, e kjo do të thotë se ndërhyrja e shtetit, apo çdo lloj organizate në fe, për ta lakuar fenë sipas agjendës së vet, është ngushtim i kësaj dritareje providenciale (të cilën komunistët e mbyllën fare) dhe një hap më afër drejt një shtëpie apo hapësire infernale.

Ndërsa fundamentalizmi islamik, një dukuri që edhe falë kulturës së sensacionit mediatic duket sikur është mbizotëruese, jo vetëm që është një dukuri krejt e huaj, por është krejt ‘mish i huaj’, nëse mund të shprehemi kështu, për Islamin. Siç edhe e cekëm më lart, në ndryshim nga shembujt e perandorive e mbretërive myslimane në shekuj – që jo vetëm e njohën larminë por edhe e mbrojtën atë, qoftë në aspektin fetar, etnik apo kulturor – fundamentalistët, në mënyrë shumë të ngjashme me një mori projektesh politike moderne (– *izma* të formave të ndryshme), synojnë të diktojnë çdo detaj të jetës shoqërore e personale dhe të rrafshojnë çdo larmi, paçka se nën petkun e një religjioni të caktuar. Fundamentalizmi, qoftë islamik, çifut, kristian, budist etj., nuk është tjetër veçse një infiltrim agresiv i ideologjive

profane në sferën e religjioneve, madje këto të fundit janë viktimat e parë e tij. Ky infiltrim ka qenë i mundur në sajë edhe të një zbehjeje të të kuptuarit të traditës së mirëfilltë intelektuale e shpirtërore të religjioneve, shpesh duke i reduktuar ato në ritualizëm e moralizëm, që nuk mund të çonte kundërveç se në një dobësim, apo edhe me raste lëngatë, të religjioneve<sup>25</sup>.

Shoqëria shqiptare, mendoj unë, akoma vuan pasojat e imponimit të mentalitetit intolerant e monokrom komunist për dekada me radhë. Shembujt ka të panumërt, për fat të keq, por unë do të veçoja kohët e fundit thirrjen ndaj z. Fatos Lubonja, një figure të njohur publike, në faqen e parë (!) të një prej gazetave kryesore në vend, për tu vetëvarur në litar për shkak se ai shprehu mendimin e tij ndryshe; gabimi i parë ky i tij, dhe i dyti mund të jetë shumë mirë se shkrimi i tij kishte koherencë logjike. Hapësira mes thirrjes për vetëvarje apo dëbim dhe togës që të arreston e dënon në emër të popullit e partisë, apo edhe nën petkun e të tjera epiteteve – apo fjalëve plastike siç i quan profesor Pöerksen – si sekularizëm, laicizëm,

25. Është interesant se në një hadith, profeti Muhamed thotë se komuniteti (ummet) më i mirë është ai i brezit të tij, pastaj brezi më pas, e pastaj ata pas tyre (Sahih Muslim, 31:6150). Kjo do të thotë se për nga dija e devotshmëria besimtarët e sotëm, në tërësi, janë gradualisht inferiorë karshi brezave paraardhës. Në mënyrë paradoksale fundamentalistët deklarojnë se duan të kthehen në origjinën e fesë sepse brezat para tyre, që hadithi garanton se janë superiorë, e kanë korruptuar atë. Kjo s’është e papritur sepse edhe religjione të tjera – Hinduizmi, p.sh., flet për epokën e *kali jugës*, që i korrespondon *abr-i zamanit* në Islam – flasin për një “plakje” graduale të njerëzimit, që rezulton në errësim të dijës e flamurtarë të injorancës.

23. H. D. Thoreau, *Civil Disobedience* (1849).

24. Methnevi III, 2404.

progres, interes gjeopolitik etj, është shumë e vogël – dhe kjo është mjaft serioze!!! Kur ky mentalitet intolerant e histeri kolektive nuk kurseu as z. Lubonja, që jo vetëm njihet publikisht, por është edhe një njeri që e ka vuajtur mbi shpinë pasojat e një mentaliteti të ngjashëm, atëherë çfarë duhet të presin të tjerët?

A do të ishim vallë të gabuar nëse do të shtronim pyetjen jo nëse Islami pajtohet me demokracinë, por nëse demokracia, siç e kuptojnë shqiptarët

sot, e shteti që i përfaqëson, pajtohet me praninë e një komuniteti besimtarësh të sinqertë, qoftë myslimanë a të krishterë, të cilët prioritet qendror të jetës se tyre kanë Hyjnoren? A do ta lejojë ambienti shqiptar që ky komunitet ta mbajë hapur atë dritaren që na thotë Rumi, apo ka rrezik t'i kthehemi një epoke të re ferri (të nusëruar me fjalë të bukura)?

### Literatura

- Uwe Pöerksen, *Plastic Words: The Tyranny of a Modular Language* (University Park, PA: PSU Press, 1995).
- George Orwell, *Politics and the English Language* (1946).
- Alexis de Tocqueville, *Democracy in America* (Indianapolis, IN: Liberty Fund Inc, 2010), Vol. 2.
- S. Murata & W. C. Chittick, *Vizioni i Islamit*, shqip. Sokrat Ahmataj (Tiranë: Fondacioni Rumi, 2008).
- S. H. Nasr, *Ideale dhe Realitete të Islamit*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2008).
- William C. Chittick, *Doktrina Sufiste e Rumiut*, shqip. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2009).
- Imam Birgivi, *The Path of Muhammad*, trans. Shaykh Tosun Bayrak (Bloomington, IN: World Wisdom Inc., 2005).
- Sahih Buhari.
- Éric Geoffroy, *Pluralism or the Consciousness of Alterity in Islam* në përmbledhjen nga Patrick Laude, *Universal Dimensions of Islam Studies in Comparative Religion* (Bloomington, IN: World Wisdom Inc., 2011).
- Charles Gai Eaton, *Islam and the Destiny of Man* (Albany, NY: State University of New York Press, 1985).
- H. D. Thoreau, *Civil Disobedience* (1849).
- Methnevi III.

# Luftërat Ballkanike

## Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia në Vitet e Fundit të Perandorisë Osmane

Myzejen Myftari  
Tiranë

### Abstrakt

“The Balkan Wars, *British Consular Reports from Macedonia in the Final Years of the Ottoman Empire*” (Luftërat Ballkanike, Raporte Konsullore Britanike nga Maqedonia në Vitet e Fundit të Perandorisë Osmane) është libri më i ri që sjell në duart e lexuesve historiani dhe studiuesi shqiptar Bejtullah Destani në bashkëpunim të ngushtë me albanologun Robert Elsie.

Pjesërisht histori e pjesërisht diplomaci “The Balkan Wars, *British Consular Reports from Macedonia in the Final Years of the Ottoman Empire*” është libër mjaft interesant, i cili na fut në analet e historisë dhe të fakteve reale, njëqind vjet të shkuara. Libri, i promovuar në Tetovë me rastin e 101 vjetorit të Pavarësisë dhe 100 vjetorit të Luftërave Ballkanike, vjen në duart e lexuesit njëkohësisht në tri gjuhë; anglisht, shqip dhe maqedonisht. Ky fakt ndihmon në plotësimin e mangësive burimore në studimin e historisë në një vend multietnik siç është Maqedonia, duke ju ndihmuar kështu të gjitha kombësive që jetojnë aty. “The Balkan Wars” për nxjerrjen dhe selektimin e materialeve të të cilit, autorët kanë punuar për shumë vite, sjell mbi 50 raporte politike të diplomatëve

britanikë, dërguar Ministrisë së Jashtme Britanike, nga Manastiri dhe Shkupi në periudhën 1912-1914. Varianti origjinal i librit është në gjuhën Angleze. Ai ka rreth 300 faqe dhe është botuar nga shtëpia botuese prestigjioze, tashmë e njohur edhe për publikun shqiptar “I. B. Tauris & Co. Ltd London-New York”. Libri i përkthyer në gjuhët shqipe dhe maqedonase, është botuar nga shtëpia botuese LOGOS-A në Shkup.

Çfarë e bën më të rëndësishëm këtë libër është fakti se më shumë se një libër analize dhe mendimi personal, “The Balkan Wars” është një libër që përmban raporte sekrete diplomatike, për ngjarjet që kanë ndodhur gjatë viteve 1912-1914 dhe masakrat, ndaj popullsisë, kryesisht myslimane, por edhe ndaj popullsisë së krishterë maqedono-bullgare dhe asaj hebreje, duke u bërë kështu një

burim i padiskutueshëm të dhënash për historianët dhe studiuesit e asaj periudhe të historisë Ballkanike.

Jo pa qëllim editorët e librit i sjellin lexuesve dhe studiuesve dërgesa duke filluar nga viti 1912. Është pikërisht ky vit që shënon fillimin e Luftës së Parë Ballkanike. Shkaku ishte përzënia e Perandorisë Osmane nga shtetet e Ballkanit. Serbia, Bullgaria, Greqia dhe Mali i Zi bënë një aleancë ndërmjet tyre, duke bërë sulme të rrufeshme ndaj Perandorisë Osmane, tashmë në rënie dhe arritën ta përzënë atë nga trevat e tyre. Me largimin e Perandorisë Osmane u bë plani për ndarjen e Maqedonisë dhe Shqipërisë.

Lufta e Dytë Ballkanike filloi kur Serbia, Greqia dhe Rumania patën mosmarrëveshje me Bullgarinë për ndarjen e rajonit pas pushtimit të përbashkët të Maqedonisë. Më 1 Qershor 1913, Serbia dhe Greqia bënë aleancë kundër Bullgarisë gjë e cila, çoi në fillimin e luftës në fund të qershorit të vitit 1913, kur mbreti Ferdinand i Bullgarisë urdhëroi trupat e tij, të sulmonin forcat greko-serbe në Maqedoni. Sidoqoftë bullgarët humbën, dhe mes palëve luftuese u nënshkrua një traktat paqeje (Traktati i Bukureshtit) më 10 Gusht të vitit 1913. Nën kushtet e këtij traktati, Greqia dhe Serbia e ndanë pjesën më të madhe të Maqedonisë mes tyre, duke i lënë Bullgarisë vetëm një pjesë të vogël.

Të gjitha këto ngjarje u shoqëruan me masakra të përmasave të paimagjinueshme. Në emër të çlirimit të territoreve nga Perandoria Osmane u kryen masakra të tmerrshme mbi popullsinë vendase. Dërgesat e diplomatëve të huaj tregojnë qartë se, Luftërat Ballkanike ishin larg të qenit “Çlirimtare”.

“The Balkan Wars” sjell pikërisht skena nga këto masakra të bëra nga grekët, bullgarët dhe në mënyrë të konsiderueshme nga serbët, të cilët të etur për gjak dhe pasuri nuk mëshiruan as pleqtë, gratë dhe fëmijët, në ofensivat e tyre spastruese etnike dhe fetare, veçanërisht ndaj popullsisë myslimane. Popullsia civile e pambrojtur dhe e paarmatosur u gjend nën stuhinë e sulmeve të barbarëve të cilët, pa mëshirë, vranë, përdhunuan, masakruan dhe dogjën në mënyrat më çnjerëzore këdo që i dilte përpara.

Duke qene se i gjithë rajoni ishte përfshirë nga kaosi dhe anarkia që sillte mungesa e ligjit, jo vetëm të huajt por edhe vetë banorët e zonës, kryesisht ato katolikë u përfshinë në vrasje, plaçkitje, djegie dhe përvetësim të pasurisë së fqinjëve të tyre myslimanë.

Harri Lamb, Konsulli Përgjithshëm, në dërgesën me numër [FO 95/2438] Nr. 166, drejtuar Konsullatës së Përgjithshme të Madhërisë së tij Britanike në Selanik më datë 3 dhjetor 1912, ndër të tjera citon:

*... shfarosja e elementit mysliman në Maqedoni është sistematike dhe është pjesë e një politike të qëllimshme dhe të miratuar.*

Libri nuk përmban materiale që trajtojnë politikën apo ngjarjet ushtarake të Luftërave Ballkanike, por paraqet raporte që përqendrohen në ngjarjet reale, të perceptuara personalisht nga diplomatët e huaj, nga ajo që ata vetë kanë parë apo kanë dëgjuar prej dëshmitarëve okularë apo të mbijetuarve të masakrave të ushtruara mbi popullsinë e atyre trevave.

“The Balkan Wars” paraqet harta, fotografi dhe dërgesa të mbushura dhe statistika të shumta për humbjet në njerëz dhe të vlerave në natyrë, madje

shpesh të detajuara, duke përshkruar mënyrën e masakrimit dhe duke dhënë emrat e viktimave. Jo vetëm kaq por, siç citon Robert Elsie, njëri prej dy editorëve të librit, *të hartuara në pjesën më të madhe nga Çarls Grej, zv. Konsulli i Britanisë në Manastir, ndonëse disa prej dërgesave mund të tingëllojnë si të frohta dhe indiferente... Grej u orvat të vinte në dukje padrejtësitë që i bëheshin popullatës myslimane nga fitimtarët, forcat dhe grupet e popullatës së krishterë. Raportet e tij – vazhdon Elsie – si dhe ato të përfaqësuesve të tjerë diplomatikë britanikë, na vijnë mjaft në ndihmë për të kuptuar të vërtetat e zjarreve të luftërave ballkanike në prag të Luftës së Parë Botërore.*

Të bie në sy qëndrimi i paanshëm që kanë mbajtur hartuesit e këtyre dërgesave, kur i kanë shkruar ato. Jo vetëm kaq, por saktësia me të cilën diplomatët britanikë i përshkruajnë masakrat, e bën lexuesin të kthehet prapa në kohë dhe ta ndiejë se po i përjeton ato masakra barbare të bëra mbi njerëz krejtësisht të pafajshëm dhe të pambrojtur.

Ja disa shembuj të shkëputur nga disa prej dërgesave të paraqitura në libër:

Nr. 166.1

*Shtojcë e Dërgesës nr. 166 të Konsullit të Përgjithshëm Lamb, 3 dhjetor 1912*

*Memorandum*

*Për masakra të ndryshme dhe akte të tjera dhune që janë raportuar se janë kryer kundër popullatës myslimane nga forcat e rregullta dhe jo të rregullta ushtarake bullgare në pjesët lindore të vilajetit të Selanikut pas pushimit të tij nga trupat bullgare.*

*Një nga zonat nga është marrë informacion më i hollësishëm në lidhje me barbarizmat bullgare është ajo mu në veri të Selanikut, që përfaqëson kazatë e Avret-Hisarit dhe të Dojranit.*

*Thubet me siguri, për shembull, se në nahijen e Rajanovës nuk ka mbetur gjallë pothuaj as edhe një mysliman i vetëm. Vetë fshati Rajanovë përbëhet nga rreth 80 shtëpi turke. Shumë prej tyre, si dhe kazermat e xhandarmërisë, janë djegur, ndërsa të gjithë banorët meshkuj janë vrarë dhe kufomat e tyre janë hedhur nëpër puse. Nga e gjithë popullata e këtij fshati tani thubet se kanë mbetur gjallë vetëm 60 gra dhe fëmijë që gjenden në fshatin fqinjë, Dolni-Todorak. Në fshatin fqinjë të Planinicës rreth 30 myslimanë u masakruan në një shtëpi ngjitur me xhaminë. Në të dy këto raste, Popi i krishterë (prifti i fshatit) thubet se ka marrë pjesë aktive në këto akte, por rolin kryesor e ka luajtur një maqedono-bullgar i ri, rreth 27 apo 30 vjeç, që deri para pak kohësh thubet se studionte “belles lettres” në Paris. - Në Kërkat, ose Korkidovë, një fshat i madh rreth 10 kilometra në lindje të Avret-Hisarit, thubet se të gjithë meshkujt, së bashku me një numër të konsiderueshëm grash e vajzash, i kanë grumbulluar në xhami dhe në disa stalla aty afër. Në fillim mbi ta u hodhën tri bomba, por meqë ato nuk shpërthyen, ndërtesave iu vu zjarri dhe të gjithë sa ishin brenda u dogjën të gjallë. Thubet se të vetmit persona që kanë mbetur gjallë nga ky fshat janë nja gjashtëdhjetë vajza, nga të cilat dhjetë janë rreth 15 vjeçe, kurse pjesa tjetër janë fëmijë të vegjël 18 muajsh e lart, që janë mbledhur në Mutlovë, një fshat fqinjë i krishterë, banorët e të cilit kanë marrë për vete pjesën më të madhe të sendeve të vjedhura prej viktimave të tyre... Pak më në lindje të kësaj zone, fshatarë bullgarë nga Vurlani ose Virlandja sulmuan fqinjët e tyre myslimanë në mehallen Vakef dhe ua morën të gjitha bagëtitë e ua plaçkitën depot e drithit... Më në afërsi të Selanikut, një fshat mysliman me 50 shtëpi u plaçkit tërësisht nga ushtarët bullgarë të ndihmuar prej fshatarëve greko-bullgarë nga Kapuxhillari, Kireç-Koj dhe Hortiakua, që rrëmbyen të gjitha bagëtitë e fshatit, 230 kokë gjedhë, 5000 dhi dhe 3000 dele.*

Ndërsa raporti i datës 5 shkurt 1914 [FO 294/53] i dërguar nga Nën-Konsullata e Madhërisë së Tij Britanike në Manastir, ndërmjet të tjerave citon:

*...Autoritetet serbe nuk u kanë shpërndarë asnjë armë myslimanëve, në asnjë kohë dhe në asnjë pjesë të kësaj prefekturë. Kjo është më se e sigurt dhe më është konfirmuar plotësisht nga inspektori i përgjithshëm i prefekturës, të cilin pak ditë më parë arrita t'i nxjerr një deklaratë për këtë çështje, pa i treguar se cili ishte qëllimi im. Po të kishin qenë me të vërtetë të armatosur, myslimanët nuk do të kishin përfunduar të therur e të vrarë aq lehtë. Fakti që, me sa kemi dijeni, asnjë zyrtar i vetëm serb, asnjë vojvodë e asnjë komitaxhi serb, nuk është lënduar gjatë këtyre masakrave pa bujë, tregon shumë.*

*... Po bashkëngjis këtu tre shënime...*

**Shënimi 1:**... Banda që sulmoi fshatin Sop përbëhej nga të krishterë të armatosur nga fshatrat fqinje, me në krye një vojvodë serb nga Krusheva me emrin Gjorgje, si dhe nga zyrtarët e komunës së Cerskos, Belicës, dhe Cerit. Gjithashtu mori pjesë dhe luajti rol të rëndësishëm edhe një ish prift bullgar i Cerit me emrin Jovan. Ata filluan duke rrabur me kamxhikë tetë burra të fshatit, dhe pasi iu zhvatën atyre ato pak para që kishin si çmim për t'i përjashtuar nga ndëshkime të mëtejshme, i vendosën në një qerre, sepse ishin tejet të gjymtuar dhe nuk ecnin dot, dhe i dërguan në xhami, ku i lidhën dhe i kyçën brenda. Pastaj ata arrestuan të gjithë burrat e fshatit që ishin të pranishëm, rreth 50 në numër, të cilët gjithashtu i lidhën dhe i kyçën brenda në xhami. Pas kësaj, njëzet fëmijë i mbyllën në një dhomë të vogël në pjesën e sipërme të xhamisë. Pas kësaj ata filluan të shtinin me breshëri armësh përmes dritareve të ndërtesës, duke vrarë dhe plagosur shumë nga të burgosurit. Pastaj xhaminë e mbushën me lëndë djegëse nga të gjitha anët, kryesisht me dru, dhe i vunë zjarrin. Disa burra që u

përpoqën të shpëtonin duke dalë nga dera, i vranë ose i therën me bajoneta. Shumë u dogjën të gjallë, përfshirë edhe të gjithë fëmijët të cilët, ngaqë ishin në katin e sipërm, nuk i kishin kapur plumbat e breshërive të armëve që vranë dhe plagosën viktimat poshtë. Britmat e tyre vazhduan të dëgjoheshin për gjysmë ore.

*Ndërkohë që po ndodhte kjo, gjetkë nëpër fshat u vranë shtatë gra.*

*Mua më futën në xhami së bashku me burrat e tjerë, por më shpëtoi prifti Jovan, me të cilin kisha pasur marrëdhënie të mira.*

*Kur ikën të krishterët, unë thirra të mblihbeshin ata pak vetë që kishin mbetur gjallë në fshat, dhe kemi shkuar bashkë me ta drejt Kërçovës. Gjatë rrugës hasëm në një vojvodë tjetër serb me emrin Bogoja, nga Kurshina, me një bandë me 60 komitaxhinj. Ata na i morën edhe ato pak gjëra që kishim dhe ma vranë djalin, Adem Osmanin, 'për qejf', duke ia prerë kokën.*

(2) Dëshmia e Zelije Demisit ishte që në xhami humbën jetën këta anëtarë të familjes së saj.

Burri – Hasani.

Vëllai – Aliu.

Axha – Rifati, Ibrahim, Mefaili.

Axhat e burrit – Zeqiri, Sejfedini, Hebiu, Xhabiri, Rashidi.

Tezja e burrit – Fatime.

Kushërinjtë e burrit – Mehmeti (18 vjeç), Halimi (19 vjeç), Ismaili (15 vjeç), Vebibi (10 vjeç), dhe Hazmiu (10 vjeç).

(3) Dëshmia e Esmë Damirit, e cila ka shenjat e një plage plumbi që i ka përshkruar krabrorin, shkaktuar gjatë kësaj masakre, ishte se djali i saj Xhelili, 12 vjeç, humbi jetën në xhami.

(4) Dëshmia e Bedrije Hasanit ishte se djali i saj Ademi humbi jetën në xhami.

(5) Dëshmia e Shefike Hasanit ishte se në xhami humbën jetën anëtarët e mëposhtëm të familjes së saj. –

Burri – Hasani.

*Djali – Xbelili (10 vjeç).*

*Vëllezërit – Emini dhe Halidi.*

*Djali i vëllait të burrit – Rexhebi.*

*Djali i këtij të fundit – Mustafai (17 vjeç).*

*Një anëtare e familjes së saj me ermin Hatixhe u vra brenda në shtëpinë e saj.*

*(5) Dëshmia e Shabsime Zehmanit ishte se djali i saj, Zyhdin (16 vjeç), humbi jetën në xhami.*

*(6) Dëshmia e Ismet Rashidit ishte se anëtarët e mëposhtëm të familjes së saj humbën jetën në xhami.*

*Burri – Rashidi.*

*Djali– Hazmiu (8 vjeç), të cilin e futi në xhami vetë prift Jovani.*

*Vëllezërit e burrit – Zeqiri dhe Nebiu.*

*Nipat e burrit – Mehmeti (17 vjeç) dhe Vehibi (13 vjeç), të cilin e futi në xhami sekretari i komunës së Belicës, një serb.*

*Nëna e burrit, Aishja, dhe gruaja e vëllait të saj, Fatimja, u vranë brenda në shtëpitë e tyre.*

*Këto dëshmi të dbëna më lart përmbajnë vetëm një pjesë shumë të vogël të personave të vrarë, por ato kanë rëndësi kryesisht sepse tregojnë që masakra është kryer nga banorët e krishterë të zonës dhe nga komitaxhinjtë e udhëhequr nga zyrtarët dhe vojvodët serbë; që këjo masakër u krye në një mënyrë tejet barbare; dhe se gratë e fëmijët ishin ndër viktimat e zgjedhura enkas.*

**Shënimi 2: Masakra në Pllashnicë (Kërçovë)**

*Rreth dy javë pas ngjarjeve të Sopit, që ndodhën nga 17 deri 20 shtator, fshati mysliman i Pllashnicës në të njëjtën zonë u vizitua nga një bandë prej 40 fshatarësh të armatosur të krishterë, nën udhëheqjen e një vojvode serb të quajtur Arso, nga fshati Llokvicë, (komuna e Brodit). Ata arrestuan nja pesëdhjetë burra e djem të fshatit dhe u thanë se kishin urdhër nga nën-prefekti i*

*Brodit për t'i çuar atje. Për një farë kobë nuk u mor vesh asgjë për ta, por më vonë, rreth dy muaj pas zhdukjes së tyre, shokët e tyre i gjetën trupat e bërë shoshë nga plagë të shkaktuara me bajonetat e tyre në një bregore të vogël afër një vendi të quajtur Ledovë, midis Pllashnicës dhe Brodit.*

*Emrat e viktimave janë si vijon. –*

*Abmed Ismaili me dy djemtë e tij, Ali Hasani me djalë, Rahman Mustafa me djalin (13 vjeç), Baktiar Ymeri (80 vjeç), Dalip Mahmudi, Zejnel Dajri, Hamid Hasani, Jusufi, Said Ahmet, Rexheb Hajrullahu, Abedin Rahmani, Mexhid Tabiri, Rasim Mobarremi, Abdullah Jusufi (19 vjeç), Ferad Hajredini (62 vjeç), Maliq Feradi, Abdullah Osmani (90 vjeç), Iljaz Abdullahi, Rakib Miftahu, Ali Hasani me dy djemtë e tij, Rushid Mustafa me djalin e tij Qamilin (15 vjeç), Fetah Ymeri me djalin e tij Rakibin (14 vjeç), Bajram Seferi, Mifail Ristemi, Zejnel Taifi, Salihu, Mustafa Ramadani me djalin Nuredinin, Belul Hajrullahu, Mehmed Rahmani, Hasan Rahmani, Esad Ramadani, Rasim, Zulfiqar Nasufi, Abaz Beqiri, Miftahu (72 vjeç), Bejeb Iljazji (60 vjeç), Abaz Sadiku, Salih Dalipi, Mehmet Ahmed, Xhafer Halimi, Shefki Danti (18 vjeç).*

*Pas kësaj, edhe shumë myslimanë të tjerë nga e njëjta komunë u thirrën në Brod dhe u zhdukën në mënyrë të mistershme.*

*Shënimi i mësipërm ka interes më tepër sepse tregon për kasaphanën pa kriter që u bë kundër myslimanëve pas trazirave në kufirin shqiptar, në një kohë kur, sipas autoriteteve serbe, në Maqedoninë serbe nuk ka pasur rebelim dhe nuk ekzistonte asnjë fije mundësie që myslimanët e Maqedonisë të bashkëpunonin me shqiptarët. Ai tregon se masakrat u kryen nga fshatarë të armatosur të udhëhequr nga vojvodë serbë, dhe se ndër viktimat ishin edhe pleq të moshuar e të pafuqishëm dhe fëmijë.*

**Shënimi 3** *Hetimi serb për masakrat e kryera nga vojvodët dhe bandat serbe*

*Nga fundi i dhjetorit, qeveria serbe duket se e kuptoi që teprimet e vojvodëve dhe të bandave të tyre, të cilat deri në atë kohë ishin nxitur në heshtje, nuk mund të fshiheshin më dhe po u shkaktonte kritika të dëmshme nga të gjitha anët, ndaj edhe nisi një farë hetimi për keqbërjet e tyre. Ky hetim, sipas një pobimi që më bëri zoti Alimpiq, inspektori i prefekturës, çoi në heqjen nga puna të nën-prefektit të Kërçovës, pushimin nga punësimi zyrtar i nën-prefektit të Krushevës dhe dëbimin nga Maqedonia serbe të vojvodëve të përfshirë në to. Heqja e nën-prefektëve është konfirmuar nga informacione të marra nga burime të tjera, dhe disa nga vojvodët thuhet se nuk shihen më në ato vende që i frekuentonin zakonisht më parë.*

*Nga dëshmitarët okularë myslimanë kam mësuar se gjatë kryerjes së hetimeve të bëra nga një oficer ushtarak, u zhvarrosën kufomat e 26 myslimanëve, të cilët i kishte marrë një bandë serbe nga Llezhani në komunën e Prilepit dhe i kishte vrarë me bajoneta afër Turkos. Aty u zbulua se atyre ua kishin prerë kokat pas vdekjes, sigurisht për të penguar identifikimin në rast se do të bëheshin hetime. Të gjitha kufomat ishin të lidhura.*

*Nuk kam ndonjë informacion që të jenë ekzaminuar kufomat e shumta që janë varrosur ose hedhur nëpër bunarë në fshatrat e tjera.*

*Por barbaritë serbe nuk mënuan të binin edhe mbi maqedono-bullgarët. Qëllimi ishte që t'i imponohej kësaj popullsie të njihnte kryepeshkopatën e Beogradit dhe të braktisin kishat e tyre të vjetra.*

*Një dërgesë e datës 9 shtator 1913 ndër të tjera citon:*

*... Iliino (Në jug-perëndim të Demir Hisarit)*

*Ky fshat u vizitua nga banda e Bogojas më 15 gusht. Dymbëdhjetë vajza u përdhunuan. Personat e mëposhtëm u lënduan: Jovan Gjorgjen, (u rrah potbuaj për vdekje), një grua me emrin Mitrisca (u rrah dhe plagos me bajonetë), Jovan Iliev (u rrah potbuaj për vdekje). Përveç kësaj, 30 burra u morën dhe u çuan në Krushevë, dhe që prej asaj kohe nuk dihet asgjë më për ta. Banda, kur u largua, i paralajmëroi fshatarët se do t'ua shkatërronte shtëpitë nëse do të ankoheshin tek autoritetet për çka kishte ndodhur.*

*Mramorec (Në jug-perëndim të Kërçovës)*

*Rreth datës 12 gusht, gratë e mëposhtme janë dhunuar nga një bandë serbe e komanduar nga një me emrin Mirkoviq. Cveta Cvetanova, Krista Spasova (u dhunua nga shtatë ushtarë ose komitaxhi në praninë e të shoqit, të cilin e kishin lidhur), Grosda Petrova, Parashqeva Trenkova, Veljana Gavriloza, Hristica Gavriloza (që u lëndua rëndë).*

*Belica (në jug-perëndim të Kërçovës)*

*Një prijft me emrin Boris dhe një fshatar me emrin Jovançe u rrahën për vdekje nga komitaxhinjtë serbë. Gratë u përdhunuan.*

*... Gorno Divjak (në perëndim të Krushevës)*

*Gjergj Shaqiri u rrah dhe u lëndua rëndë sepse i biri kishte dezertuar nga xhandarmëria serbe.*

*Sloeshtica (Në jug-perëndim të Pribilcitet)*

*Isb vojvodët bullgarë, Bale dhe Daniel u vranë nga një bandë serbe. Siljan Ivanov u plagos në kokë, duar dhe këmbë me bajonetë. Shtatë fshatarë u rrahën egërsisht.*

*Zhvan (në perëndim të Pribilcitet)*

*Kryeplaku e fshatit e torturuan dhe e tërhoqën zvarrë në rrugë me një litar të lidhur rreth qafës.*

*Breshani (Jug-perëndim të Demir Hisarit)*

*Burra dhe gra të rrahur. Gra të përdhunuar... .*

# Pozita kushtetuese e Kosovës në Federatën Jugosllave gjatë viteve 1946-1974

(vështrim historik)

**M.A. Ramadan Shkodra**  
**Bashkësia Islame e Kosovës**

## Hyrje

*Pas Luftës së Dytë Botërore, rrjedha objektive e ngjarjeve që çonte drejt zgjidhjes së drejtë të çështjes së Kosovës, u ndërpre. Popullsia shqiptare e Kosovës u përball me presionet, me mashtrimet dhe me dhunën e udhëheqësve komunistë jugosllavë, sidomos të atyre serbë. Deklaratat e tyre premtuese për vetëvendosjen e popullit shqiptar pas luftës u harruan. Derisa brigadat partizane shqiptaro-kosovare marshonin drejt veriut dhe luftonin përkrab popujve jugosllavë për çlirimin e plotë të Jugosllavisë, mbi popullsinë shqiptare në Jugosllavi u ushtrua një shtypje e egër kombëtare, pati arrestime, terror e persekutime të shqiptarëve, u ndalua përdorimi i flamurit kombëtar, nëpunësit shqiptarë u pushuan nga puna dhe u zëvendësuan me ata serbë. Kufomat e shqiptarëve të torturuar i gjeje kudo nëpër rrugët e qyteteve dhe fshatrave të Kosovës. U mobilizuan me forcë në ushtrinë jugosllave djem shqiptarë, të cilët derisa arrinin në destinacion, ecnin në kolonë për katër, të çarmatosur dhe rubeshin anash nga rojat serbe e malazeze, sikur të ishin të burgosur. Gjatë rrugës u pushkatuan mijëra shqiptarë, që përpigeshin të arratiseshin për t'u shpëtuar provokimeve e mundimeve nga serbët. Vetëm në Tivar brenda një nate dhe një dite u masakruan afro 1600 shqiptarë të mobilizuar. Këto veprime ngjallën reagimin e natyrshëm të popullsisë shqiptare për t'u vetëmbrojtur. Që t'u shpëtonin ndjekjeve e persekutimeve, shumë fshatarë braktisën fshatrat e tyre dhe dolën në male. Nga malet ata filluan të sulmonin repartet e ushtrisë jugosllave të vendosura në qytete. Shpërthyen revolta masive në Ferizaj (fillim i dhjetorit 1944), në Gjiilan (dhjetor 1944), në Drenicë (dhjetor 1944, janar, shkurt 1945), në Mitrovicë (janar 1945). Numri i të revoltuarve arriti në rreth 30.000 veta.*

**P**as shtypjes së revoltave masive popullore, qëndresa kundër pushtetit jugosllav vazhdoi në rrugë ilegale. U krijuan disa organizata të fshehta. Më të rëndësishmet ishin: Organizata Nacional-Demokratike Shqiptare (ONDSH) dhe Besa Kombëtare.

ONDSH ishte një organizatë politike që u angazhua për evidentimin e shqiptarëve të zhdukur, për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë.

Goditjet që u ndërморën mbi popullsinë shqiptare menjëherë pas luftës e gjatë Administratës Ushtarake ishin në përputhje me elaboratin e Vasa Çubrilloviqit “Problemi i pakicave në Jugosllavinë e re”, dërguar qeverisë së re jugosllave ende pa mbaruar lufta, më 3 nëntor të vitit 1944.

Kështu shqiptarët në Jugosllavi, jo vetëm mbetën në statusin e paraluftës, të shkëputur nga shteti amë, por as nuk u bashkuan në një njësi të vetme federative. Ata u copëtuan administrativisht, midis tri republikave jugosllave, Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Qëllimi i kësaj ndarjeje, ishte çintegrimi dhe shkombëtarizimi i shqiptarëve.

### **I. Statusi kushtetues-juridik i Kosovës (1945-1948)**

Pas shtypjes së revoltave masive popullore, me masa të dhunshme, Serbia më 18 shkurt të vitit 1945, në një mbledhje të udhëheqjes më të lartë të Komitetit Qendror të PKJ në Beograd, nën diktatin e përfaqësuesve serbë mbi ata malazez e maqedonas, u vendos

që Kosova t'i bashkëngjitej Serbisë. Për t'i dhënë ngjyrimë juridike, madje dhe parimore këtij vendimi të marrë nga lart, pas dy muajsh, më 7-9 prill të vitit 1945, u organizua Mbledhja e Jashtëzakonshme e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Serbisë dhe më 8-10 korrik 1945, në Prizren, u mbledh një i ashtuquajtur Kuvend i Këshillit Popullor të Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, i cili në historiografi njihet si “Kuvendi i Prizrenit”<sup>1</sup>.

Në të dy këto forume u bënë përpjekje që aneksimi i Kosovës nga Serbia të paraqitej si shprehje e vullnetit të vetë popullit të Kosovës. Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Serbisë (7-9 prill 1945) u gjet një pjesëmarrës malazez nga Kosova, për të shprehur “dëshirën e KANÇ të Kosovës, që edhe popujt e Kosovës t'i aneksoheshin Serbisë federale motër”. Megjithëse ky pjesëmarrës vuri në dukje në fund të fjalimit të tij se “ne nuk e kemi marrë akoma këtë vendim në Kuvendin tonë, për shkak se në Kosovë ekziston pushteti ushtarak”, Kuvendi i Serbisë e konvertoi dëshirën në vendim dhe e pranoi aneksimin e Kosovës në Serbi.

Pas tre muajsh, më 8-10 korrik 1945, në “Kuvendin” e mbledhur në Prizren, ku nga 137 pjesëmarrës vetëm 32 ishin shqiptarë, të cilëturvejoheshin nga njerëz të armatosur të UDB-së, u miratua me duartrokitje, pa votime e nënshkrime, një rezolutë e ardhur e gatshme nga Beogradi. Në Rezolutë shprehej dëshira e popullit të Kosovës për t'iu bashkëngjitur Serbisë federale si pjesë përbërëse e saj. Përfundimisht, më

1. Historia e popullit shqiptar - IV, Tiranë 2008, fq. 341.

3 shtator 1945, ligji i Kryesisë së Kuvendit Popullor të Serbisë “Mbi caktimin dhe ndërtimin e Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë” sanksiononte juridikisht Kosovën si njësi autonome. Ky sanksionim përsëritej edhe në Kushtetutën Jugosllave të janarit 1946<sup>2</sup>.

“Kuvendi” i Prizrenit u mbajt dy ditë pas heqjes së Administratës Ushtarake. Njerëzit, të tmerruar pas 5 muajsh masakre e dhune shtetërore të Administratës Ushtarake, nuk guxonin të thoshin hapur atë që mendonin për të ardhmen e tyre politike. Në “Kuvendin” e Prizrenit, as nuk u krijuan kushtet dhe as nuk u realizua e drejta e vetëvendosjes nga shqiptarët.

### **Kosova rajon autonom në Kushtetutën jugosllave të vitit 1946**

Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë e janarit 1946 përcaktonte tërësinë e federatës me të gjitha subjektet përbërëse, duke përmendur krahas Republikës së Serbisë, të Maqedonisë, të Bosnjë e Hercegovinës, të Kroacisë, të Sllovenisë e të Malit të Zi, Krahinës Autonome të Vojvodinës edhe Rajonin Autonom të Kosovë-Metohisë. Por, në të njëjtën kohë, Rajoni Autonom i Kosovë-Metohisë, së bashku me Krahinën Autonome të Vojvodinës, përfshihej edhe në kuadër të Republikës Popullore të Serbisë<sup>3</sup>.

Kushtetuta e RFP të Jugosllavisë e vitit 1946 sanksiononte lidhjen dhe varësinë e dyfishtë të Rajonit Autonom të Kosovë-Metohisë si nga Federata Jugosllave, ashtu edhe nga

Republika e Serbisë. Ajo garantonte ekzistencën e RAKM dhe përcaktonte parimet themelore të organizimit e të funksionimit autonom të tij. Si i tillë, RAKM, pavarësisht se ndodhej në përbërje të RP të Serbisë, së pari, ishte kategori kushtetuese e RFP të Jugosllavisë.

Sipas Kushtetutës së RFP të Jugosllavisë të vitit 1946, organi më i lartë i pushtetit popullor në RAKM ishte Këshilli Popullor i RAKM, të cilin e zgjidhnin qytetarët, jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, me mandat trevjeçar. Organi ekzekutiv politik dhe i administratës ishte Këshilli Ekzekutiv i RAKM, qeveria, të cilin e zgjidhte këshilli popullor krahinor. Për punën e tij, Këshilli Ekzekutiv i RAKM përgjigjej para Këshillit Popullor të RAKM.

Kushtetuta e RFP të Jugosllavisë e vitit 1946 nuk i njihte RAKM autonominë financiare dhe gjyqësore. Gjykata popullore e RAKM, si gjykatë e shkallës së dytë, e formuar më 10 korrik të vitit 1945, ishte suprimuar në dhjetor të po atij viti. RAKM përfaqësohej drejtpërdrejt në Këshillin e Kombeve të Kuvendit Popullor të RFP të Jugosllavisë, nëpërmjet delegacionit të vet, të përbërë prej 15 deputetësh. Në të gjitha forumet e tjera politike-shoqërore dhe organet administrative-ekzekutive të federatës, përfaqësuesit e RAKM mungonin. RAKM nuk mund të nxirrte ligjet e veta, por vetëm vendime<sup>4</sup>.

### **II. Statusi kushtetues-juridik i Kosovës (1953-1963)**

Pas shpalljes së Rezolutës së

---

2. Po aty.

3. Kosova në vështrim enciklopedik, Tiranë 1999, fq. 120.

4. M. Verli, Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspirate, vëllim II, Tiranë 2007, fq. 304.

Informbyrosë, më 28 qershor 1948, në Jugosllavi u krijua një situatë e ndërlikuar. Qeveria jugosllave çdo qëndrim miratues ndaj Rezolutës së Byrosë Informative e konsideronte si “vepër penale të tradhtisë ndaj shtetit dhe popullit”.

Në janar të vitit 1953, Kuvendi Popullor i RFP të Jugosllavisë miratoi “Ligjin Kushtetues mbi bazat e rendit shoqëror e politik në RFP të Jugosllavisë dhe të organeve federative të pushtetit”, me të cilin ndryshoheshin një varg nenesesh të Kushtetutës federative të vitit 1946<sup>5</sup>.

Ligji Kushtetues i RFP të Jugosllavisë i vitit 1953 sanksiononte procesin e decentralizimit që kishte filluar në RFP të Jugosllavisë dhe në bazë të të cilit një pjesë të të drejtave të federatës kalonin në republikat federale, duke zgjeruar kompetencat e tyre. Konkretisht për RAKM, lidhjet e tij me Federatën Jugosllave u dobësuan, ndërsa kontrolli i RP të Serbisë mbi të u rrit.

U likuidua Dhoma e Këshillit të Kombeve, si dhomë e pavarur në Kuvendit Popullor të RFPJ dhe ia bashkëngjiti atë Këshillit Federativ të Kuvendit Popullor të RFPJ. Ndërkohë u krijua si dhomë e re e veçantë Këshilli i Prodhuesve, që së bashku me Këshillin Federativ, përbënin Kuvendin Popullor të RFPJ<sup>6</sup>.

Ligji Kushtetues i Republikës Popullore të Serbisë, i miratuar më 17 janar të vitit 1953, ruante akoma raportet hierarkike të nënshtrimit të organit

përfaqësues ekzekutiv të RAKM jo vetëm ndaj organeve përfaqësuese, por edhe ndaj atyre ekzekutive republikane.

Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1963, e forcoi më tej tendencën e shndërrimit të RAKM në subjekt ekskluziv të Republikës së Serbisë.

Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, e vitit 1963, dëshmonte më hapur për minimizimin e pozitës autonome të Kosovës. Qysh në fillim vëmë re se ajo nuk e përmendte Krahinën si pjesë të veçantë administrative politike të Serbisë, por në një radhë me 17 distriktet e tjera administrative të RSS.

### **III. Amendamentet kushtetuese të viteve 1971-1972, bazë e ndryshimit të statutit juridik të Kosovës**

Në korrik të vitit 1966 në Brione u mbajt Mbledhja e IV e KQ të LKJ, që njihet me emrin Plenumi i Brioneve, i cili shënoi një etapë të re në zhvillimin e Jugosllavisë. Në këtë Plenum u mënjanua rryma unitariste e ultrashoviniste e udhëhequr nga serbët, ku triumfoi rryma më demokratike në krye me Titon e përkrahësit e tij. Vendimet e Plenumit të Brioneve patën një rëndësi të veçantë edhe për Kosovën dhe viset e tjera shqiptare jo vetëm sepse u zvogëluan në një farë mase dhuna dhe terrori mbi shqiptarët, por edhe për arsye se për herë të parë do t'u kushtohej kujdes më i madh Kosovës e shqiptarëve dhe zgjidhjes së problemeve të tyre të shumta.

Për herë të parë shqiptarët mund të organizonin jetën e tyre, të paktën në një pjesë të rëndësishme të viseve të tyre etnike, që tani drejtoheshin nga një qendër politike, administrative, nga Prishtina.

---

5. Dr. Hysni Bytyqi, Kosova dhe shqiptarët, Prishtinë, 2006, fq. 68.

6. Po aty.

Më 1976 u formuan komisionet për ndryshimin e plotësimin e akteve më të larta politike-juridike në Federatë, në republika dhe në krahina autonome<sup>7</sup>.

Diskutimet kushtetuese që u organizuan kudo në Kosovë, i udhëhiqte një Komisioni i Posaçëm në krye të të cilit ishte Fadil Hoxha, kryetar i Kuvendit të Kosovës. Në shumë tubime të aktivëve politikë si në Gjakovë, në Prishtinë, në Gjilan, në Pejë, në Mitrovicë etj....u kërkua që me Kushtetutën dhe ligjet e RSFJ kombësia shqiptare të emërtohej kombi shqiptar, të lejohej përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar dhe Kosova të shpallej Republikë. Në këtë mënyrë kërkohet që popullit shqiptar t'i njihej e drejta e vetëvendosjes.

Përveç diskutimeve kushtetuese, manifestimet me rastin e 500-vjetorit të Skënderbeut, lëvizjet studentore në Evropë (1968), etj... qenë faktorë shtytës në luftën për çlirim e bashkim kombëtar. Pozita e re që fitoi Kosova në sistemin federativ kushtetues të Jugosllavisë, e në të njëjtën kohë dhe në atë të RS të Serbisë, me amendamentet kushtetuese të viteve 1967-1969, ngjalli pakënaqësi të forcat hegemoniste serbe. Hapat konkretë që u morën për më shumë barazi kulturore, ekonomike e politike të shqiptarëve me popujt e tjerë në Kosovë e në Jugosllavi, i shihnin si padrejtësi ndaj popullit serbo-malazez, si qëndrime që “respektonin vetëm interesat e popullit shqiptar.”

Ndërkohë, duke u shprehur kundër të drejtës së ligjshme të popullsisë shqiptare për të qenë të barabartë në Federatën jugosllave, këto forca manifestuan hapur ambiciet e tyre

7. Po aty, fq. 92.

nacionaliste ekstremiste, ku dolën me teza të vjetra si: “Pozita kushtetuese e KSA të Kosovës është çështje e RS të Serbisë” dhe se “sovrانيتeti dhe shtetësia e krahinës pasqyrohet dhe realizohet nëpërmjet sovranitetit dhe shtetësisë së republikës”, u shprehën hapur në forumet e larta politike të Serbisë, si në Kryesinë e LS të Serbisë (1971) etj.<sup>8</sup>

Tezat e lartpërmendura dëshmuuan se udhëheqësit serbë, megjithëse kishin miratuar vendosjen e marrëdhënieve të reja në federatë nuk niseshin nga të njëjtat parime kur shtrohej çështja e ndryshimit të statusit politik kushtetues të Kosovës. Kundër këtyre deklaratave e qëndrimeve të tyre u shprehën me guxim forcat përparimtare të krahinës.<sup>9</sup>

Ky konfrontim forcash vazhdoi edhe më i tensionuar gjatë diskutimit të amendamenteve të reja të Kushtetutës federative, të Kushtetutës republikane dhe të Ligjit Kushtetues të KSA të Kosovës, i cili do të rishikohej sërish. Pati në këto momente funksionare politikë kosovarë që e kuptuan rëndësinë e çastit historik, perspektivën e procesit të decentralizimit të Federatës jugosllave, dhe kërkesën mbarëpopullore në Kosovë, në forumet e ndryshme kërkuan thellimin e mëtejshëm të ndryshimeve kushtetuese.<sup>10</sup>

Jo, pak intelektualë shqiptarë, me argumente hodhën dritë mbi faktorët që çuan në lindjen e Kosovës, si njësi e veçantë territoriale politike, duke veçuar,

8. Ana Lalaj, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Tiranë, 2000, f. 205.

9. Po aty.

10. Syrja Pupovci, Nuk është shkencë ajo që predikon pabarazi, Përparimi, Prishtinë, 10 prill 1971, fq. 205.

së pari faktorin kombëtar. Ata theksonin dhe dëshmonin se shqiptarët e Kosovës në të gjitha dokumentet e partisë dhe të pushtetit gjatë LANÇ quheshin komb ose popull e jo kombësi. Me argumente historike shkencore u kundërshtuan dhe pikëpamjet antishqiptare të shfaqura në simpoziumin e Novi Sadit nga dr. Radomir Lukić dhe dr. Jovan Gjorgjević, të cilët mohonin qenien e Kosovës si element kushtetues i Federatës jugosllave.<sup>11</sup>

Me të drejtë, prej politikaneve kosovarë, konstatohej se pas ndërrimeve kushtetuese të vitit 1968-69, nevoja për pozitë më të avancuar të krahinave ishte bërë domosdoshmëri e zhvillimit historik dhe se, në këtë kuadër, përvoja po diktonte nevojën për një rol të ri e vendimtar të KSA të Kosovës në RSF të Jugosllavisë. Gjatë diskutimit të amendamenteve të fundit të Kushtetutës së RSFJ, nga Kosova pati mjaft kërkesa që të përcaktohej qartë funksioni legjislativ i krahinave autonome. Për këtë qëllim përfaqësuesit nga Kosova si: E. Stavileci, S. Kurteshi, H. Hoxha, në publikimet e tyre shtronin nevojën për autorizime më të gjëra, të drejta burimore për mbrojtjen popullore, të sigurimit shtetëror, të planifikimit shoqëror, të politikës së jashtme, duke u formuluar juridikisht të drejtat, kompetencat dhe funksionet e federatës ashtu edhe ato të republikave e të krahinave.<sup>12</sup>

Në fushën e planifikimit shoqëror, të mbrojtjes popullore e të sigurimit të shtetit, Krahinës Socialiste Autonome

të Kosovës edhe më parë, me amendamentet kushtetuese të vitit 1968-69, i njiheshin disa të drejta burimore. Por, fakti që RS Serbisë e kishte unifikuar pjesën dërrmuese të këtyre të drejtave, kishte sjellë për rrjedhojë pasivitetin e minimizimin e rolit të krahinave në fushat e lartpërmendura.<sup>13</sup>

Edhe në fushën e politikës së jashtme, KSA e Kosovës nuk kishte të drejta burimore. Andaj, përfaqësuesit kosovarë theksonin se Kosova si bashkësi kufitare ishte posaçërisht e interesuar të ushtronte funksione kontrolluese në qarkullimin e njerëzve dhe të gjërave të tjera të rëndësishme të shtetit. Gjithashtu në kërkesat e kosovarëve dhe në diskutimet publike, kërkohej që kontrolli në fushat e arsimit, të mbrojtjes shëndetësore dhe asaj sociale, të kulturës dhe të shkencës, të kalonte krejtësisht në organet e Kosovës.<sup>14</sup>

Nisur nga fakti se parimi i barazisë së kombeve dhe kombësive, respektivisht i republikave dhe i krahinave, u ngrit në nivel kushtetues federativ, kosovarët shtronin nevojën e pasqyrimin konsekuent e të plotë të këtij parimi si në amendamentet e reja të Kushtetutës së RS të Serbisë, ashtu edhe në ligjin kushtetues të KSA të Kosovës të vitit 1969, që ende nuk e shprehte në mënyrë adekuate pozitën e re kushtetuese të krahinës dhe autonomitetin e saj.

Në amendamentet e reja të vitit 1971-1972, marrëdhëniet krahinë-federatë rregulloheshin drejtpërdrejt me kushtetutën federative jugosllave.

---

11. Po aty, fq. 207.

12. E. Stavileci, *Autonomia dhe federalizmi. "Përparimi"*, Prishtinë 1971, nr. 1, f. 1.

---

13. H. Hoxha, *Barazia e pakicave kombëtare*, Prishtinë. 1984. f. 132.

14. Po aty, f. 2.

Por, duke qenë se KSA e Kosovës ishte edhe në kuadër të RS të Serbisë, kjo u shfrytëzua nga politikanët e juristët serbë për të ruajtur sa qe e mundur pushtetin e Serbisë në Kosovë.<sup>15</sup>

Por kishte edhe marrëdhënie të tjera unike, që rregulloheshin jo si më sipër, por me një kategori tjetër ligjesh republikane, sipas të cilave, krahinat nuk kishin gjithnjë të drejtë të nxirrnin ligjet e veta. Në këtë mënyrë Republikës së Serbisë edhe me amendamentet e reja i garantohej pushtet jo i vogël në legjislacionin krahinor. Krahinës i jepeshin të drejta me vëllim më të kufizuar se republikës. Në çështjet e saj, për gjërat unike, krahina duhej të autorizohet nga republika.<sup>16</sup>

Ndryshimet në Ligjin kushtetues të KSA të Kosovës, Kuvendi Krahinor i miratoi në shkurt 1972. Me amendamentet e reja KSA e Kosovës siguronte të drejta burimore për organizimin e vet, për përcaktimin e politikës ekonomike, tatimore dhe të sistemit të financimit.

Amendamentet e reja federative, duke ngritur në nivel kushtetues parimin e barazisë së kombeve dhe kombësive, e lidhur me këtë, parimin e pavarësisë së republikave dhe të krahinave, bënë që edhe KSA e Kosovës të merrte përgjegjësi për zhvillimin e vet ekonomik, shoqëror e politik, si dhe për funksione të tjera në federatë. Megjithëse amendamentet linin në kompetencat e federatës, mbrojtjen e vendit, sigurimin shtetëror, marrëdhëniet me botën e

jashtme, si dhe kujdesin për zhvillimin e viseve jo mjaft të zhvilluara. Krahina e Kosovës ashtu si edhe republikat ishte bashkëpjesëmarrëse edhe në këto fusha, në sajë të të drejtave që ia garantonte Kushtetuta e RSFJ.<sup>17</sup>

Gjithashtu institucioni i marrëveshjes që me amendamentet e reja u ngrit në nivel kushtetues federativ, e solli në një pozitë dhe rol të ri KSA të Kosovës, si element kushtetues i Federatës Jugosllave. Institucioni i marrëveshjes propozonte që krahinat bashkë me republikat të vendosnin për punët e federatës mbi parimin e ujdisë (konsensusit) d.m.th. që një organ federativ në të cilin merrnin pjesë përfaqësues të republikave dhe krahinave, mund të miratonte një vendim vetëm kur për të jepnin pëlqimin të gjithë anëtarët e tij.<sup>18</sup>

Kushtetuta e re jugosllave e vitit 1974 që funksionoi deri në shthurjen përfundimtare të Jugosllavisë, u siguronte Krahinës Autonome të Kosovës dhe asaj të Vojvodinës, një status të barabartë, në shumë rrafshje me ato të gjashtë republikave. Ato tani kishin përfaqësuesin e tyre të drejtpërdrejtë në forumet kryesore të Federatës Jugosllave.... Në këtë kushtetutë ishin përfshirë edhe ndryshimet e rëndësishme që tashmë ishin bërë pjesë e amendamenteve të miratuara, më 1971: këto u kishin dhënë krahinave autonome status të barabartë me republikat në shumë forma të marrjes së vendimeve për çështje të

---

15. K. Salihu, - Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonomitetit të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në Jugosllavinë Socialiste. Prishtinë, 1984. f. 176.

16. Po aty.

---

17. Noel Malcolm,- Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë. 1998, f. 341.

18. A. Lalaj, - Kosova ...vepër e përmendur, f. 239.

ndryshme shtetërore.<sup>19</sup>

Amendamenti XXXVI përcaktonte se Presidenca e Jugosllavisë ishte një trup kolektiv me dy përfaqësues, nga çdo republikë dhe me nga një përfaqësues, nga çdo krahinë autonome. Kushtetuta e vitit 1974 siguronte edhe një të drejtë tjetër të rëndësishme, sipas së cilës, krahinat autonome mund të nxirrnin kushtetutat e tyre.

Në këtë mënyrë KSA e Kosovës, në bazë të institucionit të marrëveshjes, gëzonte të drejtën për të deklaruar qëndrimin e vet dhe për të dhënë pëlqimin në të gjitha vendimet që miraton federata. Vota e krahinave, në bazë të parimit të paritetit, ishte e barabartë me atë të republikave. Edhe në kuadrin e politikës së jashtme të RSFJ dhe marrëveshjes ndërkombëtare të nënshkruar në nivel federate. KSA e Kosovës kishte të drejtë të nxirrte ligje të reja ose t'i ndryshonte ato ekzistueset, si dhe të bashkëpunonte drejtpërdrejt me institucione të ndryshme të shteteve nënshkruese të marrëveshjes dhe me organizatat ndërkombëtare.<sup>20</sup>

Siç shihet amendamentet e vitit 1971, në pikëpamje juridike kushtetuese, i siguronin KSA të Kosovës disa elemente shtetësie të lidhura ngushtë me to edhe qenien si element kushtetues i Federatës Jugosllave. Por, duke qenë se statusi i elementit kushtetues të federatës ishte kompleks, kërkonte veprimtari intensive praktike të institucioneve krahinore brenda hapësirave të sanksionuara nga legjislacioni i kohës, mund të themi se amendamentet e vitit 1971 krijonin

vetëm mundësi juridike për realizimin e tij. Por, mundësitë nuk janë e njëjta gjë me realitetin. Shkalla e pjesëmarrjes së KSA të Kosovës në përcaktimin dhe zbatimin e politikës së federatës, njësoj si republikat tjera si dhe përgjegjësia që ajo do të kishte për këtë veprimtari, do të duhej të kishte një guxim më të madh të politikës kosovare dhe të një kuadri më të shkathët të Kosovës për t'u bërë rezistencë më të fuqishme presioneve dhe propagandës që vinte nga forcat nacionaliste dhe hegjemoniste të Serbisë.<sup>21</sup>

Pse atëherë nuk u ndërmor edhe hapi i fundit për shndërrimin e krahinave autonome në republika si krahinat tjera? Për këtë ekzistojnë shumë përgjigje, por më e rëndësishmja është se stafi politik i Kosovës, as atëherë por as sot nuk arriti, e nuk është duke mundur të realizojë qëllimin shekullor të shqiptarëve.

#### IV. Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974

Vitet 50-të dhe 60-të, nga këndvështrimi i shqiptarëve, janë pika më e ulët e tërë sundimit të periudhës së Titos dhe e një pabarazie të madhe etnike, e cila nuk u përmirësua, kur dihet se serbët dhe malazezët të cilët nuk e përbënin as 17% të popullatës së Kosovës, në sajë të regjistrimit të vitit 1953, përbënin 70% të administratës dhe posteve udhëheqëse.<sup>22</sup>

Këtyre problemeve ekonomike dhe shoqërore, do shtuar edhe statusin “autonom” të Kosovës, i cili ra në pikën absolute më të ulët në nivel të tij, në sajë të Kushtetutës së re të Jugosllavisë, të vitit

19. Po aty, f. 240.

20. Blerim Reka, - Rrënim i autonomisë së Kosovës, Prishtinë. 1992.

21. Ukshin Hoti, - Filozofia e çështjes shqiptare, Tiranë, 1995.

22. Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë. 1998, f. 336.

1963. Megjithëse kjo kushtetutë i solli Kosovës titullin e Krahinës autonome, e cila përcaktonte se republikat kishin të drejtë të formonin krahinat e tyre autonome në sajë të iniciativës së tyre, kurse Krahina Autonome e Kosovës dhe ajo e Vojvodinës ishin themeluar me vendim të Kuvendit të Serbisë. Për të parën herë, statusi kushtetues i Kosovës, kishte humbur tërësisht ingjerenat e nivelit federativ dhe ishte vënë vetëm në kuadrin e funksionit të Republikës së Serbisë.<sup>23</sup>

Me amendamentet kushtetuese të vitit 1967-1972 u bë një reformë e rëndësishme në marrëdhëniet e federatës me republikat e krahinat, u bë ndarja e funksioneve shtetërore midis qendrës federative dhe njësisive që e përbënin. U rrit funksioni i republikave dhe i krahinave qoftë si subjekte të federalizmit jugosllav, ashtu edhe si bashkësi të veçanta me funksione politike shoqërore.<sup>24</sup>

Mirëpo, amendamentet e miratuara sollën ndryshime vetëm në disa fusha të sistemit kushtetues. Andaj, vënia në jetë e këtyre amendamenteve qysh në fillim hasi në vështirësi që s'mund të kapërceheshin pa një përpunim të mëtejshëm, më të plotë e më preciz të disa çështjeve themelore, si në sistemin politik në tërësi.<sup>25</sup> Për të harmonizuar në nivel federate zgjedhjet kushtetuese të republikave dhe krahinave të veçanta, u krijua Komisioni Koordinues federativ.

Me pëlqimin e kuvendeve të republikave dhe të krahinave për

zgjdhjet bazë, Komisioni Koordinues dhe komisioni ekzistues për çështje kushtetuese, së bashku, në prill të vitit 1973, arritën të hartojnë Projektin e Kushtetutës së re të RSFJ, i cili në korrik u dha për diskutim publik, edhe Projektkushtetutat republikane dhe krahinore.<sup>26</sup>

Në debatin publik që u zhvillua në mjedise të gjera, ku morën pjesë të gjitha strukturat e gjëra shoqërore, kudo pati interesim të madh, siç njoftonin mjetet e informimit në atë kohë. Edhe në Kosovë debati kushtetues u vlerësua nga kosovarët si veprimtari me shumë përgjegjësi.

Pas debatit publik që zgjati më shumë se gjysmë viti, Kuvendi federativ miratoi më 21 shkurt 1974, kushtetutën e re të RSFJ. Disa ditë më vonë secili kuvend republike dhe krahine autonome miratoi kushtetutën e vet. Kushtetuta e RS të Serbisë u miratua më 25 shkurt, kurse Kushtetuta e KSA të Kosovës, më 28 shkurt të vitit 1974. Kjo ishte kushtetuta e parë e KSA të Kosovës.

Kushtetuta e RSFJ e vitit 1974, nuk kishte kapitull të veçantë për krahinat autonome, por ato e gjenin veten në mjaft prej neneve të saj, duke filluar madje që nga parimet themelore mbi të cilat ishte ndërtuar gjithë sistemi ekonomik, politik e shoqëror i federatës. Kushtetuta Federative e përcaktonte KSA të Kosovës si pjesëmarrëse të drejtpërdrejtë në kushtetutën e federatës.<sup>27</sup>

Në kushtetutën e RSFJ të vitit

---

23. Po aty, f. 337.

24. Esat Stavileci, Autonomia dhe federalizmi, Përparimi, Prishtinë 1971, nr. 1, f. 71.

25. Ana Lalaj, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Tiranë. 2000, f. 223.

---

26. Po aty.

27. K. Salihu, Amendamentet kushtetuese vazhdim i politikës së barazisë së kombeve dhe kombësive, "Përparimi", Prishtinë 1971, nr. 4, f. 279.

1974, pjesëmarrja sipas institucionit të paritetit të republikave dhe krahinave në organet federative dhe vendimmarrjet përmes institucionit të marrëveshjes, sanksionohej si në pjesën parimore ashtu edhe në pjesën normative të saj. Në nene të veçanta jepej mënyra konkrete e pjesëmarrjes dhe e procedurës së vendosjes së republikave dhe krahinave autonome në organet e ndryshme të federatës. Por, në dallim nga parimet themelore, në këto nene shihet se pjesëmarrja e republikave dhe e krahinave nuk është plotësisht e barabartë. Ky diferencim fillonte qysh në organin më të lartë të pushtetit dhe të vetëqeverisjes shtetërore, në Kuvendin e RSFJ.<sup>28</sup>

Gjendja e shqiptarëve në Kosovë u përmirësua dukshëm nga vitet 70, e sidomos me nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës, së paku në çështjet e teorisë kushtetuese. Kushtetuta e re jugosllave e vitit 1974, që mbeti në fuqi deri në shthurjen përfundimtare të Jugosllavisë, i siguronte Krahinës Autonome të Kosovës një status të barabartë, në shumë rrafshje me ato të republikave.

Në veprimtarinë legjislativë të KSA të Kosovës, duhet të kemi parasysh që krahas çështjeve që krahina i rregullonte me ligjet e veta dhe në mënyrë të pavarur, kishte edhe çështje të tjera për të cilat shprehej me ligje federative. Sipas Kushtetutës së RSFJ të Jugosllavisë, ligjet federative konsideroheshin shprehje e interesave të përbashkëta të kombeve dhe të kombësive, e si të tilla ato kishin fushëveprim si në republikat e federale, ashtu edhe në krahinat autonome.<sup>29</sup>

Por, në disa fusha që Kushtetuta federative i kishte caktuar “me interes të përbashkët”, krahina kishte gjithashtu të drejtë të nxirrte normat e veta juridike. Fjala ishte për disa çështje e marrëdhënie që krahina me ligjet e dispozitat e veta i rregullonte hollësisht deri atëherë kur për to ende nuk ishin miratuar e nuk vepronin ligjet federative.<sup>30</sup>

Megjithatë, veprimtaria legjislativë e krahinës pas shpalljes së kushtetutës, pavarësisht se pati rritje në krahasim me të kaluarën, ishte nën parashikimet dhe nevojat reale.

KSA e Kosovës karakterizohej nga lidhje e dyfishtë hierarkie. Ajo ishte në të njëjtën kohë element kushtetues i Federatës jugosllave dhe njësi autonome në kuadër të RS të Serbisë.

Kushtetuta e RS të Serbisë, në nenin 299, përcaktonte marrëdhëniet që rregulloheshin njësoj për republikën dhe krahinat dhe për të cilat krahinat nuk mund të nxirrnin dispozitat e veta. Ndërsa neni 300 përcaktonte çështjet që rregulloheshin me ligjin republikan në mënyrë unike për tërë territorin e Serbisë e të krahinave autonome, por ku krahinat kishin të drejtë të nxirrnin ligjet e veta, për ato çështje që nuk ishin rregulluar me ligjin republikan. Në këtë kontekst, jo vetëm për nga vëllimi, por edhe nga terminologjia e papërcaktuar, në Kushtetutën e RS të Serbisë kishte mjaft hapësirë në paraqitjen e funksioneve unike. Të gjitha këto krijonin pasiguri e kontradikta në marrëdhëniet midis republikës e krahinave, pasi linin vend për mëdyshje, duke hapur diskutime të panevojshme e duke gjetur zgjidhje të ndryshme varësisht nga raporti i forcave

---

28. Po aty, f. 226.

29. Po aty, f. 230.

---

30. Po aty.

republikane e krahinore në momentin e vendosjes.<sup>31</sup>

Është e vërtetë e më se e qartë se RS e Serbisë, në emër të unitetit, me anë të ligjeve unike punonte për të ruajtur forcën e saj dhe pushtetin dominues centralist mbi Kosovën, duke zgjedhur kuadro e njerëz me të cilët më lehtë mund të punonte e realizonte qëllimet e saj shtetërore.

Në Kushtetutën e RS të Serbisë ekzistonte edhe një nen tjetër, ai 301, sipas të cilit, me ligjin republikan në bazë të marrëveshjes, mund të rregulloheshin në mënyrë unike për territorin e republikës edhe ato çështje, të cilat republika e krahinat i rregullonin pavarësisht nga njëra-tjetra, secila në territorin e vet. Sipas këtij neni të Serbisë, respektohej vullneti i secilit subjekt, si për nxjerrjen e ligjit unik, ashtu edhe për t'u tërhequr e për të rregulluar këto marrëdhënie me ligjin e vet. Ligjin unik e nxirrte Kuvendi RS të Serbisë, pasi të kishte marrë pëlqimin prej kuvendeve të krahinave.<sup>32</sup>

Për të pasur një përfytyrim më real për shkallën e autonomisë që kishte arritur KSA e Kosovës me aktet kushtetuese të vitit 1974, është e nevojshme që t'i kuptojmë edhe në funksionet e tjera të saj, si në atë ekzekutiv, financiar, gjyqësor, arsimor, e kulturor.

Për zgjidhjen e konflikteve, që mund të lindnin midis ligjeve republikane e dispozitave juridike të kuvendeve krahinore gjatë zbatimit të ligjeve unike, vepronte një Këshill i Posaçëm pranë Gjykatës së Lartë të Serbisë.

---

31. K. Salihu, Lindja... vepër e përmendur, f. 95-99.

32. Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës..., .kap. III.

Në bazë të autorizimeve që rridhnin nga ligji republikan për mbrojtjen e përgjithshme popullore, KSA e Kosovës me kushtetutën e vet ka caktuar organet si dhe detyrat e të drejtat e tyre në fushën e mbrojtjes popullore (Kryesinë e krahinës, Këshillin Ekzekutiv të Kuvendit, Këshillin e Mbrojtjes Popullore, Shtabin Kryesor për Mbrojtjen Popullore e civile, dhe Sekretariatën krahinor të Mbrojtjes Popullore).<sup>33</sup>

Duke qenë se në sistemin politik jugosllav gjykatat ishin organizuar mbi parimet unike, ishte kërkesë kushtetuese që ligjet republikane e krahinore të harmonizoheshin dhe të mos bien ndesh me kushtetutën jugosllave, por të harmonizohen dhe të koordinohen në bazë të sistemit të shumicës.

Gjithsesi, kushtetuta e re e Kosovës, si një proces pozitiv i pas vitit 1966, ka në përmbajtje përpjekjet e përbashkëta të të gjitha kombeve dhe kombësive të krahinës, për të zhvilluar më tej statusin politik, shoqëror e ekonomik të saj.

Për të pasur kushtetutën e tyre, kosovarëve iu është dashur të zhvillonin një luftë të ashpër me forcat nacionaliste e konservatore në Kosovë, në serbi e në Jugosllavi. Në këtë kushtetutë, gjithmonë brenda sistemit ekzistues hibrid të vetadministrimit, ishte shtuar mëvetësia, por edhe përgjegjësia e krahinës për zhvillimin e vet të përbashkët. Pozita e re kushtetuese e KSA të Kosovës e vitit 1974, ishte një segment i përvijimeve përparimtare të kohës. Për këtë qëllim vetë pozita kushtetuese e Kosovës dëshmon procesin demokratik që ndodhte në Kosovë, e në gjithë

---

33. Po aty.

Jugosllavinë. Megjithatë, duhet thënë se problemi i Kosovës nuk ishte vetëm kushtetues, po edhe shumë më shumë sesa kushtetues. Me veprimet e vetë përfaqësuesve të pushtetit në krahina, mund të plotësoheshin shumë boshllëqe midis parimeve të shpallura dhe praktikave të përditshme.

Pavarësisht nga arritjet pozitive për autonominë e Kosovës, që bartte sistemi kushtetues i vitit 1974, ai kishte edhe kufizimet e veta. Parimi kushtetues i barazisë kombëtare që sanksiononte Kushtetuta e RSF të Jugosllavisë për statusin politik të popullit shqiptar, respektivisht të KSA të Kosovës, nuk ishte konsekuent. Kjo shihej në gjithë përmbajtjen e Kushtetutës, po edhe me rastin e ngjarjeve të pas vitit 1981, deri në mbarim të luftës së fundit.

Përmasat e statusit të KSA të Kosovës nuk ishin konsekuente. Përmasat e statusit të KSA të Kosovës, si element kushtetues i Federatës jugosllave ishin të pamjaftueshme për ta zgjidhur drejt e përfundimisht problemin kosovar. Pavarësisht se pozita e KSA të Kosovës në sistemin federativ ishte përcaktuese për statusin e saj, në raportin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi, legjislacioni serb, me ligjet e veta unike, e reduktonte dhe e çrregullonte shumë veprimtarinë e pavarur të krahinës.

Me zhvillimin e një klase të re të shqiptarëve të shkolluar e të edukuar-njëmend, një klasë që ishte tepër e madhe për numrin e vendeve ekzistuese për një personel të këtyllë në sistemin ekonomik ende tepër të pazhvilluar të Kosovës, pabarazia etnike në disa fusha të jetës publike, u korrigjua pjesërisht, ku u desh të kalonte ca kohë për zhvillimin

e këtij procesi deri me amendamentet e vitit 1971.<sup>34</sup>

### Përfundim

Në qoftë se viti 1963 ishte pika më e ulët e interesave kombëtare shqiptare në Kosovën titiste, atëherë viti 1974, ishte kulmi i interesave kombëtare shqiptare, së paku në çështjen e teorisë së të drejtave të një populli. Kushtetuta e re jugosllave e vitit 1974 - që do të mbetej në fuqi deri në shthurjen përfundimtare të Jugosllavisë - u siguronte Krahinës Autonome të Kosovës dhe asaj të Vojvodinës një status të barabartë, në shumë rrafshje me ato të republikave, ku ato tani kishin përfaqësuesin e tyre të drejtpërdrejtë në forumet kryesore të Federatës Jugosllave.<sup>35</sup>

Në këtë kushtetutë ishin përfshirë edhe ndryshimet e rëndësishme që ishin bërë në bazë të serisë së amendamenteve të miratuara, më 1971: këto u kishin dhënë krahinave autonome status të barabartë me republikat në shumë forma të marrjes së vendimeve për çështje ekonomike, madje edhe marrjes së vendimeve në disa fusha të politikës së jashtme. Amendamenti XXXVI përcaktonte se Presidenca e Jugosllavisë ishte një trup kolektiv me dy përfaqësues, nga çdo republikë dhe me nga një përfaqësues, nga çdo krahinë autonome.<sup>36</sup>

Megjithëse Kushtetuta e vitit 1974, vazhdonte të deklaronte se Kosova dhe Vojvodina ishin pjesë e Serbisë, në sajë të shumicës së kriterëve të Ligjit

---

34. Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë 1998, f. 340.

35. Kushtetuta e Krahinës Socialiste të Kosovës ..., vepër. e përmendur, Neni 3.

36. Po aty.

kushtetues, ato ishin në të njëjtën kohë, po të njëjta dhe me të drejta të plota të forumeve federale.<sup>37</sup> Pavarësisht nga arritjet pozitive për autonominë e Kosovës, që bartte sistemi i amendamenteve kushtetuese, ai kishte edhe kufizimet e veta. Përmasat e statusit të KSA të Kosovës, si element kushtetues i Federatës jugosllave, ishin të pamjaftueshme për ta zgjidhur drejt e përfundimisht problemin kosovar<sup>38</sup>.

Edhe pse në sistemin kushtetues të vitit 1974, statusi i popullsisë shqiptare diferencohet nga ai i pakicave të tjera kombëtare, duke u konsideruar kombësi e madhe dhe duke krijuar formën e vet të organizimit politik, shoqëror të Krahinës Socialiste Autonome, ajo nuk e zgjidhi problemin kombëtar të popullsisë shqiptare në Kosovë.

Kosova, përsëri nuk kishte statusin që e meritonin shqiptarët në Jugosllavi. Pavarësisht tendencave për të barazuar në fusha të ndryshme funksionet e krahinave autonome me republikën, pavarësisht të gjitha pengesave që paraqiteshin, Kushtetuta e RSF të Jugosllavisë e vitit 1974, i krijonte KSA të Kosovës hapësira të reja për

një evoluim të mëtejshëm të statutit të saj. Historia e pranon një realitet të tillë evolucionesh që shkojnë drejt tendencave për kërkesa, aspirata dhe përpjekje të popullit të atij vendi për t'u barazuar me popujt shtetformues të një vendi.

Pas vdekjes së Titos dhe ngjarjeve të vitit 1981, statusi shoqëror-politik e juridik i shqiptarëve dhe i vetë Krahinës Autonome të Kosovës erdhi duke u minimizuar. Ky fenomen u forcua dhe u shpejtua pas ardhjes së Millosheviqit si president i Serbisë, më 1985, i cili u mbështet në forcat më konservatore e nacionaliste serbe. I inkurajuar nga heshtja e faktorit ndërkombëtar dhe i republikave të tjera jugosllave ndaj problemit të Kosovës, si dhe për të forcuar pushtetin serb në Jugosllavi, filloi të luajë me kartën nacionaliste që është e njohur si teori e luftërave gjatë tërë historisë, për të sensibilizuar opinionin serb për pozitën e disfavorshme kushtetuese, territoriale, ekonomike e shoqërore të Republikës së Serbisë në Federatën Jugosllave.

---

37. Po aty.

38. Ana Lalaj, vepër e cituar, f. 243.

### Literatura

- Historia e popullit shqiptar IV (shqiptarët gjatë luftës së dytë botërore dhe pas saj 1939-1990, redaktor shkencor, prof. dr. Xhelal Gjeçovi, Toena, Tiranë, 2008.
- Lalaj, Ana, Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes, Tiranë, 2000.
- Malcolm, Noel, Kosova një histori e shkurtër, Prishtinë, 1998.
- Salihu, Kurtesh, Lindja, zhvillimi, pozita dhe aspektet e autonimitetit të krahinës socialiste autonome të Kosovës në Jugosllavinë socialiste, Prishtinë, 1984.
- Hoti, Ukshin, Filozofia e çështjes shqiptare, Tiranë, 1995.
- Hoxha, Haradin, Barazia e pakicave kombëtare, Prishtinë, 1984.
- Pupovci, Syrja, Nuk është shkencë ajo që predikon pabaqëri, Prishtinë, 10 prill 1971.
- Kushtetuta e KSA e Kosovës e vitit 1974, Prishtinë, 1974.
- Kosova në vështrim enciklopedik, Toena, tiranë, 1999.
- Verli, Marenglen, Shqipëria dhe Kosova, historia e një aspiqërate, vëllimi II, Botinpex, Tiranë, 2007.
- Bytyçi, Hysni, Kosova dhe shqiptarët, pozita kushtetuese-juridike e shqiptarëve në ish-Jugosllavi, Prishtinë, 2006.
- Salihu, Kurtesh, Amendamentet kushtetuese vazhdim i politikës së barazisë së kombeve dhe kombësive, "Përparimi", Prishtinë 1971, nr. 4.

# Përhapja e besimit mysliman në rrethin e Pukës ndër vite (1523-1990)

Gëzim Kopani  
Myfti i rrethit Pukë

## Abstrakt

*Përhapja e fesë islame në rrethin e Pukës daton pas vitit 1523. Familjet fisnike të bajrakut të Kabashit bëhen mysliman duke u ndjekur nga Puka, Rrapja, Kryeziu etj. Familja e njohur pukjane "Dizdarë" përqafojnë besimin mysliman duke dhënë kontribut të drejtpërdrejtë në përhapjen e fesë islame në rrethin e Pukës. Pas shek. XVII në fshatin Kabash feja islame u hap me shpejtësi të madhe. Sipas të dhënave, i pari që pranoi fenë islame në fshatin Kabash ishte Hadër Leka. Nopça shkruan se; Kabashi ka qenë i pari fis i Shqipërisë së Veriut që kaloi në Muhamedanizëm. Pas vitit 1900 Kazaja e Pukës numëronte mbi 700 mysliman.*

Sipas dokumenteve osmane të shek. XVI dhe të historisë sonë princi Progon Dukagjini më 1502 hyri në bisedime me qeveritarët osmanë në Shkodër, ku u arrit marrëveshja. Progonit i njihej sundimi mbi Zadrimë. Pas vdekjes së tij, Zadrima do të ishte autonome, hase e Sulltanit. Progoni do të njihte vasalitetin e Sulltanit.<sup>1</sup>

Më 1523 pasardhësi i tij u bë mysliman. Nga Sulltani mori gradën e pashait, duke u shpallur Mustafa Pasha. Nën shembullin e tij, familje fisnike të Kabashit, Pukës, të Pal Mziut e Boçë Mziut, pinjollë të tyre, përqaftuan islam

dhe e përhapen te vartësit e tyre e në popullin e thjeshtë me të cilët kishin lidhje fisnore e shoqërore.<sup>2</sup>

Dihet historikisht se turqit në shek. XVI formuan sanxhaqe me në krye sanxhakbeun me qëllim që ta kontrollonin më mirë situatën politike në Shqipëri. Puka, Iballa e Spasi u shpallen "Nahi"<sup>3</sup> të sanxhakut të Dukagjinit<sup>4</sup> me qendër në Pejë. Në krye të këtyre krahinave sundonin "zotni", agallarë vendas. Agallarët e Pukës, Kryeziut e të Iballës e quajnë veten prej Kabashi.

Defterët apo regjistrat osmane të

2. Prof. Xhemal Meçi "Kabashi që në lashtësi 2".

3. Nahi: Zonë, rreth.

4. Dukagjin: Qyteza e Pukës.

1. Prof. Xhemal Meçi "Kabashi që në lashtësi 2".

shek. XVI janë një pasqyrë e gjendjes së popullatës së regjistruar më 1529, 1571 e 1591, ku shënohen edhe sipas besimit që kanë. Në regjistrimet e para nuk shënohen familje myslimane. Megjithatë, më 1571 “*timarli*”<sup>5</sup> del një farë Sulejmani, i biri i Ilhanit.

Ilhani ishte rojtar në kështjellën e Dukagjinit (Pukë), ndërsa Sulejman Ilhani kishte për shfrytëzim (timare) *Komanin* e *Dobranin*.<sup>6</sup>

Pas 20 vjetësh, 1591, na jepen dy breza me emrat e *Dizdarëve* të Pukës. Konkretisht emri i Ali Mustafë *Dizdarit* e Mustafë *Dizdarit*. Këto funksione në administratën osmane nuk janë në radhën e fshatrave të *Qytezës së Re* të Dukagjinit.

Sipas regjistrimit të vitit 1591 në *nahijen* e Pukës kishte 23 fshatra që kishin 355 zjarre (shtëpi), 11 familje kishin hyrë në Islam, ishin bërë myslimanë. Prej këtyre 11 familjeve, tre ishin prej *Qerretit te Epërm*, dy në *Qerretin e Poshtëm*, një në *Koman* dy në *Shënkollë* (Delmace), një në *Shinpal* (Kabash), dy në *Rrape*, si edhe dy familje me nga një beqar. Por duhet të kemi parasysh faktin së këto të dhëna faktojnë vetëm ato familje të krishtera e myslimane me tokë në ngarkim mbi bazën e së cilës u janë vënë detyrimet.

Në Kabash më 1637 kishte tre familje agallarësh, gjithsej nga 24 familje. Nga këto 12 të besimit mysliman. Në fillim të shekullit XVII besimi mysliman kishte ecur shumë më shpejt se në fund të shekullit XVI.<sup>7</sup>

Kryesorja në dokumentet osmane, si edhe të relatorëve të shek. XVII është fakti se familjet që hynin në besimin e

ri mysliman nuk ishin të detyruara të pranonin këtë fe të re. Nuk del gjëkund përdorimi i dhunës. Kjo duket sidomos në ato familje ku bashkëjetonin të krishterë e myslimanë pa asnjë problem. Në lidhje me këtë ja se si e shpjegon Frang Bardhi<sup>8</sup>: “*Agaj (Dizdari i kështjellës së Dukagjinit) ka tre vllazën të krishterë të martuem dhe një turk, që asht bamë ma vonë. Gruaja e agës asht një e krishtenë e urtë dhe e mirë.*”<sup>9</sup>

Për rreth 40 vjet, fundin e shek. XVI dhe fillimin e shek. XVII pati një kalim të shumtë nga besimi i krishterë në atë mysliman. Kjo faktohet nga relacionet e Ipeshkvit F. Bardhi që shkruan: “*Ky i mbrapshti (Magaroli), shqiptar prej qytetit të Prizrenit, sanxhakbeu i Dukagjinit, pasi e ndërtoi qytetëzën<sup>10</sup>, shumë të krishterë i bani aso kobe turg, disa për frikëm disa me dhurata e disa për tituj. Sidomos në Pukë bani më shumë, kështu aga i sipërthanun meqenëse mori premtimin se do ta banin agë të asaj qytezeje, katolik (fisnik) tua qenë, u ba turk (mysliman) aso kobe.*”<sup>11</sup>

Sipas traditës së përhapjes së besimit mysliman në Kabash, del që myslimani i parë të ketë qenë Hadër Leka<sup>12</sup>. Për arsye se u bë mysliman, dhe për arsye të revoltës së vëllait Koka, Hadër Leka u largua për në Kosovë. Teksa po udhëtonte për në Kosovë, vëllezërit i zunë pritë Hadër Lekës pikërisht teksa po kalonte Urën e Vezirit mbi *Dri*. Ata shtinë mbi të, dhe Hadri ra i vdekur. Fisi i Kabashit e priti keq këtë vrasje. U mblodh kuvendi dhe e la fajtor

8. Frang Bardhi: Lindi në Kallmet të Zadrimës më 1606. Më vonë u bë prift. Në vitin 1653 ai u emërua Ipeshkëv i Dioqezës së Sapës.

9. Kabashi që në lashtësi 2, fq. 94.

10. Rindërtimi i qytetezës u bë më 1608.

11. Kabashi që në lashtësi 2, fq. 95.

12. Vëllai i katër vëllezërve të fisit.

5. Tirmali: Pronë në shfrytëzim, të dhëna me dekret.

6. Dobra: Fshat krahas Komanit.

7. Kabashi që në lashtësi 2, fq. 93.

Kokën duke argumentuar: “*Nuk vritet vllai pse ndrron fenë*”.

Kuvendi gjithashtu vendosi që t’ia hiqte prijën e fisit të Kabashit. Shumë shpejt Kabashi bëhet në shumicë mysliman. Këtë e nënvizon edhe Durham ku Kabashin e quan “*Kabashi mysliman*”.

Ndërsa Nopça shkruan: “*Kabashi ka qenë i pari fis i Shqipërisë së Veriut që kaloi në Muhamedanizëm*.” Përhapjen e besimit mysliman në rrethin e Pukës e faktojnë edhe varrezat mbi 300 vjeçare. Kemi varreza të vjetra në fshatin Kabash, Grykë Hadroj, Rrype (Rrape), Kryezi, Flet etj.<sup>13</sup>

Gjatë shek. XVI dhe pas vitit 1900 *Bajraku i Pukës* numëronte 700 mysliman. Në Kazanë e Pukës – e quajtur edhe Dukagjin – bëjnë pjesë katër fise: Kabashi, Dukagjini, Thaçi e Mali i Zi. Në vitin 1900 kemi 6.300 banorë myslimanë dhe 10.000 katolik. Mirëpo pas një viti kemi shifra krejt të tjera, të cilat e përmbysin këtë situatë. Pra, më 1901 kemi 6.130 banorë myslimanë dhe 4.300 katolikë<sup>14</sup>. Fisi i Kabashit ndahet në dy bajraqe *Puka – Kabashi* (Qelza). Bajraku i Pukës në vitin 1900 numëronte 700 myslimanë – rreth 44% dhe 910 katolikë. Kabashi (Qelza) në vitin 1900 kishte 940 banorë myslimanë dhe po aq katolikë, pra 50%

me 50%, ndërsa në vitin 1916 shifra e banorëve mysliman u rrit në 52%.<sup>15</sup> Po ashtu edhe Kabashi ka qenë një fis i përzier në mënyrë të barabartë.<sup>16</sup>

Në vitin 1923, Myftinia e rrethit Pukë përfaqësohet zyrtarisht me një delegat që mori pjesë në Kongresin e 24 shkurtit të vitit 1923. Puka përfaqësohej nga Xhemal Naipi.<sup>17</sup>

Pasqyra mbi gjendjen e popullsisë myslimane në fillim të viteve 1990 në qytetin e Pukës është 70% mysliman.<sup>18</sup> Fshati kishte 40 % myslimanë. Konkretisht dy qytete kishin 6077 banorë, fshati kishte 44209 banorë. Nga kjo kemi: Qyteti kishte 2734 mysliman ndërsa fshati kishte 17604 mysliman.<sup>19</sup>



### Literatura

Prof. Xhemal Meçi “Kabashi që në lashtësi 2”.

Baldaci, Studime.

Seiner.

Ali Basha, “Nëpër gjurmët e Islamit”.

Ali Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve”.

13. Shënimet e Gëzim Kopani, viti 2006.

14. Baldaci, Studime, fq. 100,101.

15. Seiner, fq. 109.

16. Ali Basha, “Nëpër gjurmët e Islamit”, fq. 504-505.

17. Ali Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve” fq. 127.

18. Përfshihen dy qytete.

19. Ali Basha, “Islami në Shqipëri gjatë shekujve” fq. 216.

## Karakteristikat e stilit kryesor të literaturës boshnjake të shkruar me shkrimin arab

Dr. Munir MUJIĆ  
Bosnjë-Hercegovinë

### Hyrje

*Përbapja e Islamit në Bosnje sollë përdorimin e shkrimit arab në Bosnje përmes veprave dhe librave të ndryshëm të shkruar në gjuhën arabe, osmane dhe perse. Me kohë, shkrimi arab u përshtat për shkrimin në gjuhën boshnjake. Gjatë një periudhe të gjatë, shkrimi i emrave boshnjakë vendas ishte shkaku kryesor i kësaj përshtatjeje. Përdorimi shprehës i shkrimit arab për shkrimet në gjuhën boshnjake vërehet në fillim të shekullit 17. Mënyrat e përdorimit dhe përshtatjes së shkrimit arab në sistemin fonologjik të gjuhës boshnjake ishin shumë të ndryshme. Mënyra e pranuar gjerësisht dhe mënyra e shkrimit u shfaq në shekullin 19, pas procesit të përshtatjes së alfabetit arab të kryer nga dijetari dhe udhëheqësi i njohur fetar, reisi Xhemaludin Çausević. Shumë vepra fetare dhe letrare, si edhe libra shkollorë, janë krijuar në gjuhën boshnjake, të shkruara me shkrimin arab. Disa revista boshnjake janë shtypur me shkrimin boshnjak. Së bashku me shkrimin latin dhe sllav (cirilik), shkrimi arab në Bosnje dhe Hercegovinë është përdorur deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Më shumë se 40 libra me një numër të pakrahueshëm të shpërndarjes, gjysmë milionë, janë botuar në gjuhën boshnjake, të shkruar me shkrimin arab. Në këtë kumtesë, çështja kryesore i është kushtuar dorëshkrimeve të belles letters (letërsisë artistike) në gjuhën boshnjake të shkruar me shkrimin arab, më saktë, karakteristikës së gjinisë kryesore të kësaj letërsie, poezisë fetare.*

**G**juha e poezisë fetare është e afërt me gjuhën e poezisë popullore. Ky është një tipar i kundërt krahasuar me poezinë mistike të krijuar në arabisht, osmanisht dhe persisht e cila karakterizohet nga një stil i lartë. Ndryshe nga poetët e divanit, stili i poetëve fetarë është i thjeshtë dhe gjithëpërfshirës. Kështu që duhet vënë një kufi mes këtyre dy gjinive.

Ndryshe nga poezia sufiste e cila është shkruar në gjuhët orientale, poezia fetare e shkruar në boshnjakisht me shkrimin arab nuk përdor një gjuhë simbolike. Ajo nuk përdor terma metaforike dhe mënyra alegorike të paraqitjes si në rastin e poezisë tipike sufiste. Këto poezi janë shumë të afërta me poezinë didaktike. Dallimi në planin formal është se poema fetare është më e shkurtër dhe ka më shumë kuptim

emocional. Ndryshe nga poemat didaktike, poemat fetare nuk përdorin forma të gjata dhe elemente treguese. Përmbajtja e tyre është e shkurtër, e qartë dhe më etike sesa natyra mistike:

*Tek Zoti i Plotfuqishëm që krijoi gjithçka  
Si do të shkoj unë, si do ta takoj?  
Atë i Cili i dha mendjen dhe shpirtin çdo  
gjëje  
Si do të shkoj unë, si do ta takoj Atë?  
(Sirri, 61)*

Disa nga këngët fetare janë shkruar për të treguar se si një njeri për të jetuar me ndershmëri duhet të pranojë jetën e dervishit dhe t'i përkasë dervishit. Prandaj, disa nga këto poema janë kënduar në rrethe dervishësh deri në ditët tona në Bosnje dhe Hercegovinë:

*Nëse do të bëhesh dervish  
zemra jote do të bëhet e pastër... (Sirri,  
69)*

Poemat me karakter fetar, shprehin kryesisht paaftësinë njerëzore, kërkojnë faljen e gjynaheve dhe udhëzimin në rrugën e drejtë. Vlen të përmendet se poezia fetare përfshin poema të gjata treguese për jetën e profetëve Ismail, Ibrahim, Is'hak, Ejjub, etj. Këto poema janë shkruar nga Muhammed Rushdi. Veç kësaj, aty gjendet një nën-gjini e veçantë e kësaj poezie e quajtur "mevlud". Mevludi është poema kushtuar profetit Muhammed (a.s.) dhe prezantohet nëpër xhami edhe sot. Kryesisht, këto poema të mevludit janë përkthime të poemave osmane të shkruara nga Sulejman Çelebiu.

## Poezi dashurie

Gjenden vetëm disa poezi dashurie në gjuhën boshnjake me shkrimin arab. Megjithatë, duhet të themi se kënga e parë e shkruar në gjuhën boshnjake me shkrimin arab ka një temë dashurie. Kjo këngë titullohet "Hirvat turkisi", që nga viti 1588, dhe është shkruar nga Muhammed Erdeljaç.

Poemat e dashurisë nuk i kushtohen një të dashuri ideal, por një njeriu real, ndonëse emri i saj nuk është përmendur. Për shembull:

*Oh, nusja ime e dashur, ti je shpirti im  
Më mbush mua plot me gaz e hare  
Deri kur zemra ime pushon së qenuri  
Dhe i vë zjarrin lumturisë brenda meje.*

Dashuria në këto vjersha nuk shprehet në kuptimin e ndërsjellë. Aty nuk ka dialog si një shkëmbim fjalësh, ndonëse poema përfshin të dy personat poetikë, një folës (*poeti*), dhe dëgjuesi (*e dashura*). Në vështrimin kryesor të poemës, ne ndeshim të dashuruar i cili i vjen rrotull të dashurës së tij. Këto poema janë të mbushura me tone të ulëta emocionale dhe ndjeshmëri tragjike. Dashuria është perceptuar si një plotësim i pazbatuar. Një shembull unik i poezisë së dashurisë është poema e shkruar nga Fejzo Softa, në të cilën tema e dashurisë është zhvilluar përmes alfabetit arab. Në një mënyrë shumë interesante dhe të stërholluar, poeti e mëson të dashurën e tij në alfabetin arab. Për shembull:

*"Ba" është hëna me një pikë poshtë saj  
Ti je hënë dhe unë jam pikë*

*Për një hënë pika është dritë  
Për një pikë hëna është ngrohtësi*

### Poezia didaktike

Elementet didaktike janë shpërndarë gjatë gjithë letërsisë së shkruar në gjuhën boshnjake me shkrimin arab. Poemat didaktike i kushtohen kryesisht fëmijëve, por ka dhe poema të tjera, si p.sh. “Këshillë gruas” ose “Poemë kundër pirjes së duhanit”. Është e dukshme se këshillat në poemat didaktike janë paraqitur pa kërcënime, kanosje dhe mallkime. Toni është i butë dhe i këndshëm. Kjo mbase është arsyeja se pse këto poema ishin shumë të përhapura në mesin e njerëzve.

Një nga poemat më të famshme të këtij lloji është poema “Abdija”, e shkruar nga Murad Bej Čengić kushtuar kushëritit të tij Abdiut. Kjo poemë është shkruar në vitin 1870. Në të vërtetë, kjo poemë është prezantuar si një varg këshillash:

*Mos mendo diçka  
Mos fol diçka tjetër  
Mos e vrit tjetrin  
E keqja do të të kthehet ty, Abdija (92)*

Veç kësaj, autori tërheq vëmendjen se vlerat e përkohshme nuk mund të jenë më të rëndësishme sesa vlerat e përhershme:

*Vdekja është një dragua  
Ti je vetëm një udhëtar  
Vdekja është një lak tatar  
Qofsh i lumtur Abdija (94)*

Shumë interesante është një poemë e gjatë didaktike me titull “Letra e babait” nga poeti dhe muderrizi Alija Sadiković (v. 1936) - poeti i fundit i mirënjohur i cili shkroi poezi në gjuhën boshnjake me shkrim arab). Në këtë poemë ai këshillon djalin e tij. Kjo poemë mund të konsiderohet si një lloj i poezisë didaktike të shkruar në vargje kushtuar rinisë në përgjithësi. Poeti në fillim jep disa këshilla dhe më pas “përkthen” po të njëjtën këshillë në formën e paraqitjes me aforizma ose të një pasqyrimi poetik. Në poezinë e tij ne gjithashtu gjejmë disa elemente me aforizma. Pasqyrimet dhe krahasimet të cilat janë përdorur për tema diskutimi janë ilustruar me shembuj nga natyra:

*Dubet ta dish, fshikullimi nuk mund ta  
lëndojë bujarin  
Për këtë, shpatat dhe pambukun e butë  
dubet të kujtosh. (114)*

*Ai që urren të punojë fortë, do të dështojë  
me siguri  
Për këtë, dubet të kujtosh bletën mashkull  
që do të vdesë. (117)*

Në fund, duhet të përmendim se poezia didaktike e këtyre poetëve është shumë e afërt me prozën përmes të shprehurit dhe ritmit të saj.

### Poezia shoqërore dhe politike

Poezia e shkruar në gjuhën boshnjake me shkrimin arab na përçon neve imazhe të besueshme të marrëdhënieve në shoqëri dhe problemeve shoqërore gjatë krizës në Sulltanatin Osman në shekujt 18 dhe

19. Poetët qëndruan trimërisht kundër padrejtësisë, tiranisë, korrupsionit, shërbyesve të pamoralshëm, dijetarëve dhe gjykatësve (kadive) të korruptuar fetarë. Ne mund të konstatojmë lirshëm se kjo poezi ishte zëri i njerëzve të zakonshëm në kuptimin e vërtetë të fjalës. Poema më e rëndësishme e këtij lloji është poema “Një kohë e çuditshme filloi”. Kjo poemë mbart një kritikë guximtare të shoqërisë, e cila ishte prezantuar nga Abdulvehab Ilhami, një poet i cili jetoi në fund të shekullit 18 dhe fillim të shekullit 19. Ai paraqiti një kritikë të fortë kundër autoriteteve dhe përfaqësuesve osmanë të autoritetit hipokrit fetar.

*Një kohë e çuditshme filloi  
Çdokush u bë batakeçi  
Çfarë duan ata, për hir të Zotit?!*

.....

*Dijetarë të çuditshëm fetarë ka tani  
Kotësia tani i lavdëron ata  
Ata e shkatërruan veten për pasuri  
Çfarë duan ata, për hir të Zotit?!*

-----

Në një mënyrë të fshehtë dhe të stërholluar, ai kritikon zyrtarët e lartë osmanë, si p.sh. pashallarët, dhe thotë:

*Në mesin e pashave ka njerëz të mirë  
Ai që është i mirë, ai ndjen dhimbje  
Por kur e keqja njerëzit sundon  
I vetmi që di është Zoti*

Poeti Ilhami u ekzekutua nga kryetari turk i Bosnjës, Xhelaludin pasha, më 1822.

Po e përfundojmë duke thënë se poezia shoqërore përfaqëson një thirrje të përgjithshme. Ajo na tregon neve për belatë e njeriut të zakonshëm. Megjithatë, kjo poezi nuk bën thirrje direkte për revoltë kundër autoriteteve. Kjo tregohet qartë në poemën e famshme “Të varfrit boshnjakë shkruajnë një kërkesë”. Poeti Mustafa Firaki e ka shkruar këtë poemë në vitin 1815, kur në emër të popullit boshnjak ai ia adresoi sulltanit, të cilin ai e përshkroi si “Dielli i ndritur”, në fund të çdo vargu:

*Ne po të shkruajmë një kërkesë modeste  
Që ti mund të dëgjosh zërin tonë  
Në lidhje me pasurinë tonë të varfër  
Të cilën e patëm dhe e shpenzuam, për ty,  
dielli i ndritur.*

Përktheu nga gjuha angleze:  
**Ermal BEGA**

## Vehbi Agolli (Dibra) teolog dhe veprimtar i shquar për pavarësi kombëtare

Dr. Mois Kamberi



**V**ehbi Agolli (Dibra) lindi në Dibër të Madhe më 1867 në një familje të përmendur në luftën për çështjen kombëtare, arsimore, kulturore dhe fetare. I ati i tij, Myfti i Dibrës, me kulturë dhe vizion të gjerë, ndikoi personalisht në edukim duke transmetuar tek Vehbiu, dijen, edukatën, traditën dibrane, kulturën fetare dhe traditat atdhetare.

I lindur dhe i rritur në një mjedis të shëndoshë patriotik dhe i ushqyer që në vegjëli me traditat më të mira të familjes dibrane, Vehbi Agolli (Dibra) që në rininë e tij do të hynte në radhët e liderëve progresistë që gjithë jetën e tyre

ja kushtuan çështjes së shenjtë të lirisë e të pavarësisë së atdheut.<sup>1</sup>

Fryma e përgjithshme antiosmane dhe nevoja e shkrimit dhe mësimin të gjuhës shqipe me alfabetin e saj, që përbënte një imperativ në platformën politike të Rilindjes Kombëtare pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, e vunë Vehbi Dibrën, që në fillimet e veprimtarisë së tij politike në opozitë të hapur me Portën e Lartë.

Në vitin 1892, në valën e luftës së përgjakshme antiosmane të popullit shqiptar dhe sidomos të sukseseve të Dibrës kundër pashallarëve osman, Vehbi Agolli (Dibra) zë vendin e të atit pas dorëheqjes së tij për arsye moshe, myfti i Dibrës.<sup>2</sup> Petku fetar nuk e pengoi Vehbiun, të predikojë tek shqiptarët vëllazërim e bashkim, pa dallim besimi.

Tek Vehbi Dibra ishin mishëruar në mënyrë më të plotë organike bindjet e thella të një teologu, filozofi islam, të cilat në çdo rast, sipas parimeve të shenjta kur'anore, janë në një unitet të plotë me parimet e botëkuptimit

---

1. M.H.D, Dr. Adem Bunguri, “*Vehbi Dibra, teolog i madh*”, Peshkopi, 1999, f. 3.

2. Ivzi Shehu, Haxhi Vehbi Dibra (1867-1937), dorëshkrim, Peshkopi, mars 1987.

atdhetar. Veprimtaria klerikale dhe atdhetare e Vehbi Dibrës janë në unitet dhe kanë ecur paralelisht në një rrugë, çka dëshmon se të qenit klerik nuk bie në kundërshtim me të qenit atdhetar, përkundrazi i shërbyen më mirë dhe më shumë çështjes kombëtare.

Vehbi Dibra është një nga ato klerikë që ka marrë pjesë në të gjitha etapat e Lëvizjes Kombëtare dhe ka dhënë kontributin e tij të çmuar në këtë lëvizje. Të qenit klerik i lartë i fesë islame, nuk e pengoi atë për të qenë një atdhetar i shquar.

Pavarësia e Shqipërisë ishte aspiratë dhe punë atdhetare e një kombi të tërë, nga gjiri i të cilit lindën shumë heronj. Midis tyre historiografia jonë duhet të nënvizojë fort emrin e Vehbi Dibrës, njeriut me shumë reputacion në Dibër e në mbarë Shqipërinë, i aftë, largpamës, me nuhatje e drejtpeshim politik.<sup>3</sup>

Është jeta e tij plot ngjarje e bëma për atdhe, që e vendosi Vehbi Dibrën në ballin e Kuvendit të Vlorës. Zhvillimi i ngjarjeve dhe vetë jeta e tij flasin shumë. Ai është ndër promotorët kryesorë të atyre ngjarjeve madhore të cilat çuan në finalizimin e luftës pesë shekullore të popullit tonë, në shpalljen e Pavarësisë. Për të arritur deri këtu Vehbi Dibra ka një aktivitet të gjerë sa atdhetar dhe fetar. Ai është organizatori i një sërë kryengritjesh të cilat luajtën një rol të rëndësishëm në zhdukjen e zgjedhës osmane.

Duke i bërë një vështrim retrospektiv veprimtarisë së tij, si organizator i rezistencës antiosmane, kuvendeve e kongreseve të mbajtura

në Dibër dhe jashtë saj, aktivitet që rriti popullaritetin e tij jo vetëm në Dibër por dhe në krahinat e tjera shqiptare.<sup>4</sup>

Gjatë viteve 1900-1912, Vehbi Dibra është i pranishëm në të gjitha ngjarjet më të rëndësishme të jetës politike, social-arsimore të vendit tonë. Me mendimin dhe qëndrimin e mbajtur, Vehbi Dibra luan rol të rëndësishëm në orientimin kombëtar të tërë jetës së vendit tonë. Në gjirin e kësaj lëvizje të gjerë politike, arsimore dhe ushtarake, ai bashkëvepron me figura të rëndësishme të lëvizjes sonë kombëtare Ismail Qemalin, Isa Boletinin, Hasan Prishtinën, Nikoll Kaçorrin, etj.

Në kuvendin e Dibrës të 27-28 shkurtit 1899, Vehbi Dibra luajti një rol të rëndësishëm, duke dhënë një shembull se si duhej të zgjidhej çështja kombëtare. Ai është jo vetëm një përfaqësues i Dibrës në këtë kuvend, por dhe një figurë me shumë reputacion në delegatët e tjerë pjesëmarrës të këtij kuvendi. Fjala e tij zinte vend sa herë që shprehej. Ndikim të madh pati Vehbiu dhe në vendimet që mori kuvendi i Dibrës i shkurtit 1899.

Vehbi Dibra është pjesëmarrës dhe në Kongresin e Manastirit si përfaqësues i Dibrës. Në këtë kongres ai mbështeti idenë për përdorimin e një alfabeti të ri të gjuhës shqipe me germa latine dhe për mësimin e shqipes në shkollat e Shqipërisë.<sup>5</sup> Më pas, Vehbi Dibrën do ta gjejmë në krye të luftës kundër të gjithë atyre që përpiqeshin për të penguar zhvillimin e kulturës kombëtare shqiptare. Ai do të kundërshtojë me

4. M.H.D, Fondi kujtime, Kujtime të mbledhura nga Ivzi Shehu.

5. Prof. Dr. Qazim Xhelili, Monografi, “Vehbi Dibra”, Tiranë: Albin, 1998, f. 27.

3. M.H.D. Fondi Dosje Patriotësh, *Vehbi Dibra*, dosja, nr. 598.

forcë përpjekjet që bënte rryma islamike për përdorimin e alfabetit arab si alfabet të gjuhës shqipe.

Më 23 korrik 1909, Vehbi Dibra do të vihet në krye të luftës kundër xhonturqve që përpiqeshin të pengonin zhvillimin e kombit shqiptar, bashkimin e tij. Në Kongresin e Dibrës të 23 korrikut 1909, Vehbi Dibra për aktivitetin e tij fetar dhe politik do të zgjidhet pas Ismail pashë Saraçit, kryetar i Kongresit. Ky kongres i kalonte caqet kombëtare, që tregohet nga pjesëmarrja e delegatëve nga vilajetet e Selanikut, Manastirit, Janinës, Kosovës dhe Shkodrës, por dhe e përfaqësuesve serb, grek, bullgar e vllah. Ky ishte i pari kongres ku më tepër se 300 delegatë toskë, gegë, mysliman, ortodoks, katolik, priftërinj, hoxhallarë e shehlerë u takuan në një pikë, shkëputjen e Shqipërisë nga Turqia dhe arritjen e pavarësisë kombëtare.

Atdhetarët Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Kenan Manastirli, Vehbi Agolli, Haxhi Ali Elbasani, Rexhep Voka, Dervish Hima, Sotir Peçi, Feim Zavalani etj., e bënë Kongresin e Dibrës arenë të luftës e shpalesjes së mendimit e kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, kërkesa që ishin nga më të avancuarat të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si rezultat i kësaj lufte kongresi punimet e tij i nisi dhe i përfundoi si një Kongres shqiptar, si një kongres që trajtoi dhe shumë probleme të rëndësishme kombëtare që dilnin dhe jashtë kompetencave të rendit të ditës së kongresit. Në këtë kongres u ngritën probleme me kërkesa të mirëfillta shqiptare ku u shfaqën hapur:

- kërkesat me karakter të theksuar politik kombëtar, që çonin drejt

realizimit të autonomisë së Shqipërisë,

- kërkesat për hapjen e shkollave shqipe të mbrojtura nga shteti,

- futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore,

- çështjen e alfabetit etj.<sup>6</sup>

Punimet e Kongresit, lufta e ashpër politike që u zhvillua aty, provuan plotësisht se kërkesat e delegatëve patriotë ishin një përpjekje e hapur për realizimin e autonomisë së Shqipërisë. Kërkesa të tilla si ajo që nëpunësit e administratës vendase të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend, përdorimi dy gjuhës në dokumentet përfundimtar të tij janë arritjet më të mëdha të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, suksese që nuk ishin arritur në Kongreset e tjera kombëtare.<sup>7</sup>

Pas kongresit të Dibrës të 23 korrikut 1909 në shumë krahina shqiptare të Dibrës, Lumës, Prizrenit, Pejës e Ferizajt shpërthyen lëvizje të reja të drejtuara kundër xhonturqve dhe politikave të tyre që donin të impononin në Shqipëri. Për të shtypur këto lëvizje, xhonturqit ndërmorën ekspedita ushtarake me në krye pashallarët më të shquar.

Kulmin e ngritjes së tij në veprimtarinë atdhetare, Vehbi Dibra e arrin me pjesëmarrjen e tij në Kuvendin e Vlorës dhe zgjedhjen në organet më të larta të Qeverisë së Përkohshme.

Në situatën e krijuar kur forcat Ballkanike po pushtonin Shqipërinë

6. Gazmend Shpuza, "Kongresi kombëtar i Dibrës 1909", Dibër, 2005, f. 32.

7. Kenan Manastirli, "Kongresi i Dibrës", Istamboll, 1912, f. 7.

dhe trevat shqiptare rrezikoheshin nga një copëtim i ri, rrethet atdhetare shqiptare brenda dhe jashtë atdheut, arritën në përfundimin se e vetmja rrugë për shpëtimin e Shqipërisë ishte shpallja e Pavarësisë. Për këtë qëllim do të organizonin një kuvend mbarë kombëtar ku do të merrnin pjesë delegatë të zgjedhur nga të gjitha krahinat shqiptare.

Lajmi mbi mbajtjen e Kuvendit Kombëtar, ndikoi në zgjedhjen sa më shpejt të delegatëve të Dibrës për në Kuvend. Pas zgjedhjes, delegatet e Dibrës do të bashkoheshin me delegatët e Kosovës Mehmet pashë Dërrallën e Ajdin Bej Dragën<sup>8</sup> për tu nisur së bashku për në Kuvendin e Madh.

Telegrame të shumta të dërguara nga Vlora për prefekturën e Elbasanit tregonin interesin e veçantë që kishin organizatorët e kuvendit për zgjedhjen e delegatëve të Dibrës dhe nisjen e tyre për në Vlorë.<sup>9</sup> Mandati i përfaqësimit të Dibrës në Kuvendin e Vlorës ju dha dy burrave të shquar të saj, personalitete me kontribut fetar e politik të gjithanshëm për çështjen kombëtare, Vehbi Agollit (Dibrës) dhe Hafiz Sherif Lëngut, mandate që ua ngarkonte mbarë popullsia e Dibrës dhe e krahinave për rreth për të dërguar fjalën e tyre në Kuvendin Kombëtar në Vlorë. Vehbi Agolli u ngarkua të kryesonte delegacionin e Dibrës, përgjegjësi që atij ia ngarkonte popullsia e Dibrës.<sup>10</sup>

Për të plotësuar këtë detyrë të vështirë, mbledhjen e Kuvendit

Kombëtar, më 21 nëntor 1912, Ismail Qemali arriti në Durrës. Pengesat që u nxorën autoritetet turke për ngritjen e flamurit në Durrës bënë që atdhetarët shqiptarë prej andej të niseshin për në Vlorë. Plaku Ismail Qemali, Luigj Gurakuqi e atdhetarë të tjerë të shoqëruar nga dibrani Nikoll Kaçorri u nisën për në Vlorë. Për organizimin e Kuvendit të Pavarësisë, Vehbi Dibra ishte i njohur nga telegrami që Ismail Qemali i dërgonte Bashkisë së Dibrës që më 18 nëntor 1912. Në telegram thuhet se : “Para së premtes jemi në Durrës. Asht domosdo e nevojshme me u mbledhë delegatët në Durrës ose në Vlorë. Ftoni të tanë. Deri sa të vi unë mbani qetësi e bashkim. Çështja politike jona kryekëput asht sigurue”.<sup>11</sup>

Menjëherë pas caktimit të delegatëve të saj, përfaqësuesit e Dibrës që më 20 nëntor 1912 me anë të një telegrami të firmosur nga Ismail Strazimiri, Sefedin Pustina, Shyqyri Beu, Vehbi Agolli e Muharem Ballçishta informonin Elbasanin se delegatët e Kosovës dhe Dibrës kanë për t’u nisur prej këtu.<sup>12</sup> Po këtë ditë Bashkia Dibrë njoftonte Vlorën se përfaqësuesit e tyre ishin zgjedhur dhe pas bashkimit me delegatët e Kosovës, nesër do të niseshin prej këtu për të marrë pjesë në ngritjen e flamurit.<sup>13</sup> Më 21 nëntor 1912 Isa Boletini, Ajdin bej Draga, Mehmet pashë Dërralla dhe delegatët e zgjedhur të Dibrës, Vehbi Agolli dhe Hafiz Sherif Lëngu, u nisën nga Dibra

---

8. A.Q.SH.-Fondi 245, D. 2, viti 1912.

9. A.Q.SH.-Fondi 71, D. 1, Përkthim nga turqishtja.

10. Zani i Naltë, viti 1937.

11. A.Q.SH.-Fondi 71. D.1, dok. 10307, Përkthim nga turqishtja.

12. A.Q.SH.-Fondi 245, D. 12, dt. 22 nëntor 1912.

13. A.Q.SH.-Fondi – 245, D. 2, f. 6, viti 1912.

për në Elbasan<sup>14</sup> ku i prisnin delegatët e kësaj treve për të shkuar së bashku drejt Vlorës.<sup>15</sup>

Ndërsa delegatë nga të gjitha krahinat e tjera shqiptare grupoheshin dhe së bashku niseshin për në Vlorë, disa qyteteve shqiptare që rrezikoheshin nga pushtimi i shteteve fqinje iu kërkua nga rrethet patriotike që të ngrihej flamuri kombëtar me qëllim që pushtuesi i ri t'i gjente të pavarura. Por gjendja në Dibër në këtë kohë si rezultat i marshimit të ushtrive serbe ishte mjaft e nderë. Dibranët duhej të përballonin jo vetëm situatën e krijuar nga sulmet e ushtrive të shumta Ballkanike por të bënin përpjekje dhe për të ngritur flamurin kombëtar në zonat që rrezikoheshin nga pushtimi.

Ndërkohë që ushtritë ballkanike po marshonin drejt Shqipërisë së Mesme dhe dibranët ishin të përfshirë në një luftë për jetë a vdekje, plaku Ismail Qemali ishte i shqetësuar se a do të arrinin në kohë në Vlorë përfaqësuesit e Dibrës. Ai vazhdimisht pyeste: “A kanë arritur dibranët? A kishte ardhur Vehbi Agolli?” Me gjithë pengesat e nxjerra gjatë rrugës, delegatët e Dibrës arritën në Vlorë në kohë, disa orë përpara se të fillonte punimet Kuvendi i Madh më 28 nëntor 1912. Midis 37 delegatëve<sup>16</sup> dalloheshin delegatët e Dibrës Vehbi Agolli, Sherif Lëngu dhe Nikoll Kaçorri.

Përballë kërcënimit të ri të pushtimit nga ushtritë Ballkanike dhe situatës së re të krijuar për trevat shqiptare, plaku Ismail Qemali dhe atdhetarë të

tjerë të mbledhur në Vlorë, hapën më 28 nëntor 1912, ora 14.<sup>00</sup> punimet e Kuvendit Kombëtar për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, pa pritur ende të gjithë delegatët e krahinave shqiptare për shkak të vështirësive të mëdha që ekzistonin. Që në mbledhjen e parë të Kuvendit, dibrani Nikoll Kaçorri do të deklaronte: “Në qoftë se kemi për të vdekur nesër, të vdesim sot. O flamur, o vdekje. Flamurin ta ngremë sot”. Mendimi i tij u mbështet nga të gjithë delegatët të cilët me në krye plakun Ismail Qemali e shpallën Shqipërinë shtet të pavarur: “...Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë e mosvarme”.<sup>17</sup> Menjëherë pas ngritjes së flamurit dhe shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali me telegramet dërguar ”krerëve të Bashkive të Elbasanit, Dibrës ...etj. dhe parisë së këtyre krahinave, udhëzonte që të merrnin masa për shpalljen e pavarësisë dhe sigurimin e rendit e qetësisë”.<sup>18</sup> Por këto telegrame nuk arritën kurrë në Dibër. Një ditë para se të shpallej pavarësia, më 27 nëntor 1912, ushtria serbe sulmoi përsëri Dibrën në befasi nga Gryka e Radikës dhe u shtri në të gjithë pjesën lindore të Drinit të Zi. Më 27 nëntor 1912, Dibra u pushtua nga serbët.<sup>19</sup> Me pushtimin e Dibrës një ditë para se të shpallej Pavarësia, serbët shpresonin të realizonin aneksimin e saj. Po në këtë datë arriti në qytetin e Dibrës së Madhe një letër e firmosur nga Ismail Qemali, me anë të së cilës porosiste dibranët që menjëherë në këtë qytet të ngrihej flamuri kombëtar. Të nesërmen,

---

17. Histori e Popullit Shqiptar, Vëll. II, Tiranë: Toena, 2002, f. 511.

18. A.Q.SH.-Fondi 71, dok. 723/1, viti 1912.

19. Gafur Zota, Dibra dhe etnokultura e saj, vëll. I, Dibër, 1995, f. 288.

14. A.Q.SH.-Fondi – 245, D. 2, f. 6, viti 1912.

15. A.Q.SH.-Fondi 32, D. 26, f. 133.

16. Valentina Duka, “Histori e Shqipërisë 1912-2000”, Tiranë: Shblu, 2007, f. 19.

kur në Vlorë, Kuvendi Kombëtar kishte shpallur pavarësinë, patriotët dibranë i dorëzuan dokumentin e ardhur nga Vlora dhe të firmosur nga Ismail Qemali komandantit serb duke i kërkuar atij që ushtria serbe të largohej menjëherë nga qyteti. Komandanti serb nuk e përfilli aspak këtë kërkesë të drejtë e legjitime të dibranëve.<sup>20</sup> Ky qëndrim mospërfillës i komandës serbe e rriti në një shkallë të pa përmbajtur revoltën dibrane dhe kudo në krahinat e Dibrës filluan përgatitjet për një kryengritje të re.

Interesimi i veçantë për përfaqësimin e Dibrës në Kuvend nga Ismail Qemali nuk ishte i rastësishëm. Dibra dhe dibranët gjatë gjithë zhvillimeve historike shqiptare kishin qenë në qendër të tyre, atje ku rreziku ishte më i madh dhe ku ishte më e domosdoshme ndihma dibrane, pa të cilën nuk mund të arriheshin fitore. Dibranët qenë të suksesshëm dhe pengesa kryesore në realizimin e qëllimeve të pushtuesve në luftërat kundër ushtrive turke, serbe, bullgare, malazeze e greke. Dibranët qenë faktor përcaktues në këto luftëra të vazhdueshme të shqiptarëve për autonomi, në kryengritjet e viteve 1909-1912 dhe në shpalljen e pavarësisë.

Për meritat e Dibrës dhe dibranëve, të figurave të saj popullore e atdhetare gjatë gjithë veprimtarisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, përfaqësuesit e saj në Kuvend u zgjodhën në organet më të larta të përfaqësimit të qeverisë

Shqiptare që u krijua pas Ismail Qemalit. Në mbledhjen e dytë që u hap më 30 nëntor 1912, me propozim të Luigj Gurakuqit, Vehbi Agolli u propozua të zgjidhej kryetari i Pleqësisë shqiptare (senatit). Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi edhe Pleqësinë prej 18 anëtarësh. Kryetar i pleqësisë u zgjodh Vehbi Dibra.<sup>21</sup> Në Kuvendin e Vlorës, Vehbi Agolli bëri dhe betimin e flamurit dhe dha Fet'fanë për shpalljen e pavarësisë. Kjo që zgjedhja e dytë e një atdhetari dibran në postet më të larta të qeverisjes pas zgjedhjes së Dom Nikoll Kaçorrit si nënkryetar të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës.

Haxhi Vehbi Dibra, ishte sa një misionar fetar aq dhe një patriot i shquar i kombit. Kultura dhe formimi i tij i gjerë e bënë atë të kërkonte një fe pa absurditete dhe vulgaritete, një fe racionaliste e utilitare. Si kryemyfti i përgjithshëm dhe kryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar për disa vjet, ky patriot i shquar dhe teolog i formuar dha një kontribut të vyer në reformimin e këtij komuniteti duke e çuar deri në shpalljen e mëvetësisë së tij, si dhe për përputhjen e fesë islame në interesat kombëtare.

Për zgjuarsinë dhe potencialin intelektual që e karakterizonin, ai është vlerësuar nga qarqet intelektuale e fetare të vendit dhe të huaja si një mendimtar i thellë, teolog dhe një dijetar në kuptimin e vërtetë të fjalës.

---

20. A.Q.SH.-Fondi 143, Dosja nr. 857, viti 1878-1912, dok. nr. 8.

---

21. Valentina Duka, "Histori e Shqipërisë 1912-2000", Tiranë: Shblu, 2007, f .24.

## Tefsiri i sure-i Ihlasit

H. Ali Korça

### Tefsiri i sure-i Ihlasit (i tevhidit)<sup>1</sup>

**K**ëjo sure përshtjellë shtyllat ma të forta qi pegamberlliku i Muhammed Mustafajt për mbi ato asht ngrehun te cillat janë tri:

I- Shtylla e parë t'a njitosh t'a dlirtç Zotin nga të metat e çfarësive (sifate) q'i pështetin bota. Këjo quhet Tevhid.

II- Të vendosç gjith kufitë për me punue punët e me u rujt nga të këqijat. Ky kufizim quhet SHERIAT.

III- Janë gjindjet e pësimet e shpirtit te cilat kanë me ngja mbas ringjalljes, si shpërblim mirësjie e keqësjie e tj. Këjo quhet Iman bilgajb.

Shtylla e parë (Tevhidi e tenzihi) njiuëmja e delirtja qi me anën e të cillës Arabët do të qitshin nga shiqri e tshbihi d.m.th. do të shpëtojshin nga besimi i disa perëndish dhe nga e përgjasmja ZOTIN e vërtet në figurat e krijueme.

1. Myfes-siret thonë se, sebepi i zbritjes asht ky: Myshriqet Zotin e besofshin se mos asht prej guresh të pa ç'mueshim a prej metalesh. Pra kur u pyet peigamberi se ZOTI prej se asht, zbriti këjo sure e cila e deliri ZOTIN nga besimet e kota të tyne.



Ja këjo asht ma e madhja shtyllë qi mbi atë pështetet besimi (Imani) e cila kishte, me i ftue si Myshriqët e Arabisë ashtu dhe libër-patsit fetare t'atjeshëm edhe gjith botën me e njiuëm Zotin e math. Këjo sure qi përmban vetëm nji rresht fjalë ka katër ajete. Këjo surë asht fort e shkurtë por si merret vesht mbas haditheve barasonet me nji të tretën e Kur-anit. Dihet fort çiltaz e sigurisht se aji qi e kupton mana-ne (kuptimin)

e Ihlasit si lypset, aji qi hyn mbrenda në thelbit të kësajë sures me një kuptim të thellë e të pa dyshim nuk i mbetet nevojë për të tjerat, por edhe në këndoft ajetet e tjerë të tevhidit i këndon vetëm e vetëm për me e zgjanue ditunin e parë.

ZOTI i vërtetë n'ajetin e parë urdhëron (.....) O i dashuni im i ndershmi i dërgueshmi im Muham-med! Thuej se lajmi qi po ju jepet asht një lajm i vertet' i forcuem me dishmija të sakta. Nd' ajetin e dytë urdhëron (.....) Zoti asht një i vetëm. S'asht i përziem nga trupet e ndryshëm. Nuk asht as landë as nga rranjët të ndryshme të pa landshme ashtu si po e pandehin disa zot feshe tue thanë se Zoti ka dy rranja a Zoti ka tri rranja e i perzijnë të cillat i numrojn një. Por njeriu u mentoka s'u mentoka si dyja ashtu edhe trija janë shumë, pra kurrë kurrë s'bahen një.

Përse Zoti asht i vetëm një e jo i përziem?

Se gjith ata qi kanë ment në krye' janë të kuptueshëm' i thonë vehtes intelektual dhe inteligjen janë dakord' gjith janë në një gojë tue thanë se krijuesi i gjithsis asht Zoti i vërtet i cilli qenjen'ndodhmenin e ka prej vetvehtes (!) dhe për me e pat ndodhmenin prej vetvehtes mbas mendjes të kthiellt vetvehtja e tij të jetë i vetëm (Vehdeti Dhat). Vetvehtja e tij të ishte shumicë duhesh t'ish i përzie edhe t'ish i përmbledhun prej shumë copash. Ahere as këjo përmbledhja e shumicës nuk mundet të quhet krijues e ZOT as këto copët nuk munden të quhen zotna me vehte. Sepse të gjitha janë të krijueshme.

Edhe ndrydhet e kësajë gjithësis (Zerr-rrati qainat) sa na i merr mendja, sa na i ndejnë e na i kuptojnë pes

ndjenjat t'ona, qi të gjitha janë futun në një rregullim të mbarueshim edhe ashtu jana lidhun njena me tjetrën sa mendjet ma të nalta e ma të fellta habiten. Pra edhe këto sende na tregojn se Zoti, krijuesi asht një i vetëm. Sa për fjalët qi thuhen se ZOTI asht prej dy rranjesh a prej tri rranjesh, këto s'janë tjetër veç se hajalate (Imazhinazione) të kota.

Për me i besuem këto pralla si thotë M. Geuteja duhet me i qit trutë krejt.

ZOTI ndër ajetin e dytë urdhëron: (.....) Gjith nevojat i sillen e i pështeten vetëm ZOTIT. SAMED i thuhet një zotnije qi për me i ba ballë nevojavet të sikushit q'i sillet e i peshtetet ati, fjala SAMED asht një fjalë aq shumë kutpim-përmbledhëse sa njeriut për atë mëjtim q'ushqen pa hequr as pak mundim e merzi gjith qëllimet e tija ja mbush. Ky ajet pa na tregon se të gjitha të shkakëtuet (Mysebebat) ZOTIT i pështeten edhe ç'do gja në këtë jetë (Meuxhudat) të gjitha janë të krijuëmet e tija. Njeriu e me (esbabet) me veglat e shkaqet mbas fuqisë të vet dyke u pështet në ndihmën e ZOTIT punon një punë edhe për mbarimin t'i siellet e ti pështetet vetëm ZOTIT. Nevojari duhet t'i përfshijë shkaqet e veglat e përkatëshme pastaj t'i sillet ZOTIT drejt për së drejti e t'i kërkojë ndihmë pa ndërmjetsue askushin, se ZOTI asht i vetmi zgjedhësi i punës vetëm ay t'a kryen atë punë qi s'ta kap as fuqija as mendja t'ate. ZOTI me fjalën SAMED po thërret njerzin që t'i luten ati drejt për së drejti e jo si kujtojshin myshriqet arab të cilët, kur do ti luteshin ZOTIT ndërmjetësojshin putnat si urdhënon ZOTI në Sure-i Tenzil: Kur u thuhesh myshriqevet të cilët kishin adoptue

putnat miq edhe ndërmjetës, :(Përse u faleni putnavet?) ata përgjegjeshin: (na nuk i falena putnavet se po i njohim si perëndi po u falena se ata shtatet të ndërmjetësohen te ZOTI i math e kështu të na afrojnë ma tepër).

Në Buhar-i sherif ashtu dhe në shifa i shifet ky Hadith: (Mas vdekjes t'ime mos ma adoptoni vorrin t'em si pute. Mos më njihni Zot. Mos m'u falni. ZOTI i ka mar në gazebe ata kombe që vorrin e profetëve të vet e paten adoptue falisht e u faleshin si i faleshin ZOTIT.) Ndodheshin shumë njerës që njëfnin një fe edhe ata përfaqe të zez kujtojnë se kryetarët e tyre gjoja pranë ZOTIT paskan nga një gradë të madhe edhe me ndërmjetësin e tyre paskan me i mërrit qëllimit dhe dishirit të vet edhe kështu sikur gjindeshin gjallë ashtu edhe mbas vdekjes së tyre u shkojnë nepër vorre dhe u rrinin më kamb e u luteshin si u luteshin ZOTIT të vërtet. Ngaj ky shkak i madhi profet nga ky adoptim po na largon. Njeriu kur e kupton një çështje duhet me pyet të kuptueshmin edhe me i kërkue dishmite e sakta e jo me punue kuntra qitabit të ZOTIT e kundra urdhënit të pejgamberit.

ZOTI me fjalën e parë t'ajetit të tretë urdhëron (.....) dhe e pastron vehten e vet nga pjellja edhe na tregon mendjen e kalbët t'atyne që thonë se ZOTI ka birë e bija sikundër thojshin myshriqet e arabisë dhe Hindjanët etj. Edhe me këtë fjalë na difton se ZOTI po të kish bir e bija duhesh të pille d.m.th. duhet të çillesh e të mbylles.

Pjellja rrjedh prej ati të gjallti që ka mizaxh (melange) dhe ay që ka mizaxhe asht i përzie prej copnash edhe siç di i përziem së fundi ka me u çkrie, ka me u fik edhe me u shduk krejt. Por ZOTI i vërtet nga këto asht i pastër ZOTI me fjalën e dytë (.....) të këtij ajeti të tretë na tregon çeltazi se janë krejt të kota fjalët e atyne që pandeshin tue thanë se ZOTI ka bir, edhe aji asht ZOT si i ati, duhet me i u fal birit ashtu si atit të vetë. Pale disa tue kalue kufinin thojshin se ZOTI ka edhe një mëmë fuqi plotë. (Hasha). Them i pjelli asht i çpikun edhe ka një melange (Mizaxh) fundi i fundit domosdo ka me u çkrie e me u çduk. Hindjanët Budist thonë se ati me gjithë birin e vet janë ezeli, eternel (pa misje) vetvetiu, janë të ndodhçin e të qenshim të cillat s'mundet me i pranue mendja e shëndoshtë.

ZOTI n'ajetin e katertë (.....) urdhënon edhe na largon prej atyne besimeve të kalbëta e të shkretueme që ushqejshin myshriqet. ZOTI na urdhëron se nuk ka asnjë përngjases, asnjë shoq që t'i shëmbëllej në punët edhe në fuqitë të vet ashtu si besojshin Mexhusitë tue thanë se edhe dreqi ka një fuqi ndër vehte si ZOTI (Hasha). Ky ajet gjithë shirquet, gjithë shoqënitë e gjithë besimet e kota i shporr dhe me këtë ajet ngref gjithë rregullat rranjore të njisisë e pastrisë të madhësis të ZOTIT.

Thuhet se kjo Sure fshtjell dhe pes' ajete.<sup>2</sup>

2. Artikulli i Hafiz Ali Korçës i marrë nga revista "Zani i Naltë", nr. 3, viti I, 1923, f. 67 – 74.

## Vargje nga Sheh Ahmed Shkodra

Zoti na ka thanë,  
Shpirt e pasuni me dhanë,  
Atdhetarit me i ndihmue,  
Nderë e fe me shpëtue.

Kush e don kombësinë,  
Ka dashtë Perëndinë,  
Anmikun largon,  
Din edhe gëzon.

Sille vedin mbarë,  
Banu atdhetarë,  
Puno për kombësi,  
Besim e liri.

Lutena Zotit pa pushue,  
Kët Shqypni me na e zgjanue.

Herët fort jam atdhetar,  
Nuk e due kush asht tradhtar  
Unë një herë kam ba be  
Për besim e për Atdhe.

Të gjithë shqyptartë janë fetar  
Me fe zbashkut atdhetar.

Gjith shqiptari një kombisije  
Me dy anë jena vllazni  
Të gjith zbashkut me punue  
Atdheu si me përparue.

Pse nuk jena një me fe  
Jena vllazën për Atdhe  
Lutem Zotit pa pushue  
Për këtë jetë me na bashkue.

Besën e nderin të kam qitë,  
Drue se pendohna një ditë  
Atdheu sqindron pa besim  
Zoti na vuftë në rregullim.

Shoqi shoqin ta shtrëngojmë  
Për atdhe bashkë le të punojmë  
Mos të ngatërrohena për besim  
Atëherë kena përparim.

## Abstracts in English

### Islamic science

#### 1. What is Islam?

**H. Ali Kraja**

##### Abstract

It is true that Islam is not a new faith, but it is eternal. People can accept or throw it, but it always remains a true faith, being aware that faith acceptance is of a great benefit for the humanity. Islamic faith never lost, but like the science sometimes lose its value because of people's ignorance, the Islamic faith have lost its value in the recent years too. No matter what people say or desire, but God is a caring Creator of everything.

#### 2. The worship in the Prophet Muhammad life

**M.A. Elton Karaj**

##### Introduction

If we take into consideration the first meaning of the word ibada, then we can say that Prophet Muhammad's entire life was focused on this objective's fulfillment... It must be said that Hz. Muhammad (a.s.) was extremely devoted in his worship acts. When observed the Prophet Muhammad's devotion, every human being thought that during all his life, he haven't done anything else but worship. In this aspect, nobody can be compared to him. During salaah, he experienced the deepest worship process and he felt and expressed so strongly it, that there were no salaah act during which he didn't shudder and shed tears.

#### 3. The Islamic message – An embracing religion

**Muhamed Teufik Ahmed – Egypt**

##### Abstract

Islam is the religion of all humans, it calls for equality of all people before their Creator. Despite the various countries in which they live, they should cooperate with each other through good mutual relationships where the rich helps the poor.

All these mutual obligations constitute the system of social existence. Each division and discrimination in base of race, color or culture doesn't come from Islamic principles. All people in Islam constitute a family made up of blacks and whites, all of these brothers with each other.

### Studies

#### **4. The interfaith tolerance and understanding as a dimension of the Albanian national history**

**Prof. Dr. Ferit Duka - UET, Tirana**

##### **Abstract**

The data obtained from various historical sources clearly prove the existence of tolerance and peaceful coexistence between Albanian people of different faiths. The Albanian National Movement for liberation from Ottoman rule and the establishment of independent national state, is a very significant example of the sincere cooperation and without prejudice of patriotic intellectuals and activists who regardless of religious, gave a decisive contribution to political and cultural affirmation of the Albanian nation.

#### **5. The deportation of the Albanian people to Turkey (1937-1941) and the role of the Islamic Community in its prevention**

**Qerim Lita – Skopje**

##### **Abstract**

The Islamic Religious Community in the Kingdom of SCS (Yugoslav), respectively the Ulema Majlis of Skopje, which included all Albanian territories under Yugoslavia, played an important role in the organization of the Muslim population. Based on this fact, that time government of Yugoslavia, saw in this organization, see a robust «Alete» (gadget) for the implementation of their obsolete plans as: the assimilation of Muslim population especially the Albanian and Turkish one; the violent expulsion of this population to Turkey and colonization of these regions with Slavic colons.

### Sociology-Philosophy

#### **6. The philosophy of Madrasa's educational system in Albania**

**Doc. Genti Kruja - Director of Culture – Muslim Community of Albania**

##### **Abstract**

The problems of education and tuition have preoccupied many philosophies, religions, thinkers, scholars and political systems in different times and places of the world. Education and tuition today is one of the main pillars of society, because in many countries and areas where it is absent or misused, there exist social problems, which often cause social crises, conflicts and even wars.

So, today through a better-seeking education and education, where the sciences are interwoven with the values of faith, especially with the norms and principles of Islam, we will have a healthier society, morally and spiritually, from which will radiate peace, understanding and coexistence without distinction of race, sex and religion. This model is currently applied with a great success in the madrassas of Albania, which in recent years have confirmed the success and achievements thesis through a very good level of their students.

## **Communication Science**

### **7. The communication through Islamic worship places in Albania**

**Msc. Ferit Lika – Muslim Community of Albania**

#### **Abstract**

In these cult objects it was communicated and still continues to communicate the human need to study, to be educated to be learned, for gaining knowledge is a primary duty of every Muslim, because the essence of Islam itself is learning and conveying knowledge...

The massive flows at mosques after the collapse of communism showed that believers strongly held religious convictions of their own, despite the persecution. All those religious patriots who opposed the destructive ideas of that regime were persecuted, killed and slaughtered in the most inhumane way, but even this could not tear the roots of faith in our country.

## **Political Science**

### **8. Is Islam compatible with democracy?**

**M.S. Fatos A. Koplaku – Ann Arbor, Michigan, USA**

#### **Abstract**

Islam agrees with any form of governance, democracy or whatever it might be called, as long as the state does not interfere with every detail of social and personal life, dictating with the razor of laws and regulations the way it should be lived. Muslims would heartily agree with the American poet and philosopher Henry David Thoreau when he says that «That government is best which governs the least.»

It is very important, especially, to Muslims that religion, the re-binding with the Divine, is not harmed or manipulated by the state intervention. Rumi says that «A house without windows is hell. The mission of religion is to open a window», and this means that any state intervention, or of any organization for that matter, to bend religion according to its own agenda, means the narrowing of this providential window (shut completely by the communists) and a step closer towards an infernal house or space.

## **History**

### **9. Balkan Wars**

**British Consular Reports from Macedonia in the last years of the Ottoman Empire**

**Myzejen Myftari - Tirana**

#### **Abstract**

The Balkan Wars, British Consular Reports from Macedonia in the Final Years of the Ottoman Empire” is the most recent book that the Albanian historian and researcher Bejtullah Press brings into the readers hands due to a close collaboration with the scholar Robert Elsie.

**10. The constitutional position of Kosovo in the Yugoslav Federation during 1946-1974**

**(A historical view)**

**M.A. Ramadan Shkodra – Kosovo Islamic Community**

**Introduction**

After World War II, the objective course of events that lead to the solution of the Kosovo issue, was interrupted. Kosovo's Albanian population faced pressures, fraud and violence by Yugoslav communist leaders, especially those Serbs. Their promising statements about the self-government of the Albanian people were forgotten after the war. While Kosovo Albanian partisan brigades marched northward and fought alongside the Yugoslav peoples for the entire liberation of Yugoslavia, the Albanian population in Yugoslavia experienced a fierce national repression, arrests, terror and persecution, where was banned also the use of the national flag, Albanian officials were fired and replaced with those Serbs.

**11. The propagation of Muslim population in the district of Puka over the years (1523-1990)**

**Gëzim Kopani - Mufti of Puka district**

**Abstract**

The propagation of Islam in the Puka district dates back since 1523. The noble families of Kabashi Bayrak were the first who became Muslims followed by Puka, Rrapja, Kryeziu etc. The Puka's well-known family «Dizdari» embraced early the Muslim faith contributing directly to the propagation of Islam in the entire district of Puka. After the XVII century in Kabashi village, Islama was propagated with a great speed. According to the data, the first who accepted Islam in Kabashi village was Hader Leka. Nopcsa wrote that Kabashi was the first tribe of northern Albania who converted in Mohammedanism. After 1900, the Puka Kazaa numbered over 700 Muslims.

**Translations**

**12. The main characteristics of the style of Bosnian literature written in Arabic alphabet**

**Dr. Munir Mujić – Bosnia and-Herzegovina**

**Introduction**

The spread of Islam in Bosnia brought the use of Arabic script in Bosnia through different works and books written in Arabic, Ottoman and Persian. By the time, the Arabic script was adopted for writing in Bosnian language. Over a long period, the local Bosnian names writing was the main cause of this adaptation. The use of writings in Arabic script for Bosnian language for expressive purposes was observed in the early 17-th century. The methods of using and adapting the Arabic script in the Bosnian language phonological system were very different.

**Personalities**

**13. Vehbi Agolli (Dibra), an outstanding preacher and activist in field of national independence issue**

**Dr. Mois Kamberi - Durrës**

**Abstract**

In Vehbi Dibra were embedded in the most comprehensive organic way the deep convictions of a theologian and an Islamic philosopher, which in any case, according to the principles of the holy Quran, are in complete accordance with the principles of the patriotic worldview. The clerical and patriotic activity of Vehbi Dibra are compatible with each other and have developed parallely in the same direction, what indicates that being a cleric is not inconsistent with being a patriot, rather it served better and fully to the national issue.

**Retrospective**

**14. Tafsir of Surah al-Ihlas**

**by H. Ali Korça**

**15. Verses by Sheikh Ahmed Shkodra**

## Rregullat e shkrimit

Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere.

2. Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.

3. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt i shkurtër, duke radhitur të gjitha nënçështjet.

4. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje në varësi të tematikës që shtron.

5. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat, që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij.

6. Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data – Muaji – Viti, titujt e nënçështjeve do të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.

7. Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet.

8. Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe Bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 10 referenca dhe vepra.

9. Çdo artikull duhet të ketë footnote-a dhe referenca për çdo material dhe autor që ka studiuar dhe referuar duhet vendosur në formë citati, në thonjëza, shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë.

10. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë, autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, faqen nga është marrë citati.

11. Nëse autori është konsultuar me një site interneti duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë: p.sh. akses më 10 Maj 2008. Në fund të footnote-s vendoset pikë dhe footnote-a jepet me «Justify».

12. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.

13. Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”. Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me “ë” dhe “ç”.